


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

514-31

N 38



*Apostol Nasi*

**KRESHNIKASIT**

*Roman*

8JH-3/  
1426

# Apostol Nasi

**KRESHNIKASIT**

Roman



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



1942  
1942

Apostol Nazit

---

Redaktor:  
Dhimitër Gjoni

KRESHTIMKASIT

Romani



SHTETI BOTUESI - NAIM FRASHËRI

*Ky ishte një aksion tepër i guximshëm.*

*Rrugën për në Kreshnikë, në mes të dëborës dhe suferinës, ne e çamë me shumë mundime dhe, kur mbërritëm në vend, u ndeshëm me vështirësi e pengesa të panumërta.*

*Shteti ynë i ri i punëtorëve dhe fshatarëve sapo kishte dalë nga lufta, kështu që atij i duhej që çdo gjë ta fillonte pothuajse nga e para. Ekonomia jonë ishte e shkatërruar. Ne nuk kishim as mjete teknike e financiare, si këto që kemi sot dhe as fuqi punëtore e specialistë që të drejtonin punimet. Specialistët e huaj, në vend që të na ndihmonin, hidhnin gur në rrota, ndërsa armiqtë e klasës brenda vendit i mbanin iso veprimtarisë së tyre sabotuese.*

*Megjithatë, ndonëse në kushte e rrethana tepër të vështira, ne nuk u tërhoqëm asnjë hap prapa, detyrën e ngarkuar nga Partia e kryem me sukses: minierën e re të kromit e vumë në shfrytëzim.*

*Nuk mund ta marrësh me mend se sa u gëzuar kur bëmë shpërthimin e parë. Na mbeti në mendje jehona e tij. Bile, edhe tani më duket sikur ajo vazhdon të oshëtijë në tërë bjeshkët e Veriut.*

*Terreni ishte jashtëzakonisht i vështirë. Binte dëborë vazhdimisht dhe frynte nga të katër anët një erë e akullt. Por ne ishim të rinj dhe as që donim t'ia dinim nga dimri i egër.*

*(Nga biseda me ish-drejtorin e parë të minierës «Fitorja»)*



## NËPËR RRUGËT E KRYEQYTETIT

Në mëngjesin e ditës së shtunë Kristaq Dvorani ishte ngritur më herët se ditët e tjera. Si nëpunës i Zyrës së Botores ai kishte dhënë kontributin e tij për zbukurimin e kryeqytetit të tij të dashur. Kishte ditë që ndiqte me një interesim të veçantë lyerjen e ndërtesave nga jashtë dhe ja, më në fund, çdo gjë ishte gati: fasadat e ndërtesave ndrisnin ngado që të hidhje sytë. Një pamje madhështore kishte marrë sidomos sheshi «Skënderbej», ku ndodheshin ndërtesat e dikastereve qendrore.

Kur Kristaq Dvorani doli në rrugë, ora ishte gjashtë e tridhjetë minuta. Ai mendoi se, para se të shkonte në zyrë, kishte kohë t'u hidhte një sy ndërtesave të rrugëve kryesore të qendrës së qytetit, për të parë se mos kishte mbetur pa u lyer ndonjë vend i dukshëm. Mëngjesi ishte gjithë lagështi dhe tepër i ftohtë. Gjatë natës kishte rënë shi i rrëmbyer, i shoqëruar me erë të fortë, ndërsa tani çdo gjë kishte rënë në qetësi. Qielli ishte i kaltër. Njerëzit nxitonin nëpër rrugë e trotuare me jakat e palltove të ngritura dhe trupin paksa të kërrusur nga të ftohtët. Gjithsecili shkonte në punën e vet në heshtje dhe duke hedhur herë pas here vështrimin nga vitrinat e zbukuruara me rastin e zgjedhjeve. Kristaq Dvorani ngriti sytë për të parë muret e ndërtesave që ndodheshin në të dy

anët e rrugës «Mine Peza». Vende-vende ato ishin ndotur nga ujërat që kishin rrjedhur gjatë natës nga çatitë e moçme. Kjo ishte e tmerrshme. Tërë ajo punë e kujdesshme e bojaxhinjve të Zyrës së Botores kishte shkuar kot. Kristaq Dvorani gati sa s'pëlçiste nga inati. Kaloi në rrugën e Durrësit dhe vuri re të njëjtën gjë: koha e keqe e kishte bërë kudo punën e vet. Ç'kohë e poshtër, tha me vete ai. Megjithatë, ndonëse muret ishin ndotur vende-vende, prapëseprapë ndërtesat e ruanin shkëlqimin e tyre. Drita e bardhë e mëngjesit po e nxirrte më në pah bukurinë e ngjyrave që ishin kombinuar aq mirë. Tutje midis kreshtave të larta të Dajtit, të ngarkuara me dëborë, po bëhej gati të lindte dielli. Rrezet e tij do të binin së shpejti mbi qytet dhe do ta largonin atë pamje të zyrtë. Flamurët, banderolat, pankartat, parullat, fasadat e ndërtesave, drurët nëpër trotuare do t'i jepnin sërish pamjen festive që kishte marrë kryeqyteti shqiptar.

Lëvizjet e automjeteve dhe të pajtoneve po bëheshin përherë e më të dendura. Kristaq Dvorani, si eci për një copë herë të gjatë midis kalimtarëve, u kthye në të majtë, në një rrugicë të ngushtë që kalonte prapa ndërtesës katërkatëshe të Komitetit Ekzekutiv të qytetit të Tiranës. Pas pak ai doli në bulevardin «Stalin», ku kishte më shumë gjallëri. Te hyrja e një librerie ishin grumbulluar shumë njerëz. Ata kishin zënë radhë njëri pas tjetrit për të blerë gazetën e ditës. Kristaq Dvorani ngriti jakën e gjerë të kapotës ushtarake që e kishte kujtim nga koha e luftës dhe vazhdoi rrugën. Ai e blinte gazetën në librarinë e re që ishte hapur në pazarin e vjetër, ku punonte si librashitëse e shoqja, Margarita. Ai ishte i bindur se ajo do ta priste dhe do t'ia ruante gazetën «Bashkimi», ashtu siç bënte vazhdimisht.

Shpejtoi hapat. Nuk donte ta bënte atë të priste, sidomos tani që ajo ishte në ankth për shkak të emërit të tij në një detyrë të re. Dy-tri ditë më parë Kristaq Dvoranit i kishte ardhur një njoftim nga sektori i kuadrit, ku thuhej se ai vihej menjëherë në dispozi-



cion të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave. «E si do të ikim nga Tirana pikërisht tani që u strehuam në një shtëpi të tillë?» — i kishte thënë e shoqja me njëfarë keqardhjeje. Kristaq Dvorani i kishte rënë menjëherë hiles. Këto nuk ishin mendimet e së shoqes. Dikush kishte ndikuar tek ajo dhe për këtë arsye ajo kishte filluar të lëkundej. Ndoshta Donika, kishte thënë me vete ai, duke menduar për komshien, me të cilën Margarita kishte shoqëri të ngushtë. Ç'janë këto fjalë që po më thua? — i qe kthyer ai së shoqes. Ndoshta nuk është fjala për ndonjë transferim nga Tirana, por, edhe po të ndodhë një gjë e tillë, ne duhet të shkojmë atje ku e kërkojnë interesat e Atdheut. E shoqja ishte skuqur menjëherë nga turpi. Ti e di, kishte vazhduar edhe më tej ai, unë jam komunist, dhe... komunistët... ashtu si edhe gjatë kohës së luftës, nuk mund t'ia bëjnë fjalën dy Partisë. Margarita ishte dorëzuar menjëherë. Vërtet, ashtu është, i kishte thënë të shoqit dhe e kishte përqafuar duke mbështetur kokën në gjoksin e tij për një copë herë të gjatë. Kristaq Dvorani ia njihte mirë karakterin së shoqes. Dashuria e tyre që kishte lindur në zjarrin e luftës partizane, ishte e fortë. Ajo ishte bërë më e fortë dhe e pathyeshme qysh kur kishte lindur Rudina, vajza e tyre e vogël. Zënkat e vogla, hezitimet e përkohshme të së shoqes dhe keqkuptimet që lindnin ngadonjëherë midis tyre, para dashurisë së madhe që kishin për njëri-tjetrin ishin aq të parëndësishme, saqë harroheshin menjëherë. Kristaq Dvorani ishte një tip i tillë që dinte t'u shmangej me takt shpërthimeve të papritura të së shoqes, e cila, sapo e kuptonte gabimin e vet, ia plaste gazit, sikur të mos kishte ndodhur asgjë midis tyre.

Këto mendime bluante në kokë Kristaq Dvorani ndërsa ecte nëpër trotuar e që pa e kuptuar as vetë kishte arritur në fund të bulevardit «Stalin». Tek po kalonte përbri Klubit të Gazetarëve, iu kujtua se pikërisht aty kishte qenë dikur kafe «Odeon», një lokal tepër i preferuar i borgjezisë vendase dhe i pushtuesve të huaj. Aty ai kishte shërbyer disa vjet me radhë,



mirëpo një ditë pronari ishte zemëruar së tepërmi dhe e kishte flakur në bulevard pa asnjë qindarkë në xhep... Në trotuarin e krahut të majtë ai pa Fatos Trebeshinën, komshiun e tij, me të cilin kohët e fundit kishte filluar të takohej shpeshherë dhe të shkëmbente vizita familjare. Fatosi ishte gazetar dhe, ndonëse i ri në moshë, kishte shkruar disa artikuj seriozë, gjë që e kishin bërë atë njeri tepër të njohur në rrethet gazetareske të kryeqytetit. Kristaqit padashur i shkoi mendja te nënë Ulja, e ëma e Fatosit. Djalë të vetëm e kam Fatosin dhe e dua shumë, i kishte thënë një ditë nënë Ulja, po edhe ty, Kristaq, të dua shumë. Më ke hyrë mu në zemër, more djalë. S'di se pse të dua kaq shumë. Edhe nusen, të mirë e ke, nuk ta shan nëna, po ti sikur je ca më i mirë... Të paktën kështu më duket mua, more bir. Asaj i bëhej me të vërtetë zemra mal sa herë që i shikonte të dy, krah për krah, duke kaluar nëpër rrugën «Mine Peza».

Në rrugën përbri hotel «Vjosës» mezi kalohej nga njerëzit. Në fasadën e ndërtesës pesëkatëshe po vinin një pllakat të madh kushtuar ditës së zgjedhjeve. Njerëzit nuk kishin parë ndonjëherë një pllakat të tillë me përmasa kaq të mëdha, prandaj shtyheshin për të parë mirë. Pllakati ishte vendosur në një konstruksion të fortë prej druri, siç duket për ta mbajtur të tendosur dhe për ta ruajtur nga erërat e forta që frynin sidomos gjatë natës. Në pllakatin e madh binte menjëherë në sy një punëtor i veshur me kominoshe, i cili ishte duke votuar, dhe dhjetëra të tjerë që e ndiqnin pas. Punëtori dukej i qeshur dhe vështrimi i tij ishte tepër optimist. Dukej sikur thoshte: «Votoni për Frontin.» Në krahun e majtë të pllakatit ishte shkruar me germa kapitale: «Zgjedhjet e reja të Këshillave Popullore do të forcojnë bashkimin dhe unitetin e popullit tonë në Frontin Demokratik.» Ndërsa në anën e kundërt lexohej: «Shokë punëtorë e punëtores! Bashkohuni me të gjitha forcat tuaja për zgjedhjet e Këshillave Popullore. Votoni që të gjithë për kandidatët e Frontit Demokratik!» Pllakati nuk ishte vendosur ende në vendin e duhur. Disa nga



kalimtarët po ndihmonin për ta fiksuar atë në fasadën e lartë të hotel «Vjosës».

Një fshatar tiranas po vështronte i habitur, duke mbajtur me dorë qylafin e tij të bardhë. Ai qëndroi një copë herë të gjatë me sytë nga pllakati dhe pastaj u largua duke murmuritur me vete.

Kristaq Dvorani vështroi sahatin e madh të qytetit dhe pastaj u nis në drejtim të pazarit të vjetër. Ora ishte shtatë e tridhjetë e pesë minuta. Margarita me siguri e priste që ai të shkonte të merrte si zakonisht gazetën «Bashkimi».

## JETA NË PAZARIN E VJETËR

Kristaq Dvorani ishte futur në thellësi të pazarit të vjetër dhe po ecte nëpër rrugicat e shtruara me kall-drëm ku të zinte syri ndërtesa të vjetra njëkatëshe, vitrina dyqanesh, reklama, njerëz gjysmë të dehur, matrapazë të regjur, tregtarë, lypës dhe gra të përdala. Zërat, të qeshurat, tringëllimat e këmborëve e së bashku me ato zhurmat shurdhuese të teneqepunuesve dhe bu-celabërësve krijonin një zallamahi të vërtetë, që të shkaktonte dhimbje koke.

Pazari i vjetër ishte ajo pjesëz e kryeqytetit shqip-tar që zgjohej më herët në mëngjes dhe flinte në orët e vona të natës.

Kundërmimi i qebaptoreve që ndodheshin në qën-dër përhapej me shpejtësi në të katër anët e pazarit. Nëpër rrugicat dhe trotuaret e tij të ngushta kishte shumë lëvizje.

— Gështenja të pjekura! Hajde, gështenja!

— Qofte të skarës! Qofte të mira me rigon! —  
thërriste një zë që përpiquej të dilte mbi të tjerët.

— Shitet një peliçe e bukur grash me gjysmë çmimi.

— Ua, kjo është peliçja e zonjës Meliha?! E njoh mirë, sepse ia kam parë të veshur gjatë kohës së luf-tës, — po thoshte një zë gruaje.

— E shkreta, si do të jetë katandisur, — murmuriti tjetra nën hundë.



— Qofte të mira me rigon! Kemi edhe raki rrushi nëntëmbëdhjetëgradëshe!

— Rakia sot është e ndaluar. A nuk e keni marrë vesh akoma? Nesër kemi zgjedhjet.

Kristaq Dvorani u ndal një copë herë të gjatë në këmbë te bërryli i një rrugice, për të dëgjuar se si i lëvdonin matrapazët sendet që kishin nxjerrë për të shitur në pazar. I vetmi njeri që nuk thërriste dhe që për çudinë e të gjithëve kishte grumbulluar rreth vetes mjaft kalimtarë, ishte Dimkë Teneqexhiu, shitësi ambulant i shtypit të përditshëm. Ai e kishte zbuluar karrocën e tij të vogël trirrotëshe tamam si për ditë feste dhe në pjesën e saj të përparme kishte vënë një parullë të shkruar me germa të kuqe kapitale: «VOTAT TONA—PLUMB PËR ARMIKUN!». Gazetat dhe revistat i kishte sistemuar në një mënyrë të tillë që të binin në sy menjëherë emërtimet e tyre me germa të mëdha.

— Gazeta «Bashkimi» u shit! — tha dikush, që mezi po dilte nga turma.

— Si kështu?! Kaq shpejt! — tha një tjetër, që sapo kishte mbërritur aty.

— Qofte të skarës me rigon! Qofte të mira me rigon!

Zëri i shitësit të qebaptores përpiquej që të dilte vazhdimisht mbi tërë atë zallamahi që të merrte mendjen.

— Gazeta «Bashkimi» u shit! — vazhdonin të thoshin disa zëra nëpër rrugicën e ngushtë mbushur plot e përplot me njerëz.

— Shitet një peliçe e bukur grash me gjysmë çmimi. Njeriu që kërkonte të shiste peliçen ishte një skërfyell i gjatë që dukej sikur mbahej me shumë vështirësi në këmbë. Ai kishte veshur një xhakë të vjetër kadife ngjyrë kafe të errët dhe pantallona të arnuara në gjunjë. Peliçja e bukur vija-vija dukej tepër e huaj në duart e tij të dobëta, që dridheshin nga të ftohtët.



Ndërkohë, në mes të kalldrëmit, po kalonte Shemshedin Bërdëllima, tregtari i dëgjuar i peliçeve, i cili, siç thoshin me zili miqtë e tij të vjetër, qëndronte ende në këmbë, sepse kishte gjetur rrugë e mënyra të përshatshme për t'u shpëtuar komunistëve. Ai i hodhi një vështrim të shkurtër me bishtin e syrit njeriut që kërkonte të shiste me gjysmë çmimi peliçen që kishte në duar dhe pastaj vazhdoi rrugën e tij duke qeshur nën hundë. Shemshedin Bërdëllima ishte një burrë i shëndoshë, me ca sy të fryrë nga dhjamët dhe që binte menjëherë në sy të kalimtarëve. Ai e dinte këtë gjë, prandaj ecte midis tyre duke u tundur dhe me kokën kurdoherë lart. Zakonisht Shemshedin Bërdëllima ishte kostume të errëta me vija të gjera, që i ndërronte tri-katër herë gjatë javës, dhe pallto të madhe prej stofi anglez me jakë gëzofi. Matrapazët dhe tregtarët e vegjël përkuleshin me respekt para tij.

Tek po kalonte pranë shitësit ambulant të shtypit të përditshëm, ai përshëndeti me një pamje të qeshur në fytyrë dhe pastaj u takua me një burrë të shkurtër me borsalinë. Ç'maskarenj, tha me vete Dimkë Teneqexhiu, duke i dhënë reston një gruaje që bleu revistën «Shqiptarja e re». Kristaq Dvorani hodhi sytë në anën tjetër të rrugës dhe vuri re se kishte dhjetëra tabela me mbishkrime të ndryshme: «QEBAPTORE — Jani Gërdalla»; «KADAIF — Agim Allushi». «FOTO — Mastora»; «Kallajxhi — Tërfon Thomallari». «QELLESHPUNUS — Sherif Habibi». Kristaq Dvorani buzëqeshi me vete dhe pastaj u kthye nga shitësi ambulant i shtypit të përditshëm. Dimkë Teneqexhiu ishte një djalosh i ri, fytyrën e të cilit ai e kishte parë diku, mirëpo se ku, tani nuk po i kujtohej. Ai priti pak për të parë në do ta njihte vetë shitësi i gazetave; por shpejt u bind se kjo ishte e kotë. Në sytë e tij të buhavitur, si duket nga pagjumësia, Kristaq Dvorani nuk vuri re asgjë përveç vështrimeve mekanike që u hidhte herë pas here kalimtarëve, të cilët vazhdonin të dyn-deshin në drejtim të tij për të blerë gazetatat dhe revistat, që sapo ishin vënë në shitje.



Kristaq Dvorani ngjiti tri-katër shkallë të gurta në afërsi të një kthese dhe pastaj doli në një rrugicë që të nxirrte më shpejt në qendrën e pazarit ku ndodhej libraria. Margarita më pret me siguri me padurim, mendoj ai. Midis strehëve të ulëta të dyqaneve dukej një rrip i ngushtë qielli, kurse tutje në horizont ndrishte dëborë e bardhë në shpinën e lartë të malit të Dajtit, që dukej sikur bëhej përherë e më i lartë dhe çdo ditë i afrohej Tiranës. Në të vërtetë ky ishte një iluzion i gënjeshtërt që shkaktohej, si dukej, ngaqë, ajri ishte i ftohtë dhe transparent. Kristaq Dvoranit iu kujtua përsëri njoftimi që kishte marrë dy-tri ditë më parë nga sektori i kuadrit, sipas të cilit ai vihej menjëherë në dispozicion të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave. Kjo kishte qenë një gjë e çuditshme dhe disi e papritur për të. Në një kohë që ai i ishte futur punës, si i thonë fjalës, me mish e me shpirt, për të zgjidhur mjaft probleme të ngutshme të Zyrës së Botes, urdhërohej që të bënte menjëherë dorëzimet për t'u ngarkuar me një detyrë tjetër. Vallë, me ç'detyrë do të kishte të bënte në të ardhmen? Ndoshta do të kem fatin e mirë të shkoj në ndonjë minierë, thoshte vazhdimisht me vete. S'dihej se pse i qe fiksuar në mendje një mendim i tillë i çuditshëm. Mos vallë ngaqë gati çdo ditë shtypi i përditshëm dhe radioja flisnin për gjendjen e keqe të minierave ku, më tepër se kudo gjetkë, ndihej më shumë nevoja për kuadro, specialistë dhe forca punëtore? Apo ndofta ngaqë i ati, Todo Dvorani, kishte qenë minator tërë jetën e tij dhe shpeshherë krahas tregimeve për jetën e vështirë të minatorëve, gjë për të cilën ai ia hidhte fajin gjithmonë regjimit të Ahmet Zogut, i kishte folur edhe për pasuritë e mëdha të tokës shqiptare, të cilat, po të shfrytëzoheshin me nikoqirllëk, mund ta bënin Shqipërinë një nga vendet më të pasura në botë? Këto biseda të largëta vezullonin tashmë në ndërgjegjen e tij dhe i shtonin nga çasti në çast dëshirën për të punuar në ndonjë minierë. Sigurisht, do të ishte më mirë që ta emëronin në minierën e njohur që ndodhej përbri fsha-



tit të lindjes. Atje ai do ta ndiente veten me të vërtetë të lumtur, meqenëse edhe Margarita do të ishte pranë njerëzve të saj. Duke u menduar të përfytyronte minierën e fshatit të tij, i dolën përpara syve mali i lartë e i zhuritur, plot shkëmbinj, që zbriste gjer poshtë në fushën e bukur dhe pjellore, pastaj çatitë e gurta të shtëpive, rrugët e pastra të shtruara me kalldrëm, vreshtat dhe manat e dëgjuar për rakinë e tyre të fortë, plepat e lartë në të dy anët e xhadesë që zbriste në qytet... Sikur të ndodhte ashtu siç ëndërronte ai, do të ishte me të vërtetë një gjë e bukur.

Ambienti i ndotur i pazarit të vjetër nuk u përshatetej kujtimeve romantike të Kristaq Dvoranit. Nëpër rrugët e tij të ndotura ecnin vazhdimisht ca karroca shkatarraqe, me kuaj gërdallë, që mezi hidhnin këmbët. Duke e krahasuar me jetën e re plot dritë me bulevardin «Dëshmorët e kombit», me Rrugën e Barrikadave» apo me bulevardin «Stalin», pazari i vjetër dukej pors i një njollë e zezë mu në mes të Tiranës. Ishin dy botë krejt të ndryshme që qëndronin përballë njëra-tjetrës. Ndërkaq Kristaq Dvorani arriti të ngjiste shkallët e librarisë. Mbi derën e hyrjes ishte shkruar vetëm fjala «LIBRARI». Germat ishin të mëdha dhe ishin shkruar me ngjyrë të kuqe të fortë, që binte menjëherë në sy në të gjithë ambientin që e rrethonte. Libraria sipas tij ishte pors i një rreze drite mu në zemër të një bote kaq të vjetër e të perënduar njëherë e përgjithmonë. Ky ishte i vetmi lokal ku ai hynte me qejf dhe kjo ndodhte jo sepse atje shërbente e shoqja, por sepse që andej ndërmerreshin sulme dhe vazhdonte lufta kundër atyre klaseve dhe mbeturinave të tyre, që rënkonin diku nëpër bodrume, zvarriteshin fshehurazi nëpër errësirë, pshe-rëtinin, shanin, dhe i binin gjoksit me grusht duke ëndërruar për t'u rikthyer në kolltukët e tyre të mëparëshëm. Duke hyrë në librari, ai priste që në çast e shoqja të pyeste për çështjen e transferimit. Dhe në të vërtetë ashtu ndodhi.



— E, Kristaq? — thirri ajo, sapo e pa te dera e librarisë. — Të thanë gjë?

Ai i buzëqeshi dhe pastaj i dha dorën në heshtje. Ajo u hutua fare nga ky qëndrim mospërfillës i të shoqit. Çudi. Ai e merrte çështjen e transferimit si një gjë krejt të zakonshme e të natyrshme. Të paktën këtë përshtypje linte para saj. Ndërsa me të po ndodhte krejt e kundërta. Ajo ishte tepër kureshtare të dinte se ç'do të bëhej me të shoqin tani që do të largohej nga Zyra e Botores. Dhe ajo që e shqetësonte më shumë ishte nëse do të largohej apo jo nga Tirana. Sido që të shoqit i kishte thënë se ishte gati të shkonte kudo që ta lypte nevoja, përbrenda e mundonte një ndjenjë tjetër që e kishte të vështirë ta shfaqte. Bisedat që kishte bërë me shoqen e saj, Donikën, ia kishin prishur fare mendjen.


Ata qëndruan një copë herë të gjatë në heshtje.

— Ama edhe ti, — i tha pas pak të shoqit, — gjithmonë kështu tallesh me mua!

— Më vjen keq, — i tha Kristaq Dvorani me të qeshur. — Ti e di që unë kam për ty një respekt të jashtëzakonshëm. Unë për ty...

Margarita uli sytë mbi banak, sepse nuk guxonte që ta shikonte drejt në sy të shoqin. Në të vërtetë ajo e kuptonte se mendimet që kishte në kokën e saj nuk ishin të mira, po ja që ishte krijuar një gjendje e tillë e sëmurë në ndërgjegjen e saj.

Ajo po shndërrohej gradualisht në një Margaritë tjetër, së cilës i pëlqente më tepër të merrej me problemet e familjes së saj të re dhe pastaj me ato të shoqërisë. Kristaq Dvorani ishte më se i bindur se në këtë drejtim po lozte një rol negativ shoqja e saj më e ngushtë, Donika, e cila, ndonëse nuk ishte grua e keqe, përkëdhelej shumë dhe kishte filluar ta shikonte jetën me syrin e një mikroborgjezeje. Kjo ishte një arsye tjetër tepër e fortë që e shtynte Kristaq Dvoranin të plotësonte dëshirën për të shkuar në ndonjë minierë të largët, ku ishte i bindur se do të gjente njerëz të mirë dhe afër të pastër.





— Hë de, pa më thuaj: çfarë të thanë? — e pyeti ajo pas pak të shoqin, duke e marrë me të mirë.

Zëri i saj ishte lutës dhe tepër i dashur. Kristaqi, megjithëse ndaj sa tregohej kurdoherë mjaft i sjellshëm, këtë herë po ia hante shpirtin me ato buzëqeshjet e tij të heshtura, me të cilat mbulonte gjendjen e tij shpirtërore. Për këtë arsye ajo nuk po kuptonte nëse i shoqi ishte i gëzuar apo atë diçka e mundonte përbrenda. Fytyra e tij simpatike tepër e qetë dhe gati përherë e qeshur, e pengonte Margaritën të hynte në botën e tij të brendshme. Ndërsa me të ndodhte krejt e kundërta: çdo gjë që kishte në mendje ajo e shfaqte menjëherë me fjalë ose nëpërmjet mimikës së saj tepër plastike.

— Ama edhe ti, — i tha prapë të shoqit. — Kështu ma bën gjithmonë mua. Hë de, fol, se më plase?

— E çfarë të të them? — foli Kristaq Dvorani me një ton krejt familjar. — Nuk më kanë thënë asgjë deri tani. Ndoshta nesër do të marrim vesh çdo gjë që ka të bëjë me caktimin tim në detyrën e re.

— Përse?

— Sepse nesër në orën dymbëdhjetë do të jem në zyrën e ministrit.

— Vërtet?! Po nesër është e diel. Pastaj... nesër kemi edhe zgjedhjet... Si është e mundur që...

— Po ja që është e mundur, — ia ktheu ai. — Pastaj ç'rëndësi kanë të gjitha këto që më thua?! Ne jemi ushtarë të Republikës dhe do të shkojmë atje ku ka nevojë Atdheu. Apo jo?

Ai mbështeti bërnylat mbi banak dhe i dha fytyrës së tij simpatike një pamje serioze. Ishte e kotë që Margarita të bisedonte me të shoqin në këto rrethana. Kur atij i mbushej mendja për një gjë, s'luante nga e tija, prandaj ajo detyrohej të hidhte armët dhe të kapitullonte pa kushte.

Në librari hyri Dimkë Teneqexhiu me disa gazeta e revista në duar. Ai dukej tepër i lodhur, po, kur pa se aty ndodhej Kristaq Dvorani, u gjallërua menjëherë. U mat të thoshte diçka, por aty për aty ndërroi



mendje. Ndoshta u druajt nga prania e Kristaqit ose u emocionua nga ky takim krejt i papritur.

— Dimkë, ulu këtu, — i tha Margarita, pasi e përshëndeti me një lëvizje të lehtë të kokës dhe e vështroi me ata sytë e saj të mëdhenj ngjyrë ulliri. — A e njeh Dimkën? — i tha të shoqit, duke u buzëqeshur të dyve si me druajtje.

Kristaq Dvorani po e shikonte atë me vëmendje për të gjetur se ku e kishte parë gjetkë këtë djalosh që përpigjej ta tregonte veten më të pjekur se ç'ishte. Ai kishte një pamje shumë të qetë dhe dukej tepër i pashëm. Kishte veshur një kostum të qepur sport prej stofi me kuadrate dhe flokët i kishte krehur me kujdes.

— Nuk po më kujtohet, — tha më në fund Kristaq Dvorani me një pamje të menduar në fytyrë.

Dimka i buzëqeshi me përzemërsi Kristaq Dvoranit që rrinte i mbështetur mbi banak dhe pastaj i hodhi sytë nga Margarita.

— More djalë, pa dale një çikë, — tha Kristaq Dvorani duke drejtuar shtatin e tij të lartë. — Ndoshta më bëjnë sytë, por... ne duhet të njihemi vërtet prej kohësh bashkë... Pa më thuaj: i kujt je?

Dimkë Teneqexhiu uli kokën i menduar dhe filloi të qëronte një gështenjë të pjekur.

— Unë nuk kam prindër, — tha. — Jam rritur në strehën vorfnore.

Kristaq Dvorani hodhi sytë nga karroca e tij tri-rrrotëshe që rrinte në trotuarin para hyrjes së librisë dhe pastaj ktheu kokën nga Dimkë Teneqexhiu. Prapë ia nguli sytë karrocës ku mezi dalloj mbishkrimin: «Caffe Odeon». Tashmë çdo gjë ishte pothuajse e qartë. Ata ishin njohur me njëri-tjetrin dhjetë vjet më parë në kafe «Odeon».

— Tani po më kujtohesh mirë, — tha Kristaq Dvorani. — Ti ke punuar dikur në kafe «Odeon», po atëherë ke qenë shumë i vogël. Ndoshta shtatë ose tetë vjeç. Apo jo?

Dimkë Teneqexhiu ngriti kokën dhe fytyra indriti nga një kënaqësi e brendshme.

— Po, — tha, duke hedhur mbeturinat e gështenjave jashtë në trotuar. — Ajo është karroca jote, me të cilën u çoje zotërinjve shampanjë shtëpi më shtëpi!

Kristaq Dvorani vështroi karrocën e vogël i habitur. Mbishkrimi: «Caffe Odeon» u bë edhe më i qartë në kujtesën e tij.

— Vërtet! — tha.

— Dimkë Teneqexhiu pohoi me kokë dhe pastaj iu afrua Kristaq Dvoranit duke vërtitur nëpër duar tri-katër gështenja të pjekura.

— Na, merri, — i tha. — A të kujtohet. Edhe atëherë hanim gështenja të pjekura.

Kristaq Dvorani i buzëqeshi me dashamirësi dhe ia mori gështenjat, duke i thënë «falemnderit». Dy ia dha Margaritës dhe pastaj u kthye përsëri nga Dimkë Teneqexhiu.

— Qenke rritur, — i tha, qenke bërë burrë!

Dimkë Teneqexhiu qeshi me gjithë shpirt.

Margarita po e ndiqte bisedën e tyre me buzë në gaz dhe duke përfytyruar gështenjat e pjekura.

Në të vërtetë Kristaq Dvorani ishte tani njëzet e gjashtë vjeç, po tregonte më i vogël. Dimkë Teneqexhiu ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, por ngaqë kishte hedhur shtat, diferenca e moshës ndërmjet tyre nuk dukej edhe aq e madhe.

Ata qëndruan një copë herë të gjatë në heshtje duke sjellë njëkohësisht nëpër mend vitet e shkuara...

— Po! — tha Kristaq Dvorani. — Tani po më kujtohet mirë se pikërisht me këtë karrocë të vogël bashkë me shishet e shampanjës, pijet e ëmbëlsirat e ndryshme që porosisnin në kafe «Odeon», ne u çonim familjeve borgjeze edhe trakte... Ato tërboheshin, po asnjëherë nuk u shkante mendja te ne. Sa qenke rritur, — i tha pas pak Dimkës, duke i hedhur dorën në qafë. Atëherë se ku zhdukeshe herë pas here. Të kujtohet? Njëherë bile u bëmë merak, se kujtuam se kishe rënë në kthetrat e italianëve. Ç'takim interesant? Të kisha



parë kaq herë që hyje e dilje këtu në librari, po s'të kisha vënë re me kujdes në mënyrë që të të njihja.

— A të kujtohet se ç'të rrahur të kanë bërë një-herë fashistët, — tha Dimka.

Kristaq Dvorani kishte rënë në mendime.

— Si jo, — tha pas pak ai sikur të ishte zgjuar nga një gjumë i rëndë. — Ja, pa shiko, — dhe vuri gishtin tregues në vetullën e djathtë. — Këtu kam një shenjë, e kam kujtim nga ajo ditë që më rrahën karabinierët në zyrën e padronit aq sa mend vdiqa... Vetëm pas një muaji munda ta merrja veten.

— Vërtet? — ia bëri Margarita. — Si s'më ke thënë që këtë shenjë e ke ngaqë të paskan rrahur. Vërtet? Aq shumë të rrahën, Kristaq?

Ajo po fliste me një zë të mallëngjyer.

— Vërtet, — tha Kristaq Dvorani, duke vështruar drejt e në sy të shoqen. — Kurse ti... nisi të thoshte ai, po e la mendimin përgjysmë.

Kur Margarita ngriti kokën, Kristaqi vuri re se ajo ishte përlotur.

— Ç'ke që qan? — e pyeti.

Dimkë Teneqexhiu u prek nga kjo skenë dhe i erdhi rëndë kur mendoi se ishte pikërisht ai shkaktari i kësaj gjendjeje.

— Kristaq, — tha Margarita e mallëngjyer, — ti e di shumë mirë që unë s'kam asgjë të keqe në zemër. Dhe... në qoftë se të them ndonjë fjalë që s'duhet thënë, ti mos ma merr për keq...

— Ç'budallaqe që je! — tha Kristaq Dvorani me të qeshur. — Unë i kam më se të qarta qëllimet e tua, e njoh mirë sinqeritetin tënd dhe e di që zemrën e ke të pastër, por... që të ëndërrosh për një jetë të rehatshme... Ti, Margarita, e di që lufta mbaroi, po mos harro se ne jemi të rrethuar nga armiq të shumtë... Një ditë... ky rrethim... mund të bëhet edhe më i egër... Megjithëse ne i dhamë fund luftës, gjene jemi në luftë... A më kupton?

Dimkë Teneqexhiu uli kokën dhe doli jashtë, sepse e pa që ishte i tepërt në këtë bisedë gjysmëfamiljare.

Jeta në pazarin e vjetër sa vinte gjallërohej. Në fund të rrugicës që vinte nga pjesa verilindore e pazarit ndodhej një kovahçanë që s'pushonte nga mëngjesi gjer në orët e vona të mbrëmjes. Uturima e çekanit të kovaçit plak jehonte në tërë pazarin, duke sunduar mbi çdo zhurmë tjetër.

Një i dehur që sorollatej poshtë e përpjetë nëpër pazar vazhdonte të murmuriste me vete të njëjtën frazë bajate.

«Taho Leka me dyfek, të ha m... dhe s'të vret. Taho Leka me...»

Gjithandej dëgjoheshin zëra.

— Gështenja të pjekura!

— Qofte të mira me rigon!

Ishte po ai zë që përpiqej të dilte mbi të tjerët. Aty-këtu shfaqej papritur edhe skërfyelli i gjatë, i cili vazhdonte të kërkonte me këmbëngulje që të shiste me një gjysmë çmimi peliçen e zonjës Meliha Vrioni.



## HEZITIMET E MARGARITËS

Kristaq Dvorani dorëzoi sektorin e punës, duke shkëputur në këtë mënyrë çdo marrëdhënie me Zyrën e Botores, dhe u kthye në shtëpi i gëzuar, duke menduar se Margarita duhej të kishte ndërruar mendje.

Në të vërtetë Margarita ishte nga ato gra, ndaj të cilave njeriu duhet të tregohet shumë i matur. Kristaq Dvorani e njohte mirë karakterin e saj. Ai e dinte se ajo merrte zjarr shpejt, pothuajse, për çdo gjë që aty për aty nuk i pëlqente. Po ai dinte gjithashtu se ajo ishte një grua e bindur dhe serioze. Në qoftë se do të detyroheshin të largoheshin nga Tirana për shkak të transferimit të tij në detyrën e re, pavarësisht nga hezitimet e përkohshme, ai mendonte se ajo do të kërkonte të shkonte menjëherë bashkë me të në çdo skaj të Republikës. Për këtë ai ishte i sigurt, sepse e dinte që e shoqja e donte me gjithë shpirt aq, sa nuk mund të jetonte larg tij qoftë edhe për një kohë të shkurtër.

Kristaq Dvorani sapo kishte mësuar se dy-tri ditë më parë në qeveri ishte vendosur, që të hapej një minierë e re kromi, diku në veri të vendit. Ky lajm i gëzueshëm ishte bërë tashmë i njohur për punonjësit e Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave, po ende nuk ishte publikuar. A e kishte mësuar këtë gjë rastësisht e nëpërmjet shokut të zyrës së tij në çastin që po firmonte procesverbalin e dorëzimit të sektorit të punës. Prandaj që tani ai ishte pothuajse i bindur se njëri nga ata kuadro që do të caktoheshin me detyrë

në këtë minierë të re duhej të ishte patjetër edhe ai. Për këto gjëra, kuptohet tërthorazi dhe me takt, ai kishte vendosur që të bënte një bisedë edhe me Margaritën, me qëllim që ajo të përgatitej shpirtërisht për transferimin e tij në një minierë të re kromi diku në veri të vendit.

Ndërsa rrinte shtrirë në minderin e kuzhinës, duke pritur të shoqen që të kthehej nga puna, ai nisi të shfletoonte disa letra të vjetra që ia kishte dërguar Margarita gjatë kohës së luftës, kur dashuria e tyre ishte ende e fshehtë. Ishte pikërisht koha kur ai sapo ishte kthyer në fshat dhe kishte hyrë në organizatën e rinisë antifashiste, ku bënte pjesë edhe Margarita. Duke u njohur më nga afër me të, dalngadalë midis tyre kishte filluar të lindte dashuria. Ajo kishte nisur me ca vështrime të ngrohta ndërmjet njëri-tjetrit, që në fillim nuk merreshin vesh në ishin miqësore, shoqërore, apo diçka më tepër... Shumë shpejt çdo gjë u bë e qartë nëpërmjet letërshtëmbimit që ata më vonë e vazhduan për një kohë të gjatë. Në njërin nga këto letra, të cilën ai tashmë e kishte marrë në dorë dhe po e lexonte me kujdes, Margarita i shkruante me një ndjenjë të rrallë dhembshurie që ia ngrou zemrën dhe po e qetësonte disi edhe tani. Ajo e pyeste se si jetonin partizanët në mal, a u kishin mjaftuar ushqimet që kishin marrë një javë më parë në fshat, kur do të dërgonin njerëz për të marrë veshmbathjet që nuk i kishin marrë dot për shkak të qarkullimit të shpeshtë të patrullave gjermane rrotull fshatit të tyre etj.

Ai e lexoi dy herë me radhë letrën që kishte në dorë dhe vuri re se Margarita nuk shkruante asnjë gjysmë fjale për dashurinë e tyre. Por, midis radhëve të letrës ai nënkuptonte pyetje të tilla si: a do të kthehej shpejt ai, a do të mbaronte një ditë lufta e mallkuar dhe a do të arrinin ata të jetonin bashkë, të kuvendonin për të ardhmen, për fëmijët që do të bënin, për çdo gjë? Të gjitha këto ia përforconin më tepër disa pika loti në fund të letrës që, si dukej, i kishin



shkuar asaj padashur. Gjurmët e tyre dalloheshin edhe tani që ai po shfletonte letrën e saj. E palosi letrën me kujdes, e futi përsëri në zarfin e vet dhe pastaj e bashkoi me letrat e tjera.

Sa mirë kishte bërë që i kishte hapur ato letra të vyera. Në lëmshin e madh të mendimeve që vërtiteshin në kokën e tij, spikati qartë vetëm pyetja: përse vallë nuk gjykonte Margarita edhe tani ashtu siç gjykonte gjatë kohës së luftës? Atëherë ajo ishte fare e re, ndoshta gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë vjeçe, dhe megjithatë shfaqte mendime aq të pjekura! Ndërsa tani... Ah, ajo kishte filluar të ndryshonte. Atij i dukej se nuk ishte më Margarita e kohës së luftës, po një Margaritë tjetër, një Margaritë që nuk e shihte më veten si një luftëtare të çështjes së përgjithshme. I dukej se ajo qe shndërruar në një amvisë që duhej të kujdesej vetëm për punët e shtëpisë, për Rudinën e vogël dhe për çdo gjë tjetër që përfshihej brenda katër mureve. Pse kështu mendonte ajo se do t'ia bënte jetën të lumtur të shoqit dhe tërë familjes!

Margarita të linte ngandonjëherë përshtypjen se ishte një grua kokëfortë, që grindej pa shkak me të shoqin dhe që e mërziste ngandonjëherë aq shumë, sa që dukej se ata nuk do të jetonin gjatë së bashku; në të vërtetë punët qëndronin krejt ndryshe, ajo merrte flakë shpejt e në mënyrë krejt të papritur, po aty për aty ndërronte mendje dhe i kërkonte ndjesë të shoqit. Megjithatë ai ende nuk ishte në gjendje që të përcaktonte se si do të përfundonte dyluftimi midis tyre. Po një gjë e kishte të qartë: sapo t'i thoshte se për të po diskutohej se do të transferohej me punë në një minierë të re kromi, diku në veri të vendit, ajo me siguri do të zemërohej dhe do të fillonte të grindej me të. Ai s'kishte shumë kohë që kishte biseduar me të në librarin në lidhje me këtë problem dhe ja, tani do t'i duhej prapë të ngacmonte të njëjtën plagë që e kishte shkaktuar ndoshta padashur vetë Margarita. Sa për Kristaqin, ai nuk shqetësohej fare: atij nuk i bënte përshtypje se do të transferohej e se mund të shkonte diku në

viset e Veriut apo në ndonjë vend tjetër. Aq të gjalla ishin kujtimet e tij për kohën e luftës, sa që i vinte të thërriste me sa kishte në kokë: Margarita, ti s'je në vete! Herë-herë nuk i besohej që e shoqja kishte filluar të ndryshonte. Si është e mundur? thoshte me vete. Harroi ajo se si i shpërndante traktet nëpër fshat, nën hundën e italianëve e duke vënë shpeshherë jetën në rrezik? Jo. Kjo nuk ishte e mundur të ndodhte!

Ç'është e vërteta, sa herë që njerëzit pësojnë ndryshime në jetën e tyre, kjo nuk kalohet pa dhimbje. Jeta nuk rrjedh kurrë si në vaj. Ai po ndeshej tashmë me konceptet e gabuara të së shoqes, por njëkohësisht nuk mund të mos shqetësohej edhe për qëndrimin që mund të mbanin prindërit e tij që jetonin në fshat. A do të ishin dakord ata që ai të shkonte në viset e Veriut ose në Jug të vendit në një kohë që ata prisnin që të afrohej sa të ishte e mundur më shumë dhe, po të kishte mundësi, të rikthehej përsëri në fshat? Në mënyrë të veçantë e ëma ëndërronte që ai të kthehej sa më parë në vendlindjen e tij, sepse duhej ndihmuar i ati në punët e bujqësisë, pasi moshë dhe punët e rënda në minierë e kishin bërë punën e vet. Por kjo ishte një ëndërr që nuk mund të realizohej. Ai nuk mund të kthehej në fshat, se interesat e Atdheut kërkonin që të shërbente diku gjetkë dhe ndoshta në një minierë. Në një minierë?! Ç'ishte ajo fjalë?! Djali i saj të bëhej minator, të vuante tërë jetën si i ati? Jo. Njëqind herë joi! Ai ishte i bindur se, kur ta mësonte këtë gjë, e ëma do t'i thoshte: Ç'janë këto fjalë që po më dëgjojnë veshët, more bir? Po miniera të ha të gjallë! Si kështu? Paskësh qenë e thënë që edhe ti të katandisesh si yt atë! Dhe kishte rrezik që këtë këngëz, që tashmë i kishte shikuar koha, ta kthente në vaj si dikur... Ajo nuk e kuptonte se kishte lindur një jetë krejt e re, një jetë e vrullshme, që të rrëmbente dhe të çonte përpara.

— E, ç'bërë? — i tha e shoqja duke hyrë rrëmbimthi në kuzhinë. — Qenke kthyer herët sot në shtëpi. Nuk ishe në zyrë?



— Vajta, — iu përgjigj ai.

— Edhe u ktheve kaq shpejt?

— Po.

— A ishe në ministri?

— Jo akoma.

— Përse?

— Po të thashë, pra. Do të paraqitem nesër në orën dymbëdhjetë te ministri personalisht. Po ti, Margarita, mos u shqetëso. Zëre se ma kanë thënë. Do të shkojmë në minierë...

— E përse, mos vallë të detyron ndokush që të shkosh e të robëtohesh në minierë si dikur yt atë? — tha ajo me të hequr pallton dimërore bojë hiri me pikëza të zeza.

— Më detyron, si jo?!

— Kush?

— Ndërgjegjja ime prej komunisti!

— Kristaq, si e ke punën? Vërtet të ka shkrepur në kokë që të shkosh në minierë?!

— Ndofta, — tha i shoqi.

Megjithëse përgjigjja ishte e paqartë, Margarita po e kuptonte se diçka serioze fshihej në fjalët e të shoqit. Tani ajo po bindej se ai nuk po bënte vetëm një shaka, por, pa u vënë re, i kishte thënë asaj një të vërtetë të hidhur. Margaritës po i shtohej përherë e më shumë shqetësimi.

— Po na ecën fati, — tha ajo me inat. — Si duket, paskësh qenë thënë që të robëtohemi në ndonjë vend të shkretë. Bukur po ma punon, Kristaq! S'më vjen keq për vete, po për vajzën. Të paktën të kishte mbushur një vit. E ku do të na çosh në mes të një dimri të egër si ky i sivjetmi me një bebe të vogël? A e di ti ç'do të thotë ta fillosh çdo gjë nga e para? Të presësh të marrësh shtëpi, të transportosh plaçkat, të gjesh punë për mua? Ou, nuk i bën këto hesape ti, prandaj fluturon!

Ata qëndruan një copë herë në heshtje. Kristaq Dvorani u hodhi shpejt e shpejt një sy patateve që i kishte dhënë e shoqja për t'i qeruar dhe, si u bind

se ato ishin gati, vendosi të ngrihej në këmbë për t'ia dhënë asaj dhe, të mburrej me punën e mirë që kishte bërë.

— E me çfarë detyre do të të çojnë në minierë? — pyeti e shoqja.

— Ndoshta drejtor ndërmarrjeje, — u përgjigj ai me të qeshur.

Kristaq Dvorani fliste si pa të keq, sepse mendonte që edhe së shpejti do t'i pëlqente jeta në minierë. Ai shpresonte se do të vinte një ditë që ajo vetë me gojën e saj do të fliste me simpati dhe dashamirësi për minierën dhe minatorët, se do ta ndihmonte të shoqin në kryerjen e detyrave.

Ajo drejtoi trupin dhe, me një shprehje të papërcaktuar në fytyrë, ktheu kokën nga ai. Një vështrim të tillë ajo i kishte hedhur atij edhe disa vjet më parë kur ai i kishte propozuar të martoheshin bashkë. As buzët, as vetullat e saj të zeza, as balli i kërcyer nuk kishin ndonjë shprehje të veçantë.

— Ç'është e vërteta, — tha pas pak ajo, — ke ca ditë që po më ngacmon shumë. Nuk e kuptoj se ku e ke hallin.

Ai e vështroi një copë herë në heshtje.

— Po ti ç'ke? — pyeti pas pak ai.

Biseda midis tyre mori papritur një karakter serioz.

— As vetë s'e di se ç'kam?! — tha pas pak ajo, me një pamje të menduar në fytyrë.

I shoqi u përpoq edhe një herë t'ia shpjegonte se në kokën e saj po zinin vend ca mendime të gabuara, krejt të huaja për karakterin dhe të kaluarën e saj.

— E kam të vështirë të ta shpjegoj më qartë, Margaritë, — tha ai.

— Po ç'do të më shpjegosh?! — u inatos përsëri ajo.

— Qëndrimin tënd të gabuar!

Ai e bëri feta-feta pataten e fundit që kishte në dorë dhe pastaj u ngrit për t'i shpëlarë edhe një herë në çezmë. Margarita rrinte në këmbë si e ngrirë.



— Unë dua që ta ndërtojmë me kujdes të ardhmen tonë, — po thoshte i shoqi, ndërsa shpëlante patatet në lavapjatë. — Kjo ka shumë rëndësi për ne, — tha ai, pothuajse duke murmuritur me vete. — Ti e kupton se unë të dua të mirën ty edhe gjithë familjes sonë.

— Sa po më lodh, — ia preu fjalën ajo. — Laji më shpejt patatet!

Për Kristaqin kjo ishte një fyerje e rëndë që e goditi thellë në zemër, por s'foli.

Margarita donte të thoshte edhe ca fjalë të tjera, po nuk vazhdoi më tej, mbasi pati frikë se mos brenda një sekonde mund të shkatërrohej çdo gjë që kishte të bënte me marrëdhëniet e tyre bashkëshortore. Megjithatë, qëndrimi i saj ndaj të shoqit ishte mjaft i shkujdesur dhe mospërfillës. Tek po vështronte kokën e tij ulur mbi lavapjatë, vuri se re po i dridheshin duart nga inati. Për një çast mendoj që t'i kërkonte falje, por u tërhoq, se nuk deshi që ta ulte veten. Ajo vazhdoi të skuqte mishin në heshtje të plotë.

— Po përse të vazhdojmë të grindemi në këtë mënyrë? — tha pas pak Kristaq Dvorani. — A nuk e shikon se në ç'rrugë të rrezikshme po na fut?! — pyeti ai fytyrëngrysur.

— Kristaq, — foli Margarita me një pamje tepër të lodhur, — mos më ngacmo më shumë sot, se ka rrezik të bëj ndonjë skandal.

Kristaq Dvorani vuri re se ajo ishte prekur aq shumë, sa, po të vazhdonte të thoshte edhe disa fjalë kundër saj, ajo me siguri do ta shfrynte zemërimin e saj haptazi. Përse kishte marrë një pamje aq të çuditshme ajo? Ndërkohë ai po mendonte se të gjitha sa thoshte Margarita nuk ishin vetëm mendimet e saj. Kristaqi ishte i bindur se ajo që i frynte në vesh së shoqes ishte Donika, shoqja e saj më e ngushtë që s'dinte gjë tjetër veçse të pispillosej tërë ditën e ditës dhe pastaj t'u shiste mend të tjerave. Në të vërtetë Donika nuk ishte grua e keqe. Kjo vinte, ndoshta, ngaqë Fatos Trebeshina, i cili kohët e fundit ishte bërë i njohur si gazetar në radhët e inteligjencies së kryeqytetit,



e përkëdhelte ca si shumë të shoqen. Ndryshe s'kishte si të shpjegoheshin disa qëndrime të Margaritës, krejt të huaja për marrëdhëniet e tyre bashkëshortore.

— A ke ndonjë punë tjetër për mua? — pyeti pas pak ai, pasi i kishte shpëlarë patatet dhe e kishte vënë tepsinë mbi tryezën e bukës.

Duke vështruar fytyrën e vrenjtur dhe të hutuar të së shoqes, Kristaqi mendonte se duhej të mbante veten dhe të mos bëhej qesharak para saj.

— Shko për të çarë ca dru! — tha ajo me një ton mospërfillës. — Zjarri po fiket!

Në zërin e saj, përveç pakënaqësisë, nuk ndihej gjë tjetër. Siç dukej Margarita kishte vendosur të mbronte me kokëfortësi deri në fund mendimet e saj.

I mbyllur në vetvete, ngaqë e shoqja e kishte prishur krejt atmosferën gazmore që përpiquej të krijonte ai në familje, doli jashtë kokulur për të çarë dru. Jashtë frynte një erë e ftohtë dhe binin ca pika shiu herë-herë të përziera me flokë bore. Siç dukej koha do të egërsohej edhe më keq, kaq sa gjatë natës kishte shumë mundësi të binte vetëm borë. Ndërsa çante dru, Kristaqi mendonte se duhej të ruante gjakftohtësinë, pikërisht tani që e shoqja ishte bërë tym dhe s'dinte se çfarë thoshte, sepse, po ta humbiste durimin, tërë planet e tij për ta sjellë Margaritën në rrugë të drejtë do të dështonin.

— Hajde, shpejt! — thirri e shoqja, kur e pa te dera, duke sjellë drutë e çara. — Zjarri po fiket!

Ai shpejtoi, por, si duket ngaqë u pengua te shkorra e derës, u përplas në dysheme me gjithë drutë e çara. Margarita ia plasi gazit, ndërsa Kristaqi u bë flakë i kuq në fytyrë. Ai u përpoq të vinte buzën në gaz, po, kur mendoi se buzëqeshja do të ishte në favorin e saj, i dha fytyrës një pamje serioze.

— Nuk di as të ecësh, — i tha ajo. — Nuk shikon fare nga sytë?

Kristaq Dvorani kërciti dhëmbët dhe, tek po ngrihej me ngadalë, u mundua ta mposhte zemërimin. Në këto çaste ai nuk donte ta shihte me sy të shoqen, se-



pse ishte zemëruar së tepërmi. Ndërsa po hidhte dru në zjarr, Kristaqi ndjeu se po i dhimbte balli. Preku me dorë vendin që i dhimbte dhe vuri re se qe bërë me gjak. Si dukej, diku duhej të ishte çarë. Ai hodhi edhe disa dru të tjera në sobë dhe pastaj, duke mbajtur ballin me dorë, shkoi në dhomën e gjumit. Kur vuri re se Kristaqi qe tepër i zemëruar, Margarita mbuloi fytyrën me pëllëmbët e duarve dhe filloi të qante. Përse vallë kishte filluar të shkatërrohej lumturia, për të cilën kishin ëndërruar aq shumë? Si nuk gjenin gjuhë të përbashkët, po vazhdonin të grindeshin përditë e më shumë. E ç'të keqe do të kishin, fundja, po të shkonin në minierë? Fundja, edhe atje jetojnë njerëz. Kudo jetojnë njerëz. Dhe, po të dish ta ndërtohet jetën, ajo kudo bëhet e lumtur. Si dukej, ai kishte të drejtë, kurse ajo i binte kot së koti në qafë. Kristaq, thoshte ajo me vete. Ti duhet të më falësh, se unë nuk kam pjekurinë tënde. Ti je rrahur me jetën dhe di t'i gjykosh gjërat më mirë se unë, prandaj më fal! Po a ishte në gjendje ajo që t'ia shfaqte tërë mendimet që i vërtiteshin në kokë, pikërisht tani që ishin të zemëruar në kulm me njëri-tjetrin? Në këto rrethana Margarita e pa të arsyeshme që, sapo Kristaqi të dilte nga dhoma e gjumit, t'i hidhej në qafë dhe t'i kërkonte të falur për të gjitha. Fytyra filloi t'i shkëlqente nga gëzimi. Por pikërisht në këtë çast, kur, duke dalë nga dhoma i gjakosur, pa se e shoqja po buzëqeshte tërë qejf, Kristaqi u kthye mbrapsht, rrëmbeu kapotën ushtarake dhe kasketën bojë hiri dhe doli jashtë si i tërbuar. Ky ishte kulmi! Margarita e kishte mbushur kupën. Megjithëse e dinte se zemërimi do t'i kalonte, i dukej se nuk do ta falte kurrën e kurrës Margaritën.

Kur doli nga shtëpia, Kristaqi nuk e vuri re që e shoqja kishte mbuluar përsëri fytyrën me pëllëmbët e duarve dhe ia kishte plasur të qarit.

Pas një gjysmë ore ajo mezi e mori veten. Dreka mbeti pa ngrënë. Kristaqi u kthye afër mbrëmjes.

# DITA E DYTË

E diel, 15 shkurt 1948



## MINIERA E RE E KRESHNIKËS

Në kohën që Kristaq Dvorani po bëhej gati të fikte cigaren e markës «Partizani», hyri në zyrë në mënyrë krejt të papritur ministri. Nëpunësi i kuadrit, u ngrit menjëherë në këmbë. Pas tij, pothuajse në mënyrë mekanike, u ngrit edhe ai dhe, me një buzëqeshje të druajtur në fytyrë, hodhi sytë nga dera. Ministri përshëndeti me kokë dhe në çast hoqi kapelen dhe kapotën e tij ushtarake.

Kristaq Dvorani i dha dorën atij me një lëvizje krejt të natyrshme dhe pastaj bëri një hap prapa në mënyrë që t'i hapte rrugën ministrit për të hyrë në zyrën e tij.

— Ejani, — tha ministri në mënyrë të rrufeshme.

Ai u buzëqeshi të gjithëve dhe pastaj e ndali vështrimin e tij të mprehtë te shtati i gjatë i Kristaq Dvoranit, i cili që në pamjen e parë i la përshtypje të mirë.

— Hajde, — tha prapë ai, duke i shtrenguar kra-hun me dashamirësi.

Ata i buzëqeshën njëri-tjetrit dhe pastaj ministri, duke kaluar përmes derës gjysmë të hapur, hyri me të shpejtë në zyrën e tij.

Ndërkohë që Kristaq Dvorani po mendonte se në cilin krah të tryezës së gjatë në formë T-je duhej të zinte vend, Jaho Abazi, që e kishte pikasur këtë, i bëri shenjë me dorë që të ulej në njërën nga karriget e

krahut të djathtë. Si drejtoi mirë trupin e tij të hollë e të lartë, Kristaq Dvorani tërhoqi prapa një karrige dhe u ul përmbri nëpunësit të kuadrit. Në krahun tjetër, përballë tyre, u ulën dy kolegët e të njëjtit profesion, gjeologët Dhori Grabocka dhe Petrit Ardënica. Kristaq Dvorani, ngaqë i dukej vetja disi i huaj ndër-mjet tyre, përpiquej që të mos e linte një përshtypje të tillë. Ministri kishte nxjerë kutinë e duhanit dhe, duke dredhur një cigare me duhan të grirë, vazhonte ta vështronte me bishtin e syrit. Ai krijoi përshtypjen se Kristaq Dvorani ishte një djalë i aftë, i gatshëm për të marrë përsipër çdo detyrë që mund t'i ngarkohej. Ministri u tha që secili ta ndizte nga paqeta e vet, pasi duhani që pinte ishte shumë i fortë. Nëpunësi i kuadrit u përgjigj në emër të të pranishmëve se sapo i kishin fikur cigaret. Kristaq Dvorani donte të dinte se si do të dilte ministri te çështja, për të cilën e kishin thirrur. Mirëpo, me sa po shikonte, ai e kishte marrë aq shtruar, saqë dukej sikur s'kishte asgjë me rëndësi për të thënë. Ai e drodhi cigaren e tij qetë-qetë, duke bërë ndonjë shaka të vogël, dhe pastaj filloi ta lagte me majën e gjuhës. Qëndrimi i tij në karrige ishte aq i natyrshëm, saqë mund të thoshe pa frikë se nuk i shkonte aspak uniformës ushtarake me spalinat e gjeneralit. Jaho Abazi qëndronte pranë tyre fare i shkujdesur dhe fliste me ca fjalë të thjeshta, që të linin përshtypjen se ata ishin mbledhur për të bërë muhabete. Kjo i dha mundësi Kristaq Dvoranit që t'i hidhte një sy zyrës së tij të thjeshtë, e cila, përveç tryezës së madhe në formë T-je, karrigeve të drunjta dhe kasafortës së hekurt, që kishte në krahun e djathtë, s'kishte asgjë tjetër. Në muret e bardha e të larta, sipër mbi kokën e tij, ishte varur një portret i Komandantit të Përgjithshëm; në krahun tjetër, përballë dritareve të veshura me perde ngjyrë vishnje, ndodheshin katër portretet e klasikëve, kurse në fund të zyrës që varur një hartë e madhe e Shqipërisë. Këto ishin të gjitha pajisjet e zyrës së tij, të cilën Kristaq Dvorani e kishte përfytyruar disi ndryshe; me mobil-



je të reja prej dru arre, me një qilim të madh persian si edhe me një llampadar me zinxhirë bronzi të errët.

— A e dini përse ju kemi thirrur? — tha Jaho Abazi në mënyrë të papritur dhe me vështrimin mbërthyer mbi sipërfaqen e lëmuar të tryezës së tij të punës.

Kristaq Dvorani, duke mos ditur se ç'përgjigje të jepte, ngriti supet dhe buzëqeshi lehtë, duke vështruar në fillim nga ministri dhe pastaj nga të tjerët.

Jaho Abazi qeshi me zë.

— Sigurisht s'keni se si ta dini, — u përgjigj vetë ministri, duke i dhënë papritur një pamje të qeshur fytyrës së tij të rrudhur para kohe.

Në zyrë ra një heshtje e rëndë. Të gjitha fytyrat u bënë serioze.

Ministri kaloi vetëtimthi dorën nëpër flokët e tij të drejtë që i kishin rënë mbi ballë dhe me një ton solemn tha:

— Lufta, shokë, na shkaktoi dëme të mëdha dhe e la vendin tonë në gjendje të mjerueshme. Mirëpo Partia, ashtu si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare edhe mbas çlirimit të vendit është vënë në ballë të punës dhe po udhëheq me vendosmëri rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit tonë. Siç po e shikojmë, ajo jo vetëm që po përpiqet të mbyllë plagët e kohës së luftës, por në të njëjtën kohë po bën përpjekje për të ndërtuar vepra të reja, siç janë hekurudha Durrës-Peqin dhe ajo Durrës-Tiranë, e cila sapo ka filluar. Po kështu me sukses po ndërtohet hidrocentrali i parë shqiptar në Selitë, që mban emrin e Leninit të madh... Sikurse e dini fare mirë, një sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë sonë është edhe industria nxjerrëse, e cila, si çdo sektor tjetër, u dëmtua rëndë nga lufta. Dy-tre vjet më parë ne nuk mund t'i futeshim punës në të gjitha drejtimet dhe sektorët. Përse? Sepse mungonte organizimi, mungonin specialistët dhe mjetet e nevojshme teknike e financiare, mungonte dhe dokumentacioni, të cilin na e vodhën të huajt... Pra, neve na duhej që ta nisnim çdo gjë nga e para. Dhe, meqë nuk kishim for-



ca e mjete për të punuar frontalisht, filluam me naftën, sepse pa naftën dhe benzinën vendi nuk mund të hidhte asnjë hap përpara. Si rrjedhim, minierat e bakrit e të kromit, të serës e të qymyrgurit mbetën për një kohë të pashfrytëzuara.

Jaho Abazi thithi cigaren e tij të dredhur dhe, si qëndroi një copë herë në heshtje me një pamje të menduar, ngriti sytë nga Kristaq Dvorani dhe tha:

— Minierat, shokë, janë mbështetja kryesore e sektorit shtetëror, prandaj shfrytëzimin e tyre ne duhet ta marrim me seriozitetin më të madh. Kjo është një direktivë e Partisë, që na ngarkon me detyra të vështira ne punojësit e industrisë sonë të re minerare. Në të ardhmen minierat do të bëhen kolona kryesore e industrisë së rëndë, sepse ato do t'i japin ekonomisë sonë lëndët e para tepër të çmueshme. Produktet e minierave tona në të ardhshmen do të jenë buka e industrisë sonë dhe burimi kryesor i eksportit. Mbase të gjitha këto që po ju them, shokë, — nënvizoi ai, — hëpërhe duken si një ëndërr. Ato do t'i kthejmë në realitet me punën dhe djersën tonë, pa pritur që të na i bëjnë gati të tjerët... Sigurisht, ndihmat e vendeve vëllezër, — shtoi pas pak ai, — ndoshta nuk do të na mungojnë, por, sidoqoftë ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast fjalën e urtë të popullit tonë punëtor: «I zoti e nxjerr gomarin nga balta!» thotë ai. Apo jo, shokë?

Ata qeshën me zë dhe tundën kokat në shenjë miratimi. Bashkë me ta qeshi edhe Jaho Abazi.

— Ne, — tha pas pak ai, duke ngritur zërin, sikur të donte të nxirrte inatin që kishte me dikë, — kemi forca dhe energji jo vetëm për të vënë në shfrytëzim mjaft nga minierat e shkatërruara dhe të mbyllura që nga koha e luftës, por... të hapim edhe miniera të reja, shokë... Dhe... e tillë do të jetë miniera e re e Kreshnikës, për të cilën qeveria, pasi diskutoi, vendosi këto ditë që ajo të hapet me forcat tona... Qeveria ka vendosur që në vendin ku do të hapet miniera të nisët që nesër një ekspeditë, të cilën kemi menduar ta kryesoni ju, shoku Kristaq.



Ai i tha këto fjalë në një mënyrë të tillë, sa që Kristaq Dvoranit iu duk vetja sikur të ishte në ëndërr. Ai shtangu për një çast. Si tha? Një ekspeditë e kryesuar prej tij?! Por si ishte e mundur që të kryesonte një ekspeditë gjeologjike ai që s'kishte pothuajse fare haber nga kjo punë? Ai priste çdo gjë dhe ishte përgatitur shpirtërisht që të shkonte në çdo skaj të Atdheut, por jo me një detyrë të tillë kaq të vështirë dhe në një sektor të panjohur për të. Jo. Në asnjë mënyrë nuk do të pranonte të merrte përsipër këtë detyrë. Po ta pranonte, ai do të turpërohej, me siguri që do të turpërohej. Të kundërshtonte? Jo, këtë nuk mund ta bënte. Ai ishte komunist dhe, për një komunist kundërshtimi është një turp i pashlyeshëm. Të pranonte, edhe kjo ishte pothuajse e pamundur.

— Ç'mendoni, Kristaq? — pyeti Jaho Abazi me një ton krejt familjar.

— Asgjë, asgjë, — murmuriti ai dhe shkundi kokën që të vinte në vete.

— Pra, — vijoi të thoshte minisri, — pikërisht për këtë arsye ju kemi thirrur sot këtu. Çështja, sikurse e shihni, është urgjente, prandaj ju thirrëm sot, që është e diel. Duke qenë se nuk mund ta shtyjmë nisjen e ekspeditës as edhe një ditë më tej, qysh nesër duhet të udhëtoni për në Kreshnikë. Në krye të javës ne duhet t'i raportojmë qeverisë se u krye shpërthimi i parë... Specialistët tanë këtu janë të mendimit që shfrytëzimi të fillojë në sipërfaqe, ndërsa më vonë, krahas shfrytëzimit në sipërfaqe, të fillohet nga puna për hapjen e galerive. Apo jo, more shokë? — pyeti ai, duke u kthyer nga të dy inxhinierët që po e dëgjonin në heshtje.

— Si urdhëroni? — iu përgjigj Dhori pyetjes së papritur të ministrit.

Kristaq Dvoranit po i dukej vetja si në ëndërr. Miniera e re e kromit në Kreshnikë! tha me vete ai. Ky emër tingëllonte pothuajse i huaj në veshin e tij. Ai kishte dëgjuar për Kuçovën, për minierën e serës në Selenicë, për minierën e qymyrgurit në Mborje-



-Drenovë dhe atë të Kërrabës, ndërsa për minierën e Kreshnikës... ai nuk dinte gjë... Madje, ai nuk dinte, me saktësi se ku ndodhej ky vend me emrin e çuditshëm Kreshnikë... Si do të ishin, vallë, këta kreshnikasit, me të cilët ai do të kishte të bënte në të ardhmen? E përse të ikim nga Tirana? jehoi diku në thellësi të trurit të tij zëri i së shoqes. Përse? Le të ikin të tjerët. Cilët? Ata, që nuk e shkrepen asnjëherë gjatë Luftës, ata që... kurse ne... E përse luftove ti?... Një kaos i vërtetë mendimesh vërtitej në trurin e tij të lodhur. Si të bënte? Të pranonte të shkonte në krye të një ekspedite për të vënë në shfrytëzim minierën e re të kromit në Kreshnikë?

Kristaq Dvorani e humbi për një çast dhe kjo gjë u ra menjëherë në sy të pranishmëve. Ministri hodhi sytë nga harta e Shqipërisë që ndodhej e varur në mur. Njëri nga specialistët dhe, pikërisht Dhori, u ngrit në këmbë.

— A e dini ku bie Kreshnika? — pyeti Jaho Abazi me dashamirësi.

Kristaq Dvorani ngriti supet.

— Jo, — tha ai.

I përpirë nga biseda, ai gati kishte harruar se ndodhej në njërin nga dikasteret qendrore më të rëndësishme të Republikës. Për një çast iu duk, se ishte në një orë mësimi të lëndës së gjeografisë, prandaj i erdhi rëndë që nuk e dinte se ku ndodhej ai vend që mbante emrin e çuditshëm Kreshnikë.

— Ja këtu, — tha Dhori, i cili po rrinte në këmbë pranë hartës, sikur të ishte një mësues i vërtetë gjeografie!

Kristaq Dvorani buzëqeshi.

— Në të vërtetë ky emër nuk figuron në hartë, — foli papritur ministri. — Por ne shpresojmë që së shpejti ai do të bëhet i njohur jo vetëm brenda vendit, po edhe jashtë tij.

Kristaq Dvorani ktheu kokën përsëri nga harta, duke i dhënë fytyrës së tij simpatike një pamje edhe më serioze.



— Specialistët tanë, — vijoi pas pak ministri, duke pasur parasysh Dhorin, Petritin e ndonjë tjetër, — thonë se kromi i Kreshnikës është i një cilësie shumë të lartë. Për sa u përket rezervave, ato nuk janë llogaritur ende.

— Kjo është e vërtetë, — shtoi aty për aty Petriti, i cili deri tani e kishte ndjekur bisedën në heshtje.

Nëpunësi i kuadrit vështronte herë njërin dhe herë tjetrin. Atij iu bë qejfi në mënyrë të veçantë kur ministri përdori shprehjen «specialistët tanë». Ashtu është, tha me vete ai. Pavarësisht nga... kemi edhe ne specialistët tanë... që...

Kristaq Dvorani ia nguli sytë për një copë herë të gjatë Petritit, pastaj u kthye nga ministri. Jaho Abazi po dridhte një cigare tjetër.

— Pra, kështu, — tha nëpër dhëmbë ai, ndërsa po lagte me majën e gjuhës letrën e cigares. — Detyra për hapjen e kësaj miniere të re ju është ngarkuar pikërisht juve, shoku Kristaq.

Kristaq Dvorani buzëqeshi lehtë dhe pastaj lëvizti pak në karrige. Ndoshta nuk do t'ia arrij qëllimit, mendoi ai për një sekondë, po aty për aty një zë tjetër i thoshte të kundërtën.

— Sgurisht, kjo është për ju një gjë krejt e papritur, një detyrë e vështirë e me përgjegjësi, — tha ministri me buzë në gaz.

Kristaqi filloi të vriste përsëri mendjen. Vërtet. Si do ta kryente ai këtë detyrë, si do të drejtonte ai një ekspeditë gjeologjike dhe si do të vinte në shfrytëzim një minierë të re, që nuk figuronte as në hartë.

— Ne e dimë, — tha prapë ministri, — se ju do të ndodheni para shumë vështirësishë... por... kjo është detyrë Partie... Dhe ju, si komunist, jo vetëm që duhet ta kryeni atë, por... më njëzet shkurt një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë duhet t'i raportoni Partisë se miniera e kromit në Kreshnikë u vu në shfrytëzim! Pra, keni në dispozicion vetëm pesë ditë!

— Vetëm pesë ditë?! — pëshpëriti nëpër dhëmbë Kristaq Dvorani. — Por a është e mundur që...

Kjo ishte një e papritur tjetër, që e turbulloi edhe më shumë. Vetëm pesë ditë?! Po si mund të vihej në shfrytëzim një minierë e re brenda një kohe kaq të shkurtër?

Ministri ndezi cigaren.

— Më datën njëzet shkurt, — tha prapë ai, duke i dhënë një pamje serioze fytyrës së tij, — ju duhet të kryeni patjetër shpërthimin e parë...

Përse, vallë, një afat kaq i shkurtër?! Vetëm pesë ditë! Po si ishte e mundur që... «Kjo është një detyrë Partie», jehoi përsëri zëri i ministrit diku në thellësi të ndërgjegjes së tij.

— Mirë, — tha Kristaq Dvorani me një zë të dobët. — Dakord jam! Vetëm se...

Fytyra e tij ndriti në mënyrë krejt të papritur nga një ndjenjë e brendshme e pakuptueshme.

— Vetëm se doni të dini kushtet, — ia priti Dhori me buzën në gaz.

— Po.

Jaho Abazi qeshi me zë.

— Ngado që të kthehem, — tha ai, — neve na dalin vështirësi të panumërta, prandaj le të mendojmë më mirë se nga do t'ia fillojmë... pa... s'ka kala që nuk marrin komunistët...

Të gjithë qeshën me gjithë shpirt. Nëpunësi i kuadrit mbajti një shënim në bllokun e tij.

Dhori filloi t'u fliste të pranishmëve për minierën e ardhshme të kromit.

— Në këtë rajon, — tha ai duke hedhur vështrimin nga harta, — gjatë luftës kanë bërë studime edhe disa specialistë italianë... Duke pyetur vendasit, ndoshta, nuk do ta keni vështirë për ta gjetur vendburimin... Kështu vepruam edhe ne një vit më parë dhe... vetëm se tani vendi është i mbuluar me dëborë... kështu që... Sidoqoftë me ju do të jetë edhe «inxhinier» Baudin Kazazi, i cili e di pak a shumë se ku ndodhet vendburimi...

Në vijim të bisedës ata diskutuan për mjaft hollësira që kishin të bënin me organizimin e punës.



— Atje nuk do të gjeni asgjë, — tha i shkujdesur Dhori, — prandaj disa punëtorë dhe materialet më të domosdoshme si motokompresorin, barominat, lëndën eksplozive, sende të ndryshme, veshmbathje dhe disa ushqime të thata do t'i merrni në minierën fqinjë «Ylli i kuq». Ne kemi biseduar për këtë çështje me drejtorin e minierës, shokun Xhavit Çeliku, i cili u tregua plotësisht i gatshëm. Ai do t'ju japë çdo gjë, që ju nevojitet hëpërhë, sa për të filluar punimet. Kur të mbërrini në vend, kërkoni edhe ndihmën e banorëve të Kreshnikës. Aty do të gjeni me siguri forca punëto-re. S'ke ide se ç'njerëz të mirë që janë. Po të hasni vësh-tirësi, sidomos ditët e para, drejtojuni shokëve në rreth. Ata janë në dijeni të vendimit të qeverisë për hapjen e minierës së re, prandaj nuk kanë për t'u kursyer për asgjë.

Ministri po e ndiqte bisedën me vëmendje. Herë pas here ai tundte kokën në shenjë miratimi.

— Sigurisht, ju do të ndesheni atje edhe me vë-sh-tirësitë e motit, — ndërhyri pas pak ai. — Dimri në Kreshnikë është tepër i ashpër. Tani atje bie dëborë. Por ne nuk duhet të presim sa të shkrijë dëbora dhe pastaj të fillojmë punimet. Vënia në shfrytëzim e kësaj miniere, — theksoi me një ton solemn ai, — nuk ka vetëm leverdi ekonomike, por edhe një rëndësi të madhe politike... Ne duhet t'u tregojmë armiqve dhe... përse jo dhe miqve... se jemi në gjendje që... të jetojmë me djersën tonë, po të jetë nevoja...

Jaho Abazi i shqiptoi këto fjalë në një mënyrë të veçantë dhe aty për aty i dha fytyrës së tij një pam-je tepër serioze, gati kërcënuese.

— Po, shokë, — tha përsëri ai. — Me djersën tonë... Populli shqiptar ka jetuar kurdoherë me djersën e tij. Edhe një herë po ju kujtoj afatin: më njëzet shkurt duhet të raportoni se u krye shpërthimi i parë... Pra kështu, — thirri papritur ai dhe u ngrit instinktivisht në këmbë. — Duhet të realizohet patjetër dhe shpër-thimi i parë... dhe pastaj... jehona e tij le të oshëtijë ndër shekuj... Ne shqiptarët...



Ai po thoshte disa fjalë gati të pakuptueshme për të pranishmit. Ata ishin ngritur në këmbë dhe për një copë herë të gjatë qëndruan si të ngrirë.

Pas pak ministri e la karrigen dhe u drejtua nga Kristaq Dvorani. Fytyra e tij po zbutej gradualisht; në çastin që po i shtrëngonte duart, ai i buzëqeshi Kristaqit me gjithë shpirt. Kristaq Dvoranit i dukej sikur njihej prej kohësh me Jaho Abazin. Ministri e përcolli atë gjer te dera dhe i dha edhe një herë dorën, duke e përçafuar me mallëngjim.

— Sukses! — i tha.

Kristaq Dvorani u takua edhe me nëpunësin e kuadrit dhe pastaj u largua, duke shtrënguar fort në duar shapkën e tij ngjyrë hiri. Kapota nuk i rrinte mirë pas trupit, sepse ishte ca e gjerë për trupin e tij të hollë e të lartë. Pikërisht për këtë Jaho Abazi filloi të vështronte me keqardhje.

Dhori dhe Petriti e përcollën Kristaqin gjer poshtë, te hyrja kryesore e ndërtesës së Ministrisë së Industrisë dhe Minerave. Para se të ndaheshin, i kujtuan edhe një herë atij se pasdite do të shkonin së bashku në arkiv për të shfletuar disa dokumente të vjetra që bënin fjalë për kromin e malit të Kreshnikës.

Kristaq Dvorani ia bëri me dorë nëpunësit të rojës dhe doli jashtë, duke ngritur jakën. Tek ecte nëpër trotuaret e lulishtes që ndodhej midis ndërtesave të heshtura të dikastereve qendrore, atij i dukej vetja si në ëndërr. Sa herë gjatë periudhës së luftës kishte marrë udhëzime dhe ishte nisur për në aksione... Mirëpo tani puna ndryshonte... Atij nuk i kërkohesh të kryente një atentat, as të hidhte në erë një urë të armikut, por të ngrinte një minierë... Të ngrinte një minierë krejt të re! Luftë është edhe kjo, tha pas pak me vete, ndërsa po kalonte nëpër sheshin «Skënderbej». Luftë si të gjithë luftërat. Një luftë e vërtetë për jetë a vdekje për ndërtimin e socializmit.

Nëpër rrugë e trotuare kishte shumë lëvizje. Flamurët e kuq, banderolat e parullat e shumta që u kush-toheshin zgjedhjeve të reja, dridheshin nga era e akullt.



## KUDO JETOJNË NJERËZ

Ora po shkonte tre. Margarita duhet të ketë ngrënë drekë, tha me vete Kristaq Dvorani, ndërsa po ngjiste shkallët që të çonin në banesën e tij. Por e vërteta qëndronte krejt ndryshe. Ajo e kishte shtruar tryezën dhe priste me padurim të shoqin.

— Hë, ç'të thanë? — pyeti Margarita, sapo e pa atë në korridorin e gjatë që kalonte para derës së kuzhinës.

Ai buzëqeshi dhe nuk tha asgjë. Fytyra i dukej disi e lodhur dhe pak si e zbehtë, kështu që buzëqeshja i doli krejt artificiale. Hoqi shapkën dhe kapotën e murme dhe, si e vari atë në korridor, hyri në kuzhinë, duke krehur flokët me gishtërinjtë e duarve.

— Hë de, pa më thuaj: ç'të thanë? — pyeti përsëri e shoqja.

Ajo po rrinte si e ngrirë, me pëllëmbët e duarve të kryqëzuara përpara, në një mënyrë krejt të panatyrshme.

— Asgjë, — tha pas pak Kristaq Dvorani.

— Si «asgjë»?! — u zemërua Margarita. — Ti ishe në takim me ministrin. Apo jo?

— Po.

— Epo, atëherë, më thuaj, çfarë të thanë?

Sytë e Kristaq Dvoranit u ndeshën me sytë e ndritshëm të së shoqes. Ajo vazhdonte të rrinte në mes të kuzhinës si e ngrirë. Dukej tepër e shqetësuar.

Rudina flinte në krevatin e vet që ndodhej tutje thellë mu në qoshe të dhomës së gjumit.

— E dashur grua, — tha Kristaq Dvorani. — Uromë, se u bëra shef...

Ai u sul në drejtim të saj me dorën të zgjatur përpara, sikur të kishin vite pa u parë. Margarita rroku dorën e tij akull të ftohtë, kurse fjalët që donte të thoshte iu grumbulluan në grykë dhe u bënë porsinjë lësh. Përse ta uronte vallë? Në sytë e saj dukej një lloj shqetësimi.

— Vërtet?! — tha pas pak Margarita, duke ngritur sytë drejt fytyrës së tij. — Po çfarë shefi?

Vështrimi i tyre u takua përsëri në një pikë. Sytë e Margaritës me bishta ndritën edhe më shumë.

— Shef i një ekspedite gjeologjike që do të shkojë në Veri për të hapur një minierë të re kromi.

— Ashtu?

— Po.

— Kur do të niseni?

— Qysh nesër.

— Kaq shpejt?!

— Po. Është vendim qeverie me rëndësi të madhe ekonomike dhe politike. Brenda javës ne duhet të kryejmë shpërthimin e parë.

Ata u ndanë nga njëri-tjetri, pa e vënë re një gjë të tillë. Veprimet e tyre ishin pothuajse mekanike. Një copë herë qëndruan në heshtje. Margarita po hidhte gjellën nëpër pjata.

— Po habitem, — tha ajo.

— Përse?

— Si është e mundur? Kaq shpejt mund të hapet një minierë?!

Kristaq Dvorani qeshi me zë. Ai hapi shishen e verës, që s'dihej se kur e kishin fshehur në fund të bufesë, dhe pastaj tha:

— Po atje minerali është në sipërfaqe, grua e dashur, dhe ne do ta fillojmë shfrytëzimin pa hapur galeri. A më kupton?

— Aha! — ia bëri Margarita.



Si nëpër mjegull asaj i erdhën ndër mend gale-  
ritë e thella të minierës së qymyrgurit që ndodhej në  
afërsi të fshatit të tyre dhe pastaj iu zhdukën nga  
truri i lodhur po me të njëjtën shpejtësi. Ajo u mun-  
dua të përfytyronte një minierë pa galeri, mirëpo kjo  
qe e pamundur për të.

I shoqi sapo i kishte mbushur gotat me verë të  
kuqe dhe po trazonte sheqerin që kishte hedhur në  
gotën e saj. Margarita e pinte vazhdimisht verën me  
shumë sheqer dhe këtë zakon të saj Kristaq Dvorani  
s'e harronte kurrë.

— Si quhet vendi ku do të hapet miniera e re? —  
pyeti Margarita.

— Kreshnikë.

— Kreshnikë?!

— Po. Kreshnikë, për afërsisht, do të thotë vend  
heroik, që banohet nga njerëz bujarë dhe trima njëko-  
hësisht.

— Ashtu? — tha Margarita.

Ajo u ul në karrigen përballë tij.

— Kristaq, — tha ajo, — thuamë të vërtetën: a të  
vjen keq që po largohesh nga Tirana?

— Jo.

— Kurse mua, se si më duket. S'di si të të them!

— Jo, — tha prapë ai. — Mua nuk më vjen aspak  
keq. Kudo jetojnë njerëz. Për sa më përket mua, unë  
do të thosha se ne jemi nga ata njerëz që mund të  
bëjnë një jetë të rregullt familjare qoftë edhe në një  
kasolle me kashtë!

Margarita buzëqeshi.

— Nga e di ti këtë?

— E di, si nuk e di. Dashuria ndërmjet nesh është  
një forcë shumë e madhe. Pastaj, ne jemi të bindur se  
sakrificat e përkohshme i bëjmë për hir të së ardhmes,  
për të cilën ne jemi të bindur se do të jetë më e lum-  
tur. Apo jo?

Margarita e shikoi të shoqin në sy.

— Hajt, gëzuar! — tha Kristaq Dvorani, duke ngritur  
gotën i pari.

— Gëzuar! — tha edhe Margarita me një ndjenjë shqetësimi diku në thellësi të ndërgjegjes së saj. — Sukses në detyrën e re!

— Ta pimë për të ardhmen tonë të ndritur! — tha pas pak Kristaq Dvorani, në kohën që po bëhej gati ta vinte gotën në buzë.

Margarita buzëqeshi me dashamirësi dhe ndërkaq filluan të hanin drekën.

— A jeni shumë veta? — pyeti Margarita.

— Këtej nga Tirana jam unë, një gjeolog dhe shoferi që do të na çojë në vend.

— Vetëm kaq.

— Po. Gjatë rrugës do të ndalemi në minierën «Ylli i kuq» që është një minierë bakri diku në afërsi të Kreshnikës; aty do të marrim disa minatorë dhe materialet e nevojshme për fillimin e punimeve.

— Po ai gjeologu a do ta marrë familjen në Kreshnikë? — pyeti Margarita me njëfarë dinakërie.

— Gjeologu? — tha Kristaq Dvorani i kapur në befasi. — Të them të drejtën... ai më duket se është beqar, kështu që...

— Ah, pa shiko si na qenka puna, — tha Margarita. — Domethënë vetëm ti je familjar?!

Ajo lëshoi lugën nga dora dhe ngadalësoi papritur të ngrënët. Një copë herë ata hëngrën në qetësi.

Nëpër derën e hapur dukej një pjesë e dhomës së gjumit, krevati dopio i rregulluar me kujdes dhe i mbuluar me një mbulesë ngjyrë ari, një komodinë e vogël e mbi të një abazhur i vjetër, që s'dihej se në sa duar kishte kaluar, një pasqyrë tualeti që Margaritës ia kishte falur e ëma dhe krevati i Rudinës së vogël në qoshe, pranë oxhakut të zjarrit. Oxhaku ishte me të vërtetë i bukur. Si dukej, Veli beu, ish-pronari, duhej të kishte qenë i dhënë pas oxhaqeve angleze! Kristaq Dvorani e kishte shndërruar atë në bibliotekë, duke vendosur mjaft libra të zverdhur nga koha. Aty-këtu dukeshin edhe libra të rinj që i blinte herë pas here.

Pas pak Margarita e theu heshtjen.



— Kristaq, — tha ajo. — Kam për të të thënë diçka, por të lutem mos ma merr për të keq.

— Fol, — tha ai.

— Dëgjo, ti e di që unë nuk jam rritur në qytet, prandaj, në fund të fundit, nuk më bën ndonjë përshlyetje të madhe që do të largohemi nga Tirana. Vetëm se... se si më duket që do të shkojmë për të jetuar në një fshat krejt të panjohur, diku në Veri të vendit... Ndoshta edhe klima do të jetë tepër e ashpër... Ne jemi me fëmijë të vogël dhe... Si të të them? Sikur të të kishin emëruar në minierën e fshatit tonë, puna do të ishte krejt ndryshe. Atje ne të dy kemi prindërit dhe... Dua të them se edhe atyre do t'u bëhej qejfi, ndërsa tani... Nuk di si të të them... Se si më duket që do të shkojmë për të jetuar në një vend të panjohur...

Ai vazhdonte të hante në heshtje. Piu verë, pa thënë «gëzuar», siç bënte vazhdimisht kur ishte në qejf. Si dukej, nuk e kishte mendjen aty. Kjo ishte me të vërtetë e tmerrshme. Ajo mendoi se i shoqi ishte zemëruar për të gjitha ato që i tha. Në të vërtetë kishte të drejtë të zemërohej, sepse ata e kishin rrahur këtë problem. Si dukej, ajo kishte rënë dakord me të vetëm me fjalë, ndërsa në vetvete, në ndërgjegje diçka e mundonte. Në qenien e saj vepronin, si të thuash, dy forca: njëra që e shtynte përpara, dhe kjo ishte më e fuqishme, dhe tjetra që e tërhiqte mbrapsht dhe e bënte që të lëkundej për t'u larguar nga Tirana. Kristaq, ti ke shumë të drejtë të më qortosh, po thoshte me vete ajo, ndërsa hante e zhytur në mendime. Unë nuk jam... unë nuk jam... Por mendimi nuk i dilte i plotë. Me një zë të dobët, krejt të dobët e gati duke pëshpëritur i pari e theu heshtjen Kristaqi.

— Ti je shumë e lodhur, Margarita!

— Po, — tha ajo. — Ti ke shumë të drejtë. Se si më duket vetja. S'di si të them. Transferimi yt ishte një gjë krejt e papritur për mua. S'e prisja fare, prandaj... ndoshta nga kjo edhe jam e turbulluar...



Megjithëse u mundua të buzëqeshte, në të vërtetë sytë e saj dukeshin më tepër të mallëngjyer sesa të gëzuar. Kristaqi buzëqeshi gjithashtu, por edhe buzëqeshja e tij ishte e druajtur, e shtirur, si të thuash sa për t'i bërë qejfin së shoqes.

— Ndoshta do të na bëjë mirë klima e ashpër e Kreshnikës, — tha pas pak, duke u munduar të buzëqeshte përsëri. — Hajt gëzuar!

Ajo ngriti gotën e verës dhe e vështroi të shoqin drejt e në sy. Në çast edhe ai ngriti gotën e tij. Gotat u takuan, duke lëshuar një tringëllimë të gëzueshme.

— Gëzuar! — tha edhe Kristaq Dvorani.

— Gëzuar! — tha prapë Margarita, duke e ngritur zërin.

Ora po shkonte katër pa një çerek. Ata u ngritën nga tryeza e bukës në heshtje. Margarita iu afrua të shoqit, e rroku dhe e shtrëngoi pas vetes. Vera e kishte turbulluar. Kristaq, a më beson? tha ajo me vete. Unë të dua ty, sa s'ta pret mendja. Kurse ti kujton se... Ajo po rrinte pranë tij e palëvizur si e ngrirë... Ai e puthi përsëri te flokët. Kristaqit iu bë qejfi që ajo tregojë e dashur me të. I pëlqente era e saj, prandaj nuk donte që ajo të shkëputej prej tij. E përqafoi dhe e puthi përsëri, po ajo u shkëput me kujdes dhe shkoi në drejtim të shtratit të Rudinës së vogël, e cila ishte zgjuar dhe ia bënte: «A, a, a!», sikur të donte të këndonte.

— Kristaq, pa shiko sa e mirë që është. Porsi një kukull!

Kristaq Dvorani shkoi në drejtim të shtratit të vogël ku ndodhej e bija. Ai e donte shumë Rudinën. Dashurinë për të bijën Kristaqi nuk e shprehte me fjalë, po me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë, me një buzëqeshje të një lloji të veçantë, ku merrnin pjesë vetëm sytë e tij ngjyrë kafe.

— Yllkë moj! — po thoshte Margarita, duke e marrë të bijën në duar. — Ti na e heq gjithë mërzitjen. Sa e mirë që është! — vazhdonte t'i thoshte të shoqit.



Ndërkohë Rudina e vogël po shkrihej së qeshuri, duke lëvizur këmbët e doçkat e saj të vogla. Sytë ia kishte ngulur të atit. Gati sa nuk fluturonte nga gëzimi.

— Pa shiko sa të do, — i tha Margarita të shoqit. — Merre një çikë.

Ai e rrëmbeu me të dyja duart dhe e ngriti drejt tavanit. Rudina e vogël vazhdonte të qeshte me zërin e saj të hollë.

— Ngadalë, ngadalë, — i tha e shoqja. — Ç'bën ashtu?! Ajo është ende e vogël, nuk bën ta hedhësh në atë mënyrë.

Margarita ia rrëmbeu vajzën nga duart dhe filloi t'i vishte një bluzë të kuqe. Kristaq Dvorani po shëtiste nëpër dhomë, duke hedhur vazhdimisht sytë nga e bija, e cila, si dukej, donte të shkëputej nga duart e s'emës, për të shkuar tek i ati.

Jashtë po binte një shi i imët. Kristaq Dvorani duhej të shkonte në arkivin e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave për të marrë të dhënat që i nevojiteshin ekspeditës së tyre gjeologjike. Të nesërmen në mëngjes ata duhej të niseshin drejt Kreshnikës së largët.

## NË ARKIVIN E MINISTRISË

Në arkivin e ministrisë ata mbaruan punë shumë shpejt, sepse ndërkohë që Kristaq Dvorani mendonte se aty do të gjenin dokumente të vlefshme, që bënin fjalë për kromin e minierës së re të Kreshnikës, ndodhi krejt e kundërta.

E vetmja gjë e vlefshme që gjetën ishte një shënim anonim ku thuhej: «Në Kreshnikë duhen bërë kërkime gjeologjike me sonda dhe galeri, që të përcaktohen rezervat e mundshme të mineralit të kromit në këtë rajon.»

— Vetëm kaq? — i tha Baudin Kazazi nëpunëses së arkivit me keqardhje.

— Vetëm kaq, — tha edhe ajo, duke ngritur supet.

Kristaq Dvorani vështroi në fillim nga Dhorë e pastaj nga Petriti. Ata po ndiqnin në heshtje lëvizjet e duarve të nëpunëses së vjetër të arkivit.

— Si kështu? — tha pas pak Baudin Kazazi, duke rregulluar me gishtin tregues syzet e tij optike.

Fytyra e tij anemike dukej tepër e pikëlluar. Ai u kthye nga Kristaq Dvorani dhe tha:

— Sikurse e shikoni, i dashur shef i ekspeditës, këto janë të dhënat e vetme «shkencore», që do të na shërbejnë si pikënisje për të ngritur minierën e re.

Ata qëndruan një copë herë në heshtje.

— Dihet gjithashtu se minerali i kromit të Kreshni-



kës është i një cilësie të lartë dhe ndodhet në sipërfaqe, — tha pas pak Dhori.

— E nga del kjo? — pyeti aty për aty Baudin Kazazi.

— Nga analiza e kampioneve të mineralit të kromit të Kreshnikës si edhe nga studimi i dokumenteve të minierave të tjera, — tha Petriti. — Ne diku e kemi parë një material të tillë, po tani nuk na kujtohet se ku ndodhet.

Ata u larguan nga arkivi të pakënaqur. Dy-tri minuta më vonë ishin në zyrën e specialistëve të shfrytëzimit.

— Nga t'ia fillojmë? — pyeti Baudin Kazazi.

Fytyra e tij e ngurosur fliste qartë se ai nuk kishte dëshirë të shkonte në Veri me një ekspeditë të tillë. Misioni i saj me sa dukej do të dështonte, por, meqë ishte urdhëruar, s'kishte se si të vepronte ndryshe.

— Të bëjmë njëherë një listë të materialeve që duhet të marrim me vete, — tha Kristaq Dvorani.

Baudini nxori nga sirtari një letër të bardhë, e cila, mbasi të shkruhej, do të ishte dokumenti i parë i minierës së ardhshme të kromit. Dokumenti i parë, tha me vete Kristaq Dvorani. Dhe, aty për aty, se pse i erdhi ndër mend certifikata e lindjes e Rudinës së tij të vogël. Edhe minierat kanë jetën e tyre, mendoj ai. Edhe ato lindin dhe vdesin një ditë njëlloj si edhe njerëzit. Tiranë, më 15 shkurt 1948. Ekzemplar i vetëm. Listë materialesh. Baudin Kazazi sapo i kishte shkruar këto fjalë.

— Hë, nga t'ia fillojmë? — pyeti përsëri ai me një ton jo të zakonshëm.

Kristaq Dvorani ktheu kokën nga Dhori, pastaj nga Petriti. Ngaqë nuk dinte se ç'gjëra ishin më të domosdoshme për një minierë të re, që ende nuk kishte dalë në dritë, ai la të kuptohej se me një punë të tillë duhej të merreshin ata, specialistët e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave.

— Shkruaj, — tha Dhori, duke vënë gishtin tregues mbi letrën e bardhë. — Një motokompresor, ka-

tër pistoleta, shtatë baromina dore, pesë arka me lëndë eksplozive.

Baudin Kazazi shkruante, pa e ngritur kokën nga letra e bardhë, e cila, sa vinte, nxihej nga shkronjat dhe shifrat.

Listës së materialeve ata i bashkangjitën edhe shënimin anonim që morën në arkivin e ministrisë.

Si mbaruan punë, ata zbritën shkallët e errëta të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave dhe vendosën që, ashtu siç ishin, të shkonin e të pinin nga një kafe në bar «Sahati».

Era e ftohtë vazhdonte të frynte si e tërbuar. Kallimtarët ecnin me hap të shpejtë, duke u struktur qosheve të godinave, me qëllim që t'i shmangeshin sadopak erës së akullt që të priste fytyrën.

Baudin Kazazi, shtatimët dhe i dobët fizikisht, filloi të dridhej i tëri.

— Ç'kohë e poshtë, — tha Dhori nëpër dhëmbë.

Në sheshin «Skënderbej» sapo ishin ndezur dritat shumëgjyreshe. Parullat e mëdha mbi tarracat e ndërtesave të heshtura të ministrive ndizeshin dhe shuheshin njëra pas tjetrës. «Lavdi marksizëm-leninizmit», «Rroftë Komandanti ynë i Përgjithshëm», «Rroftë Stalini», «Të gjitha votat për kandidatët e frontit», «Rroftë...». Kristaq Dvorani nuk mundi ta lexonte një-rën nga parullat që ishte shkruar me ngjyrë portokalli, pasi ata hynë në bar «Sahati».



## PËRGATITJE PËR UDHËTIM

Megjithëse i shoqi nuk ishte nisur akoma, Margarita e ndiente largimin e tij. Me bishtin e syrit ajo vështronte shtatin e tij të lartë, leshrat e dendura që herë pas here i kërcenin mbi ballë, sytë ngjyrë kafe që kërkonin gjithmonë diçka dhe duart që mbështillnin me copa gazetash sende të ndryshme të domosdoshme për udhëtim ose për të jetuar për një kohë larg familjes. Ai kishte grumbulluar mbi tryezën e bukës në kuzhinë gjithfarë sendesh: veglat e rrojës, sapun tualeti, peshqir, furçë dhe pastë dhëmbësh, ndërresa të brendshme, pe, gjilpërë dhe disa ushqime të thata. Të gjitha gjërat që po grumbullonte e që po i përgatiste për t'i marrë me vete tregonin se ata së shpejti do të ndaheshin. Margarita psherëtiu. Sa kohë do të qëndronin, vallë, pa u parë me njëri-tjetrin?! Ai endej andej-këndeje nëpër kuzhinë, në dhomën e gjumit, në korridor dhe gjithmonë sillte diçka të re mbi tryezë. Përbri qëndronte hapur valixhja, e cila do t'i përpinte të gjitha sendet e tij personale.

Margarita ishte ulur në minderin që ndodhej pranë sobës dhe punonte pa pushim; ajo kishte në dorë një pulovër që kishte menduar t'ia bënte dhuratë me rastin e ditëlindjes. Mirëpo, meqenëse Kristaqui do të nisej me ngut, ajo po përpiquej që ta mbaronte dhe t'ia jepte me vete. Sa keq që i vinte kur shikonte se

kishte ende shumë punë për të bërë. Po ta merrte veshur, mendonte ajo, ai, ndoshta, do ta kujtonte më shpesh. Një punë e përfunduar me ngut mbahet mend më shumë, thoshte me vete. Duke shtuar shpejtësinë e shtizave, ajo i hodhi një vështrim të shpejtë të shoqit dhe i buzëqeshi.

— E ke kot, — tha Kristaqi, — pulovrin nuk e përfundon dot sonte. Katër ose pesë ditë më vonë do të vijë në Kreshnikë Fatos Trebeshina, për të shkruar një artikull për gazetën «Bashkimi» për minierën tonë të re. Ky është një rast i mirë, që ti mund ta shfrytëzosh për të më dërguar çfarë të duash. Ose, s'i dihet, mund të gjej rastin të vij edhe unë...

— Jo, jo, — tha Margarita me kokëfortësi. — Do ta mbaroj sonte.

— Mirë, — tha i shoqi. — Po kam frikë se do të mundohesh kot.

Ora ishte dhjetë pa njëzet minuta. Kristaq Dvorani hapi radion. Radio Tirana po jepte këngë partizane.

Margarita filloi të shqetësohej. Ishte me të vërtetë tepër vonë. Ajo nuk mund ta mbaronte pulovrin, prandaj vendosi që ta linte dhe t'ia dërgonte pas disa ditësh me Fatos Trebeshinën. Ndoshta kështu është më mirë, tha me vete ajo.

— Çfarë do të hamë për darkë? — pyeti Kristaq Dvorani kur e pa që i kishte bërë të tëra përgatitjet e nevojshme për udhëtim.

Margarita e vështroi në sy, pa e pasur mendjen aty. S'dihej se si i erdhën në mendje, pothuajse njëherësh, takimi i parë me Kristaqin, fotografia që kishin bërë fshehurazi familjes (fotografi nuk e dinte një hille të tillë, prandaj e zmadhoi dhe e vuri në vitrinë, duke shpallur në këtë mënyrë fejesën e tyre para kohe), alarmi në familje pas kësaj ngjarjeje, nata e karnavaleve, grindja me kunatin dhe pastaj thasethemet pa mbarim...

— Çfarë? — tha ajo kur erdhi në vete.

— Thashë se çfarë do të hamë sonte.

— Ah, po! — tha Margarita.



— Gjellën që mbeti nga dreka? —

— Po! — tha prapë ajo.

Ajo vështronte të shoqin që po sorollatej poshtë e përpjetë nëpër kuzhinë pa ndonjë qëllim të caktuar dhe herë pas here i vinin në mendje copëza nga jeta e tyre para se të shpallej fejesa.

I shoqi kishte filluar të shtronte tryezën. Ai preu bukën feta-feta, përgatiti një pjatë me sallam, shtoi edhe pak djathë, ca ullinj dhe vuri midis tyre shishen e verës, që kishin hapur në drekë. Rudina e vogël vazhdonte të flinte.

— Kristaq, — i tha Margarita të shoqit, duke i dalë përpara. — Mos ma merr për keq. Jam bërë si e mpirë. S'di se si më duket që po largohesh në mënyrë kaq të papritur. Brenda tri-katër ditëve u përmbysën të gjitha planet tona. Se si më duket! Sikur do të ndahemi përgjithmonë, sikur s'do të të kem më pranë... Ah, ç'budallaqe që jam! S'dua të mendoj gjëra të tilla, por ja që aty më rri mendja...

Ajo e përqafoi Kristaqin, e puthi në faqe dhe u largua vetëtimthi në drejtim të lavamanit. Rrëmbeu disa pjata, i vuri në tryezë dhe u largua përsëri, duke i buzëqeshur të shoqit.

— Ç'po bën kështu? — tha ai. — Përse na duhen tërë këto pjata?

— Kam përgatitur një gjë që i pëlqen shumë burrit tim të dashur, — tha ajo. — A mund ta gjesh?

— Ëmbëlsirë?

— Jo.

— Po çfarë.

— Dredhanik, që ti e ha aq shumë.

— Ou?! — ia bëri Kristaqi. — Ku të paska shkuar mendja?!

— E bëra gjatë kohës që ti ishe në ministri dhe e fsheha nën bufë. Një pjesë e kam paketuar me kujdes që ta marrësh nesër me vete.

Ajo u ul përballë tij, rroku e para gotën e verës dhe i tha:

— Gëzuar dhe udhë të mbarë!

— Gëzuar! — tha edhe ai.

S'ngopeshin duke parë njëri-tjetrin. S'ka se si të jetë e këndshme ndarja, tha prapë me vete ajo. Ndërsa hanin darkë në një ambient disi të ngrohtë, Margarita mendonte se të nesërmen, që pa gdhirë mirë, ai do të nisej për në Veri, diku në një vend krejt të panjohur që mbante emrin e çuditshëm «Kreshnikë».

— Ç'mendon? — pyeti ai.

Ajo buzëqeshi prapë dhe nuk u përgjigj. Përtej derës prej xhami të akullt u dëgjua zëri i Rudinës. Ajo sapo kishte filluar të qante.

— Me siguri do të jetë lagur, — tha Margarita dhe u ngrit menjëherë nga tryeza.

— Pse nuk prite sa të hanim njëherë darkë? — tha i shoqi.

Margarita qeshi dhe për një minutë u kthye në tryezë bashkë me të bijën e cila lëvizte këmbët dhe doçkat si gaherë.

— Yllkë moj! — tha Margarita dhe e puthi me gjithë shpirt. — Po të ikën babi, moj korbë!

Rudina e vogël gati sa s'fluturonte nga gëzimi.

Radio Tirana filloi të jepte lajmet e orës së fundit. Spikeri, ashtu siç pritej, filloi komunikatën e Sekretariatit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik për zgjedhjet.

Ata i dëgjuan lajmet në heshtje të plotë.

— Mrekulli! — tha Kristaq Dvorani. — Këto janë rezultate me të vërtetë të shkëlqyeshme. S'ma merrte mendja se do të arriheshin rezultate të tilla.

Spikeri vazhdonte lajmet e jashtme. Ai foli për luftime të reja të forcave demokratike greke të gjeneral Markos, për makinacionet e partive politike me rastin e zgjedhjeve të ardhshme në Itali, për hapjen e kufirit franco-spanjoll dhe pastaj për ngjarjet në Lindjen e Mesme.

— E tërë bota zien, — tha Margarita. — Kot thonë se lufta mbaroi.

— Ne do të jemi gjithmonë në luftë, — tha pothuajse duke pëshpëritur Kristaq Dvorani.



## SHKURTIMET E SHKENCËS DHE LINGUËS

### DITA E TRETË

E hënë, 16 shkurt 1948

## DREJT KRESHNIKËS SË LARGËT

Dita e re po agonte me shpejtësi. Nëpër rrugë e trotuare kishte ende shumë pak lëvizje. Një pajton i zi kaloi nëpër rrugën e Durrësit, dhe u zhduk pastaj prapa disa ndërtesave, po troku i kuajve mbi asfalt vazhdoi të dëgjohej akoma. Gjithçka rreth e rrotull kishte ngjyrë gri në të bardhë. Mbi çatitë e banesave, mbi drurët e zhveshur që plekseshin me njëri-tjetrin, mbi supet e rrënuara të mureve të avllive dhe kudo gjetkë kishte rënë një cipë e hollë bryme. Pellgjet dhe gropat që dukeshin aty-këtu gjatë rrugës «Mine Peza» kishin zënë një shtresë të trashë akulli, që zor se mund të thyhej nga pesha e një njeriu të zakonshëm.

Kur Kristaq Dvorani dhe e shoqja dolën në trotuar përpara vilës së tyre dykatëshe, ku banonin edhe tri-katër familje të tjera, xhipsi priste në heshtje, rreth njëzet apo tridhjetë metra më larg. Si dukej, shoferi, duke mos ditur mirë se nga cila portë do të dilte shefi i ekspeditës gjeologjike, ishte ndalur aty me hamendje. Por, kur Baudin Kazazi e pa atë përmes xhamave të akullt të mbuluar aty-këtu me brymë, e urdhëroi shoferin që të ecte mbrapsht. Ata i thanë «mirëmëngjes» njëri-tjetrit dhe pastaj zbritën për ta ndihmuar. Margarita dridhej e tëra. Të ftohtit të hidhur i ishte shtuar tashti edhe gjendja e saj e rëndë shpirtërore. I dukej sikur i shoqi po nisej për në luftë,



dhe jo në krye të një ekspedite gjeologjike, për të hapur një minierë të re kromi, diku në veri të Atdheut. Papritur, porta e jashtme e oborrit të tyre kërciti dhe pas pak u shfaq aty një grua e veshur e tëra me të zeza. Ishte nënë Ulia me disa sende të paketuara ndër duar.

— Na, i merrni edhe këto me vete, o bijtë e nënë Ulisë, — tha ajo duke ecur me ca hapa të ngathët mbi trotuarin e ftohtë.

Shpina e saj, disi e kërrusur përpara, dukej sikur mbante mbi vete peshën e rëndë të kohëve tashmë të shkuara.

— Ç'janë këto gjëra, o nënë Uli? — tha Kristaq Dvorani dhe, pasi ia mori sendet që kishte ndër duar, i hodhi dorën në qafë me dashmirësi. — Është nëna e një shokut tim të ngushtë, — i tha Baudin Kazazit, që u ndodh aty pranë atë çast. — Banojmë bashkë në një shkallë dhe jemi si një familje. Nënë Ulinë e kemi si nënën tonë? Apo jo? — i tha së shoqes.

Baudin Kazazi i dha dorën. Nënë Ulisë iu bë qejfi shumë. Ajo u kthye nga Margarita, pastaj nga Kristaq Dvorani, dhe, në çast, i pushtoi në krahët e saj.

— Edhe unë, o bir, — tha ajo, — i kam këta si fëmijët e mi. Kristaqin s'e dalloj dot nga Fatosi im, po edhe nusen e tij bukuroshe s'e dalloj nga ime re, Donika. Ishim me të vërtetë si një familje, por... puna i ndan njerëzit, more bir... Atdheu mbi të gjitha...

— Të lumtë, nënë Uli! — thirri Kristaq Dvorani. — Ke thënë një fjalë me vend. Vërtet, Atdheu duhet të jetë mbi të gjitha, pa ne... sot jemi këtu... nesër diku gjetkë... e kështu me radhë...

Duke iu drejtuar Margaritës, nënë Ulia tha:

— Mos u mërzit, bijë! Edhe pse po ndahesh për-kohësisht nga yt shoq, ti nuk je pa njerëz. Na ke ne këtu... Kur t'i japin shtëpi Kristaqit, ai do të vijë t'ju marrë ty dhe vogëlushen, që s'di se pse e dua aq shumë. Ndoshta ngaqë tim bir nuk e bëri zoti me ndonjë fëmijë...



Edhe pse frynte një erë e ftohtë që të priste fytyrën, biseda që po bënin me nënë Ulinë po u dukej të gjithëve aq e ëmbël, aq e këndshme, saqë nuk u thoshte goja «do të nisemi». Shoferi e kishte vënë çdo gjë në vendin e vet dhe priste vetëm urdhër për t'u nisur.

— Nënë Uli, — thirri Kristaq Dvorani, — do të nisemi tani që të mos vonohemi.

— Ikni, o bijtë e nënë Ulisë, ikni e dalshi faqebardhë, — tha ajo.

Fjalët «do të nisemi» ishin një sinjal alarmi për Margaritën. Ajo u drodh e tëra dhe në grykë iu bë një si lëmsh që dukej sikur do ta mbyste. S'ka lezet, tha me vete. Nuk duhet të qaj këtu, po në shtëpi dhe me derë të mbyllur. Ajo e përmblodhi veten. Kristaq Dvorani u përçafua në fillim me nënë Ulinë dhe pastaj u kthye nga e shoqja. Fytyra e Margaritës dukej si e ngurosur, sytë i dukeshin tepër të hapur dhe bebëzat disi të zmadhuara. Mbahu, tha me vete Kristaq Dvorani, mos më turpëro duke derdhur lot këtu në mes të rrugës. Margarita tundi kokën, sikur të ishte në një mendje me të. Nuk të turpëroj, jo, tha me vete ajo. Vetëm, të lutem, mos më harro. Ata qëndruan një copë herë të gjatë duke vështruar njëri-tjetrin në heshtje; pastaj Kristaq Dvorani e përçafoi me të dyja duart dhe në çastin që ajo mbështeti kokën në gjoksin e tij, e puthi te flokët. Ky ishte çasti më delikat. Pikërisht tani ajo do t'ia plasë të qarit, mendoi ai. Por në të vërtetë nuk ndodhi ashtu. Kur ajo u shkëput nga gjoksi i tij, ai vuri re se fytyra e saj ishte si edhe më parë, e ngurosur.

— Mirupafshim! — tha Kristaq Dvorani dhe ngri-ti dorën në ajër.

Fytyra e tij e qeshur nuk ia fshihte aspak keqardhjen që kishte pushtuar tërë qenien e tij. Por, si do që të ishte, para së shoqes nuk duhej të linte përshypjen se edhe ai ishte mallëngjyer së tepërmi.

Mos më harro, Kristaq, po thoshte Margarita me vete. Ajo donte t'i thoshte këto fjalë me zë, por se si



iu lidh gjuha dhe iu duk sikur nuk mund të fliste. Në çast e mbloodhi veten dhe u mbështet pranë nënë Ulisë.

Ata kishin zënë vendet e tyre në sediljet e xhipsit dhe po bëheshin gati të niseshin. Motori, si dukej i ngjirur nga të ftohtët e madh, rënkoi disa herë, por pa lëvizur nga vendi. Pas pak rrotat e tij filluan të rrokulliseshin nëpër rrugën e ngrirë. Kristaq Dvorani ishte ulur në sediljen e parë në krahun e djathtë të shoferit, ndërsa Baudin Kazazi ishte ulur prapa, në njëren nga sediljet e stërgjata. U bë një heshtje kaq e thellë, sa që një grumbull zogjsh që cicërinin pak më parë në kopshtin përballë, e kyçën gojën dhe kthyen kokat nga xhipsi i markës amerikane.

— Mirupafshim! — tha me zë të lartë Kristaq Dvorani, si dukej për të prishur solemnitetin e asaj heshtjeje, dhe buzëqeshi përsëri. Por heshtja vazhdoi si më parë, e thellë dhe mallëngjyese. Nënë Ullia dhe Margarita ishin afruar aq shumë pranë njëra-tjetrës, sa që dukeshin si një trup i vetëm.

Për dy-tre sekonda automobili u zhduk nga rruga «Mine Peza». Duke marrë një kthesë të fortë nga e djathta, ai hyri në rrugën e Durrësit dhe pastaj u vërsul përpara, duke lënë pas një zhurmë të butë dhe monotone.

Kristaq Dvorani mori frymë thellë.

Ai nuk po gjente fjalë të përshtatshme sa për të hapur bisedën, sepse, siç dukej, ishte tepër i tronditur për shkak të gjendjes së rëndë shpirtërore në të cilën e la të shoqen. Ai vështroi prapa nga Baudin Kazazi, pastaj ktheu kokën nga shoferi, i cili ishte një djalë tepër i ri. Ky mund të jetë beqar, tha me vete, dhe nuk e di se ç'do të thotë ndarje. Ndërsa krejt ndryshe mendonte për gjeologun, të cilin, duke qenë se e kishte njohur vetëm njëzet e katër orë më parë, nuk kishte pasur mundësi ta pyeste për familjen e të afërmit e tij. Fytyra e imët dhe anemike e Baudinit, shtati i vogël disi delikat i kishin lënë Kristaqit për-

shtypjen e një njeriu të vuajtur, që duhej të kishte kaluar shumë vështirësi e pengesa në jetë.

— A jeni i fejuar? — e pyeti ai, duke iu drejtuar në fillim shoferit.

— Jo, — tha djaloshi, pa ia shqitur sytë xhadesë tërë dredha dhe aty-këtu me pellgje e gropa të vogla. Sa vinte, rruga bëhej përherë e më e keqe. Xhipsi, duke gulçuar, vërsulej vazhdimisht përpara. Herë pas here në të dy krahët rrotat e tij thyenin akullin, duke lëshuar një zhurmë karakteristike rrëqethëse.

— Si ju quajnë? — pyeti përsëri Kristaq Dvorani, kur automobili kishte dalë në një copëz rrugë deri diku të drejtë dhe pa gropa.

— Martin, — tha djaloshi me të njëjtin ton. — Martin Reka, — përsëriti ai.

— Ah, po, — tha Kristaq Dvorani. — Martin Reka. Emër i bukur.

Ai përpiqej të krijonte një atmosferë të ngrohtë, por pa i tërhequr vëmendjen shoferit, sepse një pakujdesi e vogël e tij mund t'u kushtonte shumë shtrenjt.

— Ç'njerëz keni në shtëpi? — pyeti përsëri Kristaq Dvorani, duke menduar se hëpërhë kjo duhej të ishte pyetja e fundit që mund t'i bënte.

Ndoshta e teprova, mendoi për një çast ai. Martin Reka nuk i dha përgjigje aty për aty. Ai u mendua pak, ktheu për një çast kokën nga Kristaqi dhe me një pamje serioze në fytyrë tha:

— Kam vetëm nënën.

— Ashtu?! — tha Kristaq Dvorani dhe menjëherë i shkoi në mendje se kishte bërë gabim që e kishte pyetur kaq shpejt për një gjë të tillë.

— Im atë u vra gjatë luftës, — shtoi, pas pak Martin Reka me një pamje të pikëlluar në fytyrë. — E torturuan aq shumë nazistët në burg, sa që vdiq dhe...

— Më fal, — tha Kristaq Dvorani. — Ndoshta nuk duhej ta bëja një pyetje të tillë, por...

Atij iu zunë fjalët në grykë.



~~efrat~~ S'ka gjë, — tha Martin Reka, duke rrotulluar kokën ngadalë nga ana e tij. — Ne do të njihemi me njëri-tjetrin, me hallet e njëri-tjetrit, kështu që...

Xhipsi bëri një kthesë të fortë dhe pastaj eci përsëri përpara drejt Veriut. Rruga automobilistike kalonte përmes rrafshultave. Në të dyja anët e saj zgjateshin nga jugu në veri vargmale të larta, kreshtat e të cilave ishin mbuluar me dëborë.

— Me familjen time u njohët, — tha pas pak Kristaq Dvorani, duke kthyer kokën mbrapa nga Baudin Kazazi, i cili deri tani kishte qëndruar në heshtje.

— Kurse unë vazhdoj të jem beqar, — e theu vetë akullin Baudin Kazazi. — Jemi shtatë fëmijë, more shokë të dashur, dhe... ndër ta unë jam i vetmi djallë... Para meje kam gjashtë motra, nga të cilat janë martuar tre dhe tani...

— Duhet pritur që të martohen edhe tre të tjerat, — ia priti si me shaka Martin Reka.

Ata ia plasën gazit.

— Ç'të bësh, o vëllezër, — vijoi pas pak Baudin Kazazi. — Kështu e kanë andej nga anët tona; janë ca zakone, të lëna nga të parët, sipas të cilave duhet të nxirren nga dera e shtëpisë, të gjitha vajzat, dhe pastaj...

Ata qeshën përsëri. Kristaq Dvoranit i erdhi keq që një djallë si ai, që ndonëse nuk duhej të ishte më shumë se tridhjetë vjeç, të ishte ende i pamartuar. Prapa syzeve të tij optike, me skelet ngjyrë ari rrotulloheshin ca sy që dukej sikur kërkonin prej kohësh diçka që e mundonte. Një zemër e djegur, një zemër e zhurit, tha me vete Kristaq Dvorani, duke dashur të sjellë ndër mend një fragment romani, autori i të cilit tani nuk po i kujtohej. Pastaj se pse iu kujtuan pusët e naftës, diku, andej nga Kuçova, që dy-tre vjet më parë digjeshin kot së koti, të ndezura nga koha e luftës. Flitej se Kuçovës do t'i vihej emri Qyteti Stalin.

Jashtë po binte një shi i hollë, ndërsa pak më tej, mbi vargmalet që dukeshin sikur kishin lëvizur nga



vendi dhe i ishin afruar rrugës automobilistike, binte dëborë e dendur.

— Ne duhet ta kemi të qartë, shokë, — tha Kristaq Dvorani, — se rruga për në Kreshnikë, siç thonë, është një rrugë e vështirë dhe dëborë e madhe që po bie do të na nxjerrë, ndoshta, shumë telashe... Po ne nuk duhet të trembemi e as të dëshpërohemi. Sonte duhet të mbërrijmë patjetër në vendin e caktuar.

Baudin Kazazi u mbush me frymë dhe pastaj tha:

— Nuk ma merr mendja që t'ia arrijmë këtij qëllimi. Ne nuk mund ta kalojmë sonte Qafën e Humerës.

Kristaq Dvorani vështroi në fillim nga shoferi dhe pastaj ktheu kokën prapa nga Baudin Kazazi.

— Për këtë mund të flasë më mirë klasa punëtore, — tha ai me shaka. — Apo jo, Martin?

Martin Reka vuri buzën në gaz dhe u hodhi nga një vështrim të shkurtër të dyve. Manovrimi i timonit kërkonte një kujdes të veçantë. Dëborë, që sapo kishte filluar të binte, e kishte lagur asfaltin dhe kishte krijuar plot rreziqe. Vendi, nëpër të cilin po kalonin tani, ngjante si një humbëtitë e vërtetë. Ata kishin një copë herë të gjatë që po udhëtonin nëpër disa rrafshnalta, në të cilat nuk të zinte zyri as fshatra, as edhe qendra të banuara.

— A u lodhët? — i tha ai Martin Rekës. — Dëshiron të bëjmë ndonjë pushim të shkurtër?

— Jo, — tha Martin Reka me një zë të gjallë dhe plot optimizëm.

Ndërsa vazhdonte të binte dëborë, xhipsi filloi të ngjitej nëpër një rrugë malore.

— A pini cigare? — pyeti Kristaq Dvorani.

— Jo, — thanë ata me një zë.

— Kurse unë pi ngandonjëherë, sa për të kaluar kohën.

Ai nxori nga xhepi një paketë «Partizani».

— Do ta nderësh? — i tha Baudin Kazazit.

Ai tha «jo» me kokë. Kristaq Dvorani nderoi një cigare dhe pastaj e futi paketën në xhepin e kapotës së



tij. Pastaj, mbasi rregulloi strehën e shapkës ngjyrë hiri, hodhi vështrimin përpara. Xhami i thyer, tërë plasaritje nga predha që kishte marrë diku sipër në krahun e djathtë, e pengonte për të parë rrugën përpara. Për këtë arsye ai përpiquej të shikonte vazhdimisht përmes xhamit të krahut të majtë, që ishte në anën e shoferit, ose anash, në të dy krahët e automobilin. Nën rrotat e tij kërciste vazhdimisht akulli i gropëzave që ndodheshin aty-këtu nëpër xhadenë malore. Kristaqi hodhi vështrimin prapa dhe me bishtin e syrit pa Baudin Kazazin që përkundej si në djep. Fytyra e tij dukej e zymtë. Përkundrazi, Martin Reka, që ishte lodhur më shumë nga ata të dy, dukej mjaft i qetë. Ai rregullonte herë pas here leshrat që i binin mbi ballë dhe në çast shtrëngonte timonin, i gatshëm për të përballuar çdo të papritur.

Ata po udhëtonin tani gjatë bregut të një lumi që zbriste plot zhurmë përmes disa maleve të larta. Zona, ku sapo ishin futur, ishte krejt e panjohur për Kristaq Dvoranin. Lumi gurgullonte vazhdimisht dhe dukej sikur ankohej nga vargmalet që ia kishin ngushtuar aq shumë rrugën në të dy krahët. Rruga po bëhej përherë e më e vështirë. Baudin Kazazi psherëtiu dytri herë, po nuk tha gjë.

Nëpër grykën e lumit erdhi papritur një gjëmim i fuqishëm.

— Ç'është kjo zhurmë e madhe? — pyeti Kristaq Dvorani duke vështruar anash i shqetësuar.

— Janë ortekë dëbore, — tha Martin Reka. — Si duket, zbresin nga kreshtat e maleve dhe rrokullisen gjer poshtë në luginë.

— Ah, ortekët! — tha Kristaq Dvorani.

Baudin Kazazi, pasi rregulloi syzet e tij optike me gishtin tregues, filloi të vështronte anash shpatet e maleve që vareshin gjer poshtë në brigjet e thepisura të lumit, që për ta ishte i panjohur. Poshtë, gjatë shtratit të tij, vende-vende tepër të ngushtë, uji gurgullonte me potere dhe stërkalat e tij ngriheshin gjer lart në

xhade. Baudin Kazazi ngriti jakën e palltos së tij dimërore dhe e ngjeshi pas veshëve që, të mos dëgjonte se ç'bëhej jashtë. Sidoqoftë, ky është vetëm preludi, tha ai me vete ndërkohë që temperatura kishte filluar të binte akoma më shumë. Ai ndiente të ftohtë, megjithëse u mundua të mblidhej sa më mirë me pallton e tij dimërore dhe me shallin e leshtë me kuadrate.

S'është e mundur, po thoshte me vete, që të mbërrimë sonte në vendin e caktuar.



## MYSAFIRË NË MINIERËN «YLLI I KUQ»

Qyteza e vogël e punëtorëve dukej me të vërtetë e bukur. Kristaq Dvorani zbriti menjëherë nga xhipsi dhe qëndroi një copë herë në anë të rrugës automobilistike, duke vështruar ndërtesat e minierës së vjetër «Ylli i kuq». Ky ishte në të vërtetë një emër kuptimplotë, që ia kishin vënë punëtorët dy-tre vjet më parë, menjëherë pas konfiskimit të pronës kapitaliste. Shumica e ndërtesave të minierës ishin baraka prej dërrase të stërgjata, të vendosura andej-këndej, pa ndonjë planimetri të caktuar, poshtë në gjunjët e një mali të lartë.

Në oborrin e minierës futeshe vetëm nga një rrugicë e thepisur që kalonte fare pranë bregut të lumit që gurgullonte pa pushim. Kristaq Dvorani vështroi sahatin e dorës me fushë të gjelbër. Duhej të kalonin edhe pesë minuta që ora të shkonte plot dymbëdhjetë. Jemi shumë vonë, mendoi ai, ndërsa po përpiqej të kapërcente disa togje dëbore, që dikush i kishte grumbulluar aty për të hapur një rrugë tjetër këmbësore, që ngjitej lart shpatit të malit. Kjo duhej të ishte ndonjëra nga rrugët që të çonte drejt galerive të minierës.

Ai shtyu lehtë njërin nga togjet e dëborës dhe masa e bardhë me formë të çrregullt filloi të rrokullisej drejt bregut të lumit, duke marrë me vete një sasi

tjetër dëbore. Ja, kështu krijohen orteqet, tha Baudin Kazazi që e ndiqte nga pas dhe pastaj... Masa e bardhë e dëborës, që sa vente po bëhej më e madhe, pas pak u zhduk nga sytë e tyre. Pas disa sekondash shtrati i lumit gjëmoi nga një zhurmë e mbytur. Bora duhej të ishte përfshirë nga valët e pamëshirshme të ujit, që zbriste me rrëmbim nga gjiri i maleve të larta.

Rrugica e rrezikshme kishte mbetur prapa; Kristaq Dvorani me Baudin Kazazin arritën në sheshin e vogël para ndërtesës së drejtorisë së minierës.

Nga e djathta e saj zgjatej ndërtesa njëkatëshe e klubit të punëtorëve. Për këtë tashmë flisnin qartë etiketa që ishte vendosur mbi derë si edhe zhurmat karakteristike të lugëve, gotave e pjatave që dëgjoheshin gjer jashtë në oborr. Përtej xhamave, të veshur me një cipë të hollë ngrice, lëviznin figura të panjohura njerëzish.

Ata u futën në klub duke shkelur mbi dyshemenë e lagur nga dëbora e shkrirë, të cilën e sillnin njerëzit që vinin nga jashtë. Në të dy anët e sallës së gjatë ishin vendosur tryeza të vogla ngjyrë hiri, kurse në mes ishte lënë një korridor i lirë, si duket për të mos shkaktuar rrëmujë gjatë hyrjes e daljes së klientëve.

Kristaqi hodhi një vështrim në të katër anët dhe, si u bind se asnjëri nuk e kishte vënë re praninë e tyre, shkoi drejt banakut që të pyeste për drejtorin e minierës..

Banakierja e re, që rrinte në anën tjetër të banakut, u përkul që të rregullonte çorapet. Baudin Kazazit i shkuan menjëherë sytë te këmbët e saj të drejta; mirëpo, për të mos rënë në sy, ai ngriti menjëherë kokën dhe në kundërshtim me dëshirën që vetëinte në ndërgjegjen e tij, ktheu kokën nga ana tjetër. Duke vështruar me ata sy që dukej sikur kërkonin diçka, banakierja pyeti:

— Mos jeni nga ata të ekspeditës që do të vinin sot nga Tirana?

Kristaq Dvorani ia bëri «po» me kokë.



Banakieria u gjallërua menjëherë dhe lëvizi kokën në fillim nga e majta dhe pastaj nga e djathta, duke kërkuar dikë me sy nëpër sallë.

— Tani sapo hyri drejtori me disa punëtorë të sektorit «D», — u tha ajo me një pamje të menduar. — Se ku u ulën!

Tymi i kaltër i duhanit nuk lejonte që të dalloheshin menjëherë fytyrat e njerëzve, të ulur andej-këndej nëpër sallën e madhe.

Ajo doli në mënyrë të papritur nga banaku dhe filloi të ecte përmes tryezave të shumta, duke e ftuar Kristaq Dvoranin që ta ndiqte. Baudin Kazazi i hodhi prapë sytë te këmbët e saj të drejta. Si ecën një copë herë nëpër sallën e madhe, arritën te tryeza, ku sapo ishte ulur drejtori i minierës «Ylli i kuq». Nga mënyra se si bisedonte banakierja me Xhavit Çelikun krijoi në çast përshtypjen se ai ishte një masovik i vërtetë, që dinte të merrej vesh për mrekulli me njerëzit. Duke qëndruar për një copë herë në këmbë pranë tryezës së tyre, ajo bëri një lëvizje të shkathët dhe u largua në drejtim të banakut.

Papritur, nga mesi i tyre, pranë së cilës qenë ulur edhe katër punëtorë që mbanin kapele minatorësh, kumboi qartë zëri i Xhavit Çelikut:

— Paskeni ardhur, more shokë?!

Ai u ngrit menjëherë në këmbë dhe zgjati dorën në drejtim të Kristaq Dvoranit, pastaj të Baudin Kazazit, të cilët, pasi u përshëndetën me radhë me të gjithë, u ulën në dy karrige që ua afruan në çast minatorët mikpritës.

— Ju paskeni qenë këtu, kurse ne ju kërkonim përjashta, — foli pas pak Xhavit Çeliku, duke pulitur sytë e tij të kaltër. — Gëzohemi sinqerisht, — shtoi pas pak ai, — që mbërritët shëndoshë e mirë. — Sonte do të jeni mysafirë te ne, ndërsa nesër....

Ata i shtrënguan dorën edhe një herë njëri-tjetrit. Xhavit Çeliku vuri re se mysafirëve të porsaardhur diçka nuk po u pëlqente.



— Si kështu? — pyeti ai. — Nuk keni dëshirë të qëndroni sonte në minierën tonë?

— Si jo, — tha Kristaq Dvorani me keqardhje. — Por... çështja është se...

— Ah, jo, jo! — ia priti Xhavit Çeliku. — Sonte nuk mund të kalohet Qafa e Humnerës. Koha është shumë e keqe dhe... përveç kësaj... rruga kalon nëpër një zonë ku qarkullojnë banda të armatosura.

Baudin Kazazi ndjeu në fillim njëfarë kënaqësie, po, kur dëgjoi fjalët «banda të armatosura», tërë qenien e tij e pushtoi një ndjenjë e pakuptueshme frike. Ai donte të dëgjonte sa më parë mendimin e shefit të ekspeditës për këtë situatë me të vërtetë të ndërlikuar. Udhëtimi natën, koha e keqe, rruga e vështirë, banda të armatosura... Të gjitha këto e turbulluan fare.

— Sido që të jetë, ne duhet të vazhdojmë rrugën pa humbur kohë, — tha Kristaq Dvorani me një pamje të menduar në fytyrë. — Kemi shumë pak kohë në dispozicion, — murmuriti ai, pothuajse me vete. — Vetëm pesë ditë...

Xhavit Çeliku qeshi me gjithë zemër.

— Vetëm pesë ditë?! — përsëriti ai me zë të lartë. — Për pesë ditë çahen malet më dysh dhe jo një minierë... Apo jo, djema? — pyeti ai, duke iu drejtuar minatorëve që i kishin rrethuar mysafirët si kurorë.

Kristaq Dvorani u mundua të vinte buzën në gaz. Ai nuk po e dallonte dot nëse kjo ishte një shaka apo një e vërtetë e pakundërshtueshme.

— Klasa jonë punëtore, — vijoi pas pak Xhavit Çeliku me zërin e tij kumbues, — vërtet është e re dhe e vogël në numër, po ajo e ka kockën të fortë. — Fytyra e tij u bë tepër serioze. — Ka Partinë që... di ta udhëheqë e ta vërë në rolin e saj pararojë... Ja se pse ajo është e do të jetë në gjendje, që të bëjë mrekullira... Apo jo, djema?

Minatorët qeshën, duke tundur kokat e tyre në she një miratimi.

— Dëgjo, more djalë! — e mori fjalën njëri prej tyre, që ishte më i vjetri ndërmjet të gjithë të prani-



shmëve. Ai kishte flokë të dredhur, po të thinjur dhe një fytyrë të kuqërreme, të rrahur nga dielli dhe erërat e ftohta të stinës së dimrit. — Mirë e ka shoku Xhavit, klasa jonë punëtore ka kockë të fortë dhe është sy-patrembur. Ja, pa shiko, tërë këta që janë këtu në sallën e klubit. — Pasi lëvizi sytë ngjyrë ulliri rreth e rrotull, ai ia nguli përsëri vështrimin Kristaq Dvoranit. — Janë të tërë sokola të vërtetë. Atë që këta e bënë për një kohë të shkurtër, qeveria e merhumit, doja të thosha e Ahmet Zogut, nuk ishte në gjendje ta bënte as për njëqind vjet. A më kupton?

Kristaq Dvorani vazhdonte ta dëgjonte me vëmendje, për të kuptuar se ku donte të dilte minatori plak, i cili, megjithëse po e shikonte për herë të parë, iu bë menjëherë një fytyrë e dashur dhe e afërt, aq sa po i dukej sikur të ishin njohur shumë vjet më parë. Në çast iu kujtua i ati, që tërë jetën ishte dergjur nëpër galeritë e minierave.

— Ju kuptoj, — tha Kristaq Dvorani. — Unë jam në dijëni të punës së madhe që është bërë këtu..., — shtoi pas pak ai. — Në shtypin tonë të përditshëm unë kam lexuar shumë gjëra në lidhje me minierën tuaj. Shkrimet e gazetarit Fatos Trebeshina, të cilin unë e kam shok, e kanë bërë tepër të njohur minierën «Ylli i kuq» në tërë Republikën... Por... çështja është se... miniera jonë e Kreshnikës... është një minierë që... ende nuk figuron në hartë... kështu që... ndoshta ne...

Ai po fliste duke i zvarritur fjalët dhe me vështrimin mbërthyer diku në një pikë të vetme mbi tryezën bojë hiri.

Xhavit Çeliku tundi kokën në shenjë miratimi dhe vuri pak buzën në gaz.

— Me sa shoh, — tha ai, — duhet ta keni marrë pak si me frikë këtë detyrë, i dashur shok. Por të keni besim në forcat tuaja dhe të mos harroni se na keni edhe ne këtu, që nuk do të kursehemi asnjëherë. Minatorëve tanë u është bërë qejfi kur lexuan njoftimin e gazetës «Bashkimi» se në zemër të Alpeve tona do të hapet një minierë e re kromi. Unë jam i bindur se të gjithë



këta minatorë që shikoni këtu do të ngrihen në këmbë për t'i ardhur në ndihmë minierës së re motër.

Kristaq Dvoranit iu bë qejfi. Në të njëjtën kohë edhe Baudin Kazazit po i ngrohej zemra dhe po i shtohej dalngadalë besimi në vetvete.

— Megjithatë, — vijoi pas pak Xhavit Çeliku, — hëpërhë, duke pasur parasysh se shfrytëzimi i mineralit do të fillojë në sipërfaqe, ne kemi çaktuar një grup prej katër minatorësh, të cilët do të vijnë me ju... Në rast se do të keni nevojë për forca të tjera, ne nuk do të kursehemi, por do t'jua dërgojmë menjëherë. Këtu jemi dhe shohim e bëjmë. Përsa u përket forcave të tjera punëtore, jam i bindur, se kreshnikasit nuk do t'i kursejnë aspak energjitë e tyre.

— Kreshnikasit janë me të vërtetë njerëz punëtorë, — shtoi minatori plak, i cili ndërkohë po dridhte një cigare.

— Dhe jo vetëm punëtorë, — theksoi Xhavit Çeliku, — por edhe trima të pashoq, mikpritës e bujarë... Janë me të vërtetë njerëz të mrekullueshëm...

Kristaq Dvorani vështroi sahatin e dorës.

— E, si mendoni? — pyeti Xhavit Çeliku. — A do të vazhdoni rrugën sonte?

Kristaq Dvorani ktheu kokën nga Baudin Kazazi dhe pastaj uli sytë mbi tryezën bojë hiri. Banakierja, siç dukej, me iniciativën e saj kishte mbushur për të gjithë gotat me konjak Korçe dhe po ua vinte përpara. Përmes syzave të tij optike Baudin Kazazi po ndiqte lëvizjet e dorës së saj mbi tryezë.

— Me të gjitha këto gjëra që u biseduan këtu, — u përgjigj me vonesë Kristaq Dvorani, — unë jam dakord. Por... përsa i përket çështjes së udhëtimit... doja të thosha se ne do të zbatojmë vendimin që kemi marrë.

— Atëherë, rruga e mbarë ju qoftë, — tha Xhavit Çeliku, duke ngritur gotën e konjakut.

— Gëzuar! Gëzuar! Gëzuar! — i thanë njëri-tjetrit.

Tryeza e tyre ishte gjallëruar papritur. Ardhja e njerëzve të ekspeditës nga Tirana ishte bërë tashmë e



njohur në tërë sallën e klubit të minatorëve. Aty kishte shumë njerëz, të cilët kureshtja i shtynte të takoheshin e të bisedonin me ta. Të gjithë pëshpërisnin me njëri-tjetrin për ekspeditën dhe misionin e saj të vështirë.

Kristaq Dvorani po rrinte si mbi gjemba. Atë nuk e mbante vendi. Ora po shkonte dymbëdhjetë e tridhjetë minuta.

— Ku janë minatorët që do të vijnë me ne? — pyeti ai, duke u kthyer nga Xhavit Çeliku.

Drejtori i minierës «Ylli i kuq» qeshi me zë. Sytë e tij bojë qielli ndritën nga një ndjenjë e brendshme gëzimi që nuk mund ta përmbante.

— Ja ku janë! — thirri ai me zë të lartë. — Këta që kanë rrethuar tryezën tonë të vogël. Xhavit Çeliku u rrahu shpatullat në mënyrë familjare. Minatori plak i buzëqeshi me gjithë shpirt. Tre të tjerët, që ishin djem të rinj, pothuajse të një moshe, vështruan njëri-tjetrin në sy. Kjo ishte një surprizë e bukur për Kristaq Dvoranin dhe gjeologun e vetëm të ekspeditës së tyre.

— Si kështu?! — u habit Kristaq Dvorani. — Këta qenkan shokët që do të vijnë me ne!

Xhavit Çeliku qeshi përsëri me zë.

— Ky është Bame Toroja, — filloi të bënte prezantimin ai. — Është veteran i minierës sonë, minator i talentuar dhe partizan i vitit 1941. Këta tre të tjerët i kemi zgjedhur nga djemtë tanë më të mirë. Janë me të vërtetë punëtorë të palodhur; kur i bëmë thirrje kolektivit, këta ishin ndër të parët që ngritën dorën dhe shfaqën dëshirën për të shkuar në Kreshnikë përgjithnjë.

Kristaq Dvorani s'dinte se si ta shprehte kënaqësinë. Ndërsa trokiste gotën me të gjithë të pranishmit, me mendje thoshte: «Ç'njerëz të mirë që janë!»

— Para se të mbërrinit këtu, unë po bisedoja në telefon me ministrin... me shokun Jaho Abazi... Ai më tha se duhet t'ju japim disa materiale të domosdoshme sa për fillimin e punimeve si dhe disa ushqime të tharta. Shkojmë t'i shikojmë?



— I kemi bërë gati dhe i kemi ngarkuar në makinën tonë, të cilën do ta marrim me vete, — tha Bame Toroja.

— Ashtu?! — tha i gëzuar Baudin Kazazi.

Xhavit Çeliku tundi kokën në shenjë miratimi.

— Ja tek është edhe shoferi, — tha ai. — Ky do të jetë gjithashtu anëtar i ekspeditës suaj.

Njeriu që qëndronte para tyre qeshi vesh më vesh dhe u afrua menjëherë për t'u takuar me mysafirët e rinj.

— Zaçe Çapoku, — murmuriti ai nëpër dhëmbë, duke bërë prezantimin e rastit në çastin që po shtrëngonin duart me njëri-tjetrin.

Bame Toroja tundi kokën në mënyrë të papërcaktuar, ngaqë s'dinte se çfarë përshtypje i la Zaçe Çapoku shefit të ekspeditës. Ai vështroi me vëmendje shoferin, të cilit i njihte, si i thonë fjalës, dhëmbë e dhëmballë, dhe pastaj u afrua te kamioni për të parë se si e kishte rregulluar ngarkesën. Mbulesa prej maushamaje, e ngarkuar me dëborë, e pengonte që të shihte se çfarë sendesh kishte nën të, megjithëse e dinte se aty ishin shtrirë gjerë e gjatë motokompresori dhe rreth e rrotull tij pistoletat, barominat, dinamiti, dyshekët, batanijet, peliçet e pambukta si dhe disa sende të tharta ushqimore.

Duke ndjekur me sy kamionin që filloi të rrotullohej nëpër sheshin e mbuluar me dëborë para drejtorisë së minierës «Ylli i kuq», Kristaq Dvorani pyeti:

— A janë ngarkuar të gjitha sendet e nevojshme?

— Mos u shqetësoni, shoku shef i ekspeditës, — tha Bame Toroja. — Kemi marrë me vete edhe gjëra të tjera që nuk ishin parashikuar në listën që na dhanë në telefon shokët e dikasterit. Apo jo?

Xhavit Çeliku pohoi me kokë. Kamioni frenoi prapa xhipsit, të cilin Martin Reka e kishte sjellë aty, për të qenë sa më afër pikës së nisjes.

— Epo, tani të nisemi, — tha Kristaq Dvorani.

Xhavit Çeliku iu afrua kamionit dhe pastaj xhipsit bojë hiri, tek i cili i ranë në sy menjëherë gjurmët



e predhëve që i kishte kujtim nga koha e luftës. Xhami i plasaritur në krahun e djathtë binte më shumë në sy.

— Plaçkë lufte! — tha ai gati me vete. — Por, sidoqoftë, i janë makina të forta. Ç'prisni? — tha, duke u kthyer prapa. — Nisuni sa më shpejt.

Ai i përqafoi me radhë anëtarët e ekspeditës dhe u uroi atyre rrugë të mbarë.

Për të përcjellë ekspeditën kishin dalë edhe mjaft minatorë, të cilët pas disa minutash do të futeshin nëpër galeri për të ndërruar turnin e paradites.

## AJRI I PASTËR I BJESHKËVE

Margarita, duke u përkulur e tëra mbi banakun e gjatë të librarisë dhe me mjekrën midis pëllëmbëve të duarve, vështronte përjashta njerëzit që lëviznin andej-këndeje nëpër rrugicat e ngushta e plot llucë të pazarit të vjetër. Ajo ishte kredhur aq thellë në mendime, sa që s'e kishte vënë re dëborën e bardhë, që sapo kishte filluar të flokonte. Ai iku, më la vetëm, porsi një qyqe, tha me vete dhe psherëtiu. Kjo ishte një psherëtimë e një lloji të veçantë, e shkaktuar si duket nga një ndjenjë përhumbeje, që kishte arsyet e veta. Ajo nuk ishte mësuar të rrinte pa të shoqin, aq më tepër këtu, në mes të kryeqytetit, ku s'kishte pothuajse asnjë nga të afërmit e saj. Largimi i tij fare papritur e kishte tronditur shumë; më e keqja ishte se ajo nuk dinte se kur do të shihej përsëri me të. Ku do të jetë tani vallë? tha përsëri me vete, duke mos e hequr për asnjë çast nga mendja të shoqin. Tutje, në drejtim të Dajtit qielli po mbulohej me re të dendura. Ajo drejtoi trupin dhe pastaj mori të lexonte një libër, me qëllim që të thyente monotoninë e mërzitshme. Pasi lexoi disa rreshta, e la librin mbi banak dhe u afrua përsëri pranë xhamit të vitrinës. Përmes tij ajo vuri re se jashtë po binte dëborë e përzier me një shi të imët.

Ja, më në fund dëborë zbriti edhe në Tiranë, tha me vete ajo. Kjo donte të thoshte se përpara kishin një



dimër të egër. Asaj i erdhi keq, që nuk kishte qenë në gjendje ta përfundonte pulovrin me jakë golf për Kristaqin. Tani, edhe në qoftë se e përfundonte, puna e saj s'kishte më asnjë vlerë. Ajo ishte e detyruar të priste gjersa të nisëj për në Kreshnikë Fatos Trebeshina, i cili, siç i kishte thënë i shoqi, do të shkonte atje për të bërë një reportazh për minierën e re të kromit. Tutje, larg, si nëpër mjegull, dukej shpina e kërrusur e Dajtit, dhe akoma më larg, sa të hante syri, mezi dukeshin kreshtat e disa vargmaleve të panjohura, përmes grykave të të cilave udhëtonte tani i shoqi me ekspeditën e tij gjeologjike.

Duke u munduar të kapte me sy disa maja malesh të panjohura, zuri të mendonte se ku ndodhej vallë tani ai dhe si i shkonin punët. Mendimi se i shoqi dhe shokët e tij të ekspeditës kishin mbetur në mes të dëborës e larg qendrave të banuara, pa asnjë ndihmë e përkrahje e në pamundësi për të çarë rrethimin e bardhë, e pushtoi tërë qenien e saj. Po sikur të mbeten në dëborë, tha me vete. Margarita mori frymë thellë dhe psherëtiu. Fshiu me pëllëmbën e dorës xhamin që u vesh me avull, me qëllim që të vështronte më mirë përjashta.

Megjithëse njerëzit që venin e vinin nëpër baltovinën e rrugicave të ngushta të pazarit të vjetër nuk e dinin se çfarë i kishte ndodhur asaj atë ditë, në mendje i vërtitej herë-herë ideja se ata e përgjonin. Po vien ndyrësira, tha me vete dhe ia nguli sytë fytyrës bullafiqe të Shemshedin Bërdëllimës, i cili u nis me hapa të shpejtë në drejtim të librarisë.

Ai hyri në librari disi i qeshur megjithëse në vet-vete mbartte një brengë. Ç'të bënte? Si të vepronte që ta shpëtonte dyqanin e tij të peliçeve nga konfiskimi! Të paktën t'ia zgjaste jetën një vit ose ndoshta edhe më pak: tre-katër muaj, se... ku ta dije... kishte mundësi që edhe një ditë të sillte... Fati... ngadonjëherë... Shemshedin Bërdëllima kishte gati një minutë që po rrinte në këmbë si i shastisur.



— Ç'dëshironi, zoti Shemshedin? — pyeti Margarita me një ton të prerë, duke dashur në këtë mënyrë të shprehte edhe urrejtje, edhe ironi njëkohësisht.

— Ah, po?! — tha Shemshedin Bërdëllima. — Si urdhëron, unë erdha për...

Ai ende nuk kishte ardhur në vete.

— Për çfarë?

— Më falni, — tha përsëri dhe vuri gishtin tregues në tëmth. — Skleroza... Ah, po, po... Erdha për... Doja të thosha se... para disa ditësh lexova në gazetën «Bashkimi» ku thuhej se do të dalë në shitje metoda e parë e gjuhës serbo-kroatishte... Sigurisht... për kurset... që... po-unë...

Margarita qeshi nën hundë dhe pastaj vuri mbi banak librin e serbokroatishtes.

— Ja tek e ke. — i tha me një ton të prerë. — E ç'ju duhet juve serbokroatishtja?

— Oh, — rënkoi ai me vete. — Tregtia, tregtia..., — murmuriti nëpër dhëmbë dhe e la mendimin përgjysmë.

— Ah, po, po, — tha Margarita.

— Pikërisht, — e ndërpreu me kënaqësi Shemshedin Bërdëllima. — Ne tregtarët, pa ditur gjuhën e njëri-tjetrit, nuk jemi në gjendje që...

— Ashtu është, — tha edhe Margarita, për ta hequr qafe sa më parë atë fytyrë të urryer.

Shemshedin Bërdëllima pagoi librin dhe doli jashtë i kënaqur, ngaqë e kishte gjetur atë në kohën e duhur. Dikur frëngjishtja kishte qenë gjuha që preferonte më shumë dhe që e zotëronte në fakt mjaft mirë, po me zgjerimin e tregtisë me Italinë atij i qe dashur të mësonte edhe italishten. Gjatë periudhës së luftës ai i vuri si detyrë vetes të mësonte edhe gjermanishten, po... koha qe e shkurtër... kështu që... Dhe ja, tani, në pleqëri, po mendonte t'i futej serbokroatishtes... Tregtarët jugosllavë blinin mallra në tregun shqiptar pa asnjë kufizim... kështu që... në këto kushte ideale s'kishte se përse të mbeteshin stoqe pelicet e tij. Ky ishte një fat i mirë për të, prandaj... gjuha...



do ta ndihmonte, për të manovruar në tërheqjen e klientelës si dhe në rritjen e çmimeve në mënyrë që... Ah, do të ishte me të vërtetë e tmerrshme... Shemshedin Bërdëllima po ngjitej në trotuarin e ngushtë para dyqanit të tij. Sytë i kishte mbërthyer mbi kapakun e gjelbër të librit. Brenda e priste tërë ankth Qerim Alluni dhe disa klientë, fytyrat e të cilëve ai po i shikonte për herë të parë.

Ah, kur do të pastrohet Tirana nga këto plehra, tha me vete Margarita dhe ra përsëri në mendime. Ku ndodhej, vallë, pikërisht tani, Kristaq Dvorani, njeriu më i dashur dhe më i afërt për të? Kur do të vinte ai për ta marrë me vete në ajrin e pastër të bjeshkëve?

Para librarisë u ndal karroca e vogël trirrotëshe me mbishkrimin e vjetër «Caffe Odeon». Dimkë Teneqexhiu ishte furnizuar me disa libra të rinj si dhe me revista. Në kopertinën e njërës ishte botuar një fotografi e njohur e Leninit, ku ai kishte dalë në një takim me disa punëtorë hekurudhash.

## RRUGA ME PLOT TË PAPRITURA

Kristaq Dvorani vështroi në heshtje për një copë herë të gjatë qytezën e minierës «Ylli i kuq», e cila, tek po hynin në një grykë të egër me ca shkëmbinj të thepisur që zbrisnin gjer poshtë te shtrati i lumit, u zhduk krejt në mënyrë të papritur nga sytë e tij. Relievi tepër i thyer dhe dëbora e bardhë që kishte vendosur kudo pushtetin e saj krijonte një ndjenjë të pakuptueshme frike dhe bënte që ata vetvetiu të rrinin në heshtje. Kristaq Dvoranit po i vinte keq për Baudin Kazazin. Ai ishte pothuajse i bindur se gjeologu i ekspeditës së tyre ishte njeriu që kishte më pak besim te ky udhëtim tepër i rrezikshëm. Ndërsa tre minatorët e rinj, Shpëtimi, Faiku dhe Adushi kishin një pamje të papërcaktuar. Ai nuk ishte njohur ende me ta, kështu që, hëpërhë nuk mund të thoshte gjë. Krejt ndryshe qëndronte puna me Bame Toron, minatorin veteran i cili që në shikimin e parë i kishte lënë përshtypjen se duhej të ishte njeri tepër i qëndrueshëm e që s'donte t'ia dinte nga vështirësitë, nga hallet e telashet që mund t'i dilnin përpara. Kristaq Dvorani ktheu për një çast kokën nga ana e shoferit dhe pastaj vjedhurazi e hodhi vështrimin prapa dhe e ndali te fytyra ngjyrë bronzi e Bame Toros. Ai po thithte cigaren e dredhur në mënyrë të tillë, sikur ata të ishin duke shkuar në dasmë dhe jo nëpër një rrugë me plot rreziqe e të papritura. Martin Reka, ndo-



nëse ishte shofer i ri, manovronte me aq zgjuarsi nëpër kthesat e forta, saqë Bame Toros i bëhej zemra mal. Të gjithë vështronin me habi se si e rrotullonin duart e tij të shkathëta timonin e xhipsit të markës amerikane, që vazhdonte të rënkonte nëpër xhadenë malore. Një pakujdesi sado e vogël mund të bënte që ata të përfundonin poshtë, në shtratin e thellë të lumit, që gurgullonte pa pushim. Nga pas i ndiqte kamioni i Zaçe Çapokut, që mbartte tërë pasurinë e tundshme të minierës së ardhshme të Kreshnikës. Bame Toroja kthente herë pas here kokën prapa për të parë nëse i ndiqte hap pas hapi kamioni i Zaçe Çapokut, i cili sipas tij ishte një frikaman i madh.

— E di ç'na ndodhi një ditë me këtë, — i tha ai Kristaq Dvoranit, — si për ta sqaruar pse e kthente kokën prapa. — Kishim hyrë në një galeri të vjetër dhe po punonim. Erdhi edhe Zaça me ne, mirëpo, për çudi, pikërisht atë ditë na rrëzohet një pjesë e galearisë dhe jeta e minatorëve, në fakt, u vu në rrezik. Megjithatë, të gjithë qëndruan si burra, ndërsa Zaçe Çapoku doli i tmerruar nga galeria e minierës.

Qeshën të gjithë. Martin Reka ktheu kokën nga Bame Toroja dhe prapë vështroi përpara.

— Po pastaj? — pyeti Kristaq Dvorani.

— Pastaj, — tha Bame Toroja, — pastaj ne shpëtuam për bukuri, ndërsa Zaçe Çapokun e damkosëm si frikaman. S'ke ide se sa inat i vjen kur i themi «frikaman». — Ai qëndroi një copë herë në heshtje dhe, pasi i dha fytyrës një pamje serioze, vijoi: — Në të vërtetë nuk është njeri i keq, — tha, — po i duhet qëndruar çekiç në kokë. Unë s'e lë rehat fare, sa herë që e shikoj se nuk është në rregull, i jap dru vendçe. Dhe ai e di se Bame Toroja nuk të fërkon kokën...

Bame Toroja kishte veshur një pelicë minatori dhe një kasketë me strehë të gjerë, ngjyrë blu të errët.

— Sa kohë e keqe! — tha njëri nga minatorët e rinj.

Sipër në kreshtat e larta të maleve vazhdonte të binte dëborë. Mbi shtratin e gjatë të lumit që gur-



gullonte si i tërbuar po grumbulloheshin re të dendura dëbore dhe, megjithëse ishte ende mesditë, gjithandej po varej një perde e rëndë ngjyrë hiri, që sa vinte bëhej më e dendur. Rrezet e dobëta të dritës binin me vështirësi gjer poshtë në xhade.

— Rruga është me të vërtetë e keqe, po ne do ta çajmë se s'bën, — tha Bame Toroja.

Ata vazhdonin të bisedonin për rreziqet e të papriturat e udhëtimeve nëpër rrugë të tilla malore e të ngarkuara me dëborë, kurse Baudin Kazazi qëndronte në heshtje dhe mendonte se fati i secilit prej tyre varej nga kujdesi i jashtëzakonshëm që duhej të tregonte shoferi. Martin Reka ktheu kokën vetëm për një sekondë nga e majta për të parë, si duket, shtratin e ngushtë të lumit që zbriste plot zhurmë nga malet e larta dhe, papritur, iu drodh timoni. Ja, për pak do të kishim shkuar në botën tjetër, mendoj Baudin Kazazi. Që nga ai çast, duke vështruar me frikë nga Martin Reka, atij po i dukej përherë e më shumë se ata po e humbisnin davanë. Kur u kthye nga Bame Toroja dhe e kuptoi se e kishte humbur, vuri buzën në gaz me pahir.

— Si duket keni shumë ftohtë, — tha Bame Toroja.

— Ashtu është, — iu përgjigj Baudin Kazazi. — S'ndihem mirë. Se si më duket! — tha ai me një zë të dridhur.

Përtej xhamave të trashë të syzave të tij optike sytë e tij të vegjël bënë ca lëvizje krejt të panevojshme.

Kristaq Dvoranit i erdhi përsëri keq për kolegun e tij të punës. Ai rrinte në sediljen e mbrapme si i ngrirë dhe kushedi se ç'mendime të frikshme bluante në kokë. Udhëtimi i ngadaltë nëpër xhadenë e mbuluar me borë, hapësira e gjerë që iu shfaq papritur në të majtë dhe relievi tepër i thyer malor në të djathtë të rrugës po ua shtonte rreziqet. Vende-vende kishin rënë togje bore mbi xhade. Duke manovruar me kujdes, Martin Reka u shmangej atyre me shumë vështirësi dhe vazhdonte të çante përpara. Me përjashtim të Baudin Kazazit, që kishte qenë një vit më parë në



Kreshnikën e largët, asnjëri nga anëtarët e tjerë të ekspeditës nuk kishte për të një ide të qartë. Kristaq Dvorani e kishte përfytyruar atë vazhdimisht si një fshat ngjyrë hiri, me shtëpi me çati të larta të stilit gotik, diku, midis bjeshkësh të mbuluara me dëborë të përjetshme. Kreshnikasit shfaqeshin para syve të tij si në ëndërr me një veshje barore me lëkurë deleje, ngjyrë hiri, të bardhë, të zezë, kafe, kafe në të zezë dhe aty-këtu lara-lara. Në këtë natyrë alpine me diell të ftohtë lëviznin pa pushim kreshnikasit e çuditshëm, pjellë e vërtetë e maleve shqiptare. Por ky ishte vetëm një mjegullim idesh të pasakta, të cilat dita e nesërme ose mund t'i vërtetonte plotësisht, ose mund t'i hidhte poshtë në mënyrë të pamëshirshme. Sa më shumë i afroreshin Kreshnikës, aq më shumë i shtoheshin kureshtja për vendasit, për mënyrën e tyre të jetesës, për zakonet e doket, këngët e vallet, që përbënin ushqimin shpirtëror të jetës së tyre të përditshme. Diku i kishte zënë veshi një fjalë se kreshnikasit nuk këndojnë kurrë të gjithë së bashku dhe se vegla e tyre muzikore më e preferuar është lahuta. Si është e mundur, thoshte me vete, që të kënaqet veshi i kreshnikasit duke dëgjuar zërin e vetmuar të lahutarit! Kishte diçka të çuditshme, pothuajse të pabesueshme në zakonet e banorëve të bjeshkëve krejt të ndryshme nga ato të viseve të tjera të Shqipërisë.

Kristaq Dvorani fshiu xhamin e veshur nga avujt e ngrohtë dhe tregoi një grykë që kalonte përmes një vargu malesh të larta të mbuluar me dëborë.

— Shikoni sa bukur! — tha. — Si quhen këto male, Baudin?

Baudin Kazazi mezi erdhi në vete.

— Si? — pyeti.

— Thashë, si quhen këto male?

Baudin Kazazi rregulloi syzet e tij optike me gishtin tregues, për të parë më mirë, dhe pastaj nisi të shpjegonte me një zë të dridhur, sikur ta ndiente veten fajtor për këtë heshtje të rëndë.

— Kjo është Qafa e Humnerës, — tha ai. — Në të



djathhtë duket Maja e Shqiponjës, ndërsa në të majtë ndodhet mali i Kreshnikës.

— Ashtu?!

— Po.

— Domethënë, përmes kësaj gryke do të kalojmë?

— Po. Pak më tej, mbi malin e Kreshnikës, po ta vini re me kujdes, duket një majë tepër e lartë dhe e mprehtë që ngrihet drejt qiellit. Ajo është Kreshta e Vdekjes, kurse nën të ndodhet Kreshnika e rrethuar nga të katër anët me bimësi alpine. Diku në afërsi të Kreshnikës, tre-katër kilometra para se të mbërrijmë atje, ndodhet vendburimi kryesor i mineralit të kromit.

— Mendoj se do të jetë një vend me të vërtetë i mrekullueshëm, — tha Kristaq Dvorani.

— Ka me të vërtetë diçka të rrallë, — tha Baudin Kazazi.

Njëri nga minatorët e rini tregoi me dorë shtratin shkëmbor të lumit që vinte duke u ngushtuar përherë e më shumë. Brigjet e tij të thepisura vend-vende dukeshin aq të afërta, sa që herë-herë të krijohej përshrypja e rreme se me një kërcim vigan mund të hidheshe në anën tjetër. Ujë të shkumëzuar rridhte, sikur të ishte një rrip i bardhë dhe i ngushtë. Edhe rruga po bëhej përherë e më e keqe. Vende-vende xhipsi ndeshej me togje dëbore të rëna nga shpati i thepisur i malit të lartë, që ngrihej në të maitë. Automobili hidhej përpjetë, tundej e dridhej, duke kaluar mbi togjet e dëborës, që çaheshin menjëherë nga fuqia e tij e përbindshme. Kristaq Dvorani u mbështet më mirë në ndenjësën e prapme dhe ia nguli sytë grykës së thellë që s'kishte të sosur. Qafa e Humnerës, që i kishte treguar pak më parë Baudini, ishte ende shumë larg. Muzgu sapo kishte filluar të binte. Po të errej, ata do ta kishin tepër të vështirë të udhëtonin nëpër një rrugë të tillë kaq të ngushtë dhe buzë greminës. Ai kishte filluar të shqetësohej sidomos pasi kishte vënë re se Martin Reka po jepte shenjat e para të lodhjes, duke u treguar herë pas here tepër i pasigurt. Por, sido që të ndodhte, Kristaqi kishte vendosur që të mos e



ndërprisnin udhëtimin. Fundja do të nxjerrim një njeri përpara që të na tregojë rrugën, mendoj ai, në mënyrë që të mos ndalemi në vend për asnjë minutë. Ndërsa vazhdonin të udhëtonin, Kristaqi mendonte dhe gëzohej që kishte midis tyre një burrë të moshuar si Bame Toroja. Ata, me përjashtim të Baudin Kazazit, që ishte disi më i madh, ishin të gjithë të rinj, rreth njëzet e katër ose njëzet e pesë vjeç. Bame Toroja u jepte zemër atyre dhe u ngjallte optimizmin. Megjithëse nuk dinin shumë gjëra rreth jetës së njëri-tjetrit, udhëtimi i gjatë e me plot rreziqe i kishte afruar ata aq shumë me njëri-tjetrin, sa që u dukej vetja sikur të ishin njohur e miqësuar prej kohësh. Në mes tyre po hidhte rrënjë një dashuri e vërtetë. Martin Reka vazhdonte të ecte me marshin e parë dhe vende-vende kaq ngadalë, sa që atyre u dukej sikur nuk po lëviznin nga vendi. Në tri-katër raste ai qëndroi për të pritur kamionin e Zaçe Çapokut, që zvarritej shumë ngadalë e duke lëshuar një uturimë të mbytur, të cilën gryka e lumit e merrte me vetë dhe e përcillte në drejtimin e kundërt. Nga veriu kishte filluar të frynte një erë e ftohtë që ndoshta mund të ishte bërë shkak që të ndërpritej rënia e dëborës.

— Kam dëgjuar, — tha Bame Toroja, — se nëpër këtë grykë të tmerrshme kanë kaluar dikur ushtritë turke, të cilat në afërsi të Kreshnikës në një fushë, që s'di se si quhet, Skënderbeu i shpartalloi plotësisht.

— Sipas historisë, — tha Baudin Kazazi, — ky ka qenë një kurth i kurdisur nga Skënderbeu. Ai i la turqit të futen në mes të këtyre maleve të larta dhe aty i shtypi pastaj porsi miza.

Bame Toroja e dëgjonte me vëmendje dhe tundte vazhdimisht kokën në shenjë miratimi.

— Ashtu është, more djalë, ashtu, — tha. — Mallet tona të larta kanë qenë e do të mbeten aleatet më besnike të shqiptarit.

Dhe ndërkohë filloi t'u tregonte diçka nga be-teja e tmerrshme e Mushqetasë, pjesëmarrës i së cilës kishte qenë dhe vetë.

Duke shtrënguar fort timonin që lëvizte sa majtas-djathtas, Martin Reka mori një kthesë të rrezikshme ngjitur me bregun e lumit dhe pastaj i dha gaz motorit, për të shtuar shpejtësinë. Ai i bëri shenjë me dorë një malësori me mustaqe të thinjura që rrinte i heshur në këmbë diku përtej kthesës së fortë dhe pastaj ia qepi sytë Qafës së Humnerës. A do të mbërrimë gjer atje, tha me vete, pa rënë plotësisht nata? Kristaq Dvorani vështroi se si i ndërroi marshet Martini dhe pastaj vështroi sahatin e dorës. Gjysmerrësira po përhapaj gjithandej.

— Si thua, Martin, — zuri të pyeste ai, — a do ta kalojmë sonte Qafën e Humnerës?

— Të vemë gjer atje njëherë, — iu përgjigj Martin Reka me ngadalë.

— Si duket, të paska zënë frika, — tha Kristaq Dvorani me të qeshur.

— Nuk e di, — ia ktheu Martin Reka, duke ngritur supet.

— Ke të drejtë. Njeriu mbi të gjitha! — ndërhyri Kristaqi me ton serioz.

— Të lumtë! — tha Bame Toroja. — Kështu është. Ja edhe në Mushqeta..., Megjithëse gjermanët kishin topa të mëdhenj dhe ishin të armatosur gjer në dhëmbë, në fund të fundit fituan shqipot që i kishin pushkët me gjalmë. — Na quajnë qeveri e rigonit, po nesër ne do të bëhemi me siguri qeveri e çelikut, — tha dhe e mbylli bisedën.

Ata bënë një copë rrugë në heshtje.

Jashtë kishte filluar të binte dëborë. Përmes flokëve të saj të dendur Qafa e Humnerës mezi dukej; errësira e natës po e pushtonte me shpejtësi grykën e ngushtë që kalonte midis majave të maleve të larta.

— Edhe kjo na duhej, — tha Martin Reka.

Ai shau nëpër dhëmbë dhe pastaj ndezi projektoret e automobilin, që vazhdonte të ngjitej me vështirësi nëpër xhadenë malore. Shtresa e dëborës sa vinte bëhej më e trashë, kurse rruga vende-vende nuk dallohej mirë.



## PARA SE TË FEJHESHIM

Margarita u vërtit një copë herë nëpër kuzhinë dhe pastaj hyri instinktivisht në dhomën e gjumit. As këtu nuk është, tha me vete dhe u shtri në pjesën e krevatit, ku flinte i shoqi. Kaloi pëllëmbët e duarve nën zverk dhe sytë ia mbërtheu tavanit. Pastaj ktheu kokën nga krevati i Rudinës së vogël. Ajo flinte e qetë e me doçkat përjashta. E mbuloi me kujdes, duke murmuritur ca fjalë të pakuptueshme. Ku e ke babin, moj zoçkë? Ishte nata e parë që ajo do të flinte vetëm me të bijën. Shtëpia i dukej bosh, tepër e vogël, tepër e huaj. Ktheu kokën nga ana tjetër. Era frynte si e tërbuar, aq sa gjëmonin xhamet e larta të dritareve. Po ai ku do të jetë tani? Mbi komodinë ndodhej libri, të cilin ai kishte filluar ta lexonte katër-pesë ditë më parë. Dhe nuk e përfundoi, mendoi ajo. Pas pak i shkoi në mendje se në sirtarin e vogël të komodinës së tij ndodhej tërë korrespondenca që kishin shkëmbyer me njëri-tjetrin para se të fejohehin. Kohët e fundit, sa herë që i vinte në vijë punët e shtëpisë, ajo e hapte atë, merrte ndonjë letër dhe e shfletonte. Letrat e tij fillonin me inicialet e njohura VF-LP, ndërsa letrat e saj të para fillonin me ca fjalë të thjeshta, tërë ankth dhe druajtje. Mirëpo, si u njohën mirë me njëri-tjetrin, ajo filloi të imitonte nga forma letrat e tij; për këtë arsye shumica e tyre mbanin të njëjtat initiale.

Bile, ndoshta ngaqë u qe bërë zakon, edhe në korrespondencën e tyre pas Çlirimit gjeje ngandonjëherë inicialet VF-LP.

Megjithëse e dinte përmbajtjen e tyre, ideja se mos e largonte vëmendjen nga ato mendime të kobshme, po e shtynte të hapte sirtarin dhe të nxirrte prej andej letrën e parë që do t'i zinte dora. Hapi sirtarin dhe mori një zarf të firmuar e me ca njolla të zeza mbi të. Adresa e tij ishte lagur si duket nga shiu, ose nuk dihej se si kishte ndodhur një gjë e tillë, dhe ishte bërë krejt e palexueshme. Ou! ia bëri me vete. Kjo letër e shqetësonte së tepërmi, mbasi aty gjente murmurima, mendime, fjalë, mërzi dhe pika lotësh. Ishte pikërisht koha kur dashuria e tyre kalonte çaste kritike. Ç'ta lexonte. Ajo e kishte lexuar atë me dhjetëra herë. M'u thaftë dora, tha me vete. Përse zuri pikërisht atë letër, që, sa herë që e kujtonte, i prishej gjaku e i bëhej ujë. E la letrën mbi komodinë, mbylli sytë përgjysmë dhe filloi të sillte ndër mend të kaluarën. Përse ishin sjellë aq keq me dashurinë e tyre të singertë? Tërë fshati pëshpëriste vesh më vesh. Të gjithë. Të gjithë. Të gjithë. I vinte të pëlçiste. Dhe më e keqja ishte se thashethemeve u besonin edhe e ëma, e motra, i kunati dhe vëllezërit. Të gjithëve u ishte ngulitur në kokë mendimi se ajo e kishte turpëruar tërë familjen e Saraçajve. Njerëzit e dhënë pas thashethemeve, që zakonisht vërtiteshin aty nga kafeneja e fshatit, i stërhollonin gjërat në atë mënyrë, saqë miopëve u dukeshin si të vërteta. Ajo që kishte bërë më shumë bujë dhe që ishte përdorur si një armë e fortë nga ana e thashethemaxhinjve ishte çështja e fotografisë. Qyteti sapo ishte çliruar. Kristaqi, i entuziazmuar në kulm, e kishte takuar atë në një rrugicë, pikërisht aty ku kufizoheshin lagjet e tij të jashtme, me fshatin, dhe i qe lutur që të bënin një fotografi. S'dihet, i kishte thënë, lufta vazhdon... dhe... unë mbase edhe mund të vritem... Brigada jonë do të ndjekë forcat gjermane deri në Jugosllavi, kështu që s'është keq që të bëjmë një fotografi bashkë... Asaj i kishte ardhur keq dhe kishte



pranuar që të bënin një fotografi te foto «Morava». Mirëpo nuk thonë kot se dardha e ka bishtin prapa. Fotografit plak i kishte pëlqyer shumë fotografia. Ai e zmadhon atë dhe e vendos në vitrinë, duke mos ditur se dashuria e tyre ishte ende ilegale. Kaq duhej mbasi në këtë mënyrë ai u kish dhënë në dorë thashethemexhinjëve të fshatit të tyre një armë tepër të fuqishme. Gjithsecili përpiquej që t'i jepte ngjyrat e veta këtij skandali. Gati tri javë rresht në fshat s'dëgjohej gjë tjetër veçse çështja e fotografisë. Atëherë Margarita ishte bërë si e çmendur. S'e donte veten. Për një kohë të gjatë nuk doli nga shtëpia, bile dhe bisedat me njerëzit e shtëpisë i rralloi së tepërmi.

Përse po më kujtohen sot të gjitha këto, tha ajo me vete, e pikërisht sot që ai u nis për në Kreshnikën e largët. Ajo ishte në merak për Kristaqin, ashtu si atëherë. Kur do të kthehesh? e kishte pyetur në çastin që do të ndaheshin, disa minuta pasi kishin bërë fotografinë. S'dihet, i qe përgjigjur ai. Të thashë se brigada jonë do të kalojë edhe në tokën jugosllave. Kemi urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm që t'i ndjekim gjermanët këmba-këmbës edhe pasi të jetë çliruar e gjithë Shqipëria. Po përse? e kishte pyetur sërishmi ajo. O, ç'pyetje?! kishte thënë ai. Sepse ne jemi internacionalistë, moj Ritkë e dashur! Dhe pastaj ishte bashkuar me forcat partizane që po largoheshin nga qyteti i porsaçliruar, duke e lënë atë në duart e sigurta të forcave territoriale. Ne jemi internacionalistë, kishte murmuritur ajo me vete. Ç'fjalë e çuditshme? Ajo e dëgjonte atë për herë të parë. Do të kthehem, i kishte thënë ai. Do të kthehem patjetër. Dhe vërtet ishte kthyer një ditë krejt papritur. Margarita qe gëzuar shumë kur e kishte marrë vesh një gjë të tillë, po nuk guxonte të dilte nëpër rrugë për ta takuar. Çështja e fotografisë kishte bërë shumë bujë dhe ajo ishte vrarë shpirtërisht.

Rrugicat e fshatit të shtruara me kalldrëm në kujtesën e Margaritës u mbuluan papritur me re, dëborë dhe vërshëllima ere. Pastaj, para syve të saj u shfaq

një rrëpirë me gurë që po përpihej në mënyrë të pamëshirshme nga errësira. Ngandonjëherë Margaritës i dukej sikur tërë jeta e saj kishte qenë një ëndërr e llahtarëshme me gjithfarë të papriturash të frikshme.

Ashtu si atëherë, tha përsëri me vete ajo. Kur do të kthehesh, e kishte pyetur ajo, në mëngjes, kur po nxirrnin plaçkat e tij të paketuara në rrugën «Mine Peza».

S'dihet, i qe përgjigjur ai. Dhe, kur i kishte thënë se ekspeditës i qe ngarkuar një detyrë e rëndësishme, asaj i qe dëgjuar: «Brigada jonë do të kalojë edhe në tokën jugosllave». Ç'mendime të çuditshme.

Margarita u ngrit nga krevati dhe vuri re se pëllëmbët e duarve i qenë mpirë, ndërsa trupi i qe bërë akull. Ç'budallaqe që jam, murmuriti me vete. U shastisa fare. Po vriste mendjen për të gjetur se përse ishte shtrirë në atë mënyrë në krevat e pikërisht në vendin ku flinte ai, po hëpërhë nuk po i kujtohej. Shyqyr që nuk më paskësh zënë gjumi, tha përsëri me vete dhe fërkoji duart e mpira. Në çast u afrua te krevati i së bijës. Rudina e vogël i kishte nxjerrë përsëri doçkat e saj përjashta.

— Ku e ke babin, moj korbë? — i tha së bijës, duke e mbuluar me kujdes, që të mos e zgjonte.

Jashtë frynte një erë e akullt që të thante. Xhamat e lartë të dritareve të dhomës së gjumit gjëmonin dhe perdet lëkundeshin lehtë nga era që hynte nëpër të çarat e vogla.

Ç'dimër i egër, tha me vete Margarita.



## QAFA E HUMNERËS

Një gjysmë ore më vonë automjetet e ekspeditës gjeologjike u futën në një rajon ku binte një dëborë e dendur që nuk të lejonte të shihje as disa çapa më tutje. Xhadeja malore ashtu si edhe më parë nuk dallohej fare. Megjithëse automjetet ecnin njëri pas tjetrit fare ngadalë, kjo nuk i pakësonte rreziqet e të papriturat. Shërbimi i udhërrëfyesit u bë i domosdoshëm dhe diçka e zakonshme. Me këtë detyrë u ngarkuan të gjithë me përjashtim të Martin Rekës që drejtonte makinën dhe Baudin Kazazit që nuk ishte në gjendje të ecte nën dritat verbuese të projektorëve. Ngaqë jashtë bënte shumë ftohtë, ata kishin vendosur ta ndërronin njëri-tjetrin në çdo dhjetë minuta.

Automjetet ecnin aq ngadalë, saqë dukeshin sikur zvarriteshin mbi dëborë. Udhëtimi kishte filluar të bëhej me të vërtetë i mërzitshëm. Baudin Kazazi i kishte humbur fare shpresat për të kaluar natën diku brenda nën çati. Ai që mbyllur në vetvete aq, sa nuk u kishte thënë shokëve asnjëherë se të gjitha këto stërmundime që po bëheshin ishin pa kuptim.

Kristaq Dvorani u gëzua së tepërmi kur pa se po i afroheshin një qendre të banuar. Ndoshta pikërisht kjo është Kreshnika jonë, tha me vete ai. Mirëpo, kur iu kujtua se ata nuk kishin kaluar Qafën e Humnerës, shkëndija e gëzimit iu fik me të njëjtën shpejtësi që

ishte ndezur. Sidoqoftë ne po i afrohemi një qendre të banuar, mendoi prapë ai sa për të qetësuar veten. Diku, tutje, në thellësi, përmes dëborës së dendur që binte pa pushim vezullonte një dritë e zbehtë. Automjetet vazhdonin të zvarriteshin ngadalë. Në rolin e udhërrëfyesit tani ishte vetë ai, shefi i ekspeditës gjeologjike. Tre minatorët e rinj ishin lutur që këtë punë ta bënin vetëm ata, po ai nuk kishte pranuar.

— Një dritë! — thirri njëri nga minatorët dhe rërceu nga makina në ecje e sipër.

— Pa shikoni, përpara kemi një dritë! — tha edhe një zë tjetër nëpër errësi.

Njerëzit, ngaqë ishin lodhur nga udhëtimi, shfaqjen e një drite të zbehtë, diku përpara tyre, e morën si një shenjë jete. Në fillim, të gjithë menduan se para tyre ndodhej Kreshnika; mirpo, duke qenë të sigurt se nuk kishin kapërcyer ende Qafën e Humnerës, dëshira e tyre e përbashkët u venit menjëherë.

Drita që u shfaq ca çaste më parë tashmë dukej shumë qartë. Ata vunë re se ndriste dritarja e një shtëpie fshati dhe aty-këtu vezullonin edhe drita të tjera të zbehta, të cilat herë pas here humbisnin nëpër errësi. Vazhdonte të binte dëborë e dendur. Tani po udhëtonin nëpër një rrugë të drejtë që të çonte në zemër të fshatit të panjohur. Minatori që kishte zbritur pak më parë nga makina hipi përsëri dhe u ul në vendin e vet. Të njëjtën gjë bëri edhe Kristaq Dvorani. Tani rruga dallohej mirë dhe dritat e zbehta të fshatit shërbenin si pika të sakta orientimi. U shfaqën përsëri disa drita të tjera njëherësh. Si dukej, para tyre ndodhej një fshat i madh ende i panjohur.

— Ç'fshat është ky? — pyeti njëri nga minatorët, duke u kthyer nga Baudin Kazazi.

— S'më kujtohet, — u përgjigj shkurt ai. — Unë kam kaluar këndej një vit më parë dhe në të dy rastet kam udhëtuar ditën.

— Ke të drejtë, — tha Bame Toroja. — Tani s'merret vesh se ç'bëhet.

Ata e bënë një copë herë rrugën në heshtje.



— Le të ndalemi sonte këtu, — tha Adushi, minator i më i ri, zëri i të cilit ishte dëgjuar shumë rrallë gjatë gjithë rrugës. — Ndoshta nuk do ta kalojmë dot Qafën e Humnerës.

— Qafa e Humnerës është tepër e rrezikshme, — tha menjëherë Baudin Kazazi. — Ne, atëherë, mezi e kaluam atë ditën dhe në kohë të mirë.

Në mes tyre ra përsëri një heshtje e rëndë. Asnjëri nuk po fliste. Edhe Kristaq Dvorani e la këtë mendim të kalonte në heshtje. Kjo donte të thoshte se, sipas tij, as që ia vlente të diskutohej rreth një mendimi të tillë. Mendimi u tret në errësirën e natës, duke lënë pas vetëm heshtje.

— Le të ndalojmë pak këtu, sa të marrim vesh se ku ndodhemi, — tha Kristaq Dvorani.

Kur frenoi Martin Reka, nga lagjja më e afërt u dëgjuan menjëherë të lehura qensh.

— Për ne lehin? — pyeti njëri nga minatorët.

— Ashtu duket, — tha Martin Reka.

Kristaq Dvorani zbriti nga makina, ngriti kokën dhe mbajti vesh, po në çast për pak sa nuk u rrëzua, sepse iu fut këmba në një gropë.

Vazhdonte të binte dëborë; era e akullt që e shoqëronte e përziante, duke e hedhur sa andej-këndej.

— Se ku leh një qen diku këtu në thellësi të kësaj rrugicës së errët, — tha Kristaq Dvorani.

— Hip në makinë, — tha Bame Toroja. — Është më mirë të afrohem deri te porta e kësaj shtëpie që ndodhet në krahun e djathtë të rrugës dhe aty të trokasim sa për të pyetur.

Kristaq Dvorani u kthye dhe hipi përsëri në makinë.

Kori i qenve vazhdonte avazin e vet. Martin Reka e ngau makinën me ngadalë duke e rrotulluar timonin nga e djathta. Ata mbërritën përballë portës së gurtë të shtëpisë njëkatëshe që ndodhej mu në krye të rrugës kryesore e që e ndante fshatin në dy pjesë. Ndërtesat që ndodheshin rreth e rrotull tyre kishin mure të ulëta dhe çati të larta me majë të mprehtë, që zbardhnin nga dëborat. Projektorët e fuqishëm të automjeteve u

kryqëzuan në drejtime të kundërta, duke nxitur në këtë mënyrë edhe më shumë të lehurat e qenve.

Kristaq Dvorani dhe njëri nga minatorët iu afruan portës, trokitën dy-tri herë dhe pritën përgjigje. Trokitën përsëri dhe qëndruan në heshtje. Të trokiturat dëgjoheshin qartë dhe nata e errët i përcillte ato gjer larg. Filluan të lihnin përsëri disa qen tutje në thellësi të fshatit. Një lloj alarmi, që kishte diçka të frikshme dhe diçka të gëzueshme njëkohësisht, filloi të shpërndahej gjithandej. Të lehurat e qenve filluan të bëheshin më të dendura. Kristaq Dvorani trokiti përsëri, po kësaj radhe më me forcë. U dëgjua edhe një e lehur e ngjirur e një qeni që duhej të ishte diku aty afër. Porta kërciti papritur. Të gjithë u gëzuan së tepërmi. Dera filloi të hapej ngadalë. Sytë e tyre ishin mbërthyer pikërisht tek ajo derë e drunjtë, që u hap duke vajtuar. Te pragu u shfaq një grua e moshuar, e veshur me të zeza.

— Kush jeni ju, o ju pastë nënë Drandja! — thirri ajo nëpër errësirë.

— Ne vijmë nga Tirana dhe shkojmë për në Kreshnikë, — tha Kristaq Dvorani, tek po i jepte dorën.

— Po është tepër vonë, o djemtë e nënë Drandes, — u dëgjua përsëri zëri i saj. — Qëndroni sonte këtu edhe nesër nisuni që pa gdhirë. Shtëpitë tona i kanë dyert të hapura për miqtë.

Kristaq Dvorani e pyeti se si quhej fshati i tyre dhe ajo ia tha. Pastaj ai i shpjegoi arsyet se përse duhej të vazhdonin udhëtimin. Nëpër errësirën e natës u dëgjua një bubullimë e fuqishme, e cila u largua gjer tutje thellë në gjirin e maleve, duke lënë pas vetëm jehonën e saj shurdhuese. Dëbora, që kishte pushuar pak më parë, filloi të binte përsëri me flokë të mëdhenj.

— Gjëmon Kreshta e Vdekjes! — tha nënë Drandja.  
— Dimri i sivjetëm s'është parë ndonjëherë.

Më në fund, pasi u tregoi se ku ndodheshin pikat më të rrezikshme që kërkonin kujdes të veçantë, u uroi atyre rrugë të mbarë.



— Në të hyrë të Kreshnikës, — tha ajo që nga pragu i derës, — është një han ku ndalen udhëtarët që i zë nata jashtë.

Automjetet e lanë pas fshatin, duke çarë me vështirësi dëborën e madhe. U dëgjuan përsëri të lehurat e qenve, sikur të donin të paralajmëronin largimin e tyre. Ashtu si edhe më parë, vende-vende rruga nuk dallohej fare. Atyre iu desh që të organizonin përsëri shërbimin e udhërrëfyesit, të cilin nuk e hoqën, gjersa mbërritën në vendin e quajtur «Qafa e Humnerës». Këtu nata dukej pis e zezë. Frynte një erë e llatarshme dhe e ftohtë. Relievi ishte tepër i thyer dhe drurët alpinë, të shtrembëruar nga ndeshja e përbindshme me natyrën e egër, kishin marrë ca forma të çuditshme, që ngjanin më tepër me kafshë gjigante. Poshtë, në krahun e majtë ndodhej humnera, e cila ishte gati të përpinte çdo gjë. Vdekja ndodhej fare pranë tyre. Të gjithëve u dukej vetja si në ëndërr.

Tri orë më vonë, kur nata ishte në të thyer, automjetet e ekspeditës gjeologjike u gjendën duke udhëtuar nëpër një rrafshinë përtej Qafës së Humnerës. Tani Kreshnika ndodhej shumë afër dhe ata ishin jashtë çdo rreziku.

Era e ftohtë vazhdonte të frynte si e tërbuar nëpër natën e errët.

# **DITA E KATËRT**

**E martë, 17 shkurt 1948**



## HANI I VJETËR NDANË RRUGËS

Kristaq Dvorani qëndroi një copë herë të gjatë në këmbë, duke vështruar në heshtje herë ndërtesën e vogël të hanit ndanë rrugës dhe herë malin e lartë të Kreshnikës, që ngrihej para tyre si një gjigant i vërtetë. Ai dukej i bardhë, krejt i bardhë. Dëbora kishte vendosur kudo pushtetin e saj. Bame Toroja kishte rënë gjithashtu në mendime. Tek thithte cigaren e dredhur, ai tundte kokën e tij të thinjur në mënyrë ritmike, sikur të donte të thoshte: «Na e more të keqen, do ta çajmë barkun tënd të madh dhe do të nxjerrim prej andej kromin që na e ke fshehur prej shekujsh!»

— Këtu do ta ngremë kantierin, — tha Kristaq Dvorani, gati duke murmuritur me vete.

— Ashtu do të bëjmë, o kapedan! — shtoi pas pak edhe Bame Toroja, duke i dhënë fytyrës së tij një pamje më serioze.

Kristaq Dvorani buzëqeshi lehtë dhe i hodhi atij një vështrim të shkurtër me bishtin e syrit.

— Këtu do t'i përqendrojmë forcat tona, — tha Bame Toroja, duke u krekosur edhe më shumë, sikur të kishte përpara ndonjë ushtri të madhe pushtuese, me të cilën së shpejti do të ndeshej për jetë a për vdekje.

Qielli ishte i ngarkuar me re të dendura dëbore.

Pas pak u afrua ngadalë nga Kristaq Dvorani, i cili po vështronte i menduar shpinën e kërrusur të malit të Kreshnikës.

— Mos u mërzit, — i tha me një ton familjar. — Do t'ia gjejmë vendin edhe kantierit, do t'ia çajmë bar-kun edhe këtij përbindëshi që kemi përpara dhe do të nxjerrim prej andej kromin. Të gjitha do t'i bëjmë, o djalë i mbarë! Vetëm mos u mërzit. Punët e mira bëhen avash-avash, thotë populli ynë.

Kristaq Dvorani ktheu kokën i shqetësuar.

— Po afati? — thiri ai papritur. — Brenda javës qeveria kërkon që...

Bame Toroja i rrahu shpatullat ngrohtësisht dhe prapë i tha:

— Edhe për këtë mos u mërzit, të gjitha do t'i bëjmë, në kohë dhe me cilësi të mirë, ashtu siç e ka zakon shqiptari. Dëgjo Bame Toron ti, të gjitha do t'i bëjmë! Vetëm mos u mërzit.

Kristaq Dvoranit iu ngroh zemra dhe e ndjeu se tërë qenia e tij u bë më e fortë.

Një copë herë ata vështruan njëri-tjetrin në sy dhe pastaj filluan të qeshnin me zë. S'dinin se si ta falënderonin njëri-tjetrin për këto fjalë të ngrohta e plot optimizëm.

— Ashtu qoftë! — tha më në fund Kristaq Dvorani me të qeshur.

— Ashtu de, kështu ju do Bame Toroja.

Kristaq Dvorani dukej shumë i lumtur.

Vendosën të pastrohej hani i vjetër dhe ambienti rreth e rrotull tij. Kur njëri nga minatorët hapi derën e hanit, ajo lëshoi një klithmë të zgjatur, sikur të donte të thoshte: Ç'bëni kështu, a nuk e shikoni se e kam trupin gjithë plagë? Dera e hanit ishte tepër e vjetër. Dërrasat nuk ishin të puthitura mirë dhe vende-vende ishin të plasaritura. Brenda kishte gurë të hedhur andej-këndej. Në mes ndodhej një vatër zjarri, kurse në të dy anët e saj kishte bar të thatë të tymosur, gjë që tregonte se aty kishin banuar njerëz. Muret ishin të pasuvatuara dhe të tymosura. Po kështu edhe



trarët që mbanin çatinë e mbuluar me pllaka guri nxinin nga tymi.

— Strehëz, moj strehëz! — tha me të qeshur Bame Toroja.

Adushi qeshi.

— Hajde, djema, hajde! — i qortoi Bame Toroja.

— I lëvizni duart! Ç'më rrini ashtu si të shastisur! S'kemi kohë të nusërojmë! Shpejt!

Bashkë me Zaçe Çapokun ai po sillte një ngarkesë që mezi po e mbanin. Martin Reka u shkoi menjëherë në ndihmë për ta ulur në tokë.

— Largoje dëborën shpejt! — i tha ai Martinin. — Hape edhe rrugën këtej nga e djathta.

Tre minatorët po pastronin me nxitim. Ata kishin nxjerrë jashtë të gjitha pislleqet dhe gjërat e panevojshme. Ndërsa Adushi po gërryente me lopatë teje-mbanë dyshemenë përdhese të hanit, Shpëtimi dhe Fakun po pastronin ambientin rreth e rrotull tij.

— Strehëz, moj strehëz! — vazhdonte të thoshte me vete Bame Toroja. — Kush të ka katandisur në këtë gjendje?

Adushi ia plasi gazit.

— Adush, mos qesh! — thirri Bame Toroja, duke mbartur me vështirësi një ngarkesë tjetër nga kamioni. — Aty ke për ta futur kokën kur të bjerë dëborë e të fryjë suferina.

Adushi qeshi përsëri.

— Kjo na paskësh qenë ajo strehëza e ngrohtë që na tregoi mbrëmë nënë Drandja, — tha ai.

— Hajdeni, djema, shpejt! — u dëgjua përsëri zëri kumbues i Bame Toros.

Dëbora kishte disa minuta që kishte pushuar. Nga lindja po frynte një erë e ftohtë që filloi t'i shpërndante retë në drejtime të ndryshme. Midis kreshtave të malit të Shqiponjës, në anën tjetër të Grykës së Suferinës, u dukën rrezet e para të diellit, i cili sapo kishte lindur. Fusha e stërgjatë që shtrihej midis dy vargmaleve filloi të shkëlqente tej e mbanë. Dolën

më në fund në pah edhe çatitë e larta me majë të mprehtë të Kreshnikës.

— Ç'fshat i bukur?! — thirri i habitur Baudin Kazazi, i cili po kthehej nga një rrugicë këmbësore, nëpër të cilën mendohej të fillonte ngjitja e motokompresorit.

Bame Toroja u kthye nga ai.

— Mos na çaj kokën me bukuritë e natyrës, «inxhinier»! Pa na thuaj si është rruga? A do ta ngjitim motokompresorin?

Baudin Kazazi tundi kokën, duke lënë të kuptohej se një gjë e tillë ishte e pamundur.

— Hajde, lëri ato! — shfryu me inat Bame Toroja. — Kështu e kemi ju të inteligjencies; po nuk thatë njëherë jo, nuk e bëni punën.

Adushi qeshi. Baudin Kazazit nuk i erdhi mirë.

— Shtëresa e dëborës është shumë e trashë, — tha si pa qejf ai. — Vendë-vendë ajo arrin deri dy metra, bile edhe më shumë.

Zaçe Çapoku e vështroi i pikëlluar.

— Mos u mërzit, «inxhinier»! — tha Bame Toroja. — Do ta çajmë se s'bën. Pa shiko, përse i kemi marrë tërë këto lopata?!

Ai i tregoi grumbullin e lopatave që kishin hedhur para hyrjes së hanit të vjetër, i cili kishte marrë tani një pamje tjetër.

— Pa hajde, hajde një çikë këtu! — i tha pas pak Baudin Kazazit. — Hadje ta ngremë bashkë këtë ngarkesë që kemi përpara. Shpejt, ulë shpinën!

Baudin Kazazi rregulloi syzet e tij optike dhe pastaj u përkul si me përtim.

Dikush andej nga prapa ia plasi gazit, kur pa se Baudini po përkundej sa majtas-djathtas nga pesha e rëndë.

— Hajde, djalë, për kokën e djalit që më je, — i tha Bame Toroja, pasi e lanë ngarkesën nën strehën e hanit. — Edhe një peshë të tillë si kjo nuk ngre, a derëzi! Dhe i thua vetes djalë!

Baudin Kazazi vuri buzën në gaz i tumpëruar. Pas-



taj rregulloi syzet e tij optike, që i vareshin mbi hundë.

— Ç'të bësh, s'është me inat, po me takat, — tha njëri nga minatorët.

Zaçe Çapoku po mundohej të zbriste disa vegla pune nga kamioni.

— Hajde, hajde, djema! Shpejt! — thërriste vazhdimisht Bame Toroja.

Ai pa orën e tij të xhepit dhe filloi të shqetësohej. Kristaq Dvorani kishte gati një orë e gjysmë që ishte nisur në drejtim të Kreshnikës dhe ende nuk po kthehej.

Qielli filloi të mbulohej përsëri me re të dendurë dhe të ulëta. Koha ndryshonte aty për aty, si duket nga erërat e ftohta që frynin nga të gjitha drejtimet.

— Në sulm me të gjitha forcat për të zbritur nga makina motokompresorin, — kumboi papritur zëri i Bame Toros.

Ai futi me ngadalë sahatin në xhep dhe pastaj filloi të ecte në drejtim të kamionit, duke i dhënë fytyrës një pamje serioze.

Zbritja e motokompresorit ishte me të vërtetë një punë e vështirë.

— Arkat me dinamit do t'i lëmë hëpërhë në kamion, — urdhëroi përsëri ai me të njëjtin ton.

Motokompresori lëvizi nga vendi.

— Kujdes, djema! — thiri Bame Toroja. — Kujdes se mos vriteni!

Pesha e tij ishte e rëndë, tepër e rëndë, po atyre u erdhën në ndihmë dërrasat që kishin vënë në të dyja anët e spondit. Motokompresori filloi të rrëshqiste ngadalë dhe, i mbajtur me kujdes në të gjitha drejtimet, në pak çaste ai u gjend në tokë. Shtati i tij ishte i gjatë dhe hijerëndë. Pa të nuk mund të bëhej asnjë hap për hapjen e vrimave të dinamitit. Barominat e dorës dukeshin tepër qesharake, po të krahasoheshin me punën që bënin pistoletat që do të ushqente motokompresori.

Gjithandej të zinte syri kazma, lopata, enë kuzhine, ushqime të paketuara, konserva, batanije, çiz-

me llastiku, peliçe, disa të sistemuara, disa të hedhura andej-këndej. Kantieri i minierës së ardhshme po merrte formë. Ndërtesa e hanit, e cila në mënyrë të papritur ishte përfshirë në gjirin e kantierit, që nga ky çast nuk do të quhej më «han» për kalimtarët që i zinte nata rrugës, por «ndërtesa e parë» e minierës.

Bame Toroja po vështronte rreth e rrotull me një pamje të gëzuar në fytyrë. Hëpërhë dukej se çdo gjë ishte në vendin e vet.

— Pra, kështu, — tha ai duke murmuritur me vete, sikur të donte të bënte bilancin e punës. — Kjo është, shokë, pasuria jonë. Me këtë bazë materiale ne do të fillojmë punën për hapjen e minierës së re të Kreshnikës.

Të gjithë qëndruan një copë herë të gjatë në heshtje.



## TE MBËSHTETEMI NË FORCAT TONA

Kristaq Dvorani i bëri një inspektim të shpejtë kantierit. Për çudinë e të gjithëve, pa treguar ndonjë interes për mënyrën se si ishin sistemuar gjërat, ai mori me vete Bame Toron dhe filloi të ecte në drejtimin nga kishte ardhur. Pas pak thirri edhe Baudin Kazazin, i cili u gjend pranë tyre menjëherë.

Të tjerët po ndiqnin me interesim çdo lëvizje që bënte shefi i kantierit. Bame Toroja dhe Baudin Kazazi po e ndiqnin atë këmba-këmbës. Kristaq Dvorani u ngjiti mbi një kodër në krahun e djathtë të rrugës automobilistike. Minatorët vinin re edhe gjestin e tij më të vogël.

— Po bëjnë planin e betejës! — tha Zaçe Çapoku me një ton ironik e duke i treguar ata me një lëvizje të kokës.

Martin Reka e vështroi i inatosur.

— Akoma nuk vure mend ti? — shfryu plot zemërim Shpëtimi.

— Ti s'je në vete, — tha një tjetër.

Zaçe Çapoku bëri një gjest pakënaqësie dhe pastaj qeshi me zë.

— Po studiojnë vendin nga ku mund të bëhet ngjitja e motokompresorit, — tha njëri nga minatorët.

— Ashtu?! — tha një tjetër.

— Pse, rruga që kemi këtu pranë nuk është e përshatshme? — pyeti i shqetësuar Adushi.

Dielli gjeti përsëri një boshllëk midis reve. Rrezet e tij verbuese ndriçuan për një copë herë të gjatë një pjesë të mirë të fushës dhe shpinën e malit të Kreshnikës. Kreshta e Vdekjes (kështu quhej maja më e lartë e tij) zgjatej drejt qiellit si koka e një kafshe gjigante prehistorike. Ajo dukej sikur kishte zënë pusi e përgjonte çdo gjë rreth e rrotull Grykës së Suferinës. Në fshat Kristaq Dvorani kishte mësuar se pikërisht që andej nga Kreshta e Vdekjes shkëputeshin ortekë të mëdhenj dëbore, të cilët zbrisnin gjer poshtë në fushë, duke përfshirë me vete çdo gjë që gjenin përpara.

— Kjo është tepër e rrezikshme! — tha me një gjysmë zëri Kristaq Dvorani. — Sektori ku mendojmë të fillojmë punimet bie pikërisht nën Kreshtën e Vdekjes, kështu që... një ortek i ardhur papritur mund të rrëmbejë tërë ekspeditën...

Baudin Kazazi u zverdh në fytyrë. Ndërsa Bame Toroja nuk tha asgjë.

— Në fshat më thanë se dëbora e madhe që ka rënë këto ditë do të shoqërohet patjetër me ortekë të fuqishëm.

— Dhe e keqja është se dëbora vazhdon të bjerë, — tha pas pak Bame Toroja.

Qëndruan një copë herë të gjatë në heshtje.

— Ç'rrugëzgjdhje ju propozuan fshatarët? — pyeti Baudin Kazazi me një zë të dridhur.

— Thanë që t'i shtyjme punimet për më vonë, gjë që neve nuk na leverdis.

— Në asnjë mënyrë! — tha Bame Toroja. — Duhet të vrasim mendjen që të gjejmë një rrugëzgjdhje tjetër.

Ai hodhi vështrimin nga e majta.

— Ndoshta nga ana tjetër e sektorit rreziku është më i vogël, — tha ai, — por, ç'e do, se andej do ta kemi të vështirë për të ngjitur motokompresorin.

— Sa për këtë, mos u bëni merak, — ndërhyri menjëherë Kristaq Dvorani. — Nga fshati do të na vijjë në ndihmë shumë forca. Për këtë bisedova edhe me kryetarin e këshillit të lokalitetit.



Baudin Kazazit i ndriti fytyra.

Bame Toroja filloi të dridhte një cigare.

Njoftimi për ardhjen e forcave punëtore nga fshati ia mbushi zemrën plot me gëzim Bame Toros.

— Po të jetë kështu, — tha Baudini, — unë mendoj që të fillojmë me rindërtimin e rrugës ekzistuese që, me sa më kujtohet, shkon deri në vend, — theksoi ai. — Kjo jo vetëm që do të lehtësojë ngjitjen e motokompresorit, por do të na shërbejë më vonë edhe për zbritjen e mineralit poshtë, në xhade. Përndryshe...

— Ne nuk duhet t'i varim shpresat te rruga, — tha Kristaq Dvorani. — Rindërtimi i saj mund të na kërkohet shumë kohë. Sipas meje, ajo që ka më tepër rëndësi është ngjitja e motokompresorit. Për këtë ne duhet të shfrytëzojmë rrugën më të shkurtër: të ngjitemi drejt monopazit që shtrihet mbi kantier.

— Çështja e rrugës hëpërhë nuk na prish shumë punë, — tha Bame Toroja.

— Mirë, po unë mendoj se do ta kemi vështirë edhe për të qarkulluar, pa le pastaj për...

Baudin Kazazi dëshpërohej sa herë që flitej për mosrindërtimin e rrugës, mungesa e së cilës, sipas tij, mund të paralizonte gjithë punën. Ai mendonte se nuk mund të ngjitej motokompresori, pa hapur më parë rrugën gjer në sektorin ku do të fillonin punimet.

— Gjëja kryesore nuk është rruga, por motokompresori, more djalë! — tha Bame Toroja që e kishte vënë re hutimin e Baudin Kazazit. — Burrat e Kreshnikës janë nga dy metra të gjatë dhe i kanë shpatullat si të ariut, e jo kështu si ti dhe unë, që para tyre do të dukemi si milingona...

Baudin Kazazit nuk i erdhi mirë që e krahasoi edhe atë me një milingonë. Megjithatë nuk ia mori për të keq, se e dinte që Bame Toroja ishte një njeri me zemër të bardhë. Ai vërtet bënte shaka, shpeshherë edhe të tepruara, bile ngandonjëherë nxehej dhe shante si t'i vinte për mbarë, por në zemër nuk kishte asgjë të keqe. Ai nuk ia donte kurrë të keqen shokut; këtë cilësi të karakterit të tij, megjithëse s'kishte veçse

dy ditë që ishte njohur, Baudin Kazazi e kishte pikasur menjëherë.

— Në këtë gjendje që paraqiten punët, — tha Kristaq Dvorani, — ne nuk mund të mendojmë për hapjen e rrugës.

— Hajde, shkojmë, se po na presin shokët, — tha Bame Toroja për t'i dhënë fund kësaj bisede.

Zbritën nga kodra e mbuluar me dëborë, duke u kujdesur për njëri-tjetrin. Shtresa e dëborës ishte e trashë dhe e shkrifët.

Kur mbërritën në kantier, vunë re se ishte përgatitur edhe «parku» i automjeteve. Xhipsi dhe kamioni qëndronin përbri njëri-tjetrit, kurse në krahun e djathtë të tyre kishte vend edhe për tri-katër automjete të tjera. Ndërtesa e hanit të vjetër kishte marrë tashmë tjetër pamje. Ajo s'kishte asgjë të përbashkët me hanin e braktisur që kishin pasur para syve gjysmë ore më parë. Përkundrazi, aty hynin e dilnin punëtorët e parë të minierës së ardhshme.

Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja hynë brenda. Baudin Kazazi u bashkua me minatorët dhe po filloi të kuvendonte për ngjitjen e motokompresorit.

Kristaq Dvorani u ul pranë tij dhe filloi të dridhte një cigare, duke u menduar.

Jashtë filloi të binte përsëri dëborë e dendur, e shoqëruar me një të ftohtë që vinte nga lindja.

— Ç'mendon? — e pyeti Bamja. — A të provojmë se mos e ngjisim motokompresorin? Unë mendoj të mos presim sa të na vijnë fshatarët në ndihmë.

Kristaq Dvorani uli kokën në shenjë miratimi.

— Nuk do të ishte keq ta provonim njëherë që të shikonim se ç'jemi në gjendje të bëjmë duke u mbështetur në forcat tona.

Bame Toroja vuri buzën në gaz. Pastaj i rrahu shpatullat Kristaq Dvoranit.

— Hajde! — tha. — S'ta prish qejfin Bame Toroja, o kapedan.

Ata u ngritën në këmbë. Fytyra e tyre shkëlqente nga një kënaqësi e brendshme.



— Bën ftohtë! — tha Kristaq Dvorani kur dolën jashtë.

— S'ka gjë, do të nxehe mi te motokompresori, — ia priti Bame Toroja. — Ku janë shokët? — pyeti ai, duke i hedhur një vështrim të shpejtë Zaçe Çapokut.

— Po pastrojnë rrugën, — u përgjigj ai me një ton gati tallës.

— Thirri shpejt, se do të fillojmë nga puna, — urdhëroi Kristaq Dvorani.

Zaçe Çapoku u largua duke ecur me kujdes mbi dëborë. Ai hidhte një rën këmbë përpara, pastaj tjetër, duke u përkundur sa nga e majta, nga e djathta.

Pas pak u këthyen të gjithë grumbull me lopata në duar.

— Ku është Baudini? — pyeti Kristaq Dvorani.

— U ngjit lart për të parë se në ç'gjendje është rruga, — u përgjigj njëri nga minatorët.

— Ja tek është, — tha një tjetër.

Martin Reka i thirri që të kthehej menjëherë në kantier.

— Është e kotë të fillojmë punën, pa hapur më parë rrugën, — tha nëpër dhëmbë Zaçe Çapoku me një ton që të linte përshtypjen se fliste në emrin e të gjithëve.

Kristaq Dvorani e dëgjoi shumë mirë, por mendoi që të mos i jepte përgjigje.

— Ç'është e vërteta, — tha pas pak Adushi, — çështja e rrugës na preokupon shumë: gjithë mëngjesin kemi diskutuar rreth këtij problemi dhe na duket se «inxhinieri» ka të drejtë. S'ma e ha mendja që ta ngjisim motokompresorin deri atje lart, pa rindërtuar më parë rrugën. Shtresa e dëborës është shumë e trashë dhe kemi frikë se mos na ndodhë ndonjë aksident. Ka mundësi të shkasim në ndonjë përrua me gjithë motokompresorin; në qoftë se na ndodh një gjë e tillë, kjo do të ishte një fatkeqësi shumë e madhe dhe një dëm i pallogaritshëm.

— Adushi ka të drejtë! — foli andej nga fundi Zaçe Çapoku.

— Ti rri, mos fol! — ia priti Bame Toroja. — Mendimet e tua s'vlejnë asnjë grosh! Dhe, dëgjo këtu: të këshilloj edhe një herë të mos ndikosh negativisht te të tjerët. E di unë, të gjitha ato që tha Adushi, nuk janë mendimet e tij, por të tuat, o Zaçe Çapoku.

Adushi uli kokën i turpëruar.

— Mirë, more shokë, mirë, — tha me një ton të butë Kristaq Dvorani. — Ju keni shumë të drejtë, sepse rruga është gjithashtu shumë e domosdoshme. Dhe në të vërtetë nuk jemi kundër hapjes së rrugës, por mendojmë se odo gjë duhet bërë në kohën e duhur.

Ndërkohë Baudin Kazazi kishte zbritur nga shpati i malit dhe që futur midis shokëve të tij.

— Hapja e rrugës do të na harxhojë shumë kohë, more shokë. — vijoi Kristaq Dvorani me një ton lutës. — Në qoftë se miratojmë propozimin tuaj, ne mund të rrezikojmë detyrën për vënien e minierës në shfrytëzim në afatin e caktuar nga qeveria. Megjithatë, le ta shqyrtojmë bashkë se cili është mendimi më i mirë, më i përshtatshëm. Ja për këtë u mbledhëm tani, që të diskutojmë dhe të vendosim së bashku. S'ka përse të bisedohet poshtë e përçjetë për çështjen e rrugës dhe të lihet përshtypja se punët po i ngatërrojnë shefat. Në qoftë se ka ndonjë shok që e heq veten si të ndershëm e të zgjuar dhe pëshpërit vesh më vesh, në i themi se nuk e ka mirë. Një ndershmëri e tillë nuk i vlen askujt, përkundrazi, ajo dëmton tëndë punën dhe prish unitetin e kolektivit. Shokë, ne jemi një ekspeditë, një trup i vetëm që udhëhiqemi nga Partia dhe të luftojmë për një qëllim, që të vëmë në shfrytëzim minierën në afatin e caktuar nga qeveria. Në qoftë se ne nuk e bëjmë këtë, kjo do të thotë të dështojmë, të diskreditohem si kolektiv dhe të vëmë në pozitë të vështirë edhe qeverinë. Nuk duhet të harrojmë së vendimi i qeverisë për vënien në shfrytëzim të minierës së kromit në Kreshnikë është publikuar botërisht. Nuk është për t'u habitur që njerëz të shikojmë ndoshta të botuar në shtypin tonë të përditshëm edhe ndonjë reportazh për misionin e ekspeditës sonë. Dhe,



a e dini se ç'do të thotë të mos realizohet shpërthimi i parë në afatin e caktuar? Kjo do të ishte një humbje ekonomike dhe politike njëkohësisht, shokë!

Atëherë ç'duhet të bëjmë në këto situata që po kalon vendi ynë? Të presim që të na e ndërtojnë socializmin të tjerët?

— Jo! — u dëgjuan përsëri zëra të vendosur.

— Kështu, pra! Dhe, që të mos largohemi shumë nga tema, të vendosim sa më shpejt se ç'do të bëjmë, do të merremi me hapjen e rrugës apo do t'i futemi punës për ngjitjen e motokompresorit?

— Të ngjitem motokompresorin! — thirrën njëzëri.

Bamë Toroja në krye të shokëve mori drejtimin nga motokompresori. Kristaq Dvorani i kishte hedhur njërën dorë në qafë Baudin Kazazit dhe po i thoshte diçka, ndërkohë që me dorën tjetër po bënte ca gjeste energjike.

Qielli ishte gjithandej i mbyllur dhe dëborë vazhonte të binte pa pushim. Era e ftohtë që frynte nga lindja kishte pushuar.

## LËVRIJNË ARMIQTË E KLASËS

Ramë Sheldia hyri papritur në zyrën e Sherif Rubianës dhe u zhvesh në heshtje. Mushamaja që kishte ngrirë nga të ftohtët i ra përdhe, duke lëshuar një fëshfërimë si ajo e gjarprit. Sherif Rubiana u përkul me vështirësi dhe, pasi e kapri mushamanë me kujdes, e vari prapa derës.

— Kudo që vete, — tha Ramë Sheldia, — shikoj të papunë që rrinë e bëjnë muhabet. Shkova në dyqan dhe aty gjeta Hajrije Opingarin që kishte mbledhur nja dhjetë-pesëmbëdhjetë vajza, të cilave po u bënte konferencë. Me siguri po u tregonte se si të shturen e të bëhen vajza të përdala. Kalova pastaj para shkollës dhe pashë atje mësuesin. Kushtrim Opingarin, që po bënte me siguri të njëjtën punë. Isha i bindur se, po të shkoja edhe në vatrën e kulturës, edhe atje do të gjeja të njëjtën gjë; prandaj erdha këtu, në zyrën e Këshillit Popullor të Lokalitetit, ku, siç e prisja, i gjeta shokët duke punuar.

Sherif Rubianës iu bë qejfi.

— Kemi shumë punë, për nder, — tha ai. — Jemi keq me grumbullimet, pa le me kurset e luftës kundër analfabetizmit.

— Me fushatën e zgjedhjeve, thuaj! — ia priti Ramë Sheldia!

— Nejse, fushata e zgjedhjeve pothuajse mbaroi, megjithatë...



— Nuk i morëm vesh rezultatet në shkallë re-  
publike.

— Duhet t'i kenë gazetat e së martës, — tha Sherif  
Rubiana. — Ne si lokalitet dolëm mirë, kjo ka rën-  
dësi.

— Ashtu është! Vetëm se...

— Pati disa ngatërresa, doni të thoni.

— Jo xhanëm, po...

Një copë herë të gjatë qëndruan në heshtje.

— Na, ndize nga kutia ime! — tha Sherif Rubiana.

Ramë Sheldia filloi të dridhte një cigare.

— Kemi shumë punë, — tha prapë Sherif Rubiana.

Fytyra e tij e gjatë e me nofulla të dala kishte  
diçka të përbashkët me kokën e një kali. Ai ishte nga  
ata njerëz që kujdesen vetëm për veten e tyre dhe që,  
për këtë arsye, shpeshherë detyrohen t'ua bëjnë qejfin  
të tjerëve duke e kyçur gojën. Ramë Sheldia vinte dhe  
i frynte në vesh atij dhe, duke e ditur se ai ishte  
frikaman i madh, kur duhej, i kërciste edhe dhëmbët.  
Një qëndrim i tillë po e komprometonte atë çdo ditë  
e më shumë dhe po e bënte një vegël qorre.

— Punë, punë, posi! — murmuriti pas pak Ramë  
Sheldia tek po e lagte letrën e cigares me majën e  
gjuhës. — Punë do të ketë, si s'do të ketë! Pse kollaj  
mbahet pushteti, kollaj është të zbresësh nga mali dhe  
të qeverisësh tërë vendin?! Të mbledhësh rigon, është  
tjetër punë dhe... të qeverisësh...

— Ashtu është, — tha Sherif Rubiana pa e ditur as  
vetë përse i tha këto fjalë.

— Dhe dale, dale, jemi shpejt akoma. Dyqanet  
janë bosh, s'ka as kripë dhe as vajguri, pa le gjëra të  
tjera... Çështjen e bukës ti po e di vetë se si është,  
rrëmbe sa andej-këndej, derisa të mbeten të gjithë  
me gisht në gojë. Po pastaj ç'do të bëjmë? Nga do  
t'ia mbajmë? Çfarë do të grumbulloni? Ku do t'i  
gjejë populli që t'jua japë të tëra ato që kërkoni ju:  
grurë, thekër, tagji, misër, fasule, qepë, vezë! Çdo  
gjë! Çdo gjë! Pse kështu mbahet qeveria?! Dhe këtij  
i thonë pushtet popullor! Apo jo?

Sherif Rubiana s'dinte se si të qëndronte në karri-ge. Ai rregulloi ca shkresa që kishte mbi tryezën e punës dhe, si e mori pak veten, tha:

— Nuk është tamam kështu, vetëm se...

— Çfarë «vetëm se», «vetëm se»! Fshati që duket, nuk do kallauz!

Sherif Rubiana u hutua fare.

— Dëgjo! Nuk mund të ecet gjatë kështu. Njerëzit duan që të udhëhiqen me mençuri dhe vendosmëri drejt një rruge me të vërtetë të lumtur. Ka ardhur koha që gjithsecili t'i vërë gishtin kokës dhe të vrasë mendjen për qëndrimin që duhet të mbajë në këto situata të turbullta. Ne kreshnikasit jemi marrë vesh mirë kurdoherë me njëri-tjetrin. Mirëpo, për fat të keq, sot njëri i bie gozhdës, tjetri potkoi. Shitësja e dyqanit përpiqet të bëjë për vete vajzat dhe një pjesë të grave të fshatit, duke shfrytëzuar për këtë qëllim organizatën e rinisë dhe atë të gruas. Mësuesi është kapur pas të rinjve dhe u fryn çdo ditë në vesh. Ujkan Shkaba, plaku më i vjetër i fshatit, ka pasuesit e vet, që s'dihet se me cilën rrugë janë. Baba Ali Çakmaxhiani pret e përcjell njerëzit e tij në teqe... Kështu që, vetëm në të dy këmbet mbetur jashtë këtyre influencave. E sheh pra se në ç'gjendje të mjeruar është katandisur Kreshnika jonë sot. Më fal, se harrova të përmendja dhe dy forca të tjera që, në fakt, janë forca të jashtme: repartin ushtarak, që është dislokuar në krahun e majtë të fshatit dhe ekspeditën që erdhi mbrëmë natën nga Tirana për të vënë në shfrytëzim minierën e kromit. Edhe këto do të kenë simpatizantët e tyre dhe do të ushtrojnë presion mbi Kreshnikën e varfër derisa t'ia zënë frymën.

— Pse flisni në këtë mënyrë? — tha me të butë Sherif Rubiana. — Miniera do të jetë një fitore, sidomos për rininë e fshatit tonë, bile edhe për fshatrat e tjera fqinje. Do të hapet front pune...

Ramë Sheldia qeshi me sarkazëm.

— Por mos harro se do të hapen njëkohësisht edhe



varre. A e di ti se ç'do të thotë minierë?! Miniera ka për t'i ngrënë të gjithë djemtë e fshatit tonë! Ke për të parë.

Sherif Rubiana, megjithëse e shikonte se biseda po merrte një rrugë shumë të keqe, nuk e ndiente veten të aftë për t'i treguar rrugën milkut të tij të vjetër.

Ramë Sheldia u çua papritur në këmbë dhe i bëri shenjë me kokë Sherif Rubianës që ta ndiqte pas. Sherifi u ngrit ngadalë e si i ngrirë dhe me kokën në tavan filloi të ndiqte pas Ramë Sheldinë. Shkuan pranë dritareve dhe qëndruan krah për krah njëri-tjetrit. Sherifi ishte tepër i gjatë në krahasim me Ramë Sheldinë, i cili para tij dukej pors i një mingo.

— Po të paralajmëroj edhe një herë, — tha Ramë Sheldia, — se, në qoftë se të shkon në mendje që të më spiunosh, do ta paguash shtrenjt...

Sherif Rubiana, dyllë i verdhë në fytyrë, filloi të dridhej i tëri. Ai e ndiente veten midis dy zjarreve.

— A më dëgjon, hajvan! — e ngriti zërin Ramë Sheldia, duke ngritur kokën për ta parë në fytyrë mikun e tij frikaman.

Sherif Rubiana po fërkonte duart me qëllim që të përballonte sëkëlldinë e madhe që e kishte pushtuar.

— Të lutem, mos më ofendo, — mundi të thoshte pas një heshtjeje të gjatë. — Unë jam njeri!

— Ah, më falni, — tha me ironi Ramë Sheldia. — Më doli nga mendja se jeni njeri, dhe... jo vetëm kaq... por jeni edhe nëpunës i pushtetit popullor... Atëherë dëgjoni edhe një herë, shoku Sherif Rubiana. Ju lutem shumë t'i harroni të gjitha këto që ju thashë, se përndryshe... besoj se e di se nga buron forca ime... nga shpëllat e Kreshtës së Vdekjes!

— Ç'janë këto që po më thua, o Ramë Sheldia?

— Mbylle gojën po të them.

Ramë Sheldia fliste me një zë që dukej sikur vërshëllente. Pasi hodhi një vështrim rreth e rrotull, sikur të përgjonte, ai zuri fort për krahu Sherif Rubianën.

— Mos të është mërzitur jeta? Shiko, ki mendjen, se përndryshe të qërova!...

— Ç'kërkon nga unë? — belbëzoi Sherif Rubiana, i frikësuar në kullm. — Unë kam punën time, ti shiko punën tënde. Unë as të kam ngatërruar dhe as do të të ngatërroj ndonjëherë. Secili le të shikojë punën e tij.

— Tani fole mirë! — tha Ramë Sheldia. — Kjo është fjalë me vend dhe, po e mbajte, do ta kemi mirë përherë.

I hodhi një vështrim me bishtin e syrit dhe, si zbardhi dhëmbët e tij katrorë, tha:

— Mos ki frikë, se edhe unë nuk ta dua të keqen.

Sherif Rubiana mori frymë lirisht. Ai hodhi dorën në ballë dhe filloi të fshinte djersët e tij të ftohta.

— E de, mirë! Besoj se tani erdhe në vete! — ia lëshoi edhe një shigjetë tjetër Ramë Sheldia.

Sherif Rubiana u mundua të buzëqeshte.

— Pa shiko atje përtej!

— Ku? — pyeti Sherifi.

— Në anën tjetër të Përroit të Thellë. Përballë, nën Kreshtën e Vdekjes.

— E pashë.

— A i dallon dot njerëzit?

Sherif Rubiana vuri menjëherë syzet optike.

— Vërtet. Paska njerëz!

— Janë ata të ekspeditës, — tha Ramë Sheldia.

— Ashtu?!

— Po. Pikërisht atje po përgatitet terreni për të bërë shpërthimin e parë.

Ramë Sheldia fliste me dhëmbët shtrënguar.

— Do të jetë tamam një skenë qesharake, — tha pas pak ai. — Habitem me kurajën që kanë. Marrin përsipër të vënë në shfrytëzim minierën në një kohë të tillë të keqe! Italianët erdhën aty në kohë të mirë dhe u detyruan të largohen, sepse... kurse këta... edhe të zgjebosur... edhe bishtin përpjetë... Kot e kanë se edhe po ja dolën mbanë, s'do t'i lëmë... s'do t'i lënë Koko-bogoja me shokë.



Sherif Rubiana po i dëgjonte të gjitha këto si i shastisur. Ai nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse ishte në ëndërr, apo ishte me të vërtetë me mikun e tij të vjetër, me të cilin nuk e kishte bërë kurrë ndonjëherë një bisedë të tillë.

— A më dëgjon?

— Si jo! — reagoi me vonesë Sherif Rubiana.

— A më kupton?

— Si jo! — foli përsëri ai në mënyrë mekanike.

— Ja, pra, përse erdha sot në zyrën tuaj në mënyrë të papritur. Besoj se u kënaqe.

— Si jo!

— Kështu, pra, mendoj se u morëm vesh. Ti duhet të kesh besim të plotë tek unë. Kur ta shikoj të arsyeshme, unë do të vij prapë këtu, mbasi më pëlqen miqësia me ty. Je njeri i ndershëm dhe i zgjuar!

Këto fjalë tingëlluan krejt false në gojën e Ramë Sheldisë.

— Po në befsh ndonjë gabim, më qafë paç veten. Atëherë do ta kesh punën pisk! Besa besë!?

— Ashtu qoftë! — belbëzoi Sherif Rubiana.

Ai ishte mbuluar me djersë të ftohta.

## GËZIMI I KRESHNIKASVE

Njerëzit që kishin ardhur nga të gjitha anët e Kreshnikës e mbushën sallën e vatrës së kulturës shumë kohë më përpara se të fillonte mbledhja. Stolat e gjatë u mbushën plot e përplot, kështu që të vonuarit, mbasi hidhnin sytë në të katër anët e sallës, ngjisheshin më në fund atje ku ua merrte mendja, duke shtyrë të tjerët më tej. Disa filluan të uleshin andej-këndej nëpër dysheme.

— Urdhëroni, urdhëroni! — thoshte vazhdimisht, kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, Burhan Kola. — Ka vend për të gjithë! Urdhëroni!

Fytyra e tij e shëndetshme, me lëkurën të rrahur nga cingërima e dimrit, dukej tepër e gëzuar.

— Urdhëroni, shokë, urdhëroni! — dëgjohej herë pas here zëri i tij aq shumë i dashur për banorët e Kreshnikës!

Te dera hynin e dilnin njerëz pa pushim. E tërë salla gumëzhinte nga zërat.

— Uluni këndej, uluni këndej, — i tha ai një grupi të rinjsh nga lagjja «Kolaj».

Ngaqë ishin fqinjët e tij, ai i drejtoi andej nga fundi, në një qoshe që kishte mbetur bosh dhe që nuk pëlqej, meqenëse ishte ballë për ballë me derën.

Dëborë kishte pushuar, por frynte një erë e ftohtë që të priste. Megjithatë njerëzit ishin në qejf. Ata, që kur dukeshin te dera, përpiqeshin të bënin ndonjë shaka.

I fundit mbërriti plaku Ujkan Shkaba, për të cilin, si zakonisht, ishte rezervuar një vend në rreshtin e parë,



përballë tryezës kryesore. Ai ishte veshur me rroba shajaku krejt të bardha, në kokë kishte lidhur, gjithashtu, një shami të bardhë sipas zakonit të vjetër. Në dy krahët dy të rinj i qëndronin pranë dhe e ndihmonin për të ecur. Sapo e pa, Burhan Kola lëshoi një britmë gazmore që tërhoqi vëmendjen e të gjithë sallës.

— O, kush na erdhi! — tha ai.

Të gjithë kthyen kokën nga dera, të habitur për ardhjen e plakut Ujkan Shkaba në mbledhje në një kohë aq të keqe.

Pasi futi të dy këmbët në sallë, Ujkan Shkaba nderoi me grusht dhe pastaj tha:

— Erdha, posi! Si të mos vij në një ditë kaq të shënuar!

Ai u mundua të buzëqeshte. Nga lodhja i merrej fryma. Burhan Kola e shoqëroi, duke e mbajtur për krahu, derisa e uli në vendin e vet.

Salla gumëzhinte nga zërat dhe të qeshurat gazmore të njerëzve. Andej nga fundi zhurma ngrinte krye herë pas here. Disa vajza të lagjes «Kolaj» qeshnin me zë të lartë. S'dihej se ç'shakara u tregonte mbyturazi Hajrija, shitësja që sapo ishte kthyer nga hekurudha.

— Pushoni ju andej nga fundi! — qortonte plot nervozizëm një zë burri aty nga mesi i sallës.

Burhan Kola kishte dalë jashtë për të pritur mysafirët. Te dera hynin e dilnin disa të rinj, të cilët, me sa dukej, duhej të ishin ngarkuar me detyrë që të njoftonin sallën për ardhjen e mysafirëve.

— Po vijnë! — u dëgjua një zë nga ato që ishin më afër derës.

— Qetësi ju lutem! — tha një zë tjetër.

E tërë salla ra në qetësi.

I pari hyri në sallë Kristaq Dvorani, i cili që në vështrimin e parë iu duk kreshnikasve tepër i ri dhe i sjellshëm. Shumë vetave u bëri përshtypje shtati i tij i drejtë dhe i lartë, që kishte shumë gjëra të përbashkëta me djemtë e Kreshnikës.

— Sa i ngjaka Sokol Dinos! — murmuriti njëra nga vajzat.

Krah për krah me të ecte Bame Toroja dhe një hap më mbrapa Burhan Kola, i cili duartrokiste, duke u buzëqeshur me dashamirësi mysafirëve.

Dy minuta më vonë të porsaardhurit kishin zënë vend në tryezën kryesore që ishte mbuluar me një cohë të kuqe.

Përballë njerëzve, në krye të sallës, ishte vendosur portreti i Komandantit të Përgjithshëm, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës, ndërsa në të dy krahët, në të majtë dhe në të djathtë të sallës, kishte parulla me rastin e fushatës së zgjedhjeve. Bame Toroja ishte ulur si në shtëpinë e tij. Ai i hodhi një vështrim tërë rreshtit të parë të njerëzve dhe, kur u ndesh me vështrimin e plakut Ujkan Shkaba, i buzëqeshi dhe e përshëndeti me një lëvizje të kokës. Ujkan Shkaba nga ana e tij iu përgjigj sipas zakonit të vendit me një të përkulur të lehtë të trupit përpara, duke vënë dorën në zemër.

— Shokë! — u dëgjua zëri i njohur i Burhan Kolës. — Mbledhjen e konsiderojmë të hapur! — shtoi ai pas pak.

Në tërë sallën shpërthyen përsëri duartrokitje të zjarrta. Bame Toroja buzëqeshte i kënaqur, ndërsa Kristaq Dvorani dukej pak si i druajtur. Ai ishte i emocionuar nga entuziazmi dhe pritja e ngrohtë e kreshnikasve.

Kreshnikasit duartrokisnin me gëzim. Ata ishin të kënaqur, ngaqë kishte ardhur më në fund koha që në Kreshnikën e tyre të largët që ndodhej në zemër të bjeshkëve të hapej miniera e kromit. Plaku Ujkan Shkaba digka po u thoshte njerëzve që kishte rreth e rrotull, po fjalët e tij humbisnin në mes të zhurmës. Kur pushuan duartrokitjet, ai tha:

— Të rrojë Partia!

Burhan Kola, pasi u uroi mirëseardhjen mysafirëve në emër të gjithë banorëve të Kreshnikës, ia dha fjalën menjëherë shefit të ekspeditës gjeologjike.

Kristaq Dvorani që në fillim të fjalës së tij plot gjallëri e bëri tërë sallën për vete.



— Qeveria vendosi këto ditë, — tha ai, — që të filloj menjëherë punimet këtu dhe brenda kësaj jave miniera të vihet në shfrytëzim.

Në sallë shpërthyen përsëri duartrokitje të zjarrra.

— Kromi që do të nxirret nga miniera e Kreshnikës është i një cilësie shumë të lartë. Në fillim do të shfrytëzojmë në sipërfaqe, kurse pastaj do të futemi thellë në zemrën e malit të Kreshnikës.

Fytyrat e kreshnikasve shkëlqenin përherë e më shumë nga gëzimi.

— Dhe, këtë punë, — vijoi pas pak ai, — do ta bëjmë bashkë me ju kreshnikasit. Ne kemi besim të plotë se, ashtu siç keni luftuar vite me radhë me armë në dorë kundër kralëve sllavë dhe okupatorëve të ndryshëm, po ashtu nuk do t'i kurseni energjitë tuaja mendore e fizike për t'i rrëmbyer këtë pasuri të madhe malit shekullor të Kreshnikës.

— Urraaa! — shpërthyen disa zëra andej nga fundi, që pas pak e përfshinë tërë sallën.

Aty nga mesi i sallës dëgjoheshin zëra që s'merrej vesh se çfarë thoshin. Ramë Sheldia që tundte vazhdimisht kokën në shenjë miratimi tri-katër herë me radhë iu afrua dikujt që kishte në krah për t'i pëshpëritur në vesh. Tjetri e dëgjoi me vëmendje dhe pastaj ia plasi gazit. Pak më tej ndodhej Sherif Rubiana, fytyra e të cilit nuk kishte asnjë shprehje.

— Sigurisht kjo është një gjë e vështirë, — vijoi Kristaq Dvorani, — por ne jemi të detyruar ta bëjmë këtë, sepse edhe situatat e komplikuar në botë na e imponojnë një gjë të tillë.

— E ka fjalën për fqinjët tanë, — i murmuriti në vesh shokut që kishte në krah Ramë Sheldia. — Më duket se po acarohen marrëdhëniet, — shtoi ai dhe pastaj duartrokiti i pari e me zhurmë të madhe, duke i ngritur duart përpetë që të binte në sy.

E tërë salla e shoqëroi, duke duartrokitur si me druajtje. Ra menjëherë në sy se nuk ishte gjetur çasti i përshtatshëm për të duartrokitur. Sherif Rubiana nuk po

kuptonte asgjë nga sjelljet dhe qëndrimi i mikut të tij, Ramë Sheldisë.

— Shokë! — tha më në fund Kristaq Dvorani. — Ne nuk detyrojmë asnjëri që të punojë në minierë. Secili le të mendohet dhe të vendosë vetë e në mënyrë të pavarur. Dëshiroj vetëm t'ju them hapur se jeta në minierë nuk do të jetë e lehtë! Kjo është një e vërtetë që jemi të detyruar t'jua themi hapur. Në të njëjtën kohë unë ju kujtoj se ne shqiptarët nuk u jemi trembur kurrë vështirësive.

Kur mbaroi, salla u mbush me zhurmë dhe njerëzit filluan të flisnin të gjithë menjëherë. Askush nuk po e kërkonte fjalën. Gjithsecili fliste me shokun që kishte në krah dhe nuk po merrej vesh asgjë se ç'thuhej. Kur dikush hidhte një mendim, tjetri ia priste dhe kështu kjo gjendje vazhdoi një copë herë të gjatë.

— **Qetësi, shokë, qetësi!** u dëgjua zëri i Burhan Kolës.

Në rreshtat e parë zhurma filloi të binte, ndërsa andej nga fundi dëgjoheshin ende zëra që të linin përshtypjen se punët mund të shkonin deri në grindje e mosmarrëveshje të pakëndshme.

— A e di ti se ç'do të thotë minierë, more! — tha një zë i çjerrë nga të ftohtët.

— Me leje! — e kërkoi fjalën i pari Ramë Sheldia.

Menjëherë e tërë salla ra në qetësi. Shumë fytyra dukeshin të habitura. Sherif Rubiana nuk po u besonte syve të tij. Të gjithë po prisnin në ankth se çfarë do të thoshte Ramë Sheldia, i cili dukej tepër i qeshur dhe me sytë e tij të vegjël hetonte reagimin e të pranishmëve.

— Unë, — tha ai, duke i zvarritur fjalët, me qëllim që t'i jepte rëndësi vetes, — jam plotësisht dakord me ato që na thanë këtu shokët që kanë ardhur nga Tirana.

— Uaaa! — u dëgjuan disa zëra andej nga fundi i sallës.

— Ky është njeri i poshtër! — i tha shokut që kishte në krah një kreshnikas i moshuar.

— Është me të vërtetë dhelpër, — ia priti tjetri.

— Dhe jo vetëm kaq, — vijoi më poshtë Ramë Sheldia me të njëjtin ton, — por... do të jem i pari që do të shkoj në minierë!



— Ooo! — ia bënë përsëri disa zëra.

Ramë Sheldia ktheu kokën prapa me një pamje serioze në fytyrë.

— Po, po, shokë! — theksoi ai. — Unë do të jem i pari. Bile... qysh mbrëmë... në qoftë se do ta dijë ndonjëri se cili është Ramë Sheldia... unë i kam strehuar të gjithë shokët e ardhur nga Tirana në shtëpinë time... Ata mbërritën këtu në Kreshnikë në orët e vona të natës dhe dera ime ishte e para që u hap për t'i mbrojtur nga dëbora e suferina. Të gjithë e dinë se ç'kohë e keqe ka qenë mbrëmë...

Bamë Toroja tundi kokën në shenjë miratimi dhe u mundua të buzëqeshte.

— Kaq kisha unë! — tha Ramë Sheldia. — Dashuria për vendin dhe pushtetin e ri popullor duhet shprehur me vepra dhe jo vetëm me fjalë e duartrokitje të zjarra!

Sherif Rubianës gati sa nuk po i binte tavani mbi kokë.

Pas Ramë Sheldisë folën edhe tre-katër kreshnikas të tjerë, të cilët u solidarizuan plotësisht me të. I fundit e mori fjalën Sokol Dinoja, sekretar i organizatës së rinisë së Kreshnikës. Fjala e tij ishte e zjarrtë dhe krejt e natyrshme. Ai fliste sinqerisht e duke pasqyruar ndjenjat e pastra të gjithë të rinjve të Kreshnikës. Ai deklaroi se të gjithë të rinjtë e Kreshnikës kishin vendosur të shkonin në minierë.

— Bile, — theksoi ai, — qysh sot, herët në mëngjes, një grup i përbërë prej njëzet vetash filloi menjëherë punën, duke ndihmuar për ngjitjen e motokompresorit; tani që ne jemi mbledhur e po bisedojmë për këtë çështje ata po luftojnë me dëborën e suferinën krah për krah me shokët e ardhur nga Tirana dhe me disa minatorë të minierës fqinjë «Ylli i kuq».

Një pjesë e mirë e të pranishmëve, që nuk e dinte një gjë të tillë, u habit pa masë.

— Ju lumtë, more djema! — thirri plaku Ujkan Shkaba.

Bamë Toroja duartrokiti i pari me tërë forcën e tij. Sytë iu mbushën papritur me lot. Edhe Kristaq Dvorani

nuk e kishte parashikuar një qëndrim të tillë të kreshnikasve. Burhan Kola s'dinte se si ta shprehte kënaqësinë e tij. Ai e hidhte vështrimin sa nga e majta ashtu dhe nga e djathta.

Duartrokitjet vazhduan për një copë herë të gjatë. Sokol Dinoja, pavarësisht se nuk shprehte, kishte diçka të veçantë, kishte diçka që nuk të binte në sy te djemtë e tjerë të fshatit.

I entuziazmuar nga duartrokitjet e papërmbajtura, Bame Toroja tha pa u ngritur nga vendi:

— Me këto duar kam gërmuar mijëra metra kub dhe nën tokë nëpër miniera të ndryshme të vendit tonë, por djersa që kam derdhur më ka shkuar, si i thonë fjalës, për dhjamë qeni. Unë dhe shokët e mi zvarriteshim nën tokë, ndërsa pasanikët shkriheshin së qeshuri e bënin qejf mbi tokë, sepse të ardhurat, qeset me florinj shkonin në xhepin e tyre. Por këto kohëra shkuan e vanë, — tha ai, duke e ngritur zërin. — Harro mushkë Valarenë, se Ali pashanë e prenë, themi ne andej nga Gjirokastra jonë!

Në sallë u dëgjuan të qeshura. Ndërsa Bame Toroja vazhdoi:

— Unë, të dashur shokë, jam pesëdhjetë e ca vjeç; megjithatë, sikurse e shikoni, nuk ndihem keq, përkundrazi, në këta pak vjet jetë të pushtetit popullor forcat më janë përtërirë.

Në sallë u dëgjuan përsëri të qeshura. Bame Toroja kishte me të vërtetë një pamje tepër energjike. Thinjat, që kishin tradhtuar botën e tij të brendshme, fundja, nuk ishin në gjendje që të fshihnin energjitë e papërmbajteshme që ruante në vetvete shtati i tij i shkurtër e plot muskuj.

— Tërë jetën kam punuar nëpër miniera dhe deri tani nuk më ka gjetur asgjë e keqe, — përfundoi Bame Toroja. — Ju siguroj se edhe këtu në minierën e re të Kreshnikës nuk kam për të pësuar gjë dhe nuk do të turpërohem kurrë. Premtoj se normën time do ta realizoj qind për qind!

Salla shpërtheu menjëherë në duartrokitje.

— Ju premtoj edhe një gjë tjetër!



Salla ra menjëherë në qetësi.

— Kam një djalë. Turabi e quajnë. Tani ai është duke kryer shërbimin ushtarak në kufi, në jug, ballë për ballë me monarko-fashistët grekë. Sapo të mbarojë ushtrinë, do ta sjell këtu në Kreshnikë që të punojë në minierë krah për krah me vëllezërit e tij kreshnikas!

Salla shpërtheu përsëri në duartrokitje edhe më të zjarrta.

— Pastaj do të shkoj që të marr edhe plakën bashkë me tre fëmijët e tjerë më të vegjël, — tha ai, — që të jetojnë këtu përgjithmonë. A nuk bëj mirë që mendoj kështu? — pyeti ai.

— Po! — u përgjigjën mjaft zëra njëherësh.

Pastaj shpërthyen të qeshura gazmore nga kreu e gjer në fund të sallës.

— Atdheu ynë është e gjithë Shqipëria! — thirri në mes të zhurmës Burhan Kola.

— Të rrojë Partia! — u dëgjua një zë nga salla.

— Të rrojë sa malet e Kreshnikës Komandanti ynë i Përgjithshëm! — tha një tjetër.

Njerëzit u ngritën në këmbë. Zhurma që e kishte pushtuar tërë sallën e vatrës së kulturës po dëgjohej edhe jashtë saj.

Plaku Ujkan Shkaba iu afrua Kristaq Dvoranit shumë pranë dhe i tha:

— Te ti kemi besim! Do të bëjmë ç'të kërkojmë... Pa shiko se ç'forcë të madhe që kanë kreshnikasit.

## NË TË GJITHË FRONTET

Një orë më vonë Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja, të shoqëruar nga Burhan Kola dhe nga shumë kreshnikas të tjerë, u kthyen në kantier. Baudin Kazazi bashkë me shokët e ekspeditës si dhe të rinjtë e Kreshnikës, që u shkuan në ndihmë, ishin munduar shumë për ngjitjen e motokompresorit, mirëpo nuk ia kishin arritur qëllimit. Ata ishin ngjitur rreth pesëdhjetë metra në shpatin e malit, por aty kishin ngecur keq midis disa shkëmbinjve të thepisur.

— Kjo është punë që s'bëhet! — tha Zaçe Çapoku.  
— Me shumë vështirësi e sollëm edhe gjer këtu.

Bame Toroja, pasi vështroi motokompresorin e zhytur thellë në dëborë, ngriti sytë nga njerëzit që ndodheshin rreth tij. Fytyrat e tyre dukeshin shumë të pikëlluara.

— Si të bëjmë? — pyeti Baudin Kazazi, duke u kthyer nga Kristaq Dvorani, i cili vazhdonte të shikonte i habitur herë motokompresorin, herë gjurmët e shumta që kishin lënë njerëzit andej-këndej nëpër dëborë.

Baudin Kazazit, që dukej shumë i lodhur, i ishte mavijosur fytyra nga të ftohtët. Ai ishte veshur e mbathur mirë me çizme dhe peliçe të trashë, mirëpo këto, me sa dukej, nuk mjaftonin për trupin e tij të dobët. Meqenëse syzet optike i ishin veshur nga ngrica, ai mezi i dallonte njerëzit.



Poshtë në rrugë ishin grumbulluar shumë njerëz, të cilët nën drejtimin e Burhan Kolës ishin ndarë në katër grupe.

— Gjer këtu e sollët? — tha Kristaq Dvorani, pasi qëndroi një copë herë të gjatë në heshtje.

Të pranishmit ulën sytë mbi dëborë dhe nuk thanë asgjë. Vetëm Zaçe Çapoku mendoi të thoshte diçka, po aty për aty u pendua dhe ndërroi mendje.

— S'ka gjë, s'ka gjë! — foli Kristaq Dvorani. — Vetëm mos u mërzitni, — shtoi ai me të qeshur. — Forcat po na shtohen, kështu që edhe motokompresorin do ta çojmë në vendin e caktuar, edhe rrugën do ta hapim. Dhe të gjitha këto do t'i bëjmë gjer në mbrëmje, duke e mbyllur në këtë mënyrë ditën e parë të punës me sukses.

Baudin Kazazi buzëqeshi. Pas pak mbërriti aty dhe Burhan Kola.

— Tungjatjetani, o burra! — thirri ai. — Dhe punë të mbarë! — shtoi pas pak.

— Mbarë paç! — iu përgjigjën të pranishmit me gjysmë zëri.

— Shoku Burhan është kryetar i këshillit të lokalitetit të Kreshnikës, — tha Bame Toroja. — Është angazhuar që të na ndihmojë me gjithçka që na nevojitet, — theksoi ai. — Në Kreshnikë na u bë një pritje e mrekullueshme, shokë!

Burhan Kola vuri buzën në gaz.

— Ndërsa këta, — vijoi Kristaq Dvorani, — janë shokët tanë të ekspeditës.

Ai e prezantoi në fillim me Baudin Kazazin, pastaj me tre minatorët, Shpëtimin, Faikun, dhe Adushin, dhe më në fund me dy shoferët, Martin Rekën dhe Zaçe Çapokun.

Burhan Kola u dha atyre dorën me radhë dhe pastaj ngriti sytë nga kreshnikasit që qëndronin në këmbë midis tyre.

— Me sa duket, jeni lodhur ca! — tha kryetari i këshillit të lokalitetit, duke hetuar me sy gjendjen.

Të pranishmit nuk dhanë asnjë përgjigje. Ata rrinin

kokulur, ngaqë ishin të pakënaqur nga rezultati i punës së tyre. Zaçe Çapoku kishte marrë në dorë një degë shkurreje dhe po e bënte atë copë-copë.

Kristaq Dvorani vështroi orën.

— Sa është? — pyeti Bame Toroja.

— Dymbëdhjetë e një çerek!

Qielli vazhdonte të ishte i mbushur me re dëbore. Gjithandej kishte rënë një mjegull e dendur. Kreshtat e maleve nuk dukeshin më, lart nga Kreshta e Vdekjes, binte me siguri dëborë.

— Gjatë këtyre ditëve kanë zbritur poshtë katër ose pesë ortekë të mëdhenj dëbore, — i tha Burhan Kola Kristaq Dvoranit. — Megjithatë, në këtë vend ku ju kenë vendosur të ngjitni motokompresorin nuk ka rrezik. Ata zbresin, zakonisht, në krahun e djathtë dhe pastaj bëhen copë e thërrime poshtë në Përruan e Thellë.

Bame Toroja po e dëgjonte me vëmendje.

— Sidoqoftë duhet të kemi shumë kujdes! — tha ai.

— Se mos na rrezikohen njerëzit.

Kristaq Dvorani ra në mendime.

Ata ishin tërhequr mënjanë dhe po bisedonin me zë të ulët, sepse, po të merrej vesh një gjë e tillë, mund të shkaktohej panik në radhët e punëtorëve.

— S'ka gjë, s'ka gjë! — tha, si u mendua pak, Burhan Kola. — Sido që të jetë, këtu jemi jashtë çdo rreziku... Pastaj... kur shkëputen ortekët e dëborës, gjëmon i tërë mali... Derisa të mbërrijnë ata këtu, duhen më tepër se dhjetë minuta, kështu që gjatë kësaj kohe njerëzit kanë mundësi të largohen në krahun e majtë ose të strehohen përkohësisht në ndonjë shpellë.

— Mirë, mirë, — tha duke murmuritur Bame Toroja.

— Këtë gjë dinë ta bëjnë vendasit, kurse njerëzit tanë nuk dinë; ka mundësi që të hutohen dhe pastaj... prandaj unë mendoj që t'i sinjalizojmë për rrezikun që mund t'u kanoset gjatë punës dhe në të njëjtën kohë t'u shpjegojmë se si duhet të mbrohen.

Kristaq Dvorani tundi kokën në shenjë miratimi.

— Kjo s'ka asgjë të keqe, — tha Burhan Kola. — Këtë



ne mund ta bëjmë, por pa zhurmë, se mund të ketë njerëz që e shfrytëzojnë këtë fakt për të përhapur panik dhe për të demoralizuar forcat punëtore.

Si ranë dakord në lidhje me rrugëzgjdhjen e kësaj çështjeje, Kristaq Dvorani pyeti:

— Si mendoni që t'i ndajmë forcat e punës?

Burhan Kola u mendua një copë herë.

— Për të ngjitur motokompresorin, — tha ai, — ne duhet të zgjedhim pesëmbëdhjetë burra nga më të fortët. Unë mendoj që motokompresorin ta vendosim në dy dru-rë të fortë, që duhen lidhur me kujdes në krye dhe në pjesën e mbrapme të motokompresorit, dhe pastaj ta ngremë peshë mbi supë... Kjo është sipas meje rrugë-zgjdhja më e mirë, që do të na kursejë shumë kohë... Jam i bindur se, po të veprojmë në këtë mënyrë, para se të ngriset, ne mund ta çojmë motokompresorin në sektorin e punës ku mendohet të bëhet shpërthimi i parë.

— Kështu mendoj edhe unë..., — tha aty për aty edhe Bame Toroja. — S'kam asnjë kundërshtim.

— Dakord! — tha Kristaq Dvorani. — Në këtë mënyrë zgjidhim një nga problemet më të rëndësishme që mua më shqetëson më shumë se çdo gjë tjetër!

Shpëtimi, Faiku, Adushi dhe Martin Reka bashkë me disa kreshnikas të tjerë po përpiqeshin ta nxirrnin motokompresorin që kishte rënë midis dy shkëmbinjve dhe që nuk donte të lëvizte nga vendi. Baudin Kazazi dhe Zaçe Çapoku vështronin me keqardhje.

— Lëreni, lëreni aty ku është! — thirri Bame Toroja. — Pushoni ca, se jeni lodhur shumë, o djemtë e Bame Toros! — shtoi ai me të qeshur.

Zaçe Çapokut i ndriti fytyra. Tre minatorët dhe Martin Reka vazhdonin të luftonin me motokompresorin.

— Është shumë i rëndë! — tha Kristaq Dvorani, sikur të donte të justifikonte pamundësinë e tyre për të lëvizur motokompresorin nga vendi.

Një copë herë ata qëndruan në heshtje.

— Po problemin e rrugës si do ta zgjidhim? — pyeti Bame Toroja.

— Kjo është gjëja më e thjeshtë, — vijoi Burhan Kola. — Me sa di unë, kjo rrugë vende-vende është mjaft e ngushtë, sepse është përdorur vetëm nga ana e druvarëve për transportimin e lëndës së drurit me kafshë; ajo shkon gjer në vend dhe nuk është shumë e keqe. Po të zgjerohet ca, xhipsi mund të shkojë gjer në sektor hëpërhë, ndërsa, për të kaluar makinat e mëdha, ajo duhet që të zgjerohet patjetër nga fundi gjer në krye.

— Kjo është një punë që mund ta bëjmë më vonë, — ndërhyri Kristaq Dvorani.

— Sigurisht! — vijoi Bame Toroja. — Tani për tani neve na duhet që të ngjitet gjer atje, të paktën xhipsi, të cilin mund ta përdorim për transportimin e materialeve siç janë lënda eksplozive dhe mjaft gjëra të tjera të nevojshme.

— Kështu do të veprojmë, — tha kryetari i këshillit të lokalitetit. — Këtu do të përqendrojmë forcat më të mëdha.

— Dhe ndoshta do të jetë mirë që punimet të fillojnë nga poshtë.

— Jo! Përse? Ne mund të fillojmë njëkohësisht nga të dy krahët.

— Kjo nuk mund të bëhet!

— Pse?

— Sepse nga sipër nuk është e përshtatshme të punohet.

Atëherë e ndajmë rrugën në mes dhe të dy grupet të ngjiten lart.

— Shumë mirë! — tha Kristaq Dvorani. — Kjo është një ide e shkëlqyer, sepse grupet do të vihen në garë me njëri-tjetrin. Ai grup që do të mbarojë i pari t'i shkojë në ndihmë tjetrit. Apo jo?

Bame Toroja buzëqeshi.

— Të lumtë, o kapedan! — thirri ai dhe i rrahu shpatullat Kristaq Dvoranit.

— Pra, në këtë mënyrë ne e zgjidhim edhe problemin e rrugës.



— Dhe realizojmë edhe dëshirën e punonjësve tanë të ekspeditës, — shtoi Bame Toroja.

— Pse?

— Se ngulin këmbë që të hapet në fillim rruga dhe pastaj të ngjitet lart motokompresori.

Burhan Kola tundi kokën në shenjë disaprovimi.

— E pse ta bëjmë këtë gjë, — tha pas pak ai, — kur kemi mundësi që t'i bëjmë të dyja punët njëherësh.

— E po ne mendonim të mbështeteshim në forcat tona, — ia ktheu Bame Toroja. — Siç duket, nuk i paskemi llogaritur mirë forcat e popullit të Kreshnikës.

Ata qeshën me zë dhe pastaj hodhën sytë poshtë, në xhade, ku prisnin grupe-grupe dhjetëra kreshnikas.

Kur po zbrisnin poshtë, Burhan Kola tha:

— Vëllezërit Ukcama kanë dëshirë t'ju ndërtojnë këtu poshtë në kantier, dy baraka prej dërrase. Ata janë duarartë. Brenda dy-tri ditësh duhet t'i keni gati. Bëjnë punë të shpejtë edhe me cilësi të mirë. Kanë ndër mend të ndërtojnë dy baraka me çati të lartë dhe me majë të mprehtë, siç e ka zakon vendi, me qëllim që të mos shkatërrohen nga pesha e rëndë e dëborës. Siç e shikoni, dimri i Kreshnikës është shumë i egër. S'ma merr mendja që të ketë ndonjë vend tjetër më të ftohtë në Shqipëri sesa Kreshnika jonë.

— Vendi ndoshta është i ftohtë, — ia priti Bame Toroja, — po njerëzit qenkan zemërzjarr!

Kryetarit të këshillit të lokalitetit i erdhi shumë mirë nga fjalët tëpër të ngrohta të minatorit të vjetër, që i kishte hyrë menjëherë në zemër.

— Miniera është e të gjithëve! — shtoi ai pas pak. — Djersa që do të derdhë populli i Kreshnikës këtu nuk do të shkojë dëm. Përkundrazi, ajo do ta bëjë të ardhmen e tij edhe më të bukur.

Burhan Kola fliste ngadalë dhe me një ton të butë, shumë të dashur, aq sa të bënte menjëherë për vete.

Sheshi para kantierit gumëzhinte nga njerëzit. Ramë Sheldia shkoi nga njëri grup te tjetri. Ai u afrohej të gjithëve me një buzëqeshje të shtirur.

Nga mali i lartë i Kreshnikës po zbriste me shpejtësi një re e madhe e ngarkuar me dëborë.

— Ç'kohë e poshtë! — tha nëpër dhëmbë Zaçe Çapoku.

Kryetarin e këshillit të lokalitetit, Kristaq Dvoranin dhe Bame Toron i rrethuan menjëherë një grup i madh kreshnikasish. Nga të katër anët njerëzit u grumbulluan aty për aty për të marrë vesh se ç'duhej të bënin. Ramë Sheldia çau përmes turmës dhe u gjend papritur mu në qendër të grumbullit të njerëzve, ballë për ballë me Burhan Kolën.

— Ejani, shokë! Shpejt! — u dëgjua zëri i tij.

— Pas pak mbërritën aty edhe ata që ishin lart pranë motokompresorit.

— Ku është «inxhinieri» ynë? — pyeti Bame Toroja.

— Jam këtu! — u dëgjua zëri i Baudin Kazazit nga mesi i turmës.

Ai, ngaqë kishte humbur fare midis trupave të lartë të kreshnikasve, po përpiquej të dilte në qendër, duke mbajtur me gishtin tregues syzet e tij optike.

— Hë, si je? — e pyeti Bame Toroja, kur e pa që u shfaq fare papritur përpara tyre.

Ramë Sheldia qeshi dhe i rrahu shpatullat Baudin Kazazit, shtati i të cilit ishte tepër i vogël për peliçen që kishte veshur. Meqenëse edhe streha e shapkës i kishte shkuar pak anash, ai kishte marrë padashur një pamje qesharake.

— Dëgjoni, shokë! — u dëgjua zëri i Burhan Kolës.

Dëbora kishte filluar të binte me flokë të mëdhenj dhe era e ftohtë e hidhte herë nga e majta dhe herë nga e djathta.

— Megjithëse koha është e keqe, — vijoi përsëri ai, si heshti për një copë herë të gjatë, — ne jemi të detyruar të fillojmë nga puna...

— Dëgjoni planin që kemi menduar ne! — tha Burhan Kola. — Dhjetë ose pesëmbëdhjetë veta, nga më të fortët, të dalin mënjanë, sepse do të merren me ngjitjen e motokompresorit.



I pari u shkëput nga turma Sokol Dinoja. Pas tij edhe tre minatorët e rinj si dhe Martin Reka.

Me grupin e Sokol Dinos u bashkuan disa kreshnikas të tjerë.

— Mund të shkojmë ne? — pyeti Sokoli me një pamje serioze në fytyrë.

— Shkoni! — tha Kristaq Dvorani me dashamirësi.

— Kjo është detyra më e rëndësishme për ditën e sotme! — tha Burhan Kola. — Derisa të ngryset, motor-kompresori duhet të jetë në vendin e caktuar. Një detyrë tjetër jo më pak e rëndësishme është hapja e rrugës deri te vendi ku do të punojnë minatorët.

— Uuu! — u dëgjuan disa zëra.

— Mos u shqetësoni, shokë! Edhe kjo është një gjë po aq e mundshme. Këtu do të përqendrojmë të gjitha forcat tona me përfundim të vëllezërve Ukcama që do të merren me ndërtimin e barakave. Ne do të ndahemi në dy grupe, njëri do të fillojë që këtu, nga rruga, deri në mes, kurse tjetri do të fillojë nga mesi i rrugës dhe do të ngjitet deri lart te minatorët. Kush të mbarojë i pari, do të marrë flamurin dhe pastaj do të shkojë të ndihmojë të prapambeturit. Dakord?

— Urra! — thanë disa zëra.

— Atëherë përpara drejt frontit të punës! — thirri Burhan Kola.

Kolona u nis drejt malit të lartë të Kreshnikës duke mbajtur në supë kazma, lopata, hekura dhe sende të tjera të nevojshme për hapjen e rrugës. Në krye të kolonës ishte një kreshnikas i thyer në moshë, i cili ia mori këngës me një zë të fortë baritoni.

*Bashkohuni, o shokë,*

*Me ne në çetë,*

*Malit të lartë*

*Të shkojmë përpjetë.*

Ata që e ndiqnin nga pas e shoqëronin me kënaqësi; megjithatë aty-këtu kënga stononte, pasi veshi i kre-

shnikasve ishte mësuar prej kohësh me zërin e vetmuar të lahutarit.

Me grupin që do të merret me ngjitjen e moto-kompresorit do të shkoj unë, — tha Kristaq Dvorani.

— Në krye të minatorëve do të jem unë, — vijoi Bame Toroja.

— Ju jeni grupi më i vogël, — tha Burhani. — Do të keni me siguri nevojë për ndihmë, prandaj do t'ju dërgoj nja dhjetë-pesëmbëdhjetë veta nga forcat e mia. Vëri të pastrojnë dëborën në tërë sektorin ku do të vendosen minat.

— Ju falem nderit! — tha Bame Toroja me të qeshur.

Ai ishte shumë i kënaqur që do të fillonte menjëherë nga puna për hapjen e vrimave për kallëpët e dinamitit.

Mendojmë të bëjmë një shpërthim tepër të fuqishëm, — tha ai plot gëzim.

— Le të gjëmojë tërë Gryka e Suferinës! — tha Burhani.

Kristaq Dvorani qeshi me gjithë zemër.

— Hajdeni, djema! — thirri Bame Toroja, duke ua bërë me kokë minatorëve.

— Ke për të parë, shef, se ç'shpërthim të fuqishëm do të bëjmë! — thoshte Adushi, ndërsa e ndiqte hap pas hapi Bame Toron.

— Mirë, mirë! Po ki mendjen se mos na rrëshqet këtu! — e këshillonte Bame Toroja.

— S'më beson?

— Si jo!

— Do ta bëjmë që ç'ke me të!

— Do të gjëmojë tërë lugina.

— Do të dridhet i tërë mali i Kreshnikës, thuaj!

Sa më lart ngjiteshin, aq më e dendur bëhej mjegulla dhe reshjet e dëborës.

Në krahun e tyre të djathtë dukej kolona e madhe e kreshnikasve, që kishin filluar nga puna për hapjen e rrugës.

— Kjo minierë do të hajë mjaft koka njerëzish!



— i murmuriti në vesh Ramë Sheldia një mikut që kishte në krahë. — Ke për të parë!

— Rreziku më i madh vjen nga ortekët e dëborës, — i tha tjetri.

— Këtu çdo gjë është e mbarsur me rreziqe! — tha prapë Ramë Sheldia, duke folur shumë ngadalë me qëllim që të mos dëgjohej.

— Paske qenë punëtor i madh, o Ramë Sheldia! — thirri një zë nga kreu që po shikonte se si punonin njerëzit.

Ramë Sheldia në të vërtetë e ngrinte kazmën lart dhe qëllonte me forcë. Ai nuk kishte pranuar që të hiqte dëborën me lopatë, sepse ishte një punë e lehtë, me të cilën, sipas tij, mund të merreshin vetëm dembelët. Ai i vështronte me vërejtje njerëzit që e rrethonin dhe godiste tokën me kazmë me tërë forcën e tij.

— Kujdes! Ki kujdes! — i tha një kreshnikas që kishte në krah. — Do të ngrihet ndonjë cifël shkëmbi dhe do të të qorrojë ndonjë sy!

Ramë Sheldia e godiste tokën si i tërbuar.

— S'ka gjë, — tha pa e ndërprerë punën. — Të rrojë pushteti popullor!

Grupi i të rinjve, që ishte caktuar të ngjiste motokompresorin ishte në krye të detyrës.

— E shikoj se të gjithë jeni gati të vini mbi supë motokompresorin, — tha Sokol Dinoja. — A më lejoni që këtu në krye të qëndroj unë?

— Ti nuk mund të qëndrosh vetëm aty, — tha një zë nga fundi.

— E pamundur, — tha një tjetër.

— Është peshë e rëndë!

Sokoli i vështroi shokët me sytë që i shkëlqenin dhe pastaj tha:

— Kini besim tek unë, more shokë. Ju siguroj se jam në gjendje ta mbaj këtë peshë, — nguli këmbi ai.

— Jo!

— Shokët kanë të drejtë, — tha njëri nga kreshnikasit që nuk kishte folur fare deri atëherë. — Pse ta vini veten në rrezik. Ne nuk dyshojmë se ti s'e mban

dot peshën. Por po të shkau këmba?! Po të kesh edhe një ose dy shokë në krah, të mbajnë ata!

— Dhe jo vetëm kaq, — tha një tjetër. — Të gjithë duhet të jemi në gatishmëri. Kush të lodhet, le t'ia lërë vendin tjetrit.

Ndërkohë Kristaq Dvorani dhe kryetari i këshillit të lokalitetit vazhdonin të këshilloheshin me vëllezërit Ukcama për dy barakat që mendonin të ngrinin në qëndër të kantierit, ngjitur me rrugën automobilistike. Si ranë dakord për vendin ku do të ndërtoheshin barakat, të dy së bashku morën rrugën për t'u ngjitur secili në sektorin e tij të punës.

Burhan Kola ndezi një cigare, duke u mbrojtur nga era. Pastaj ia afroi cigaren e ndezur Kristaq Dvoranit. Ky mezi po e mbante cigaren e tij, ngaqë duart i kishin ngrirë nga të ftohtët.

— Kristaq, ç'mendon për kreshnikasit? — pyeti Burhani.

— Më duken njerëz shumë të dashur dhe punëtorë.

— Ashtu është, — tha pas pak Burhan Kola. — Po kemi edhe disa drurë të shtrembër midis nesh.

— S'ka pyll pa drurë të shtrembër! — bëri shaka Kristaq Dvorani.

Burhan Kola ra në mendime.

— A e ke parasysh Ramë Sheldinë?

Kristaq Dvorani u mendua pak.

— Si jo, është ai që u ngrit i pari sot në mbledhje...

— Dora vetë... Ai që u mburr se ju kishte shpëtuar mbrëmë nga dëborat e suferina...

— Po.

— Nuk është njeri fort i mirë... Të kaluarën e ka të keqe... Ka qenë xhandar në pallatin mbretëror të Ahmet Zogut... Gjatë luftës ka mbajtur qëndrim indiferent, ndërsa pas Çlirimit të vendit po përpigjet të lërë përshtypjen se e do pushtetin popullor, siç e pe dhe vetë... Megjithatë, nga njerëz të tillë duhet ruajtur...

Burhan Kola kapërceu një vënd të rrezikshëm dhe filloi të ngjitej me vështirësi nëpër një rrëpirë. Pikë-



risht në këtë çast iu afrua një njeri i panjohur, i veshur me një qyrk të zi të vjetër dhe i tha:

— Ju jeni kryetari i këshillit të lokalitetit të Kreshnikës?

— Po.

— Shoku Burhan Kola?

— Sigurisht.

Njeriu i panjohur vuri buzën në gaz.

— Unë vij nga Tejmali, — tha ai, duke fërkuar duart.

— Ç'dëshironi?

Kristaq Dvorani po e ndiqte me vëmendje bisedën që po zhvillohej ndërmjet tyre.

— Ne mësuam se këtu filluan punimet për të hapur minierën e kromit, — tha me të qeshur. — Kur dëgjuam se shokët e ardhur nga Tirana janë një grup i vogël, u mblodhëm dhe vendosëm që të dërgojmë disa burra... në qoftë se nevojiten... Ja, për këtë më dërguan këtu ata të këshillit të fshatit. Në qoftë se ndihet nevoja...

Ai vazhdonte të fliste me buzë në gaz dhe duke fërkuar duart e mavijosura nga të ftohtët.

Burhan Kola u gëzua pa masë. Edhe Kristaq Dvoranit iu bë qejfi.

— Kemi nevojë, si jo? — tha Kristaq Dvorani.

— Kështu t'u thoni shokëve të këshillit të fshatit tuaj. Në do t'ju njoftojmë vetë se kur duhet të na i dërgoni forcat.

— E dëgjuat? — tha Burhan Kola. — Ky është shefi i ekspeditës. Dakord?

— Dakord! — tha njeriu i panjohur.

Ai fërkoj duart për të fundit herë dhe pastaj ndërroi me grusht.

Ata u ndanë, duke i dhënë dorën me përzemërsi njëri-tjetrit.

## LINJA E RE TELEFONIKE

Nëpër rrugët e Kreshnikës kishte shumë pak lëvizje. Njerëzit që kishin mbetur aty për shkak të kohës së keqe ishin mbyllur nëpër shtëpitë e tyre dhe, duke trazuar vatrat e zjarrit, bisedonin mbarë e mbrapsht në lidhje me minierën e re të kromit. Megjithëse shumica mendonin se ky ishte një fat i bardhë për Kreshnikën plakë, kishte edhe nga ata që thoshnin se miniera do t'ia prishte qetësinë fshatit.

Jashtë vazhdonte të binte dëborë. Kishte rënë aq shumë, sa pleqtë thoshin se nuk mbahej mend që të kishte bërë ndonjë dimër aq i egër. I tërë vendi ishte mbushur gjithandej me dëborë; rrugët kishin filluar të bllokoheshin, kurse çatitë e larta me majë të mprehtë të stilit gotik kërcisnin vazhdimisht nga pesha e saj e rëndë. Nën strehë vareshin aq shumë stalaktite, sa që të linin përshtypjen se njerëzit i kishin vendosur me dorë për të zbukuruar strehët e shtëpive të tyre.

— Çudi! Si nuk po vijnë akoma?! — tha Hajrija.

Ajo bashkë me një grup vajzash nga lagjja «Kolaj» ishte futur nën strehën e shkollës dhe po priste dikë në drejtim të rrugës që të çonte në vendin ku ishte dislokuar një repart ushtarak i forcave të ndjekjes.

— A e sqarove mirë çështjen? — pyeti Katerina, njëra nga vajzat.

— Si jo? Takova komandantin dhe ai më tha se po përgatisin një dhuratë për punonjësit e minierës së re të kromit. Çfarë? i thashë unë e habitur. Duam të



shtrojmë një linjë telefonike nga qendra e lokalitetit deri te kantieri i tyre, më tha ai. Atëherë po bashkohemi edhe ne të rinjtë e fshatit me iniciativën tuaj, i thashë unë. Ai qeshi dhe më tha se ishte plotësisht dakord.

— Po pastaj? — pyeti Katerina.

— E lamë të takoheshim këtu, para shkollës, — tha Hajrija dhe vazhdonte të shikonte me merak në drejtim të çadrave të repartit ushtarak.

Te postblloku u duk komandanti, hipur në një kalë të hazdisur, që mezi po e përmbante. Pas tij dolën edhe dy të tjerë. Ata nderuan me grusht rojën dhe pastaj kaluan përmes fshatit me tërë shpejtësinë e tyre.

— Qyqja! — tha njëra nga vajzat. — Ata do të kenë ndonjë alarm! Sa herë që ikin në këtë mënyrë, dije se diçka duhet të ketë ndodhur.

— Do të jetë diktuar ndonjë bandë diversantësh, — tha Hajrija me një pamje të menduar.

— Flitet se këndej qarkullon banda e Çuman Kobogos, — tha Maria. — A është e vërtetë?

— Ku ta dish? — tha Tana.

Thundrat e kuajve shkisinin mbi akull. Vajzat i ndoqën me sy gjersa u zhdukën tutje, në drejtim të rrugës që të çonte në teqenë e Baba Ali Çakmaxhianit.

— Uf! — ia bëri Katerina. — Sa u vonuan!

Hajrija me buzë të shtrënguara zbriti në mes të rrugës.

— Do të shkoj të pyes edhe një herë, — tha ajo.

Vajzat e ndoqën me sy Hajrijen tek po rendte e lehtë dhe e shkathët me çizmet që i rrinin pas këmbëve. Shalli i kuq i fluturonte pas krahëve, duke i dhënë fytyrës së saj ezmore një pamje tërheqëse.

— Të vijnë edhe ne? — thirrën dy nga vajzat njëzëri.

— Jo, jo, — u përgjigj Hajrija, pa e ndalur vrapin.

Një copë herë të gjatë vajzat mbetën pa Hajrijen nën strehën e ndërtesës së shkollës. Ato vështronin dëborën që binte pa pushim dhe zogjtë që cicëronin nga

të ftohtët. Një grup kalamajsh u shfaq papritur në she-shin para shkollës. Ata i kishin vënë vetes për detyrë të thyenin stalaktitet që vareshin nëpër strehët e shtëpive. Gjithsecili mburrej me numrin e madh të stalaktiteve që kishte thyer.

— Oh, po vijnë! — klithi e para Katerina.

Hajrija që ishte futur midis dy ushtarëve gati sa s'thoshte: E shikoni që ju solla dy pëllumba! Ushtarët e rinj me uniformë të gjelbër ishin dy djem tepër simpatikë. Njëri prej tyre mbante në krah një rrötë të madhe teli dhe një aparat telefonik, kurse tjetri pajimet e nevojshme, me të cilat do të punonin nëpër shtyllat telefonike.

— A jeni gati? — tha Hajrija kur u afruan.

— Si jo? — thanë vajzat njëzëri.

Katerina, si gjithmonë, vuri buzën në gaz. Leshrat e saj të verdha kishin dalë tufa-tufa nga shalli dhe i ishin derdhur mbi supe.

Vajzat u përshëndetën me ushtarët, duke u zgjatur atyre dorën. Ushtarët e rinj gati sa s'fluturonin nga gëzimi.

— Ata do të habiten kur ta shohin! — tha Hajrija, duke u nisur drejt ndërtesës së këshillit popullor të lokalitetit.

— A do ta përfundojmë gjer në mbrëmje? — pyeti Katerina.

Ushtarët ecnin midis vajzave me një pamje serioze.

— Të shikojmë! — u përgjigj njëri prej tyre pak me vonesë.

— Po nuk e çuam linjën telefonike gjer në mbrëmje në kantier, s'ka kuptim, — tha e pakënaqur njëra nga vajzat.

— Hajde, hajde! — tha Hajrija plot autoritet. — Dëta çojmë se s'bën!

Katerina qeshi përsëri. Sytë e saj bojë qielli shkëlqenin nga gëzimi.

Tek bërryli, poshtë në xhade, prisnin disa të rinj të fshatit, në gatishmëri për të shtruar linjën e re telefonike.



## NË ZJARRIN E PUNËS

Dëbora ishte pastruar tashmë nga rruga dhe të gjitha forcat ishin përqendruar në gërmimin dhe zgjerimin e saj. Vende-vende, kishin dalë në pah disa shkëmbinj që i kishin lënë për t'i shkatërruar me eksploziv. Zhurma e kazmave dhe e lopatave oshëtinte gjithandej. Nga kreu gjer poshtë në xhade dëgjoheshin zëra, të qeshura dhe ndonjë këngë, që këndohej mbyturazi.

Burhan Kola kishte dalë për të bërë një inspektim të përgjithshëm.

— Ju lumshin krahët! — dëgjohej herë pas here zëri i tij.

Njerëzit merrnin zjarr edhe më shumë. Kur e shih-te të arsyeshme, ai bënte edhe ndonjë vërejtje, për ta zgjeruar pak më shumë rrugën, sidomos në kthesa, për t'i dhënë pjerrësinë e nevojshme ose për të mbushur më mirë ndonjë boshllëk. Në disa vende duhej të ndërtohe-shin ura të vogla.

— Duhet të përdorim gurë të skalitur, — u thosh-te Burhan Kola kreshnikasve, — që të ndërtojmë ura të forta!

Ai ishte njeri i përpiktë dhe dinte të merrej vesh mirë me njerëzit, prandaj edhe kreshnikasit e dëgjo-nin dhe e respektonin shumë. Fjala e tij zinte vend kudo. Burhanit nuk ia priste mendja se rruga do të ndërtohej kaq shpejt. Tani pothuajse çdo gjë ishte drejt përfundimit. Një grup i madh kreshnikasish po vinte nga poshtë gjithë zhurmë. Ata kaluan aty si në

paradë, me kazma e lopata në krahë, pa e vënë re kryetarin e këshillit të lokalitetit.

— Nga po shkoni kështu? — i pyeti Burhan Kola.

Ata kthyen kokën të habitur.

— Lart, që të ndihmojmë të prapambeturit, — u përgjigj një burrë i shkurtër me mustaqe të thinjura.

Nga poshtë vazhdonin të vinin njerëz me kazma e lopata në krahë.

Dëbora kishte pushuar, por frynte një erë e ftohtë, që të priste fytyrën.

— Merrni shembull nga këta! — thoshte Burhan Kola, duke treguar me kokë kreshnikasit që kërkonin punë tjetër. — E mbaruan normën e tyre dhe tani...

Ai u shtrëngoi dorën me përzemërsi tre-katër vetave që kishte pranë dhe pastaj u bëri shenjë të tjerëve që të afroheshin dhe të grumbulloheshin rreth tij.

— Pa shikoni, e shokë! — thirri papritur ai. — Ja, këta burra e meritojnë flamurin!

Si hapi krahët e tij të gjatë, ai ua hodhi në qafë, duke u rrahur shpatullat dhe duke i përgëzuar për punën e mirë.

Diç deshi të thoshte, por një gjësim i fuqishëm ia preu fjalën.

— Orteku! — dha alarmin një zë i fortë nga lart.

— Orteku! — thirrën edhe disa zëra të tjerë.

Pastaj këtë fjalëz ogurzezë e përcolli tutje larg Gryka e Suferinës. Nga Kreshta e Vdekjes po zbriste me shpejtësi një masë e madhe dëbore, e cila bënte një zhurmë rrëqethëse. Vendasit ishin mësuar me «vallen» plot zhurmë të ortekëve, ndërsa anëtarët e ekspeditës një fenomen të tillë e shikonin për herë të parë. Masa e dëborës vinte duke u zmadhuar; kur mbërriti pranë sektorit ku punonin minatorët, u përplas në një shkëmb të lartë dhe pastaj, e bërë copë-copë, ra poshtë në greminë, në fund të Përroit të Thellë.

Një copë herë të gjatë puna u ndërpre gjithandej. Bame Toroja dhe shokët e tij, për t'u mbrojtur nga or-



teku, ishin futur në një shpellë, duke respektuar në këtë mënyrë këshillat e vendasve. Ai doli jashtë i pari dhe pastaj ftoi për të dalë edhe shokët e tjerë. Zaçe Çapoku mbeti i fundit. Ai ishte strukur në thellësi të shpellës dhe po dridhej i tëri nga frika.

— Hajde, hajde! — i tha Bame Toroja. — Dil edhe ti, se nuk vlen më shumë se ne të tjerët.

Zaçe Çapoku doli duke u dridhur.

— Ky është vendi më i rrezikshëm, — po i thoshte një kreshnikas Bame Toros. — Prandaj unë mendoj që të vendosim një rojë në anën tjetër, mbi atë shkëmbin atje përtej, i cili, me të parë ortekun, duke zbritur nga lart, të paralajmërojë, që njerëzit të marrin masa për t'u mbrojtur.

Bame Toroja po e dëgjonte me vëmendje.

— Ashtu të bëjmë! — tha ai, si u mendua pak, me vështrimin mbërthyer nga Kreshta e Vdekjes.

— Kur fillojnë të shkëputen ortekët, — tha kreshnikasi, — ata vijnë njëri pas tjetrit. — Ja, do të shikoni, si të kalojnë disa minuta, ka mundësi që të zbresë ndonjë ortek tjetër dëbore. Numri i tyre varet nga sasia e dëborës që është grumbulluar në Kreshtën e Vdekjes.

Njerëzit që ndodheshin rreth tyre dëgjonin me vëmendje. Tre minatorët dhe Martin Reka po vazhdonin punën për hapjen e vrimave me baromina dore, ndërsa Zaçe Çapoku dëgjonte plot kureshtje komentet që bëheshin për ortekët e dëborës.

Mendimin për të nxjerrë një njeri në krahun e majtë, me qëllim që të vëzhgonte ortekët dhe të paralajmëronte sa herë që ata të fillonin të zbrisnin poshtë, ia thanë edhe Burhan Kolës. Ai e miratoi menjëherë.

— Ky vendi këtu është mjaft i rrezikshëm, — tha ai me një pamje të menduar. — Që këtej nuk duken ortekët, dhe njerëzit mund të kapen edhe në befasi...

— Po shkoj unë të bëj rojë! — thirri Zaçe Çapoku krejt papritur.

Kryetari i këshillit të lokalitetit ktheu kokën nga

ai, ndërsa Bame Toroja i hodhi një vështrim qortues, duke ia qepur sytë për një copë herë të gjatë.

— Jo ti, jo! — tha më në fund ai me një zemërim të përmbajtur.

— Atje duhet të shkojë një vendas, që të dijë të manovrojë dhe të ketë zë të fortë! — tha pas pak Burhan Kola.

Bame Toroja i bëri shenjë me kokë Zaçe Çapokut që të largohej menjëherë prej andej.

— Shko ndihmo Martinin! — i tha ai me një buzëqeshje të ngurosur.

Burhan Kola thirri në emër një kreshnikas shtatlartë dhe, pasi e sqaroi mirë për detyrën që do të kryente, i tha të ngjitej në majën e shkëmbit që ndodhej në krahun e tyre të majtë e nga ku dukej shumë mirë Kreshta e Vdekjes.

Në lidhje me punën që po bëhej për ngjitjen e motokompresorit nuk kishin asnjë lajm. Ardhja e papritur e Sokol Dinos ngjalli një shqetësim të madh. Ai dukej tepër i lodhur dhe i shqetësuar.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti menjëherë Burhan Kola.

— Na është plagosur një shok! — tha ai, duke marrë frymë me vështirësi. — Na duhen dy veta që ta zbresin poshtë dhe ta shoqërojnë për në shtëpi. Është plagosur në këmbë!

Disa kreshnikas zbritën poshtë me nxitim. Pas tyre shkoi edhe Bame Toroja. Kur mbërritën në vend, vunë re se njeriu i plagosur ishte shtrirë mbi dëborë dhe rënkonte. Te koka i rrinte Kristaq Dvorani. Tre-katër të tjerë po përpiqeshin që t'i ndërprisnin rrjedhjen e gjakut.

— Do të ketë dëmtuar ndonjë venë! — tha dikush.

I plagosuri shtrembërohej në fytyrë nga dhimbjet e forta.

— Si ndodhi? — pyeti kryetari i këshillit, pa mbërritur mirë te vendi.



— Rrëshqitëm dhe motokompresori i zuri këmbën,  
— tha njëri nga kreshnikasit që po i lidhte plagën.

Dikush kishte hequr këmishën dhe me të kishin lidhur plagën për të ndaluar gjakun.

Kristaq Dvorani dukej jashtëzakonisht i lodhur dhe i pikëlluar nga ngjarja që kishte ndodhur. Katër veta u bënë gati që ta zbrisnin të plagosurin poshtë. Ata e ngritën atë me ngadalë dhe e ulën mbi një peliçe, të cilën e kapën në të dy anët, dhe e ngritën lart.

— Dilni më mirë në rrugë, — tha një i porsaardhur.

Pas tij po zbriste për në vendin e ngjarjes edhe Ramë Sheldia me një tjetër. Kur pa njollat e gjakut të shpërndara andej-këndeje nëpër dëborë, ai i pëshpëriti shokut që kishte në krah, duke i thënë:

— Kam thënë unë, kjo minierë do të hajë koka njerëzish.

— Hapuni, shokë, se do të fillojmë nga puna! — thirri Sokol Dinoja.

Ai dukej shumë i pikëlluar për plagosjen e shokut të tij. Megjithëse ngjarja nuk ishte shkaktuar prej tij, atij i dukej se barra e turpit binte e gjitha mbi të.

— Hapuni! — thirri përsëri ai.

— Posi! — i tha Burhan Kola. — Kështu të lodhur e të rraskapitur siç jeni, ne nuk ju lejojmë që t'i futeni përsëri punës! Uluni me shokët tuaj dhe pushoni, pastaj...

Ai e la mendimin përgjysmë. Pranë tij qëndronin në këmbë Bame Toroja dhe Kristaq Dvorani.

— Ta ndezim njëherë! — tha duke nxjerrë kutinë e duhanit Bame Toroja.

Atij nuk i qeshte buza dhe sytë i ishin skuqur nga hidhërimi.

— Nuk duhej të na kishte ndodhur kjo! — tha ai me një ton qortues, që i drejtohej më shumë Kristaq Dvoranit.

Një grumbull i madh burrash po zbrisnin poshtë me kazma e lopata në krahë. Me sa dukej, rruga ishte hapur plotësisht deri në vendin e caktuar. Sikur të

mos kishin dëgjuar për plagosjen e shokut të tyre, ata do të kishin ardhur aty duke kënduar.

— S'ka gjë me rëndësi, s'ka gjë me rëndësi! — po thoshte një kreshnikas me mustaqe të gjata.

— Ka vrrarë pak këmbën, — thoshte një tjetër. — Gjë pa zarrar!

Qielli kishte filluar të errësohej, gjë që paralajmëronte se nata e gjatë e dimrit po afrohej.

— Sot punët shkuan fare mirë, — tha Burhan Kola. — Mirë do të ishte që shoku që sapo zbritëm poshtë të mos ishte plagosur, por s'ke ç'bën. Luftë është kjo! Tani, që t'i japim fund për sot, duhet që të çojmë atje lart edhe motokompresorin. Që këtu s'na mbetet të bëjmë veçse disa hapa. Tërë këta burra që jemi e fluturojmë.

— S'është nevoja! — tha Sokol Dinoja. — Kjo punë na takon neve, ne do ta çojmë deri në fund.

Njëra nga vetullat e tij të zeza kërceu lart.

Burhan Kola vuri buzën në gaz.

— Ne këtë e dimë! — tha ai. — Por fundja edhe këta shokët tanë janë dhe të gjithë për një qëllim luftojmë. Këtu, sipas meje, nuk ka «puna ime» dhe «puna jote». Këtu çdo gjë është jona! Apo jo, o burra!

— Ashtu është! — thanë mjaft zëra.

— Ashtu qoftë! — tha i zemëruar Sokol Dinoja. — Vetëm se duhet ta dini se vendi im është këtu! — shtoi ai, duke zënë pozicion e duke u bërë gati për ta ngritur motokompresorin mbi supe.

Disa andej nga fundi ia plasën gazit.

— Atëherë, — tha me të njëjtin ton Kristaq Dvorani, — edhe vendi im këtu është!

Ai qëndroi në këmbë në anën tjetër të motokompresorit. Tre-katër kreshnikas u përpoqën që ta hiqnin atë që andej, duke e tërhequr prej krahu, po ai nuk pranoi. Atëherë ata u radhitën pas tij. Në krahun tjetër pas Sokolit zunë vend tre-katër të tjerë.

— Gati! — dha urdhër Sokol Dinoja.

Të gjithë u përkulën për të kapur drurët që kishin lidhur nën motokompresor.



— Çojeni! — u dëgjua përsëri zëri i tij.

Në çast motokompresori u gjend mbi supet e tyre. Mjaft kreshnikas qëndronin në gatishmëri në të dy krahët dhe herë pas here vinin dorën atje ku pesha bëhej më e rëndë.

Të tjerët i ndiqnin pas në heshtje. Ç'njerëz të mrekullueshëm që janë, po thoshte me vete Bame Toroja, ndërsa ecte krah për krah me kryetarin e këshillit të lokalitetit të Kreshnikës.

— Orteku! — u dëgjua zëri i kreshnikasit nga pika e vrojtimit.

— Uleni, burra! — u dëgjua një zë i çjerrë.

Ata ishin fare afër rrafshinës ku do të vendosej motokompresori.

— Vazhdoni! — kundërshtoi Sokoli — Do ta çojmë deri në vend!

— Orteku!

— Uleni, burra!

Kreshta e Vdekjes gjëmonte me tërë forcën e saj nëpër errësirë. Njerëzit që ndodheshin në krahun e djathtë kaluan të gjithë duke vrapuar në anën tjetër. Në zonën e rrezikshme mbetën vetëm Kristaq Dvorani dhe kreshnikasit që vazhdonin të mbartnin mbi supe motokompresorin.

— Edhe pak, se mbërritëm! — dëgjohej zëri i Sokol Dinos.

— Uleni, burra! Do t'ju marrë orteku përpara! — ngulte këmbë i njëjti zë.

Zhurma shurdhuese e ortekut sa vinte bëhej më e madhe; më në fund, pasi u përplas si zakonisht në shkëmbin e krahut të djathtë, ai u bë copë-copë dhe ra poshtë në greminë.

Motokompresori ishte ulur në rrafshinën ku ishte parashikuar të vendosej. Tre-katër hapa më tej kishin rënë togje të mëdha dëbore e akulli, që ishin shkëputur nga orteku.

Burhan Kola u afrua aty tepër i zemëruar.

— Neve na duhen trima, po jo kokëkrisur! — thirri ai, duke tundur gishtin tregues në ajër.

Tërë zemërimin e tij ai e kishte përqendruar në fytyrën e Sokol Dinos.

— Ç'janë këto që bëni, more shokë! — po thoshte Bame Toroja.

Mirëpo tërë këto kritika u mbytën nga «urra» të forta. Njerëzit thoshin «Bravo!» «Bravo!» dhe u shtrëngonin duart anëtarëve të grupit, që ngjitën motokompresorin.

Duartrokitjet dhe zhurma e madhe vazhduan për një kohë të gjatë.

Burhan Kola vështroi rreth e rrotull tij. Era herë-herë frynte me aq rrëmbim, sa që të linte përshtypjen se ishte gati të hidhte çdo gjë poshtë në greminë. Vërshëllima e saj ishte e llahtarshme. Por tërë këta njerëz ishin kaq sypatrembur dhe rruga që kishin hapur me duart e tyre ishte kaq e mirë, sa që atij, iu duk krejt i tepruar shqetësimi.

— Të ka zënë frika, o Zaçe Çapoku! — u dëgjua një zë nëpër errësi.

Baudin Kazazi, që kishte kohë që nuk i ishte ndier zëri, po ecte me kujdes nëpër rrugën e re. Ai vazhdonte të ishte i habitur për të gjitha gjërat që kishin ndodhur gjatë ditës së parë të punës. Ato që herët në mëngjes i qenë dukur si ëndrra, tani ishin bërë realitet. Rruga ishte hapur dhe motokompresori ishte gati për sulm. Hajde, forcë, hajde! po thoshte me vete, ndërsa hidhte këmbët kuturu nëpër errësi.



## MBRËMJA E PARË NË KANTIER

Kur zbritën poshtë në kantier, nata kishte rënë në të katër anët e Grykës së Suferinës dhe çdo gjë e kishte mbuluar me perden e saj të zezë. Shtëpitë e fshatit me drita të rralluara, që humbisnin herë pas here nëpër errësirë, prisnin burrat dhe djemtë e tyre që të ktheheshin të lodhur nga dita e parë e punës në minierë.

Në mes të kantierit një fener i varur në një gozhdë të ngulur nga vëllezërit Ukcama në qoshe të barakës së porsangritur, ndriçonte me një dritë të zbehtë. Baraka kishte hedhur shtat, po nuk merrej vesh se në ç'gjendje ishin punimet. Kur mbërritën fare pranë, njerëzit vune re se çatia e lartë me majë të mprehtë ishte ngritur plotësisht. Tani s'mbetej gjë tjetër veçse të mbyllej në të katër anët dhe të bëheshin ndarjet e brendshme. Në këtë mënyrë shtëpiza e drunjte, e ndërtuar vetëm me dërrasa ahu e pishe, po bëhej gati për të pritur punëtorët e parë të minierës së re të kromit të Kreshnikës. Njerëzit po habiteshin me pamjen e re që kishte marrë kantieri pas ngritjes së barakës prej dërrase.

Pak më tej dukej silueta e hanit të dikurshëm, i cili ishte përfshirë, tashmë, në pasurinë e tundshme dhe të patundshme të minierës.

Burhan Kola pa në dritën e dobët të fenerit Hajrije Opingarin, e cila po bisedonte me disa shoqe të saj. Midis

vajzave ndodheshin edhe dy ushtarë të forcave të ndjekjes.

— Ja ku na paska ardhur edhe shitësja e dyqanit! — tha njëri nga kreshnikasit.

— Qenka edhe Katerina! — tha një tjetër me një ton ngacmues.

— Po ju ç'bëni këtu? — i qortoi një zë burri nëpër errësirë. — A nuk ju thashë që të mos vinit!

— E di si është puna..., — u mundua të jepte shpjegime Hajrija.

— Ty nuk të foli njeri! — ia ktheu burri nëpër errësirë. — Unë po i flas kësaj! — tha ai dhe bëri shenjë me kokë në drejtim të Katerinës. — Ti ç'do këtu? — e ngriti zërin ai.

Rrefh tyre po grumbulloheshin mjaft njerëz.

— E di si është puna...

— Mbylle gojën të thashë! Unë po flas me këtë! — thirri prapë burri, i nevikosur në kulm.

Ai e kishte kapur Katerinën për flokësh dhe po ia shtrëngonte përherë e më shumë.

— Hë de, fol!

Burhan Kola, Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja, sapo e morën vesh këtë ndodhi, erdhën menjëherë aty të shqetësuar.

— Pa dale, more shokë, pa dale njëherë! — po thoshte Burhan Kola.

— A, të lutem, kryetar i këshillit! — tha burri, i inatosur në kulm. — Sa për këtë, këtu s'ka «dale», kjo është mbesa ime dhe unë i marr shpirtin, në qoftë se nuk më dëgjon!

Ai ia lëshoi flokët, por përbrenda e hante një zemërim i madh.

— E shikojmë sonte, kur të kthehem në shtëpi! — e kërcënoi ai. — Posi, u ardhka mirë të bredhin poshtë e përpjetë me ushtarët...

— Si është puna? — pyeti Burhan Kola, duke iu drejtuar Hajrijes, kur burri i inatosur u largua nëpër errësirë.



Ajo filloi të shpjegonte arsyet përse ndodheshin aty, duke folur me zë të ulët, me qëllim që të mos dëgjohej gjithandej.

— Ç'është ky tel këtu? — po thoshte një zë në errësirë.

Dikush po e tërhiqte atë me forcë. Një tjetër u nis të futej brenda në ndërtesën e hanit të vjetër, ndanë rrugës, mirëpo dy vajza u dolën përpara.

— Është e ndaluar të hyni brenda! — thanë ato njëzëri.

— Ç'është kjo punë! — thirri njëri nga djemtë.  
— Ç'është kjo gjendje shtettrrethimi?!

Vajzat qeshën nën hundë.

— Unë do të hyj! — tha njëri nga djemtë.

— Ne nuk ju lejojmë! — u kundërpërgjigjën vajzat, duke zënë plotësisht derën me trupin e tyre.

— Nuk po kuptojmë se çfarë po ndodh kështu? — po thoshte një zë nëpër errësirë.

Ndërkohë, Burhan Kola, i ndjekur nga Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja, mori drejtëmin për të hyrë në ndërtesën e hanit të vjetër. Vajzat ua hapën atyre rrugën. Pas tyre hyri edhe Hajrija, ndërsa vajzat e tjera qëndruan jashtë, duke biseduar kokë më kokë me njëra-tjetrën. Katerina dukej tepër e pikëlluar.

— Këtu diçka ka ndodhur, po ne nuk po e marrim vesh! — thirri i njëjti zë.

— Pusho! — e qortoi dikush.

— Ndoshta do të kenë kapur ndonjë diversant! — tha një tjetër kur pa dy ushtarët që rrinin në këmbë në qoshë të ndërtesës.

— Ç'ngjarje interesante! — pëshpëriste një zë nëpër errësirë.

Vëllezërit Ukcama që e dinin çdo gjë me hollësi ishin grumbulluar mënjanë dhe dëgjonin në heshtje shpjegimet qesharake që bënin njerëzit andej-këndej nëpër sheshin para kantierit.

Burhan Kola doli papritur para ndërtesës së hanit të vjetër.

— Shokë! — tha ai. — Pa dëgjoni, o shokë! Do t'ju japim edhe një lajm tjetër të gëzuar!

Njerëzit prisnin në ankth që të mësonin se çfarë kishte ndodhur. Në krah të kryetarit të këshillit qëndronin Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja.

— Thashë unë, do të kenë kapur ndonjë diversant!

— Të rinjtë e fshatit tonë, — u dëgjua përsëri zëri i Burhan Kolës, — bashkë me këta dy ushtarët që shikoni këtu, i kanë bërë një dhuratë minierës sonë të re; ato kanë instaluar në zyrat e administratës të minierës së kromit linjën e parë telefonike!

Sheshi i kantierit u mbush me zëra.

— Ju lumtë! — thirri dikush nëpër errësi.

— Të thërrasim «Urra!» për të rinjtë tanë! — tha dikush.

— Urra! — u dëgjuan mjaft zëra njëherësh nëpër errësi.

Tërë kantieri u gjallërua.

Të rinjtë krenoheshin me dhuratën që i kishin bërë minierës së tyre të re.

— Shoku shef i kantierit! — tha njëra nga vajzat.

— Ç'keni për të na thënë në lidhje me këtë dhuratë?

Kristaq Dvorani dukej tepër i mallëngjyer. Andej nga fundi vazhdonin të duartrokisnin me zhurmë të madhe. Dikush vërshëllente.

— Heshtni! Dëgjoni, se po flet shefi i kantierit!

— Qetësi, shokë! — tha edhe Burhan Kola.

Kristaq Dvorani u mendua një copë herë.

— Unë dhe shokët e mi, — u dëgjua pas pak zëri i tij, — jemi shumë të emocionuar nga të gjitha këto që ndodhën sot këtu, në minierën e re të kromit, të cilën ju po e ngrini me duar tuaja.

— Urra!

— Bravo! Bravo!

I tërë kantieri oshëtinte.

— Linja telefonike është gjithashtu një dhuratë me të vërtetë e çmuar për ne! U falemi nderit shumë për rinjve të Kreshnikës dhe shokëve të ushtrisë!

— Urra!



Dikush vërshëlleu përsëri nga gëzimi.

— Njëpërmjet kësaj linje telefonike që instaluan të rinjtë tuaj duarartë dhe dy shokët ushtarë ne do të njoftojmë qysh sonte Tiranën për të gjitha këto që ndodhën këtu!

Në të katër anët e kantierit u dëgjuan brohoritje të forta.

— Rroftë Partia!

— Rroftë Komandanti ynë i Përgjithshëm!

Njerëzit ishin përfshirë nga një entuziazëm i jashtëzakonshëm.

— Sonte do ta hamë së bashku darkën këtu! — po thoshte një kreshnikas shtatlartë, i cili se nga kishte gjetur një shishe me raki dhe po ua jepte të gjithëve me radhë, që të pinin nga një gllënjë.

Pastaj u drejtua nga shefi i kantierit.

— Pa ngrijeni edhe ju njëherë, more shokë! — tha.

Kristaq Dvorani piu i pari dhe pastaj ia dha Bame Toros, i cili e shkeli rregullin e vendosur, sepse piu tri-katër gllënjka menjëherë. Më në fund e mori edhe Burhan Kola.

— Sonte do ta hamë darkën këtu! — vazhdonte të thoshte kreshnikasi shtatlartë. — Njerëzit të mos mërziten, se do të presin pak!

Askush nuk e ndiente lodhjen e ditës së parë të punës në minierë. Të gjithë donin të merrnin pjesë në darkën që pritej të shtrohej në kantierin e porsangritur. Njerëzit po zinin vend si mundnin në barakën e re. Disa kishin filluar të hanin ushqimin që nuk kishin pasur mundësi ta hanin në drekë. Flitej se nga fshati ishin nisur disa të rinj me ushqime të thata dhe disa shishe raki që i kishin marrë ku kishin mundur. Baraka ishte mbushur plot e përplot me njerëz. Burhan Kola, Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja vazhdonin të rrinin në këmbë në mes të sheshit të kantierit. Ata po bisedonin për detyrat e ditës së ardhshme.

— Nuk do ta kalojmë gjithë natën në festë — tha Burhan Kola, duke iu drejtuar të gjithëve. — Nje-

rëzit kanë nevojë të pushojnë, sepse nesër na presin detyra edhe më të mëdha.

Baudin Kazazi bashkë me shokët e tij minatorë dhe shoferët Martin Reka e Zaçe Çapoku vështronin me interesim çdo gjë që ndodhte rreth tyre.

Atmosfera festive ndihej gjithandej. Në qoshen e barakës u dëgjua papritur zëri i kthjellët i një lahutari që po këndonte një këngë të hershme. Njerëzit s'dinin si ta shprehnin gëzimin e tyre.

Ndërkohë, në mënyrë krejt të papritur, nga shpati i malit të Kreshnikës u dëgjua një oshëtimë e fuqishme që i ngjante më shumë bubullimës.

Në mes të errësirës u dëgjua një zë:

— U shkëput edhe një ortek tjetër!

— Le të na e marrë të keqen! — tha dikush nëpër errësirë.

— Po motokompresori?

— Atë s'e gjen gjë, sepse atje ku është vendosur nuk afrohen ortekët!

Në të vërtetë nuk ishte ortek, po një tufan i papritur që ishte gati ta shkulte tërë barakën. Njerëzit u mblodhën si një grusht i vetëm, duke u ngjeshur pas njëri-tjetrit. Era vërshëllente si e tërbuar. Vajzat i futën menjëherë në ndërtesën e hanit të vjetër. Baraka filloi të kërciste. Rreziku për ta shkatërruar atë ishte i madh, ngaqë ajo ishte e hapur nga të katër anët.

— Ruani gjakftohtësinë, shokë! — thërriste njëri nga vëllezërit Ukcama. — Kini besim, baraka është aq e fortë, sa s'ka se çfarë t'i bëjë tufani!

— Nuk kemi frikë nga asnjë tufan, jo! — thërriste një zë aty nga mesi i turmës.

Shtrëngata vazhdoi për një copë herë të gjatë dhe, kur ajo pushoi, secili zuri vendin e vet.

Darkën e hëngrën ashtu siç i kishin dhënë fjalën njëri-tjetrit, kolektivisht, duke u ulur andej-këndej nëpër baraka mbi copa dërrase apo stola të sajuar aty për aty nga vëllezërit Ukcama. Punonjësit e ekspeditës dhe kreshnikasit hëngrën një darkë që u shijoi shumë. Ata pinin nga një gllënjikë raki nga shishet



që çarkullonin nëpër barakë, kuvendonin me shoku-shokun, pyesnin për jetën personale të njëri-tjetrit, për njerëzit e familjes, bënin shaka, këndonin dhe tregonin fragmente ngjarjesh nga koha e luftës. Zërin e Bame Toros, që ishte ulur, siç thoshte ai me shaka, krahu për krahu me «udhëheqësin e minierës», e gjithë baraka e dëgjonte me vëmendje. Njerëzit ishin kureshtarë ta shikonin në fytyrë kur fliste ose kur tregonte një histori nga jeta e tij, por ishte e pamundur, sepse i pengonte drita e zbehtë e fenerit që mezi ndriçonte gjysmën e barakës.

Era vërshëllente si e tërbuar nëpër errësirë, ngrinte pluhur dëbore dhe ua përplaste njerëzve në fytyrë; herë-herë ajo pushonte fare dhe kudo vendosej për-kohësisht një qetësi e akullt. Por nga të gjitha këto njerëzit as që donin t'ia dinin. Pasi e bënë qejfin e tyre, e festuan, ashtu siç mundën, ditën e parë të punës në minierën e re, u ngritën dhe, duke i thënë «natën e mirë» njëri-tjetrit, u ndanë në dy grupe: punonjësit e ekspeditës qëndruan në kantier, ndërsa kreshnikasit shkuan për të kaluar natën e gjatë të dimrit pranë vatrave të tyre.

Një gjysmë ore më vonë kantieri ra në qetësi.

Vetëm në teqenë e baba Ali Çakmaxhianit kishte ende dritë. Dervishët që ishin mbledhur në teqe, kishin ardhur me shumë mundime nga të dhjetë fshatrat e krahinës së Kreshnikës. Atyre u ishte dashur të bënin një rrugë të gjatë nëpër dëborë e suferinë.

Në kohën që baba Ali Çakmaxhiani po u jepte atyreve disa porosi të posaçme, befas trokiti dera. Kjo ishte një vizitë aq e papritur, sa që baba Aliu lëshoi një klithmë, pas së cilës iu desh një copë herë e gjatë që të merrte veten.

— Po ju sjell një peshqesh! — thirri njeriu që u shfaq papritur te pragu i derës.

Ishte Ramë Sheldia, i mbuluar me ngricë nga koka deri te këmbët.

— Ja tek është! — thirri ai, duke tërhequr zvarrë

dy sorkadhe të vrara, të lidhura bashkë në këmbët e mbrapme.

Dervishët u gëzuan pa masë. Edhe baba Ali Çakmaxhianit iu bë qejfi.

— Këto peshqeshe i kemi nga ky njeri, i cili do të jetë sonte mysafiri juaj! — thirri Ramë Sheldia dhe bëri një hap prapa.

Të pragu i derës u duk një burrë i shkurtër, që mbante peliçe të zezë meshini, çizme të gjata deri mbi gju dhe një kësulë konike prej gëzofi.

Baba Ali Çakmaxhiani u drodh përsëri nga frika. Dervishët qëndronin si të ngrirë para tij.

— Tungjatjetani! — tha vizitori i panjohur me një zë të fortë, që kumboi gjithandej.

Sytë e tij, gati të padukshëm, shkëlqenin në një mënyrë të panatyrshme.

— I merrni këto! — urdhëroi ai dy dervishë që ndodheshin më afër derës.

Baba Ali Çakmaxhiani vazhdonte të rrinte si i ngrirë në këmbë. Ai nuk po e kuptonte ende se çfarë po ndodhte në teqenë e tij.

— Natën e mirë! — tha Ramë Sheldia. — Ky ishte misioni im, të tjerat do t'jua thotë mysafiri juaj i nderuar.

Ramë Sheldia u largua me shpejtësi.

Jashtë nata ishte shumë e errët. Diku në afërsi të oborrit të teqesë prisnin në këmbë tri hije të zeza.





## AGIMI I DITËS SË RE

Kristaq Dvoranit i doli gjumi që pa gdhirë mirë. Ai hapi sytë dhe vuri re se të gjithë anëtarët e ekspeditës po flinin. Në njërin krah të ndërtesës së vjetër të hanit kishin radhitur dyshekët e tyre tre minatorët e rinj, Martin Reka dhe Zaçe Çapoku, ndërsa në anën tjetër ishin shtrirë ai dhe Bame Toroja.

Tek po vështronte nga dritarja e vogël e ndërtesës së hanit shpatin e malit të lartë të Kreshnikës, i shkoi mendja te Margarita. Ai e përfytyroi atë turbull e duke fjetur në krevatin e madh prej dru arre, ndërsa Rudinën e vogël duke luajtur me doçkat e saj nëpër gjysmerrësirë. Ora ishte pesë e tridhjetë minuta.

Çfarë po bën, pikërisht tani, Margarita? mendoi Kristaq Dvorani. Mos vallë edhe ajo është zgjuar dhe po mendon për mua? Kjo ishte një çështje që nuk mund të përcaktohej me hamendje. Ai ishte pothuajse i bindur se, meqë ishte hera e parë që ai e linte të shoqen vetëm në mes të Tiranës, ajo do të ishte mërzhitur së tepërmi. Si të bëj? tha me vete. A ka vallë ndonjë dhomë këtu në Kreshnikë, të cilën të na e japin qoftë edhe provizorisht, sa të ndërtojmë disa baraka, si ajo që ngritën dje vëllezërit Ukcama? Sigurisht që do të ketë, tha prapë me vete. Iu kujtua shtëpia e madhe e Ramë Sheldisë. Ai, me siguri, mund të



më japë ndonjë dhomë me qira, tha, por... ai njeri... Pastaj... prejardhja e tij disi e ngatërruar... xhandar në gardën e Ahmet Zogut... Kjo ishte punë që s'bëhej. Vendosi që këtë çështje ta bisedonte me kryetarin e këshillit pas dy ose tri ditësh. Në qoftë se do të rregullonte një dhomë, ai do të shkonte ta merrte menjëherë familjen e ta sillte në Kreshnikë. Dy-tri herë përsëriti me vete emrin e vogëlushes, duke e ndarë në rrokje: Ru-di-na! Ky emër, ndoshta, nuk do të tingëllonte aq bukur, po të mos ishte emri i së bijës, të cilën e donte aq shumë. Rudina. Rudina. Rudina. Ky emër, jashtëzakonisht i bukur për veshin e Kristaqit, jehoi diku në thellësi të ndërgjegjës së tij.

Nëpërmjet dritares së vogël të «ndërtesës së administratës» (kështu e kishte quajtur një ditë më parë hanin e vjetër njëri nga minatorët e rinj) dukeshin si në ekranin e kinemasë një pjesë e shpatit të mallit të lartë të Kreshnikës, Kreshta e Vdekjes, humnera që ndodhej nën të, e cila priste e përcillte orë e çast ortekët e llahtarshëm që zbrisnin nga lart plot zhurmë, si dhe rrugica që kishin hapur një ditë më parë kreshnikasit deri në rrafshin ku mendohej të bëhej shpërthimi i parë. Atje, diku nën masën e bardhë të dëborës, tha me vete ai, ndodhet edhe motokompresori. Çfarë do të kishte ndodhur vallë gjatë natës? A do ta gjenin në vendin e vet motokompresorin? Mos vallë e kanë marrë me vete ortekët e përbindshëm që zbrisnin nga Kreshta e Vdekjes? Jo. Një gjë e tillë nuk mund të ndodhte, sepse ai ishte i rëndë dhe nuk mund të shkulej aq lehtë nga vendi. Shumë-shumë ai mund të ishte mbuluar me togje dëbore, gjë që s'prishte edhe aq punë. Kreshnikasit do ta përhapnin dëborën e bardhë sapo të mbërrinin në vend dhe do ta nxirrnin në shesh shtratin e stërgjatë të motokompresorit.

Herë pas here, nga drejtime të ndryshme, herë më të mprehta, herë më të shurdhëta, vinin zhaurimat

nga Kreshta e Vdekjes. Ai ishte pothuajse i bindur se kjo ishte zhurma e ortekëve që zbrisnin nëpër humnerë dhe përplasheshin me forcë poshtë në shtratin e Përroit të Thatë. Po nuk përjashtohej mundësia që këto të ishin edhe shkarkime elektrike, të shkaktuara nga përleshja e reve me ngarkesa të kundërta, gjë që sipas vendasve donte të thoshte se dimri do të bëhej përherë dhe më i egër.

Ç'kohë e keqe, — tha me vete Kristaq Dvorani dhe befaz e në mënyrë të pavetëdijshme i shkoi mendja te ngatërresat që kishin ndodhur kohët e fundit në hekurudhën Durrës-Peqin dhe Durrës-Tiranë.

Shokët flinin. Bame Toroja kishte mbuluar edhe kokën me batanije, ndërsa Baudin Kazazi kishte marrë një pozë të panatyrshme e disi qesharake. Syzet e tij optike me skelet metalik ngjyrë ari, për të cilat kujdesej aq shumë, i kishte varur në një gozhdë që s'dihej se kush e kishte ngulur aty prej kohësh. Në anën tjetër tre minatorët, Martin Reka dhe Zaçe Çapoku po bënin, si i thonë fjalës, një gjumë për shtatë palë qejfe.

Në drejtim të Kreshtës së Vdekjes u dëgjua përsëri një gjëmim i fuqishëm. Ra edhe një ortek tjetër dëbore, mendoi Kristaq Dvorani. Duhet të ngrihem, tha prapë me vete. Ai nuk mund të qëndronte më në shtrat kundër vullnetit për të pritur agimin e ditës së re. Ishte më mirë të ngrihej, të dilte jashtë, të lante fytyrën me ujë dëbore dhe pastaj të merrej me diçka, derisa të zbardhte plotësisht drita.

Ai mendoi të përpunonte në mendje planin e punës për ditën e dytë si dhe kush do ta vinte në funksionim motokompresorin, në ç'sektor mund të punohej më mirë për hapjen e vrimave, sa lëndë eksplozive do të përdornin në shpërthimin e parë, në mënyrë që... Ai do të jetë një shpërthim... jehona e të cilit do të dëgjohet tejmbanë Grykës së Suferinës... në tërë Shqipërinë... në tërë...

Kristaq Dvorani i qe afruar derës dhe po kërkonte nëpër errësirë llozin që kishin sajuar për ta



mbajtur atë të mbyllur. E gjeti, e hapi me kujdes dhe e tërhoqi pas; duke ecur me majat e këmbëve, sepse nuk donte t'ua prishte gjumin shokëve të ekspeditës. Doli jashtë. Një copë herë të gjatë qëndroi në këmbë para ndërtesës, duke vështruar në të majtë dhe në të djathtë të kantierit. Ai vuri re se edhe xhipsi «flinte» përkrah kamionit, si të ishin vëllezër të një nëne. Hëpërhë kjo është prona socialiste e minierës sonë, mendoj ai. Pa e kuptuar edhe vetë ai kishte filluar të ecte nëpër kantier. Jashtë bënte shumë ftohtë. Megjithëse jaka e gjerë e kapotës e mbronte shumë nga era, majat e veshëve, dhe pak më vonë maja e hundës, filluan t'i skuqeshin. Nëpër kantier dhe tutje në xhade, sa i hante syri, nuk pa frymë njeriu. Ngri-ti sytë nga Kreshta e Vdekjes dhe vuri re se po agonte. Ndriçimi i ditës së re po përhapej gjithandej me shpejtësi. Ai e kishte lënë pas kantierin dhe po ecte ngadalë nëpër xhade, drejt fshatit të Kreshnikës. Majat e mprehta të shkëmbinjve dhe pishat e bredhat e lartë që dukeshin aty-këtu nëpër shpatin e malit të Kreshnikës, ishin ngarkuar me dëborë. Ata dukeshin sikur ishin të pakënaqur nga pesha e rëndë që mbanin mbi supe.

Pamja mahnitëse po ia shtonte ndjenjën e vetmisë. Tek po ecte ngadalë, në qejfin e tij, me jakën e gjerë të kapotës ngritur përpjetë dhe me kasketën ngjeshur gjer të veshët, dëgjoi një zhurmë të largët, e cila për një çast i duk se vinte nga teqeja e baba Ali Çakmaxhianit. I erdhi inat me veten e tij që nuk kishte qenë në gjendje të përcaktonte se ç'loj zhurme ishte dhe nga kishte ardhur. Në të vërtetë frynte një erë e lehtë, por e ftohtë, e cila të gënjente. Kishte mundësi që zhurma të kishte ardhur nga ndonjë drejtim tjetër, kurse atij i qe dukur sikur kishte ardhur nga ana e teqesë. Kur zhurma u përsërit, ai e uli menjëherë jakën e kapotës, me qëllim që të dëgjonte sa më mirë. Po, ai ishte gabuar. Zhurma nuk vinte nga teqeja e baba Ali Çakmaxhianit, por nga disa shtëpi që ndodheshin në periferi të Kreshnikës. Duke iu af-

ruar përherë e më shumë fshatit, ai mundi të përcaktonte karakterin e zhurmave. Ato ishin zëra njerëzish që thërrisnin njëri-tjetrin për t'u grumbulluar, me qëllim që të shkonin diku. Ndoshta janë kreshnikasit që bëhen gati për të ardhur në minierë, mendoi ai. Po aty për aty ndërroi mendje, sepse ishte ende herët, s'kishte se si të ndodhte një gjë e tillë. Kur u ngjiti mbi një bregore, duke çarë me kujdes dëborën e madhe, vuri re se rruga që të çonte për në teqenë e baba Ali Çakmaxhianit ishte plot gjallëri. Me dhjetëra njerëz me kazma e lopata në krah, bile edhe kafshë të ngarkuara, me sa dukej me materiale ndërtimi, po shkonin drejt teqesë. Kjo ishte me të vërtetë një gjë e çuditshme. Kryetari i këshillit të lokalitetit, Burhan Kola, nuk i kishte folur për ndonjë aksion tjetër më të rëndësishëm, sesa puna në minierën e kromit. Ç'të kishte ndodhur vallë gjatë asaj nate të gjatë dimri? Ku shkonin tërë ato forca?

Diku po shkojnë, tha ai me vete. Mos vallë është bllokuar ndonjë rrugë dhe ata po shkojnë për ta hapur? Mos vallë është vënë në rrezik jeta e ndonjë fshati të afërt dhe ata shkojnë të shpëtojnë njerëzit? E ku të shkonin gjetkë me kazma e lopata në duar, me kafshë të ngarkuara me lëndë ndërtimi në një kohë kaq të keqe? E gjithë rruga ishte e mbushur me zëra që tregonin se ata ishin të shqetësuar për diçka, ndaj edhe përpiceshin të ecnin sa të ishte e mundur më shpejt. E çuditshme ishte se ndërmjet turmës që shtyhej me shpejtësi drejt teqesë kishte edhe mjaft gra. Dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta më vonë u shfaqën papritur në rrugë mjaft forca të rregullta ushtarake që marshonin në të njëjtin drejtim. Kjo ia shtoi edhe më shumë kureshtjen Kristaq Dvoranit. Për çudinë e tij ushtarët kishin helmata në kokë, armët i mbanin krahaqafë, ndërsa në duar mbanin kazma e lopata. Aty nga fundi i autokolonës ai pa tre-katër oficerë, hipur në kuaj, që po nxitonin për të dalë në krye. Autokolona e kishte lënë në të majtë teqenë e baba Ali Çakmaxhianit



dhe tani po zhdukej nëpër grykën që çante midis dy vargmaleve.

Ai ndjeu se e tërë qenia e tij po vihej pak e nga pak në gjendje alarmi. Për një çast kureshtja e jashtëzakonshme e shtyu që të zbriste poshtë, në xhade, për të pyetur se ku po shkonin tërë ato forca. Mirëpo, si u mendua një copë herë, ndërroi mendje. Ndoshta ato janë mobilizuar për të kryer ndonjë stërvitje ushtarake sekrete, tha me vete.

Ai vështroi përsëri rrugën, përmes së cilës ecte me hap të rregullt autokolona ushtarake. Tani drita kishte rënë gjithandej dhe njerëzit dalloheshin mirë. Nga fshati vazhduan të vinin forca civile. Befas veshi filloi t'i kapte fragmente bisedash që bënin fjalë për ndërtimin e një ure dhe për hapjen e një rruge strategjike.

Kristaqi u mundua të kapte fragmente të tjera bisedash. Ai dëgjoi disa shprehje si «forcat monarko-fashiste», «anglo-amerikanët janë shtruar këmbëkryq në Greqi» etj., por as këto nuk e ndihmuan që të nxirrte një konkluzion të saktë për atë që po ndodhte. Autokolona ushtarake dhe grupet e fundit të kreshnikasve u zhdukën nëpër luginën që futej thellë ndërmjet dy vargmaleve të larta.

Në të hyrë të kantierit Kristaq Dvorani u përplas ballë për ballë me Bamë Toron. Ai dukej pak i alarmuar, sepse, siç dukej, e kishte kërkuar atë në të katër anët dhe nuk e kishte gjetur. Përpara ndërtesës së administratës ndodheshin Baudin Kazazi, Martin Reka dhe tre minatorët e rinj, të cilët po dëgjonin muzikë festive që transmetonte Radio Tirana.

— Hë? — ia bëri Bame Toroja, kur e pa shefin e kantierit. — Kam kaq kohë që po të kërkoj? Ç'u bëre? Nga ishe kështu që pa gdhirë mirë? Si je?

Ai lëshoi një breshëri pyetjesh kontradiktore. Kristaq Dvorani nuk dinte nga t'ia mbante dhe cilës pyetje t'i jepte përgjigje më parë?

— Ku isha? — tha i hutuar ai, ndoshta më shumë nga ato që kishte parë dhe kishte dëgjuar tutje në xhade, sesa nga pyetjet e ngatërruara që i bëri Bame Toroja. — Bëra një shëtitje! — u përgjigj ai pas pak me buzë në gaz.

— Si? Shëtitje?! — pyeti përsëri Bame Toroja.

Kristaq Dvorani u mundua të vinte përsëri buzën në gaz.

— Ti diçka ke! — tha Bame Toroja. — Nuk i ha kollaj unë këto shëtitjet e tua që pa u gdhirë. Pa më thuaj, si e ke hallin?! Përse u zgjove kaq herët sot? Ç'djallin ke? Më thuaj? Apo... mos të mori malli për vogëlushen që ke lënë në Tiranë! Se, helbete, jeni të rinj ju dhe... Po s'ma merr mendja, se nuk je nga ata tipa ti! Ty diçka tjetër të mundon! Hajde, fol!

Kristaq Dvorani ia plasi gazit. Punonjësit e ekspeditës nuk e kishin parë atë që të qeshte në atë mënyrë. Ata u kthyen nga «udhëheqja e minierës» (kështu i kishin quajtur me shaka këta të dy, meqenëse i shikonin herë pas here të rrinin bashkë) dhe po ndiqnin me vëmendje çdo lëvizje të tyre. Martin Reka e uli radion.

Kristaq Dvorani i dha fytyrës së tij simpatike gradualisht një pamje serioze.

— E di si është puna? — i tha ai Bame Toros. — Ç'është e vërteta, mua më doli gjumi shpejt dhe, ngaqë u mërzita, duke pritur agimin e ditës së re shtrirë në shtrat, dola jashtë dhe nisa të bëj një shëtitje. Kur po ecja nëpër xhade, pasi dëgjova në fillim disa zhurma, pashë të mbushej rruga që të çon në teqenë e baba Ali Çakmaxhianit plot me forca civile dhe ushtarake.

Ai donte t'i tregonte edhe për dyshimet që i kishin lindur pas copave të shkëputura të bisedave që kishte dëgjuar pak më parë, po aty për aty ndërroi mendje.

— Sot, — vijoi të thoshte ai, — ka mundësi që të mos na vijjë forca për ndihmë, mbasi, me sa pashë, i tërë fshati ishte mobilizuar dhe po shkonte drejt grykës që kemi përballë.



— Hm! — ia bëri Bame Toroja. — Kjo nuk duhet të jetë kaq e thjeshtë, diçka fshihet pas tërë kësaj zalla-mahie...

Ai përfytyroi lëvizjen e autokolonës së përbërë prej forcash ushtarake dhe civile dhe pastaj buzëqeshi me vete. Kjo ishte nga ato buzëqeshje që mbartin me vete peshën e rëndë të një mendimi misterioz... Sapo ishte ngritur, ai i kishte thënë Martinit që të hapte radion, me qëllim që të dëgjonin lajmet e mëngjesit. Spikeri i Radio Tiranës, pasi kishte dhënë si zakonisht pasqyrën e shtypit të përditshëm, ishte ndalur për të përshkruar atmosferën festive që kishte përfshirë të gjithë vendin me rastin e fushatës së zgjedhjeve. Rezultatet e votimeve nuk i kishte dhënë, për arsye se duhej të ishin njoftuar një ditë më parë. Spikeri tjetër kishte kaluar në lajmet e jashtme. S'kishte ditë që radioja dhe shtypi të mos jepnin lajme për gjendjen në Greqi. Ndërsa nga njëra anë viheshin në dukje sukseset e forcave të Ushtrisë Demokratike Greke, nga ana tjetër theksohej tërbimi i paparë i monarko-fashistëve grekë, të cilët, siç thoshin lajmet, kishin filluar të përdornin mënyrat më çnjerëzore për të frikësuar e masakruar popullin grek. Siç theksonte një lajm i freskët i mëngjesit një ose dy ditë më parë, diku në Greqinë e Veriut disa forca monarko-fashiste greke kishin mbushur katër makina me gra, fëmijë dhe pleq të pafajshëm dhe i kishin vënë përpara autokolonës së tyre për të çarë rrethimin dhe për të kaluar nëpër një zonë të minuar nga forcat partizane greke.

— Dëgjova përsëri lajme qysh në mëngjes, — tha Bame Toroja me një pamje të menduar, — dhe vura re se gjendja në Greqi është tepër e acaruar. Politikanët e Athinës po e mbysin në gjak popullin grek, me qëllim që të gjunjëzojnë forcat e Ushtrisë Demokratike; në të njëjtën kohë ata po intensifikojnë provokacionet në drejtim të kufirit tonë. Sot kishin qëlluar me top në tri-katër drejtime. Në disa fshatra të Leskovikut kishin dëmtuar mjaft shtëpi banimi. Për këto krime më shkruante para dy

muajsh edhe djali, Turabiu. Ka ca ditë që nuk kam marrë asnjë letër prej tij. S'di se pse nuk po më shkruan.

Kristaq Dvorani po e ndiqte me vëmendje bisedën. Ato që thoshte Bame Toroja kishin diçka të përbashkët me fragmentet e shkëputura të bisedave që kishte dëgjuar herët në mëngjes. Nuk është e mundur, tha me vete. Gjendja në Greqi është tepër e acaruar dhe kjo është më se e vërtetë. Dihet gjithashtu se prapa qeveritarëve të Athinës fshihet dora e anglo-amerikanëve. Por, që të sulmojë Greqia Shqipërinë në këto rrethana, kjo më duket e vështirë. Tepër e vështirë, mendoj pas pak ai. Këtu ka diçka tjetër më të tmerrshme, tha prapë me vete.

— Duhet të fillojmë nga puna! — tha Kristaq Dvorani pas një heshtjeje të gjatë. — Me sa duket, ata nuk do të vijnë. Sot ne do të mbështetemi te forcat që kemi. Kryesorja është që të vëmë në funksionim motokompresorin dhe të fillojmë nga hapja e vrimave. Na ka mbetur shumë pak kohë në dispozicion.

Ai po e vështronte Bamen në bebëzën e syrit. Duke parë nofullat katrore e tërë muskuj të Bame Toros, ai krijoi përshtypjen se ato mbanin brenda tyre një urrejtje të madhe për dikë.. për dikë... gjë për të cilën nuk po vendoste dot, nëse duhej ta gëlltiste apo ta zbraste...

— Dakord! — tha pas pak ai. — Ashtu të veprojmë!

Dhe e tërë qenia e tij u gjallërua papritur, sikur ta kishte komanduar ndokush me sustë.

Kristaq Dvorani nuk tha gjë. Ai e ndoqi atë nga pas në heshtje.



## PRANË MOTOKOMPRESORIT

Në orën shtatë e pesë minuta të gjithë punonjësit e ekspeditës ishin në sektorin ku po përgatitej shpërthimi i parë. Motokompresorin e gjetën në gjendje të mirë, gjë që i gëzoi pa masë. Dëborën që kishte rënë mbi të gjatë natës e hoqën me kujdes derisa e zbuluan plotësisht. Motokompresori, me shtatin e tij të stërgjatë, duke sikur thoshte: Jam gati të hidhem në sulm!

Bame Toroja rrinte pranë Martinit, duke mos ua hequr sytë duarve të tij të shkathëta, që po shtrëngonin disa vida.

— E, si duket? — tha ai. — A do ta vëmë në funksionim?

— Si jo! — u përgjigj Martin Reka.

Zaçe Çapoku tundi kokën i pakënaqur.

— Po ti. ç'mendon? — pyeti Bame Toroja duke u kthyer nga ai.

— Kush, unë?

— E de, ti, ti!

— Unë them se do të hamë dynjanë!

— Pse?

— Si pse? Aq kollaj ndizet motori në një të ftohtë të tillë?

Bame Toroja uli përsëri sytë nga Martin Reka, i cili ishte shtrirë në dëborë për të shtrënguar më mirë disa vida që ndodheshin në pjesën e poshtme të motokompre-

sorit. Ai, mbasi vështroi duart e Martinit që punonin pa pushim, ngriti kokën për të parë se ç'po bënin tre minatorët e tij. Një copë herë ai qëndroi pa lëvizur, kurse pastaj fërkoj zverkun me pëllëmbën e dorës dhe tha:

— Do ta kemi pisk, në qoftë se nuk do të vëmë shpejt në funksionim motokompresorin. Puna me baromina dore ecën shumë ngadalë.

Martin Reka nxori kokën nën barkun e motokompresorit.

— Për një gjysmë ore motokompresori do të buçasë! — tha ai.

Zaçe Çapoku qeshi nën hundë.

— Pse qesh në atë mënyrë? — tha Bame Toroja.

— Habitem, — tha, — habitem me angazhimet e guximshme!

Martin Reka qeshi me vete.

— Siç duket, ti nuk do të vësh mend! — tha Bame Toroja gjithë seriozitet.

— Bëra shaka, bëra shaka! — tha Zaçe Çapoku, ndër-sa po mundohej të vinte disa gurë nën motokompresor.

Me bishtin e syrit Bame Toroja po shikonte lëvizjet e kota që po bënte Zaçe Çapoku, gjë që tregonte se ishte akoma në mëdyshje nëse duhej t'i vinte apo jo gurët nën shasinë e motokompresorit. O dembeli i m... tha me vete Bame Toroja. Të dh... mu në punën tënde. Do të bëje mirë të thyeje qafën që këtej, se më shumë na pengon sesa na ndihmon me ato duar që i ke vetëm për të... Bame Toroja ishte gati që t'ia thoshte me zë të lartë tërë këto fjalë, të cilat, siç vazhdonte të thoshte me vete ai, Zaçe Çapoku i meritonte plotësisht. Por ç'të bënte? Kishte frikë se nuk do ta përmbante veten, do t'i ngriheshin nervat, do ta shante me fjalorin më të ndyrë dhe pastaj do t'i thoshte me tërë mend: «Qërohu që këtej!» Mirëpo kjo nuk ishte një gjë e mirë as për kolektivin e ekspeditës e as për atë si komunist i vjetër. Bame Toroja po e përmbante me shumë vështirësi veten. Tërë këto mendime i kishte mu në majë të gjuhës. Mjaftonte vetëm një ngacmim i vogël nga ana e Zaçe Çapokut që ai të shpër-



thente me tërë forcën e tij. Tjetër njeri ishte Martin Reka. Ai ishte shofer ashtu si ishte edhe Zaçe Çapoku, po s'kishte asgjë të përbashkët me të. Zaçe Çapoku ishte një skërfyell i gjatë me ca leshra të drejta porsi gjambat e iriqit, ndërsa Martin Reka kishte një shtat mesatar, të drejtë si qiri, një fytyrë simpatike dhe ishte të paktën katër ose pesë vjet më i vogël se Zaçe Çapoku. Ndërsa ky ishte, siç thoshte vazhdimisht me vete Bame Toroja, një dembel Stambolli, Martin Rekës çfarë s'i zinin duart. Mund të thoshe pa frikë se në tërë kolektivin e ekspeditës ai ishte i vetmi njeri që fliste shumë pak dhe që kurdoherë do ta shihje duke u marrë me një punë. Ishin pikërisht këto arsye që e kishin bërë Bame Toron ta donte atë me gjithë zemër, njëlloj siç donte djalin e tij të madh, Turabiun. Sa të mbarojë ushtrinë, i kishte thënë një natë më parë Martinin, dhe do ta sjell këtu në minierë edhe Turabiun. Dua ta bëj minator. S'ke ide se ç'punëtor që është! Ja kështu, porsi ti. S'lë gjë pa bërë. E dua shumë. Kur të shikoj ty, më duket sikur kam para syve Turabiun. Katër fëmijët e tjerë (tri vajza dhe një djalë) i kam të vegjël, ndërsa një djalë tjetër, më i madhi, u vra gjatë luftës. Që ditën e parë që doli në mal me ca shokë ra në përpjekje dhe... Këtë fat pati edhe im atë, i kishte thënë ai Bame Toros. Bashkëpunonte me njësitet guerile. Forcat gjermano-balliste e diktuan. Një ditë na erdhën në shtëpi befas. Shtëpinë na e dogjën; mua, nënën, një vëlla të vogël dhe gjyshen që më vonë vdiq na nxorën në mes të katër rrugëve, ndërsa atë... e morën me vete. Tre ose katër ditë më vonë e gjetën të vrarë diku nga kodrat e Tiranës. Na njoftuan disa komshinj që e kishin parë rastësisht. Kur shkua në vend... ç'të shikonim... Fytyrën dhe trupin e kishte tërë plagë... Duket qartë se e kishin torturuar në mënyrë çnjerëzore... E varrosëm po aty ku e kishin hedhur bishat e pangopura. Kur ia kishte treguar Bame Toros këtë histori të kobshme, atij i qenë mbushur sytë me lot. S'ke ç'bën, i kishte thënë Bame Toroja, si për ta ngushëlluar. I ka lufta këto. Dhe kështu ishte mbyllur kjo bisedë një natë më parë

diku në afërsi të barakave, fill pasi ishin ndarë me kreshnikasit.

Martin Reka u ngrit në këmbë, duke hequr dëborën që i ishte ngjitur pas trupit. Bame Toroja e vështronte me kënaqësinë e një prindi që krenohet për të birin.

— E, — i tha. — E rregullove?

Martin Reka qeshi, ndërsa Bame Toroja i rrahu shpatullat, e kapi për qafe dhe ia afroi kokën në gjoksin e tij. Atij iu kujtua ngjarja e hidhur e të atit dhe aty për aty iu bë një lëmsh në grykë.

— Do ta ndezim? — i tha, duke hedhur sytë nga motokompresori.

— Si jo? Ja tani! Vetëm se dua të kontrolloj diçka këtej, në anën tjetër.

Zaçe Çapoku po afronte ca gurë të tjerë për t'i vënë nën shasinë e motokompresorit.

— Hë? — ia bëri Bame Toroja, duke dashur që t'i jepte kurajë edhe atij.

— Duhet ngritur edhe ca nga toka, — tha Zaçe Çapoku.

— Këtu duhet të ngremë një ndërtesë për ta mbrojtur nga erërat dhe dëborat, — tha Martin Reka.

— Patjetër, — tha Bame Toroja, — por tani për tani duhet ta ndezim, me qëllim që të vëmë në funksionim pistoletat. Vetëm me baromina dore nuk bëhet punë!

— Duhet ngritur sa më parë edhe ndërtesa, — tha përsëri Martin Reka, duke bërë një gjest, që donte të thoshte se kjo ishte një gjë me të vërtetë e domosdoshme.

— Së shpejti do ta fillojmë! — tha edhe Bame Toroja.

Tre minatorët vazhdonin të hapnin vrima të reja me baromina dore. Gusi ishte i fortë dhe ata punonin duke bërë zhurmë. Njëri prej tyre, pikërisht Adushi, kishte kaluar përtej shkëmbit dhe ishte futur disa metra në zonën që ishte konsideruar e rrezikshme për shkak të ortekëve të dëborës. Bame Toroja po e vështronte atë me një pamje qortuese në fytyrë.



Kur Martin Reka bëri provën e parë për të ndezur motokompresorin, Bame Toroja pa orën e tij të xhepit. Ishte shtatë e tridhjetë minuta.

Sapo të fillojë të buçasë motokompresori, ne do të vëmë në funksionim pistoletat, tha me vete Bame Toroja.

Ai u nis në drejtim të minatorëve për të përcaktuar frontin e ri të punës.

Në provën e parë motokompresori nuk dha asnjë shenjë.

Kristaq Dvorani ishte ende poshtë në kantier. Bame Toroja u mundua të hidhte një sy nga kantieri për të parë se çfarë po bëhej, po nuk ia arriti qëllimit. Kantieri nuk dukej, sepse shpati i malit ishte i ngritur dhe nuk lejonte të shikoje deri poshtë në xhade.

Qielli po mbushej përsëri me re dëbore.

## NË KULLËN E UJKAN SHKABËS

Hajrija me shoqet e veta qysh herë në mëngjes shkoi për të takuar Katerinën. Ato e ngjitën rrugën e përpjetë plot akull e dëborë pothuajse me një frymë, se donin të mësonin sa më parë se çfarë kishte ndodhur në mbrëmje me të, pasi ajo ishte kthyer në shtëpinë e saj.

— Të rrahën? — e pyeti menjëherë Hajrija kur u siguruan mirë, duke e kyçur derën e dhomës nga brenda.

Katerina tha «jo» me kokë. Ajo po përpiqej t'i fshihej vështrimit të syve të shoqeve të saj, prandaj një copë herë të gjatë qëndroi kokulur e duke përdredhur leshrat e saj të verdha rreth gishtit tregues.

— Hë de, fol! — nguli këmbë Hajrija.

— S'kanë përse ta rrahin, — tha Maria gjithë seriozitet. — Tani ne jemi në pushtetin popullor...

— Hë de, fol! Ç'ndodhi mbrëmë me ty? — ngulte këmbë Hajrija. — As neve, shoqeve të tua më të ngushta, nuk na tregon të vërtetën?! Të të them sinqerisht, mbrëmë nuk kam fjetur tërë natën nga shkak i asaj që ndodhi në kantier... Na e nxori gëzimin nga hundët, i poshtri! Sa keq më erdhi për ty, se je aq e mirë... aq e sjellshme sa...

Katerinës iu mbushën sytë me lot.

— Do t'i them Sokolit, — tha Hajria, — dhe ta dish se ky është një budallallëk që nuk falet... Pse qan?

Vajza ngriti sytë e saj bojë qielli dhe buzëqeshi. Fytyra e saj e pastër po qetësohej e po bëhej përherë e më e gëzueshme.



— Hajde! — ia bëri Hajrija, duke i rënë me bërryl në ije. — Fol, se më plase! Si u zhvilluan ngjarjet mbrëmë?

Katerina qeshi përsëri, po kësaj radhe me zë, sepse dukej po gudulisej nga bërryli i Hajrijes, që vazhdonte t'i qëndronte nën sqetull.

— O, edhe këto? — tha duke u shkrirë së qeshuri. — Fol, më thonë, sikur të jem... Ç't'ju them? Ja, të njëjtën gjë më bënë edhe mbrëmë, — tha ajo, duke marrë menjëherë një pamje serioze, që nuk i shkonte fare fytyrës së saj tepër simpatike. — Më vunë në mes të gjithë, ja kështu si ju tani, dhe pastaj më thoshin: Fol, ku ishit dhe çfarë bëtë me ata dy ushtarët?!

— Po ti çfarë u the? — pyeti e revoltuar Maria.

— Të vërtetën?

— Mirë ua bëre! — ia priti Hajrija.

Kristina vuri buzën në gaz.

— Po pastaj?

— Më mbajtën në këmbë një gjysmë ore, — shtoi ajo me sytë e mbushur përsëri me lot.

— Hë de! Ç'budallaqe që je? Përse qan? Po babai?

— Ai qëndronte në heshtje dhe më shikonte në një mënyrë të tmerrshme.

Ato qëndruan një copë herë në heshtje.

— Kush i hidhte më shumë benzinë zjarrit? — pyeti përsëri Hajrija, duke rrudhur vetullat e saj të trasha dhe fytyrën e saj bullafiqe.

— Ai?

— Cili?

— Xhaxhai, de!

— Ai që të kapi mbrëmë për flokësh?

— Po.

— Po gjyshi?

— Baba Ujkan Shkaba?

— Po.

— Mbrëmë jam çuditur me qëndrimin e tij.

— Pse?

— Qëndronte në qoshe pranë vatrës së zjarrit, thithte vazhdimisht llullën e tij të gjatë dhe nuk fliste pothuajse

fare. Vetëm nja dy herë se ç'i pëshpëriti në vesh babait dhe pastaj e kyçi gojën.

— Ndoshta ishte kundër tërë asaj potereje që kurdisi xhaxhai.

— Jo! Nuk ma merr mendja. Edhe ai është po aq fanatik sa xhaxhai, në mos edhe më shumë, por mbrëmë nuk e di se pse qëndronte në heshtje. Unë mendova se duhet të kishte dy arsye: ose sepse më do jashtëzakonisht shumë, ose sepse hapjen e minierës ai e konsideron si një ngjarje të shënuar në jetën e Kreshnikës. Kjo është një ëndërr imja e vjetër, o burra! po u thoshte dje në mëngjes njerëzve që i çuan lajmin për ardhjen e ekspeditës nga Tirana. Fliste me kaq dashamirësi për minierën e kromit, saqë në dy-tri raste e quajti atë çlirim të dytë të Kreshnikës.

— Ashtu?! — u çudit Hajrija.

— Për kokën time! — u betua Katerina.

Hajrija rrudhi përsëri vetullat e saj të trasha.

— Deri këtu e morëm vesh. Po pastaj? — pyeti ajo.

— Pastaj më thanë që të dilja përjashta. Nuk di se çfarë kanë biseduar më vonë, sepse unë erdha dhe u mbylla këtu në dhomën time dhe qava gati një orë.

— Ç'budallaqe që je! — i tha prapë Hajria dhe i ra me bërryl në ije.

Katerina qeshi me zërin e saj të shkujdesur.

Një copë herë vajzat biseduan për gjëra pa rëndësi dhe pastaj dolën në dritare. Që andej dukej për bukuri sektori ku po punonte ekspedita. Tri-katër herë u dëgjua zhurma e një motori që në çast fikej.

— Po ndezin motokompresorin, — thirri Hajria e gëzuar. — Do vish?

Katerina uli sytë në pragun e dritares.

— Eja me ne.

— Si të them? — tha, si u mendua pak, Katerina.

Hajria rrudhi vetullat.

— Do të vish, se të urdhëroj unë! — thirri ajo. — Pse, as në rrugë nuk do të dalësh ti? Pastaj, tani është ditë, ndryshe është natën... Sot ata kanë shumë nevojë

për ndihmën tonë, sepse gati të gjitha forcat kanë shkuar në punimet ushtarake. Ti e di. Me grupin e të rinjve që u caktuan për të shkuar në minierë ishte edhe Sokol Dinoja. Unë e dëgjova shumë mirë, — tha Hajrija.

Emri i tij sikur ia merrte mendjen sa herë që e dëgjonte. Kishte raste që përpiquej ta largonte nga vetja këtë emër që kishte hyrë vetvetiu në jetën e saj, por nuk mundte. Përkundrazi, se si i dukej; në fillim i vinte një si marrje mendsh, kurse pastaj i bëhej sikur ishte në ëndërr duke vrapuar me Sokolin nëpër rrugët e ngarkuara me dëborë të Kreshnikës plakë. Një gjë e tillë i kishte ndodhur tri-katër herë këto kohët e fundit.

— Mirë! — tha Katerina si në ëndërr.

Vajzat u gëzuan shumë. Ato e rrëmbyen shoqen e tyre nga krahët, hapën derën dhe zbritën vetëtimthi nëpër shkallët e drunjtja të kullës dykatëshe të Ujkan Shkabës.



## NË GATISHMËRI NUMËR NJË

Në orën tetë e dhjetë minuta, në kryqëzimin e rrugëve së fshatit me rrugën që të çonte në teqenë e baba Ali Çakmaxhianit u dukën kreshnikasit, që ishin caktuar të punonin në minierë. Ata ishin kryesisht të rinj dhe në krye kishin sekretarin e organizatës së rinisë së fshatit, Sokol Dinon. Ata ishin më tepër se njëzet e pesë a tri-dhjetë veta. Ishin të gjithë shtatlartë. Me sa dukej, kryetari i këshillit të lokalitetit, Burhan Kola, i kishte zgjedhur nga më të fortët e më punëtorët.

Bame Toroja sapo kishte zbritur nga Zona A e minierës (kështu kishin vendosur ta quanin sektorin ku po përgatitej shpërthimi i parë) për t'i dhënë një raport të shkurtër shefit të kantierit për gjendjen e motokompresorit.

Kur Kreshnikasit ishin gati njëqind metra larg kantierit, Kristaq Dvorani tha:

— Erdhën, por nuk po shikoj midis tyre kryetarin e këshillit të lokalitetit.

Bame Toroja përplasi kapakët e syve që të shikonte më mirë.

— Ndoshta do të ketë shkuar vetë me forcat që shkuan herët në mëngjes në drejtim të rrugës së teqesë.

Në krye vazhdonte të ecte Sokol Dinoja dhe fill pas tij, apo diku në të majtë apo në të djathtë dukeshin vëllezërit Ukcama. Baftjari (ky ishte vëllai i madh) dhe pas-taj të tjerët, Bedriu, Haxhiu, Kamberi dhe Lavdimi. Ata mbanin veshje karakteristike dimërore të krahinës së Kreshnikës: rroba shajaku të bardha me fileto të zezë,

jelek prej lëkure deleje. Për t'u mbrojtur nga të ftohtët, kokën e lidhnin me shami. Ndërmjet tyre dallohej Lavdimi, i cili, si më i riu nga të gjithë vëllezërit, mbante zakonisht pantallona, çizme, bluzë me jakë golf dhe një lëkurë, e cila e mbronte shumë mirë nga të ftohtët.

— Vëllezërit Ukcama qenkan të gjithë! — tha Bame Toroja.

Kristaq Dvorani vazhdonte të vriste mendjen për të gjetur se ku kishin shkuar qysh herët në mëngjes tërë ato forca të mobilizuara nga fshati dhe që u pasuan pak më vonë nga një numër i madh forcash ushtarake.

— Mirë se na erdhët, o burra! — foli i pari Bame Toroja.

Ai bëri disa hapa përpara dhe, mbasi ia dha dorën të parit sekretarit të organizatës së rinisë të fshatit, u takua pastaj me radhë me vëllezërit Ukcama. Ai u dha dorën edhe tre-katër të tjerëve, kurse atyre që nuk kishin mbërritur ende aty, ua bëri me kokë. Të njëjtën gjë bëri edhe shefi i kantierit, të cilit nuk iu durua pa pyetur për marshimin e mëngjesit në drejtim të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit.

Sokol Dinoja u tërhoq mënjanë për t'i shpjeguar situatën, për të cilën i kishte folur në mënyrë të hollësishme kryetari i këshillit të lokalitetit, Burhan Kola. Ai, duke hedhur sytë herë nga shefi i kantierit dhe herë nga Bame Toroja, i tregoi gjithë përmbajtjen e letrës që kishin dërguar në orën dymbëdhjetë të natës shokët e pushtetit popullor me një korrier të posaçëm.

— Çështja është, — tha më në fund ai, — se ne duhet të jemi në gatishmëri numër një! S'dihet se kur mund të fillojë sulmi!

Bame Toroja u mendua një copë herë.

— Ashtu, ë? — ia bëri ai dhe pas pak shtoi: — Le ta provojnë, po të duan! Ne nuk e duam luftën, por... po të na ngacmojnë...

Ndërkohë s'dihej përse i doli para syve Beteja e Mushqetasë. Ndoshta ngaqë kjo luftë ishte beteja e fundit, por edhe më e tmerrshme, ku kishte luftuar si i tër-

buar. I shkoi mendja te Turabiu dhe prapë te Beteja e Mushqetasë.

— Domethënë, sulmi pritet nga Jugu? — pyeti Kristaq Dvorani.

Bame Toroja ishte zemëruar aq shumë nga ky lajm, saqë i dukej se duhej të nisej qysh tani për në luftë.

— Kështu thoshte letra, — shpjegoi Sokol Dinoja. — Sigurisht, të gjitha këto, megjithëse nuk janë thënë në popull për të mos përhapur panik, në një rreth të ngushtë gjërat janë thënë troç. Na u tha gjithashtu se letra është bërë me porosi nga lart.

Në kokën e Bame Toros vazhdonte të gjëmonte Beteja e Mushqetasë.

— O, ç'batërdi! — tha duke murmuritur me vete.

Pas pak u kthye nga Sokol Dinoja.

— Mirë, more djalë, mirë, — tha, — po këtej në Veri përse duhen hapur rrugë strategjike dhe përse duhen forcuar urat, përderisa sulmi pritet nga Jugu?

Sokol Dinoja u mendua pak dhe pastaj tha:

— Sepse që këtej pritet të na vijë ndihma nga Jugosllavia motër... Përveç kësaj rruga që kalon nga Qafa e Humnerës është dëmtuar rëndë nga ortekët; në mjaft vende ka shkarë dheu; kështu që në këto rrethana organet e pushtetit lokal u detyruan të rindërtojnë me urgjencë urën e shkatërruar që nga koha e luftës mbi Përroin e Thatë. S'kishte se si të veprohej ndryshe; kjo ishte e vetmja rrugëdalje për të mos e izoluar krahinën nga jeta e vendit.

Ndërkohë vëllezërit Ukcama kishin filluar nga puna për ndërtimin e barakave, ndërsa pjesa tjetër e forcave kishte marrë rrugën për në Zonën A të minierës.

Bame Toros iu kujtua përsëri Turabiu dhe pastaj Beteja e Mushqetasë, ku u vendos fati për çlirimin e Tiranës.

O, ç'batërdi, tha me vete ai, ndërsa po ecnin të tre në drejtim të barakave.

— Le ta provojnë, po të duan, — tha përsëri, — dhe do të shikojnë se sa u vlen lëkura!

Kristaq Dvorani po ecte pranë tij me një pamje të menduar në fytyrë.



## VËLLEZËRIT UKCAMA

Vëllezërit Ukcama sapo kishin filluar punën. Sipas planit të tyre baraka e parë duhej të përfundonte derisa të ngrysej dhe në të njëjtën kohë duhej të ngrihej, të paktën si karabina, baraka e dytë. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ata kishin bërë edhe njëfarë ndarjeje pune midis tyre. Baftjari, Bedriu dhe Kamberi montonin, Haxhiu sharronte, ndërsa Lavdimi merrej me përgatitjen e dyerëve dhe të kornizave të dritareve. Të pesë vëllezërit ishin, si të thuash, të specializuar në një drejtim të caktuar, por, po të lindte nevoja, ata ishin në gjendje të bënin çfarëdo lloj pune. Në krahinën e Kreshnikës ata ishin të njohur si punues të talentuar të lëndës së drurit.

Në mendjen e Lavdim Ukcamës filloi të ravijëzohej si në ëndërr qyteti i ardhshëm i minatorëve. Një ndërtesë e vjetër hani, dy baraka prej dërrase me çati të stilit gotik, pastaj tri, katër, dhjetëra të tjera mbinë nga dheu në mënyrë të papritur. Rrugët e tij mbushen me zhurmë: zëra, të qeshura, të qara fëmijësh, psherëtim, tringëllima gotash, këngë, biseda të gjata pranë vatrave të ngrohta të zjarrit, çifte të reja nëpër rrugicat gjysmë të errëta, prapë zëra, të qeshura... Jeta e këtij qyteti të drunjte do të ishte e lidhur ngushtë me mineralin e kromit. Sa më shumë mineral, aq më të thella do të ishin edhe galeritë, sa më të thella e të shumta galeritë, aq më shumë do të rritej edhe popullsia e tij. Ai

ishte i sigurt se do të vinte një ditë që Kreshnika, nga një fshat krejt i zakonshëm malor do të shndërrohej në një qytet të madh alpin me pallate të larta shumëkatëshe, me rrugë të shumta, me pisha e bredha, bulevarde, kine- ma, teatro, kafene, restorante, shkolla dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për një qytet të vërtetë. A do të arrinte vallë Kreshnika e tij të bëhej një qytet si gjithë qytetet që ka bota! E përse jo, thoshte me vete Lavdim Ukcama. Të gjitha qytetet që ndodhen sot në botë në fund të fundit jetën e kanë nga fshati. Më parë kanë lindur fsha- trat, pastaj disa nga ato janë shndërruar në qytete. Ndoshta këtë fat do ta provonte edhe Kreshnika e tij. Por, nëse do të realizohej ose jo një ëndërr e tillë kjo varej nga pasuritë. që fshihte në brendësi mali i Kreshnikës. Në qoftë se ai do të ketë rezerva të mëdha kromi, atë- herë domosdo do të shtohej numri i punëtorëve, të cilët bashkë me familjet e tyre do të krijonin një qytet të vër- tetë si të gjitha qytetet. Ka, si s'ka mali i Kreshnikës krom, thoshin pleqtë e fshatit sa herë që binin në biseda të tilla me të parin e tyre, plakun Ujkan Shkaba. Ka, si s'ka përsëriste me vete Lavdim Ukcama dhe si në ëndërr i dilte para syve qyteti i ardhshëm i minatorëve. Nga ba- rakat prej dërrase ne do të shkojmë te pallatet shumë- katëshe, mendonte ai. Papritur ai u drodh. Jashhtë, përtej dritares së hapur, fare pranë barakës, iu duk se pa atë... O, si iu drodh zemra. Ishte me të vërtetë aq e mirë... Asnjëherë nuk kishte gjetur rastin të bisedonte me të. Ndoshta sot, tha me vete. Ajo po vinte bashkë me shoqet e saj, me Hajrijen, Katerinën, Marien dhe me ca vajza të tjera të fshatit. Fërkoji sytë, i rrudhi pak për të parë më mirë dhe një copë herë mbeti si i ngrirë me zdrukth në dorë. Krejt i turbulluar ai po pyeste veten se si duhej të vepronte për t'ia shfaqur dashurinë Ajkunës, ku duhej ta ndalonte, si duhej ta fillonte bisedën. Po në qoftë se ajo... O, jo, jo! Një gjë e tillë s'ka për të ndodhur kurrë. Ai ishte i bindur se edhe ajo mendonte ndoshta të njëjtat gjëra për të, por nuk guxonte... druhej nga shoqet e saj... kishte frikë nga... Do t'ia them, tha me vete ai, do t'ia

them të gjitha... të gjitha... Do t'i them se duhemi ne të dy... le ta marrë vesh i gjithë fshati... le ta marrë vesh... Ndërkohë ajo kaloi fare pranë dritares dhe qeshi... dhe qeshi me të... Ai lëvizi pak nga vendi dhe zgjati kokën për ta parë më mirë. Pranë saj ishin edhe ato... shoqet e saj... Edhe ato qeshën, ndoshta për të njëjtën arsye. Me sa duket dhe ato e dinë që ne të dy... Do t'ua ketë thënë ajo vetë... dhe tani... Ai lëvizi prapë dhe vajzat e kuptuan se ai po vështronte vjedhurazi nga qoshja e dritares. Kjo s'ishte gjë tjetër veçse një lojë e kurdisur me kujdes nga Hajrija. Ai psherëtiu thellë dhe tha me vete se, po të gjente rastin, do t'ia thoshte të gjitha... të gjitha...

Vajzat u drejtuan nga Baftjari, vëllai i tij i madh, si duket për të kërkuar ndonjë punë. Baftjari u tha që të pastronin dëborën nga oborri i kantierit.

Duke qeshur e biseduar me njëra-tjetrën, ato filluan të hiqnin dëborën me lopata. Prania e tyre i dha një gjallëri të veçantë jetës në kantier.

Lavdim Ukcama ra përsëri në mendime. Konturet e qytetit të ardhshëm të Kreshnikës po skicoheshin përherë e më mirë në trurin e tij.



## KËNGA E BAROMINAVE

Në rrafshinën ku përgatitej shpërthimi i parë, puna ziente gjithandej. Bame Toroja me tre minatorët e rinj, Adushin, Faikun dhe Shpëtimin, shtrengonin në gjoks pistoletat që shponin shkëmbin. Zaçe Çapoku kujdesej për motokompresorin që të mos pushonte asnjë minutë, ndërsa Martin Reka dhe tre-katër kreshnikas, ndërmjet të cilëve edhe Sokol Dinoja, vazhdonin shpimin e vrimave me baromina dore. Kristaq Dvorani me katër-pesë kreshnikas që kishin thënë se ishin muratorë, po përpiqeshin të ndërtonin godinën ku do të futej motokompresori. Pjesa e forcave që kishte mbetur ishte ngjitur lart për të prerë lëndë druri për të ngritur çatinë e ndërtesës së motokompresorit si edhe galeritë e ardhshme të minierës së re.

— Kjo është një betejë e vërtetë! — thoshte Bame Toroja.

Zëri i tij mezi dëgjohej për shkak të uturimës së fuqishme të motokompresorit dhe të zhurmës rrëqethëse të pistoletave.

Kënga e barominave zotëronte mbi çdo gjë tjetër. Si të përfundonte shpimi i vrimave që ishin planifikuar nga Baudin Kazazi, do të fillonte vendosja e lëndës eksplozive.

Muratorët që morën përsipër ngritjen e ndërtesës së motokompresorit dukeshin shumë të shqetësuar. Ata kishin provuar disa herë me radhë të gatuanin llaçin që u nevojitej për ngritjen e mureve dhe në të gjitha rastet

kishin dështuar. Llaçi ngrinte menjëherë për shkak të temperaturës së ulët. Herën e fundit ata bënë një provë, duke përdorur ujë të ngrohtë, por edhe kjo u dështoi. Atëherë u detyruan të ngrinin ndërtesën me mur të thatë. Muratorët u bindën se, po t'i vendosnin gurët me kujdes njëri mbi tjetrin dhe t'i lidhnin mirë, ndërtesa s'do t'ia dinte as nga pesha e rëndë e çatisë dhe as nga goditjet e mundshme të ortekeve të dëborës.

## NJË BANDË DIVERSANTËSH

Jashtë kishte rënë nata. Sherif Rubiana i futi të gjitha dokumentet në kasafortë dhe po mendohej se nëpër cilën rrugë duhej të ngjitej për të shkuar në shtëpinë e tij, e cila ndodhej në krye të fshatit, pikërisht aty ku fillonte pyllnaja me pisha dhe bredha të lartë. Rruga më e shkurtër që të çonte për në shtëpinë e tij ishte ajo që kalonte anës Përroit të Thellë, i cili e ndante fshatin përmes; po ajo ishte njëkohësisht edhe rruga më e rrezikshme, sepse nga një pakujdesi e vogël mund të shkisje mbi akull dhe të përfundoje në fund të përroit të mbuluar me dëborë. Armët që u dëgjuan një ose dy orë më parë në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit ia bënë edhe më të vështirë rrugën për në shtëpi. Nëpër fshat dëgjoheshin zëra, por nuk merrej vesh se ç'thoshin. Para zyrave të lokalitetit kaluan disa njerëz të alarmuar nga ndodhia në afërsi të teqesë. Dikush përpiquej t'u shpjegonte atyre se ç'kishte ngjarë. Në të vërtetë ai që fliste sqaroi se nuk dinte asgjë më tepër, përveç asaj që kishte dëgjuar se një njeri kishte mbetur i vrarë!

Në zyrën e Sherif Rubianës hyri befas miku i tij i vjetër, Ramë Sheldia. Ai dukej tepër i lodhur dhe njëkohësisht i shqetësuar. Kjo ia përforcoi edhe më shumë mendimin Sherifit se diçka duhej të kishte ndodhur.

— Hë? — ia bëri, sapo e pa Ramë Sheldinë te dera.  
— Çfarë ka ndodhur?



— Si je? — i tha Ramë Sheldia, në vend që t'i përgjigjej pyetjes së tij.

Tjetri ngriti supet.

— Siç më shikon, — tha. — Pa më thuaj çfarë ka ndodhur? Ç'ishin tërë ato armë andej nga teqeja e baba Ali Çakmaxhianit?

— Hajde të dalim! — tha Ramë Sheldia. — Të tregoj rrugës.

Sherif Rubiana tha «po» me kokë dhe pastaj filloi të vishej me një pamje të menduar në fytyrë. Ai po përpiqej të gjente me mendje se përse e donte Ramë Sheldia e ku kishte ndër mend ta shpinte, në një kohë që tërë fshati ishte në alarm.

— S'ka përse frikësohesh, — tha Ramë Sheldia. — Ti i shërben për bukuri kujtdo që të kërcet dhëmbët më shumë... dhe...

— Të lutem, mos më ofendo!

— E përse po të ofendoj? Ti kështu ke qenë tërë jetën. Gjithmonë... nga ka qenë era më e fortë... Tani që era jonë do të shndërrohet në furtunë... besoj se do të vish me ne...

Jashtë nëpër errësirë vazhdonin të dëgjoheshin zëra. Në përfundim të fshatit u dëgjuan përsëri tri-katër të shtëna armësh. Ata qëndruan një copë herë në heshtje pranë dritares, duke vështruar dritat e zbehta të dy lagjeve të poshtme. Në qendër të fshatit apo diku në afërsi të vatrës së kulturës, duhej të ishin grumbulluar shumë njerëz. Herë pas here dëgjohej edhe troku i kuajve të forcave të ndjekjes që lëviznin nga lindja në përfundim.

— Hë? Ç'do të bësh? — e prishi heshtjen Ramë Sheldia. — Do të vish me mua?

Tjetri ia bëri «po» me kokë, pastaj, duke vështruar poshtë në rrugën e errët që kalonte pranë zyrave të lokalitetit, tha:

— Sigurisht që do të vij! Po ku do të shkojmë?!

— Të zbresim poshtë deri te vatra e kulturës për të mësuar se ç'është tërë kjo rrëmuje. Më duket se edhe ti je i interesuar të mësosh se çfarë ka ndodhur. Apo jo?

Atij iu duk se Ramë Sheldia po i përgatiste një grackë të rrezikshme. Ky maskarai, tha me vete ai, do të më fusë në duart e bandës së Çuman Kokobogos!

— Ke dëgjuar për bandën e kapedan Kokobogos? — i tha pas pak Ramë Sheldia.

Sherif Rubiana u drodh i tëri dhe tha:

— Diçka kam dëgjuar. Thonë se vazhdon të qarkullojë në këto anët tona dhe në disa fshatra ka bërë disa vrasje... grabitje... përdhunime...

Për një sekondë ai e përfytyroi trupin e tij të gjatë të shtrirë në mes të zyrës së grumbullimit dhe të mbuluar me gjak nga plumbat e pistoletës së Çuman Kokobogos.

— Nuk është tamam kështu, — tha Ramë Sheldia, ndërsa po zbrisnin shkallët e drunjta të zyrave të lokalitetit. — Ata kanë hequr qafe disa njerëz, që...

Ata ecën një copë herë krah për krah me njëri-tjetrin, derisa u futën në një rrugicë plotësisht të errët. Mbi muret e vjetruara prej guri në të dyja anët e saj kishte dëborë.

— Kapedan Kokobogojë ka zbritur sot nga malet bashkë me trimat e tij dhe ndodhet këtu rreth e rrotull. Ka mundësi që të jetë edhe brenda në fshat... Forcat e ndjekjes u ndeshën sonte me të dhe...

Sherif Rubiana ndjeu një si marrje mendsh dhe pastaj një përzierje në stomak.

— Atëherë ç'na duhet neve të zbresim poshtë në qendër të fshatit? Eja të shkojmë më mirë në shtëpitë tona...

— Eja pas meje! — tha Ramë Sheldia me një ton urdhërues.

Ai i ktheu shpinën mikut të tij të vjetër dhe filloi të zbriste me kujdes një rrugë të pjerrët. Sherif Rubiana i shkonte pas, duke u mbajtur anës murit të një ndërtese të lartë.

— Mos ki frikë, se asgjë s'ka për të ndodhur! — tha Ramë Sheldia kur dolën në një rrugë tjetër më të gjerë dhe të shtruar me kalldrëm, e cila të çonte në qendër të fshatit.



— Nuk po ju marr vesh, — tha Sherifi me zërin e tij të dridhur. — Ç'është kjo? Ç'na duhet neve të shkojmë nga vatra e kulturës?!

— Si shumë po më dërdëllis! — i tha Ramë Sheldia. — Të jesh i sigurt se s'ka për të ndodhur gjë!

— Nuk është puna aty, por...

Ramë Sheldia kërciti dhëmbët.

— Ç'njeri i çuditshëm?! — tha.

Tjetri vari kokën dhe e ndoqi pas, pa e zgjatur më tej. Ai ishte i bindur se Ramë Sheldia ia bënte të keqen kur të donte, prandaj kundër dëshirës ai ishte i detyruar që t'u bindej urdhrave të tij.

Ç'më gjeti, tha me vete, ndërsa ndiqte pas në mënyrë të pavullnetshme Ramë Sheldinë. Ndoshta nuk ka ndonjë qëllim të keq ndaj meje, mendoi. Po ky mendim, për çudi, nuk ia largoi për asnjë çast ndjenjën e tmerrshme të frikës që kishte pushtuar tërë qenien e tij.

Gjatë viteve të luftës në portën e tij nuk kishin trokitur ndonjëherë as partizanët dhe as forcat gjermano-balistë. Ai që mbyllur me aq kujdes në guackën e vet, saqë askush nuk kishte qenë në gjendje t'ia mësonte derën e shtëpisë. Kishte pasur raste gjatë luftës kur disa nga bashkëfshatarët e tij qenë bashkuar me partizanët, ndërsa të tjerë me gjermano-balistët, kurse ai... kishte qëndruar asnjanes... Ndërsa tani... njëfarë Ramë Sheldia... po e detyronte ta ndiqte nga pas në mënyrë të verbër... Ai e dinte fort mirë se një rrugë e tillë ishte e rrezikshme si për të edhe për gjithë familjen e tij. Por ai s'kishte forca që të kthehej mbrapsht. Disa herë kishte menduar që t'i thoshte Ramë Sheldisë që ai ta linte rehat e të mos lozte me fatin e tij, por nuk kishte guxuar... Atij i dukej sikur dikush i kishte hedhur në qafë një kapistall dhe e tërhiqte pas sikur të ishte kafshë... Ç'më gjeti, thoshte vazhdimisht me vete.

Në perëndim të fshatit u dëgjuan përsëri disa krisma armësh. Ai ecte prapa Ramë Sheldisë si në ëndërr, duke u përkundur herë nga e majta e herë nga e djathta. Ai po ndiente në grykë përherë e më shumë dhimbjet që i



shkaktonte «litari» që i kishte hedhur miku i tij i vjetër. Ndoshta më do për të justifikuar lëvizjet që bën nëpër fshat, mendoj Sherifi. Por një gjë e tillë, edhe pse e vogël në dukje, nuk është fare pa rreziqe, thoshte me vete ai. Nesër ose pasnesër mund t'i hiqen petët lakrorit dhe atij t'i hedhin hekurat, ashtu siç kanë vepruar edhe me mjaft të tjerë! Po pastaj ç'do të bëhet me mua? Sigurisht do të vijnë e do të më thonë: Pa na thuaj se ç'di për këtë njeri, me të cilin kishe miqësi të ngushtë e shëtisje poshtë e përpjetë nëpër fshat?

— O zot! — murmuriti me vete. — Ç'më gjeti!

— Mjaft, ore derr! Mjaft! Do të të zhduk!

Te porta e vatrës së kulturës dhe në sheshin e vogël para shkollës kishte shumë njerëz. Ata rrinin në këmbë grupe-grupe dhe bisedonin me zë të ulët nëpër errësirë. Drita e zbehtë që ndodhej brenda në sallën e vatrës së kulturës nuk ishte në gjendje që të ndriçonte as shkallët e gurta në hyrje të ndërtesës, pa le të depërtonte pastaj nëpër natën e zezë deri tutje poshtë nga ishin shpërndarë kreshnikasit.

— O zot! — vazhdonte të rënkonte Sherif Rubiana.

Tjetri, që me sa duket e kuptoi se mikut të tij po i binte të fikët, i futi krahun dhe e tërhoqi zvarrë në një rrugicë qorre. Aty e mbështeti pas një muri të vjetër dhe ia zuri gojën me pëllëmbën e dorës.

Qaq e pata, tha me vete Sherif Rubiana. Ky ishte i vetmi mendim i qartë që i kaloi në mendje, se pastaj u turbullua plotësisht. Ramë Sheldia e futi në thellësi të rrugicës qorre dhe, si u sigurua se aty nuk binin në sy, hodhi sytë nga vatra e kulturës e pastaj nga sheshi që ndodhej para shkollës. Veshi i zuri zërin e kryetarit të këshillit të lokalitetit që vinte nga një drejtim i papërcaktuar. Njerëzit kishin filluar të shpërndaheshin në katër drejtime të ndryshme. Shumica ishin të armatosur me pushkë të gjata, disa mbanin automatikë, me të cilët ishin furnizuar dy javë më parë nga forcat e ndjekjes. Automatikë të tillë kishin në fshat vetëm ushtarët e re-

partit të forcave të ndjekjes që ishte dislokuar pranë rru-  
gës automobilistike, në të majtë të fshatit të Kreshnikës.

— Ejani këtej! — tha një zë nëpër errësi.

— Thonë se banda e Çuman Kokobogos është shpar-  
talluar plotësisht, — tha një tjetër.

— Do na e marrin të keqen!

— Një diversant mbeti i vrarë që në përleshjen e  
parë me forcat e ndjekjes...

Sherifi ndjeu se si miku i tij po ia lëshonte dorën  
gradualisht, me sa dukej, për të parë nëse ishte në gjendje  
të vazhdonte më tej rrugën... Gishtat e Ramë Sheldisë  
u shkëputën nga nofullat e tij të gjera. Një dritë feneri  
u duk nga e majta. Ai u tërhoq prapa një qosheje, duke  
marrë me vete edhe Sherif Rubianën. Para vatrës së  
kulturës dhe në sheshin e shkollës tani kishte shumë pak  
njerëz.

— Ejani këtej! — dëgjoi përsëri një zë nëpër errësi.

— Sonte do të na e marrë të keqen banda e Çuman  
Kokobogos! — tha një tjetër.

— Është e rrethuar nga të katër anët!

— S'ka se nga t'ia mbajë, jo!

Përpara një porte të lartë me strehë u grumbulluan  
disa njerëz. Midis tyre kishte edhe ushtarakë.

— A u nisën të gjitha forcat në drejtim të teqesë? —  
pyeti dikush.

— Nuk e di, — u përgjigj tjetri.

— Besoj se jo, — tha një zë në errësi. — Tre-katër  
veta janë këtu me ne, nja dy nuk janë paraqitur akoma.

— Shpejt, se u bë vonë! — tha një ushtarak.

Kur Sherif Rubiana hapi sytë, për të parë, se ç'po  
ndodhte, nata iu duk më e errët se çdo herë tjetër. Ata  
ndodheshin në fund të rrugicës qorre, ku, edhe sikur të  
donin të lëviznin, s'kishin se ku të shkonin më tej, sepse  
edhe muret ishin tepër të larta. I vetmi drejtim nga mund  
të kalonin ishte dalja në drejtim të sheshit, në qendër të  
fshatit. Mirëpo, hëpërhë kjo ishte e rrezikshme, sepse he-  
rë-herë aty lëviznin akoma pushkatarët e fshatit dhe for-  
cat e ndjekjes.



— Ndal! Kush je?

Zëri e çau me shpejtësi errësirën dhe pastaj jehoi në anën tjetër të fshatit.

Ramë Sheldia po e ndiente se ishte futur në një rrugë pa krye. Si të vepronte? Të nxirrte thikën dhe pa zhurmë ta çonte në botën tjetër mikun e tij të vjetër? Jo! Një veprim i tillë ishte i rrezikshëm jo vetëm se mund të diktohej, por, edhe po ta bënte atë, ai nuk ishte i sigurt nëse, duke kapërcyer mbi muret e rrugës, do të mund të dilte në anën tjetër dhe të largohej pa rënë në sy.

— Kush je? — u përsërit britma në errësirë.

Ai u bind se njeriu që thërriste në errësirë i drejtohej dikujt në anën tjetër të sheshit. Kjo i dha zemër dhe e bëri që të merrte një vendim më të pjekur: të qëndronte aty derisa qendra e fshatit të binte plotësisht në qetësi. Kjo ishte rrugëzgjdhja më e përshtatshme. Përndryshe, ngado që t'ia mbanin, do të krijonin dyshime. Po ky hajvan, tha me vete. Ç'm'u desh që e mora një njeri të tillë? Në vend që të më maskonte, po më...

— Kush je? — u dëgjua i njëjti zë nëpër errësirë.

— Do të qëlloj, prandaj mos lëviz nga vendi!

Ramë Sheldia filloi të dridhej i tëri. Tjetri se ç'i tha me zë të ulët njeriut që thërriste nëpër errësirë dhe pastaj ata të dy filluan të bisedonin për gjëra pa rëndësi. Ramë Sheldia u qetësua dhe mori frymë thellë. Në djall të veni, tha me vete. Më ngrinë gjakun këta maskarenj.

— Më fal, se nuk të njoha, — tha pas pak ai që deri tani thërriste me sa i hante zëri.

Tjetri qeshi nën hundë.

— Mirë, mirë, — tha. — S'ka gjë. Kështu duhet vepruar.

— Kështu, posi! — Sa të na kalojnë diversantët nën hundë, më mirë...

Ata u larguan nëpër errësirë. Pesë minuta më vonë qendra e fshatit ra në qetësi. Si u bindën se forcat kishin ikur, Ramë Sheldia i foli në vesh Sherifit dhe pastaj të dy së bashku filluan të ngjiteshin në drejtim të la-



gjeve të sipërme të Kreshnikës. Rruga nëpër të cilën po ecnin ishte e pjerrët e plot me togje dëbore që i pengonin për të ecur shpejt. Në disa vende ata u detyruan të zvarriteshin këmbadorazi, duke i dhënë zemër njëri-tjetrit.

— Kujdes, këtu është një gropë! — tha Ramë Sheldia.

Togjet e dëborës që kishin ngrirë nga të ftohtët zbardhnin aty-këtu, ca në mes të rrugës, ca në anë e ca të stërgjatë si trupa njerëzish, të shtrirë qëllimisht për të penguar qarkullimin. Nga lindja frynte një erë e ftohtë që të thante fytyrën.

— Mbërritëm! — tha Ramë Sheldia. — Hyr pa bërë zhurmë. Pas teje do të hyjnë dy-tre mysafirë. Janë të Çuman Kokobogos. Forcat e ndjekjes po i kërkojnë me qiri. Në shtëpinë tënde do të jenë të sigurt. Se ç'do të bësh më tutje me ta do të ta thonë vetë. Derën lëre hapur. Sherifi mezi e gjeti dorezën e drunjte të portës. Pastaj e hapi me duart që i dridheshin dhe i tha «natën e mirë» mikut të tij, të cilin nuk donte ta shikonte me sy.

— Natën e mirë! — tha edhe Ramë Sheldia me zë të ulët.

## DASHURIA TË MERR MENDJEN

— Ç'natë e bukur për dashuri? — po u thoshte shoqeve të saj Hajrija.

Ato qeshën nën hundë dhe, si u panë sy më sy, ia ngulën vështrimin Katerinës. Befas Ajkunës që uli kokën e turpëruar i shkoi mendja te Lavdim Ukcama. Gjatë ditës ai kishte bërë ca gjeste të çuditshme dhe ishte përpjekur të shprehte diçka që e fshihte me kujdes brenda vetes. Siç dukej, ai nuk kishte mundur ta bënte një gjë të tillë, sepse i vinte turp. O zot, tha me vete Ajkuna, edhe me mua diçka po ndodh, edhe mua po më merret mendja ashtu si Katerinës. Dhe pastaj këto (mendoi ajo për shoqet e saj) do të tallen, ashtu siç bëjnë edhe me atë. Vajzat vazhdonin të qeshnin, ndërsa Katerina që ishte mësuar me romuzet e tyre murmuriste diçka nëpër dhëmbë. Sytë e saj bojë qielli dhe flokët e artë ndrisnin nën rrezet e verdha të hënës që shfaqej herë pas here midis reve të zeza.

— Vërtet, ç'natë e bukur! — tha edhe Maria.

Tana i futi asaj krahun dhe e shtrëngoi pas trupit.

— Ç'bën kështu? — i tha Maria. — Më copëtove llërët.

Katerina ia plasi gazit. Pas pak vajzat u gjendën në oborrin e shkollës. Hajrija u shkëput prej tyre dhe shkoi e trokiti në xhamin e dritares së shkollës, ku ndriste një dritë e dobët feneri. Ishte i shoqi, mësuesi i fshatit, Kushtrimi, i cili, siç dukej, ose po korrigjonte fletoret e nxë-



nësve, ose po përgatitej për mësimet e ditës së ardhshme.

— S'kam ç'bëj? — u tha Hajrija shoqeve, tek po kthehej nëpër rrugicën e ngushtë e të shtruar me kalldrëm. — Jam e detyruar të pres tim shoq, derisa të mbarojë punë. Më tha se nuk do të vonohet më tepër se dhjetë minuta.

Vajzat u grumbulluan kokë më kokë, murmuritën diçka të pakuptueshme nëpër dhëmbë dhe pastaj ia plasën gazit. Hajrija vazhdonte të ecte në drejtim të tyre me njëfarë krenarie në vetvete.

— C'keni që hingëllini kështu? — u tha ajo me një pamje gjysmëserioze e gjysmë për të qeshur. — E di unë, e di, — u tha pas pak. — me mua e keni. Por mos u çudisni, se kio është një gjë krejt e natyrshme. Dashuria ta merr mendjen.

Vajzat u shkrinë së qeshuri. Ajkuna uli përsëri kokën e turpëruar. Vërtet, tha me vete ajo, dashuria ta merr mendjen. Oh, se si jam sonte? Cfarë donte të më thoshte Lavdim Ukcama? Përse skuqej aq shumë ai, sa herë që afrohej pranë meje? Mirëpo këto ishin pyetje, të cilave ajo nuk mund t'u jepte përgjigje. Ajo vetëm e merrte me mendje se... O, jo, jo! C'budallace që jam! Vallë, pse kështu është dashuria? Dhe aty për aty i kaloi në mendie mendimi se duhej të giente rastin e përshtatshëm dhe të pyeste Katerinën se si kishte rënë në dashuri me Sokol Dinon.

Te porta e shkollës u shfaq papritur mësuesi me një cantë të zezë nën saetull. Ai po ecte në drejtim të tyre me hap të ngadalshëm e të sigurt.

— Po vjen kryezoti im. — tha me të qeshur Hajrija.

Vajzat u mblodhën kokë më kokë dhe qeshën mbyturazi.

— Vërtet, c'natë e bukur? — tha prapë Maria.

Pastaj ajo u kthye nga Ajkuna.

— Po ti c'ke që rri kështu sonte? — i tha me ngadalë. — Mos je gjë pa ajejt?

— Jo, — u përgjigj Ajkuna me një gjysmë zëri.



— Po atëherë ç'ke? — e ngriti pak zërin Maria. —  
Mos ke rënë edhe ti në dashuri si Katerina?

Ajkuna u turpërua.

— A, të lutem, — foli prapë me një gjysmë zëri. —  
Më lër rehat, se... — Maria e përqafoi dhe e puthi në  
ballë, sikur të ishte fëmijë.

— Më fal! — i tha në intimitet. — Ti je ende e vogël  
në krahasim me ne të tjerat, prandaj s'ka se si të ndodhë  
një gjë e tillë. Pastaj, ty të kemi edhe vajzën më të turp-  
shme.

Ajkuna filloi të dridhej e tëra. Ajo e humbi fare to-  
ruan dhe s'dinte se çfarë të thoshte.

Ndërkohë Kushtrimi mbërriti aty dhe u takua me  
vajzat, duke i pyetur se si u kishin shkuar punët në  
minierë.



## NJË LAJM I HIDHUR

Darkën e hëngrën në njërën nga dhomat e barakës së parë, pikërisht në zyrën e ardhshme të drejtorisë së minierës, mbi tryezën e punës të vëllezërve Ukcama. Pas-truan tryezën, shtruan disa gazeta dhe pastaj vunë mbi të ushqime të thata, si konserva peshku, turshi, djathë kaç-kavall dhe sende të tjera ushqimore. Ashtu si edhe një natë më parë, disa të rinj kreshnikas se nga e kishin gjetur një shishe me raki dhe e vunë atë në mes të trye-zës. Bame Toros iu bë qejfi. Ai u kthye nga vëllezërit Ukcama dhe, pasi ia nguli vështrimin vëllait të tyre më të madh, Baftjarit, tha:

— Sonte do të pimë, o vëllezër! Ju lumshin duart!

Atë qeshën me gjithë shpirt. Lavdimi po përpiquej të mbyllte kanatet e njëres prej dritareve që kishin në shpinë. Hëna e verdhë ndriste tejprtej mbi luginën e Kreshnikës. Dëbora e bardhë ua shtonte refleksët reze-ve të saj të arta. Mirëpo, në të njëjtën kohë frynte edhe një erë e ftohtë dhe e ngarkuar me lagështi. Ç'gjëra kon-tradiktore? tha me vete Kristaq Dvorani, tek po ndiqte me vëmendje lëvizjet e duarve të shkathëta të Lavdim Ukcamës, i cili i mbylli me shumë vështirësi kanatet e dritares që si dukej nuk puthiteshin mirë me njëra-tjetrën. E mira dhe e keqja qëndrojnë ndonjëherë fare pranë njëra-tjetrës, tha prapë me vete Kristaq Dvorani, pa e ditur as vetë se pse po i vinin këto mendime.



Në barakë po krijohej një atmosferë e gëzueshme. Njerëzit, pa zënë vend mirë, filluan t'i thoshin «gëzuar» njëri-tjetrit.

— Sonte do të pimë, o vëllezër! — vazhdonte të thoshte Bame Toroja.

Lavdim Ukcama u mundua të përfytyronte përsëri qytetin e ardhshëm të minatorëve. Mirëpo, sapo i vihej kësaj pune, i dilte përpara silueta e Ajkunës dhe pastaj çdo gjë mjegullohej dhe merrte karakterin e një ëndrre të vërtetë. Po ai e ndiente fort mirë se nuk ishte në ëndërr dhe se ndodhej aty në mes të punonjësve të minierës së ardhshme të kromit. Zaçe Çapoku vazhdonte të ngulte këmbë për t'ia marrë një kënge tjetër.

— Hajt të këndojmë edhe një këngë tiranase, — thërriste ai vazhdimisht.

Dhe sakaq ai ia mori një kënge të vjetër të krahinës së tij, kurse të tjerët, për të mos e fyer, e shoqëruan. Ndërkohë, dikush trokiti te dera. Martin Reka, si më i riu, doli menjëherë përjashta. Zaçe Çapoku ngulte këmbë që kënga të çohet deri në fund. Nga pija atij i ishte bërë fytyra dyllë e verdhë, kurse koka i varej mbi tryezë.

— Mbani iso, bre burra! — thërriste ai herë pas here.

Martin Reka u kthye tepër i shqetësuar dhe po qëndronte si i ngrirë te pragu i dërës.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti Kristaq Dvorani dhe u çua menjëherë për të dalë përjashta. Pas tij u ngrit edhe njëri nga vëllezërit Ukcama.

— Këndoni, bre burra! — vazhdonte të thërriste Zaçe Çapoku.

Kristaq Dvorani po bisedonte te hyrja e barakës me një njeri të panjohur. Ai po tregonte diçka, duke bërë gjeste me duar.

— Këndoni, bre burra!

Kristaq Dvorani futi kokën te dera dhe tha:

— Mbani qetësi, o vëllezër!

Në barakë ra një qetësi prej varri. Ndërkohë që Kristaq Dvorani u kthye tek i panjohuri për të sqaruar



më mirë çështjen, vuri re se po vinte me hap të ngadalshëm Bame Toroja. Atij duhej t'i kishte zënë veshi diçka nga biseda që po zhvillohej në hyrje të barakës. Megjithatë nuk po e jepte veten dhe vazhdonte të ecte në drejtim të tyre, me vështrimin të përqendruar tek i panjohuri.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti ai.

— Asgjë, — tha Kristaq Dvorani. — Ky është një shok që ka ardhur nga lokaliteti. E ka dërguar kryetari i këshillit për çështjen e forcave punëtore që na duhen për ditën e nesërme.

Bame Toroja i dha dorën të porsaardhurit dhe qëndroi në këmbë pranë tyre.

— Ju nuk po më thoni të vërtetën, — tha pas pak ai.

Heshtja e gjatë në barakën e drunjte po ia shtonte edhe më shumë dyshimin. Ai hodhi sytë nga i porsaardhuri dhe pastaj e ndali vështrimin te Martin Reka, i cili kishte në dorë një letër të bardhë.

— Më thoni çfarë ka ndodhur?

Kristaq Dvorani uli kokën përdhe.

— Ke një letër nga familja! — tha ai.

Bame Toros i rahu zemra fort. Mos, tha me vete, ku më gjeti tani... Ndjeu se u turbullua menjëherë dhe se trupi i tij sikur po qëndronte mbi dy këmbë të huaja. Zemra i rrahu përsëri fort dhe ai gati sa s'qeshi nga hidhërimi. Tani thoni çfarë të doni, tha me vete. Bame Toroja u mundua të mblidhte veten, duke tendosur tërë muskujt e fytyrës, por kjo që e pamundur. Një lëmsh i fortë iu bë në grykë.

— Kush e ka letrën? — pyeti ai, pa e hequr vështrimin e tij nga duart e Martin Rekës.

— Unë, — tha Martini i mallëngjyer.

Dukej qartë se çdo përpjekje për t'ia fshehur të vërtetën, ishte krejt e kotë. Nga baraka dolën edhe dy veta të tjerë që po afroreshin tek ata, duke shkelur me kujdes mbi dëborën e ngrirë.

— Ma lexoni tani! — tha Bame Toroja.

— Ndoshta s'ka ndonjë gjë me rëndësi, — tha Kris-

taq Dvorani. — E lexojmë më vonë, kur të shkojmë, për të fjetur.

— Jo! — tha Bame Toroja. — Ejani ta lexojmë tani. Unë dua të marr vesh se çfarë ka ndodhur.

I porsaardhuri u largua, duke u përshëndetur me të gjithë të pranishmit e duke u thënë «natën e mirë» atyre që ishin në barakë. Ndërkohë Kristaq Dvorani, Bame Toroja, Martin Reka dhe dy nga vëllezërit Ukcama shkuan në ndërtesën e vjetër të hanit për të lexuar letrën.

Mos, tha përsëri me vete Bame Toroja. Ku më gjete tani... Atij ia kishte vënë veshi emrin e Turabiut, por përse bëhej fjalë vallë? Kjo nuk ishte plotësisht e qartë. Ah, do të më jetë vrarë Turabiu, tha ai, duke e marrë cdo gjë me mend. U afrua pranë tyre. Martini nxori letrën që t'ia jepte Bame Toros.

— Jo, jo! — tha ai. — Lexoje ti, more djalë! Lexoje!

Martin Reka uli kokën i pikëlluar dhe filloi të hapte zarfin me duart që i dridheshin nga hidhërimi.

— Lexoje! — tha përsëri me mundim Bame Toroja.

Në zarf ndodheshin dy copa letre me shkrime të ndryshme. Midis tyre ra një heshtje e gjatë. Martin Rekes iu mbushën sytë me lot.

— Lexoji të dyja! — tha Bame Toroja, duke mbledhur veten.

— «I dashur baba! — nisi të lexonte Martin Reka me një zë të dridhur. — Jemi mbledhur të gjithë këtu në dhomën e zjarrit bashkë me nënën tonë dhe po mendojmë se si të të njoftojmë për një lajm të hidhur...»

Martin Reka pushoi një sekondë.

— Vazhdo! — tha Bame Toroja.

— «Mendua më të bëjmë telegram, po nëna tha se mbase nuk mbërrin në kohën e duhur ose nuk të gjen, pasi, siç kemi marrë vesh, e keni ndërruar vendin e punës... Prandaj vendosëm të të shkruajmë këtë letër, të cilën po ta dërgojmë dorazi... As neve nuk na besohet, o i dashur baba, po e vërteta është se... Turabiu na la... Lajmi i hidhur që na theri të gjithë mu në zemër na er-



*dhi me anën e kësaj letre që po ta dërgojmë ta lexosh edhe ti... E ka shkruar komandanti i forcave të ndjekjes me dorën e tij dhe... neve na e sollë një korrier i posaçëm... Letra thotë se sot do të sjellin edhe trupin e tij...»*

— Ah, m'u vra edhe Turabiu! — tha i mallëngjyer Bame Toroja. — Nuk arriti të vinte këtu në minierë...

— Mos u dëshpro, bre burrë! — tha Baftjari, vëllai i madh i Ukcamaëve.

— Mbaje veten si burrë! — u dëgjua befaz edhe zëri i Kristaq Dvoranit.

M'u vranë djemtë, m'u vranë, tha me vete Bame Toroja. M'u vranë njëri pas tjetrit në lulen e rinisë. Iku edhe Turabiu, ashtu siç iku Shabani pesë vjet më parë... Ah, fashistë të fëlliqur!

— «Tani edhe ne nuk dimë se si të veprojmë, o i dashur baba! Nëna e ka humbur fare. Janë mbledhur disa nga gratë e lagjes dhe i bëjnë gajret, po ajo është tepër e dëshpëruar. Ti je burrë dhe i duron dhimbjet, prandaj... po të vije, do të ishte një gjë e mirë... Njerëzit do të na vijnë për të na ngushëlluar dhe ne s'dimë se si të veprojmë. Patriun dhe Nexhipin i kemi çuar te halla. Ata nuk dinë akoma se çfarë ka ndodhur. Ju përqafojmë nga larg. Vajzat e tua Zenepja dhe Taibeja.»

— Ka gjë tjetër? — pyeti Bame Toroja, i cili nuk donte t'i shpëtonte as edhe një fjalë nga letra.

— Jo! — tha Martin Reka.

— Mirë! — tha Bame Toroja. — Tani lexo këtë tjetrën.

Martin Reka e lexoi më shpejt letrën që kishte dërguar komandanti i forcave të ndjekjes. Aty përshkruhej në mënyrë të hollësishme akti i heroizmit të Turabiut, i cili kishte luftuar më tepër se një orë bashkë me dy shokë të tjerë kundër një bande diversantësh, që kishin tentuar të hynin në tokën shiptare. «Ata lanë në tokën tonë mjaft të vrarë. Por në të njëjtën kohë nga radhët tona mbeti në fushën e betejës djali juaj, Turabiu, i cili ndodhej në pozicionin më të vështirë. Kjo është një hum-



bje e hidhur si për kolektivin tonë, ashtu edhe për ju, të dashur prindër të Turabiut! Ju humbët djalin tuaj, njeriun më të dashur, ne humbëm një ushtar besnik të **Atdheut, shokun tonë më të ngushtë, të cilin e donim dhe e respektonim aq shumë, se ishte me të vërtetë një njeri i mirë. Sigurisht, kjo është një dhimbje e madhe, e padurueshme, por ne, dhe ju bashkë me ne, do të gjejmë forca për ta përballuar atë. Rroftë Partia!»**

Një copë herë të gjatë ata qëndruan në heshtje.

— Dëgjo këtu, o Bame Toro! — tha Baftjari. — A më dëgjon? Nuk është vetëm familja juaj që është goditur rëndë nga armiqtë tanë të shumtë. S'ka familje shqiptare që të mos ketë plagë të marra nga plumbat e armiqve! Unë, në të vërtetë, nuk dua të të ngushëlloj, bre burrë i dheut, se shqiptari s'e ka për zakon ngushëllimin, por dua të të ndihmoj që të mbahesh fort. Ti ke të drejtë të pikëllosh, se t'u vranë në një moshë të re dhe njëri pas tjetrit dy djemtë më të mëdhenj, por mos harro se nuk je vetëm, na ke ne, ke tërë këta shokë e miq... Ke shumë shokë! — shtoi pas pak ai.

Bame Toroja rrinte në heshtje, sepse s'donte të kuptohet se ishte tepër i tronditur. Bame Toroja nuk dinte se si ta lehtësonte veten nga kjo brengë e madhe.

— Mbahu, o Bame Toroja! — i tha edhe Kristaq Dvorani, duke i vënë pëllëmbën e dorës në sup. — Ji i fortë, siç ke qenë kurdoherë!

— Falemnderit! — tha prapë Bame Toroja.

Ai i kuptonte drejt këshillat e shokëve, por ç'të bënte. Ngaqë dhimbja ishte e fortë, ai nuk po e mblidhte dot veten. Vështroi Martin Rekën drejt në sy dhe menjëherë i rrodhën lot.

— Nuk arrite ta njihje Turabiun! — i tha me një zë të mallëngjyer. — Të ngjante shumë, more djalë! Ju kishit shumë gjëra të përbashkëta. Unë doja ta sillja këtu në minierë që të nxirrnit krom bashkë, por... ç'të bësh... Megjithatë, të rrojë Partia! Ai nuk derdhi djersë këtu për të mirën e Atdheut, por derdhi gjak po për të mirën e Atdheut... Ne të gjithë jetojmë e luftojmë për

një qëllim! Këtë e ka të qartë Bame Toroja! Por ç'të bësh? Ja që dhimbja për vdekjen e fëmijës qenka e fortë, e padurueshme. Ndoshta, kjo vjen ngaqë edhe moshë bën punën e saj... Po bëhem gati pesëdhjetë vjeç tani dhe.. nervat më janë dobësuar... Po zemrën e kam të fortë, ama! Këtë ta dini mirë!

Ai u mundua të buzëqeshte.

— Kam nevojë të rri pak vetëm, — tha pas pak ai me një zë të ëmbël dhe të vendosur.

U ngrit menjëherë në këmbë dhe doli jashtë. Pas tij shkuan edhe të tjerët.

— Ku vete? — i tha Kristaq Dvorani.

Ai e zuri nga krahu dhe e tërhoqi pranë vetes.

— Unë nuk të lë vetëm, — i tha.

— Lërmë, more djalë! — tha Bame Toroja. — Ju thashë se kam nevojë të rri një copë herë vetëm. Shkoni të hani darkë. Pas pak do të vij edhe unë...

Kristaq Dvorani, i prekur nga shprehja e fytyrës së tij, u largua në drejtim të shokëve që po e prisnin në këmbë para ndërtesës. Përtej, në anën tjetër, shokët që rrinin në heshtje te baraka u shqetësuan dhe dolën jashtë.

— Përse e latë vetëm? — tha dikush nëpër errësirë.

— Nuk duhet lënë vetëm në asnjë mënyrë! — tha një tjetër.

— S'ka gjë, s'ka gjë! — tha Kristaq Dvorani. — Ejani. Pas pak do të vijë edhe ai.

— Ku hahet darka tani! — tha një zë nëpër errësirë.

Një hënë e madhe, dyllë e verdhë, vazhdonte të qëndronte në kupën e qiellit të mbushur plot me yje. Një natë e tillë rrallëherë ndeshet në Kreshnikë. Dëborë e bardhë shkëlqente gjithandej. Pishat e bredhat e lartë që ndodheshin aty-këtu anës rrugës automobilistike, apo lart në shpatin e malit të Kreshnikës, dukeshin sikur bënin rojë. Por të gjitha këto tani s'kishin asnjë vlerë, sepse pas asaj që kishte ndodhur askujt s'i shkonte në mendje të sodiste një natë të bukur me hënë në mes të pishave e bredhave të ngarkuar me dëborë.



Frynte një erë e lehtë që të thante fytyrën. Nga baraka befas buçiti zëri i vetmuar i lahutarit.

— Ç'është kjo këngë?! — thirri i revoltuar njëri nga minatorët.

Vëllai i madh i Ukcamaeve, Baftjar Ukcama, i vuri dorën në sup dhe e ndaloi minatorin e revoltuar që të hynte në barakë.

— Kjo nuk është këngë, more djalë, — tha ai i bren-gosur. — Lahutari, i dëshpëruar pa masë nga ky lajm i hidhur, u bën të ditur bjeshkëve se ra në fushën e betejës edhe një trim!

Minatori, i revoltuar, ngriti kokën dhe pa në heshtje fytyrën e bren-gosur të Baftjarit. Leshrat e gjata nën shami, vetullat e ngrysura dhe mustaqet e përdredhura e të ngritura përpjetë të linin përshtypjen se kishe të bëje me një njeri me vullnet të hekurt. Zëri i vetmuar i lahutarit vazhdonte të jehonte tejmbanë luginës së Kreshnikës. Kënga e tij ishte me natyrë alpine, pjellë e maleve të larta shqiptare. Ajo kishte diçka të përbashkët me bimësinë alpine që rrethonte kantierin e minierës së re të kromit dhe në dëborën e përjetshme që rrinte gjithmonë në të njëjtën lartësi. Nga sa kuptohej, ndonëse lahutari u këndonte luftërave të kreshnikasve kundër «kralëve», kënga e tij sillte njëkohësisht jehonën e atyre bëmave që po ndodhnin në kufirin jugor të Atdheut.

— Ne, shqiptarëve, — tha Baftjari, — gjatë gjithë historisë sonë na është dashur të luftojmë me armiq të shumtë.

— Dhe do të luftojmë, — tha Kristaq Dvorani.

— Të lumtë goja, o kapedan! — ia priti Baftjar Ukcama. — Kjo që the, është fjalë me vend.

Pak më vonë, duke kaluar përmes oborrit të kantierit, u kthye edhe Bame Toroja. Ai ecte ngadalë e duke i hedhur me kujdes hapat mbi dëborën e ngrirë. Hyri brenda dhe u shtri pranë shokëve. Gjysmë i zgjuar e gjysmë i përgjumur qëndroi deri në orën dy pas mesnate. Nga nuk i shkonte mendja; herë në familje, herë lart në minierë, ku po përgatitej shpërthimi i parë, herë te Tu-



rabi, të cilin, megjithëse mundahej ta përfytyronte të vrrarë, e shihte kurdoherë të qeshur dhe me uniformën e gjelbër të ushtarit. Mos vallë kam qenë në ëndërr, mos vallë nuk është e vërtetë që ai... Bame Toroja ndihej aq shumë i lodhur, saqë kishte filluar të autosugjestionohej nga përfytyrimet e veta. Ah, jo, jo, ia bënte me vete. Është e vërtetë, është më se e vërtetë... Ai nuk jeton më... Si është e mundur, thoshte përsëri. Unë s'jam në vete! Unë po çmendem! Jo! Bame Toroja është i fortë! Dukej tepër i lodhur dhe i hutuar. Doli përsëri jashtë duke hedhur këmbët me kujdes përpara. Trupi i tij i dërrmuar qëndronte në këmbë me shumë vështirësi.

— Si do të bëjmë, Bame? Duhet të nisesh, — i tha Kristaqi.

— Ku të vete, kapedan? — tha me një dhimbje të hidhur në zemër. Rruga është e zënë. Le ta varrosin shokët e vet Turabiun. Njëlloj është. Unë do të qëndroj këtu derisa të realizojmë shpërthimin e parë. Me kafshë prapë s'arrij...

Ai qëndroi një copë herë të gjatë në heshtje para ndërtesës së vjetër të hanit. Mëngjesi ishte i ftohtë dhe çdo gjë rreth e rrotull tij ishte shndërruar në akull.

SHKURTIMI I HALLË TOROS

## DITA E GJASHTË

E enjte, 19 shkurt 1948



## SHQETËSIMET E BAME TOROS

Ndryshe nga herët e tjera reshjet e dëborës nuk u shkarkuan mbi luginën e Kreshnikës qetë-qetë, po me shtrëngata të njëpasnjëshme, me vetëtima verbuese dhe bubullima të padëgjuaara ndonjëherë në ato anë. Çatitë e shtëpive, muret e avllive, sheshet, rrugicat, drurët e pemëve, linjat telefonike, shpinat e kodrinave, automjetet e çdo gjë tjetër që ishte ndodhur jashtë, qenë ngarkuar me dëborë. Stalaktitet e panumërta vareshin në strehët e shtëpive, në hyrjet e shpellave dhe kudo gjetkë, ku rridhin rrëqe uji. Për shkak të temperaturës jashtëzakonisht të ulët, çdo gjë ishte ndalur në vend. Andej-këndej, nëpër strehë, të zinte syri zogj të ngordhur apo gjysmë të ngordhur nga të ftohtët. Shtresa të trasha dëbore kishin bllokuar hyrjet e banesave, dritaret e shtëpive të ulëta njëkatëshe, sokakët, rrugicat dhe të gjitha shtigjet që u shërbenin njerëzve për të komunikuar me njëri-tjetrin. Natyra kishte shpallur gjithandej gjendjen e «shtetrrëthimit». Qielli vazhdonte të ishte i ngarkuar me re dëbore, kurse nga lindja dhe verilindja vazhdonte të frynte një erë e ftohtë që të priste fytyrën.

Mendimet e turbullta rreth Betejës së Mushqetasë që ishin vërtitur gjatë natës në trurin e përgjumur, apo gjysmë të përgjumur të Bame Toros, siç duket, nuk ishin vetëm pasojë e gjendjes së rëndë shpirtërore që ishte krijuar tek ai për shkak të lajmit të hidhur për vrasjen e djalit të tij, Turabiut, por edhe si rezultat i zhurmave



shurdhuese të bubullimave që nuk kishin pushuar gjer në mëngjes. Duhej të kishin qenë pikërisht dritat verbuese të vetëtimave dhe gjëmimet e fuqishme të bubullimave ato që e kishin sjellë aq të gjallë në trurin e tij të lodhur imazhin e Betejës së Mushqetasë.

Bame Toroja mori një lopatë që u gjend aty pranë dhe filloi të hapte rrugën. Me bishtin e syrit vështronte kantierin e vogël, të cilit gati sa s'po i merrej fryma nga dëbora e madhe. Truri i Bame Toros ishte tepër i lodhur. Ai ndiente një përhumbje në tërë qenien e tij. Herë-herë i dukej sikur kokën, këmbët, duart dhe pjesët e tjera të trurit nuk i kishte të vetat. Ai e fuste lopatën në dëborë pothuajse mekanikisht dhe, pasi, e mbushte, e hidhte dëborën në të majtë, apo në të djathtë në mënyrë të pandërgjegjshme. Gjymtyrët i lëviznin pothuajse automatikisht, sikur të ishin mekanizma të një roboti dhe jo pjesë të një trupi të gjallë. Në të vërtetë sistemi i tij nervor nuk ishte në gjendje që të kontrollonte të gjitha veprimet e organeve të ndryshme të trupit, të cilat kishin fituar, si të thuash, njëfarë pavarësie dhe vepronin si t'u vinte për mbarë. Pjesa e shëndoshë e trurit përpiquej të riprodhonte lajmin e hidhur për vrasjen e Turabiut; por edhe aty kishte ende qeliza të përgjumura ose të plagosura rëndë nga goditjet e forta që i kishte marrë gjatë kohës kur Martin Reka lexonte letrën që solli lajmin e hidhur... Çfarë ka ndodhur? Asgjë. Ky është një shok që ka ardhur nga lokaliteti... Ju nuk po më thoni të vërtetën! Më thoni çfarë ka ndodhur? Ke një letër nga familja. E lexojmë më mirë kur të shkojmë për të fjetur. Jo. Ejani ta lexojmë tani. Unë dua të marr vesh se çfarë ka ndodhur... I dashur baba! Jemi mbledhur të gjithë këtu në dhomën e ziarrit bashkë me nënën tonë dhe po mendojmë se si të të njoftojmë për një lajm të hidhur... Vazhdo. Lexoje të lutem. Unë dua të marr vesh se çfarë ka ndodhur... Menduam të të bëjmë telegram, po nëna tha se mbase nuk mbërrin në kohën e duhur... Vendosëm të shkruajmë këtë letër, të cilën po ta dërgojmë dora-zi. Vazhdo. Lexoje të lutem! Unë dua të marr vesh se



çfarë ka ndodhur... As neve nuk na besohet, o i dashur baba, po e vërteta është se Turabiu... na la... Lajmi i hidhur që na theri të gjithëve mu në zemër na erdhi me anën e kësaj letre... që po ta dërgojmë që ta lexosh edhe ti... E ka shkruar komandanti i Turabiu me dorën e tij... Ah, m'u vra edhe Turabiu... Nuk arriti të vinte këtu në minierë për të nxjerrë krom bashkë me shokët e tij... Mos u dëshpëro, bre burrë!... Tani edhe ne nuk dimë se si të veprojmë, o i dashur baba... Nëna e ka humbur fare...

Ndërsa truri i tij i topitur vazhdonte të riprodhonte fragmente të shkëputura nga letra e dytë, duart ulnin e ngrinin lopatën me të njëjtin ritëm. Ai e kishte çarë rrugën që nga ndërtesa e dikurshme e hanit e deri te baraka e parë dhe po vazhdonte punën për të lidhur dy barakat me njëra-tjetrën. Trashësia e dëborës duhej të ishte më e madhe se një metër e gjysmë po të llogaritej edhe dëborë e vjetër. Ndërtesat dukeshin sikur ishin ngulur me forcë në dëborë, e cila vende-vende kishte arritur pragun e dritareve... Ata lanë në tokën tonë mjaft të vrarë... Por... në të njëjtën kohë... nga radhët tona... mbeti në fushën e betejës djali juaj... Turabiu... Ai ishte në një pozicion të vështirë... Kjo është një humbje e hidhur si për kolektivin tonë, ashtu edhe për ju, të dashur prindër të Turabiu... Kjo është një dhimbje e padurueshme, por ne do të gjejmë forca për ta përballuar atë... Rroftë Partia!... Dëgjo këtu, o Bame Toro! Ah, mu vra edhe Turabiu... Unë në të vërtetë nuk dua të të ngushëlloj... shqiptari s'e ka për zakon ngushëllimin, por dua që të të ndihmoj të qëndrosh i fortë... Mos harro se nuk je vetëm... na ke ne... ke tërë këta shokë e miq... Ke shumë shokë!... Falemnderit! Mbahu, o Bame Toroja! Ji i fortë siç ke qenë kurdoherë!... Martin, ti nuk arrite ta njihje Turabiun. Të ngjante shumë ty, more djalë... Doja të punonit bashkë këtu, në minierë...

Kur doli shefi i kantierit nga ndërtesa, pa Bame Toron që po hiqte dëborën që kishte zënë rrugën e automjeteve.



— Ç'po bën kështu? — tha Kristaq Dvorani me një ton shumë familjar.

Bame Toroja ktheu kokën.

— Ja, po pastroj dëborën. Më doli gjumi shpejt dhe...

Kristaq Dvorani u mundua të vinte buzën në gaz.

— A je i fortë? — e pyeti.

Bame Toroja e la lopatën mënjanë.

— Jam, si jo! — iu përgjigj.

Ata u vështruan një copë herë sy më sy.

— Si mendon? — e pyeti Kristaq Dvorani. — A do të nisesh?

— Jo! — tha Bame Toroja me shumë vonesë. — Edhe sikur të dua unë të nisem, more djalë, nuk më lejon koha. Pa shiko se ç'dëborë që ka rënë sonte. Pastaj... ti e di, rruga është e zënë, kështu që..., — vijoi pas pak ai, duke i zvarritur fjalët. — Sidoqoftë, — tha, — unë nuk largohem që këtej pa realizuar shpërthimin e parë...

Pasi i rrahu shpatullat shefit të kantierit, ata filluan të ecnin krah për krah nëpër rrugën e bardhë që kishte hapur Bame Toroja.

Përpara ndërtesës po prisnin punonjësit e tjerë të ekspeditës. Ata ishin gati për të filluar punën.

## TE HYRJA E SHPELLAVE

Çuman Kokobogoja u ngrit herët në mëngjes dhe doli te hyrja e shpellave. Mëngjesi dukej tepër i zyrtë. Qielli ishte i mbushur me re dëbore. Mbi kokën e tij varreshin stalaktite me majë të mprehtë, që dukeshin sikur do ta shponin tejpertej trupin e tij të lartë. Shtrëngoi automatikun që mbante në gjoks dhe bëri disa hapa përpara për të parë më mirë Kreshnikën që shtrihej poshtë në këmbët e Kreshtës së Vdekjes. Nga krahu i djathtë i shpellës u afrua ngadalë roja e tij.

— Sot do të kemi prapë dëborë të shoqëruar me ortekë të mëdhenj, — tha ai.

Çuman Kokobogoja vështroi me inat, sikur t'i kishte fajet ai për të gjitha ato që po ndodhnin. Diku, anash, dëgjohej një zhurmë e shurdhër këmbësh, ndërsa sipër kokave të tyre rrëshqitën disa copa dëbore.

— Ç'është kjo? — thirri Çuman Kokobogoja i shqetësuar.

Ai u fut menjëherë në shpellë dhe mori pozicion për të qëlluar me automatik.

— Duhet të jetë ndonjë ari, — tha roja, duke reaguuar me vonesë.

— Ç'më rri ashtu si gallof?! — thirri Çuman Kokobogoja. — Pa shiko, ç'është ajo zhurmë që po vjen prej andej?

Roja shpejtoi hapin dhe filloi të lëvizte kokën në të majtë e në të djathtë, për të parë më mirë; mirëpo sytë



e tij, të lodhur nga pagjumësia, nuk mundën të diktonin ndonjë gjë të dyshimtë. Ai u kthye me shpinën të kërrusur nga të ftohtët dhe pastaj tha:

— Duhet të ketë qenë ndonjë ari ose ndonjë egër-sirë tjetër.

Në pyllin me pisha e bredha të dendur dëbora kishte hedhur një perde të bardhë që të verbonte sytë. Sipër kokave të tyre kërcitën përsëri degët e thata nga ngrica.

Çuman Kokobogojja doli nga shpella dhe vuri dybinë për të parë se ç'bëhej poshtë në xhade. Kreshnika dukej ende e përgjumur, ndërsa në afërsi të kantierit të minierës së re kishte lëvizje.

Nga mjegulla e mëngjesit po dilnin përherë e më mirë në pah dy barakat, ndërtesa e vjetër e hanit ndanë xhadesë dhe njerëzit që lëviznin andej-këndej nëpër kantier. Në gypat e dylbisë dukeshin ngandonjëherë edhe mjetet e tyre të punës, gjestet që i bënin me duar njëri-tjetrit si dhe linjat telefonike të ngarkuara me dëborë. Edhe rrugët e ngushta të Kreshnikës kishin filluar të gjallëroheshin.

Ne duhet të shkatërrojmë minierën, pa u krijuar mirë, ndërsa anëtarët e ekspeditës që kanë ardhur nga Tirana, duhet t'i pushkatojmë para barakave, u kishte thënë njerëzve të tij një ditë më parë. Ky do të jetë një mësim i mirë edhe për kreshnikasit. Mirëpo papritur ngjarjet kishin marrë rrugë të keqe, sepse njerëzit e tij kishin rënë në përpjekje me forcat e ndjekjes dhe dy prej tyre kishin mbetur të vrrarë. Ngaqë kjo gjë i kishte demoralizuar shumë ata, ai mendonte se do ta kishte të vështirë t'i dërgonte për së dyti me të njëjtin mision. Kësaj radhe ishte e domosdoshme që të shkonte vetë në krye të bandës.

Do të shkoj vetë, përsëriti ai të njëjtin mendim dy minuta më vonë, ndërsa po ecte, duke shkelur me kujdës mbi dëborën e ngrirë.

Në krahun e djathtë të shpellës rrëshqiti një tog i madh dëbore, i cili u përplas poshtë në një përrua, duke marrë me vete sasira të tjera dëbore. Kështu formohen



ortekët, mendoj ai, duke u kthyer po me të njëjtin kujdes në drejtim të hyrjes së shpellës. Roja ishte mavisur në fytyrë nga të ftohtët. Veshja e tij dimërore, e prodhimit anglez, nuk ishte në gjendje që ta ngrohte trupin e tij të rraskapitur nga të pangrënët dhe nga gjendja e rëndë shpirtërore. Ata kishin dy javë që kishin mbetur pa ushqime dhe tani rronin vetëm me mish egërsirash. Bazat që kishin pasur në fshat u ishin shkatërruar, ndërsa furnizimi nëpërmjet teqesë ishte vështirësuar, sepse rreth e rrotull saj qarkullonin vazhdimisht forcat e ndjekjes. Në këto rrethana e vetmja rrugëzgjdhje ishte gjahu që, për fat të mirë, nuk ua kishte lënë barkun bosh. Pyllnajat e Kreshnikës ishin plot me gjithfarë egërsirash, të cilat për shkak të dimrit të egër ishin po aq të uritura sa edhe njerëzit e Çuman Kokobogos.

Kjo na paskësh qenë Kreshnika e egër, tha me vete ai. Një emër i padëgjuar ndonjëherë, një emër krejt shqiptar, që nuk mund ta gjesh në asnjë vend tjetër të botës, bile, as edhe në Shqipëri. Kreshnikë! Një emër që të kujtonte diçka, që kishte të bënte me trimërinë, me guximin dhe kurajën e çuditshme të vendasve për të çarë në jetë, pa marrë parasysh rreziqet që mund t'u kanoreshin nga armiqtë e çdo lloji. Që këtej rridhte emri «kreshnikas», që donte të thoshte kreshtëtarë, flokëgjatë. Këto cilësi të rralla të këtyre njerëzve të zonës alpine ka dashur të shprehë ai që e kishte krijuar i pari këtë emër të mahnitshëm! Nëpërmjet lenteve të dylbisë Çuman Kokobogojë vazhdonte të vështronte shtëpitë e gurtat të Kreshnikës. Ato kishin çati të larta me majë të mprehtë dhe ngriheshin drejt qiellit porsimaja shigjetash gjiganteske, sikur të kishin shpërthyer nga thellësia e tokës shkëmbore. Ashtu siç ishin, grupe-grupe, nga dhjetë apo pesëmbëdhjetë, dyzina-dyzina, sipas konfiguracionit të terrenit, të linin përshtypjen se kishin lidhur besën për të qëndruar në këmbë përballë çdo rreziku. Një det i bardhë dëbore i kishte rrethuar nga të katër anët, po ato qëndronin sup më sup me njëra-tjetrën. Çdo shtëpi kreshnikase kishte një, dy, ose edhe tri oxhaqe,



njëri prej të cilave tymoste ditë dhe natë: kjo tregonte se mushkëritë e Kreshnikës funksiononin normalisht dhe se jeta ecte përpara, pa u ndalur asnjë minutë. Në çdo shtëpi një sy vigjilent qëndronte kurçoherë i hapur. Na u vranë edhe dy veta, mendoi përsëri Çuman Kokobogojja për njerëzit që ishin vranë një natë më parë nga forcat e ndjekjes poshtë, diku në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit. Ai u mallëngjye papritur jo për fatin e tyre të zi, sesa për të ardhmen e tij të zymtë. Ndoshta, ndonjë ditë... filloi të thoshte ai për veten e tij, po e la mendimin përgjysmë, sepse nuk donte të kujtonte vdekjen e tij dhe ta përfytyronte veten të vranë, diku nëpër honet e malit të Kreshnikës. Ndoshta ndonjë ditë... i vetë-tiu në kokë i njëjti mendim... diku në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit... do të dergjet i mbytur në gjak trupi i kapedan Çuman Kokobogojës, i njeriut më të afërt të lartmadhërisë së tij, mbretit të Shqipërisë, Ahmet Zogollit... Jo! Jo! u mundua ta kundërshtonte këtë mendim ogurzi që vërtitej diku në thellësi të trurit të tij. Pasi hoqi dylbinë nga sytë, ai bëri disa lëvizje energjike para hyrjes së shpellës, si për t'i mbushur mendjen vetes se një gjë e tillë nuk do të ndodhte kurrën e kurrës.

Roja po ndiqte i habitur ecejaket e tij që të linin përshtypjen se kishe të bëje me një njeri gjysmë të çmendur. Iku ky, luajti nga fiqiri, tha roja duke qeshur me vete. Vate më duket, kaq e pati...

Ç'fat i poshtër, tha me vete Çuman Kokobogojja, duke sjellë ndër mend si nëpër ëndërr jetën që kishte bërë në oborin mbretëror dhe pastaj kohën e luftës, ikjen, bagazhet me florinj, gjendjen e rëndë shëndetësore të mbretëreshës, pasi kishte lindur një djalë tri ditë para se t'ia mbathnin, hemoragjinë e madhe që për pak i rrezikoi asaj jetën në çastin që po kalonin kufirin për në Greqi, dhe pastaj... dhe pastaj hemoragjia ia verboi sytë, ia ngatërroi mendimet, duke krijuar, më në fund, një pështjellim të pakuptueshëm në trurin e tij të lodhur... Tani ai... u mundua të kujtonte lartmadhërinë e tij. Kushedi se ku ndodhet... Sigurisht... pret nga ne... Mendimet po i vi-



nin duke iu pakësuar, derisa për një çast iu duk se koka e tij ishte krejt boshe e pa asnjë vlerë... një kafkë pa tru... Shkundi kokën për të parë nëse ishte gjallë apo... dhe, kur u bind se po qëndronte në këmbë para shpellës, filloi të ecte gati me hap të shtrirë si në paradat që bënte dikur lartmadhëria e tij, Zogu i Parë.

Roja vazhdonte të ndiqte me sy të shqyer lëvizjet e habitshme të shefit të tij. Ishte hera e parë që ai e shikonte Çuman Kokobogon në një gjendje të tillë.

Nga shpella filluan të dilnin dy e nga tre pjesëtarët e bandës. Ata ishin ca të shkurtër dhe ca të gjatë, dikush me peliçe lëkure, dikush me gëzof ngjyrë kafe dhe gati që të gjithë me mjekër dhe leshra të gjata përmbi supe. Sytë e tyre të skuqur dhe shpinat e kërrusura tregonin se kishin bërë një gjumë me ëndrra të frikshme.

Çuman Kokobogojë vazhdonte të bënte shëtitje para shpellës, pa vënë re se çfarë po ndodhte rreth e rrotull tij.

Do të shkatërroj minierën pa u krijuar mirë, tha me vete ai, dhe njerëzit e ekspeditës do t'i pushkatoj me dorën time, ja atje, përpara barakave.

Sytë e tij të zgurdulluar rrotullohen plot nervozizëm nën vetullat e zeza dhe të trasha. Leshrat dhe mjekra e gjatë që i dridhej mbi gjoks i jepnin atij një pamje me të vërtetë kërcënuese.

Nga krahu i djathtë i Kreshnikës dëgjohej vetëm zhurma monotone e motokompresorit. Po përgatiten për të bërë shpërthimin e parë, mendoi Çuman Kokobogojë, duke kthyer kokën ngadalë nga roja. Ai rrinte në këmbë gjysmë i kërrusur nga të ftohtët. Në shpellë nuk kishte mbetur njeri. Të gjithë anëtarët e bandës i ishin ngjitur pyllnajës me shpresë se mos gjenin ndonjë gjah sa për të siguruar ushqimin e ditës. Çështja e ushqimit po bëhej përditë e më shumë një problem shumë shqetësues. Ato pak sende ushqimore që kishin mundur të merrnin dy ditë më parë në teqenë e baba Ali Çakmaxhianit u ishin mbaruar. Po në qoftë se këta horra, tha prapë me vete kapëdan Kokobogojë, pa ia shqitur sytë rojës, nuk vrasin sot



asnjë egërsirë, ç'duhet të bëjmë?! Duhet të hamë njëri-tjetrin, mëndoi për një çast, duke qeshur nën hundë.

Ndërkohë nga e djathta, përmes disa pishave e brethave të lartë, dhe në anën tjetër, diku në afërsi të një shkëmbi të thepisur e të ngarkuar me dëborë, u dëgjuan papritur zëra që po afroreshin me shpejtësi në drejtim të shpellave. Zërat e ngjirur, si dukej, ca nga të ftohtët dhe ca nga të thirrurat, dukeshin si ulërime ujqish. Çfarë po ndodh kështu? tha me vete Çuman Kokobogja. O zot! Ndoshta këta... S'janë në vete. Siç duket, edhe sot po kthehen përsëri duarbosh... Të thirrurat e tyre herë të dobëta e herë të fuqishme po dëgjoheshin gjithnjë e më pranë. Në të dyja anët e shpellës vuri re se po vinin trimat e tij tepër të gëzuar. Kishte ndodhur krejt e kundërta. Ata po mbanin nëpër duar gjithfarë egërsirash, sorkadhe, lepuj, shpendë të ndryshëm; më e habitshme ishte se tre-katër veta andej nga fundi mezi po sillnin një ari të bardhë! Ata ia kishin lidhur këmbët egërsirës së rrallë të lartësive alpine e kishin futur në një dru të gjatë dhe e kishin hedhur mbi supe. Çuman Kokobogosi i shkëlqeu fytyra nga gëzimi. Skena që kishte përpara ishte me të vërtetë e kënaqshme për kryetarin e bandës së armatosur gjer në dhëmbë që kishte më se tre muaj që jetonte e izoluar nëpër shpellat e panjohura të Kresh-tës së Vdekjes.

— Ju lumtë, bre burra! — tha. — Tani ma keni bërë qejfin!

Ata vazhdonin të thërrisnin porsit të tërbuar.

— Lëkurën e ariut do ta marr unë! — tha pas pak ai me njëfarë mallëngjimi në vetvete. — Qenka shumë i bukur. S'kam parë ndonjëherë ari të tillë. Të rripet me kujdes.

Roja që vazhdonte të rrinte në hyrjen kryesore të shpellës po qeshte vesh më vesh e duke fërkuar duart me forcë, ndoshta për të shfaqur, sipas mënyrës së tij, gëzimin për këtë sukses që kishin arritur në gjahun e mëngjesit.

Të gjitha kafshët e egra që kishin vrarë i hodhën para tij në hyrje të shpellës kryesore.

— Ariun silleni kënde! — urdhëroi Çuman Kokobogoya.

Ai nxori thikën dhe e vuri midis dhëmbëve. Pastaj e kapi ariun nga këmbët e mbrapme dhe e tërhoqi zvarrë nëpër dëborë.

— Ja, këtu ta rrjepim! — tha.

Poshtë në xhade vazhdonte të buçiste pa pushim motokompresori. Uturima e tij dëgjohej deri lart te shpellat e Kreshtës së Vdekjes.

Dëbora vazhdonte të binte me flokë të mëdhenj. Çdo gjë rreth e rrotull shpellave dukej e bardhë. Stalaktitet e varura andej-kënde nën shkëmbinj e pranë ujëvarave së bashku me bimësinë alpine krijonin një peizazh dimëror me një bukuri të mahnitshme.



## NË VEND TË TURABIUT

Vazhdonte të binte dëborë. Nga skaji tjetër i Zonës A ku po punohej me ngut për përgatitjen e shpërthimit të parë u dëgjua për të dytën herë e qeshura e Katerinës. Bashkë me shoqet e saj Hajrijen, Tanën, Marien dhe Ajkunën, ajo po punonte për të hapur një rrugicë nëpër dëborë, me qëllim që të lidhte rrafshinën ku ndodhej motokompresori me ndërtesën, së cilës tani po i hidhej çatia. Siç dukej shefi i kantierit kishte dhënë urdhër që motokompresori të futej sa më parë në godinën e vet, me qëllim që të mbrohej nga agjentët atmosferikë.

Ishte hera e parë që Bame Toroja dëgjonte të qeshurën e saj karakteristike, e cila kësaj radhe ishte shpërndarë në tërë sektorin si një fragment i bukur kënge.

— Përse zbardh dhëmbët? — tha Maria, duke rruddhur vetullat e saj të trasha.

Katerina ia plasi përsëri gazit. Ajo ia kishte ngulur svtë fytyrës së lodhur të Sokol Dinos dhe vazhdonte të qeshte me të madhe. Mustaqet, vetullat dhe kacurrrelat e tij të zinj ishin zbardhur plotësisht nga dëborat dhe i kishin dhënë një pamje me të vërtetë të çuditshme. Nga larg ai të linte përshtypjen sikur të ishte krejtësisht i thinjur.

— Pa shikoni se ç'plak simpatik që është — tha Katerina, duke u shkrirë së qeshuri; mirëpo, kur u ndesh

me vështrimin e tij serioz, buzëqeshja i ngriu menjëherë në fytyrë.

— Ç'pate kështu? — tha Tana.

— Hiçgjë! — tha Katerina, duke ngulur lopatën e saj në dëborë.

Ajo ishte nga ato vajza gazmore që aty pikëllohej e aty gëzohej.

Bame Toroja po i mësonte Martin Rekës mënyrën se si futej lënda eksplozive në vrimën e shpuar nga barominat, si lidhej fija që çonte energjinë elektrike në kapsollë dhe se çfarë kujdesi duhej treguar për lidhien e ngarkesave të eksplozivit me njëra-tjetrën, me qëllim që të evitohej çdo aksident i mundshëm. Mëqenëse e qeshura e Katerinës u tërhoqi vëmendjen për një çast, atij iu desh t'ia shpjegonte edhe një herë procesin e punës që nga fillimi.

— Me lëndën eksplozive vetëm një herë bëhet shaka! — i tha ai Martin Rekës.

Befas u dëgjua përsëri e qeshura e Katerinës. Atij iu kuitua Turabiu. Ah, more dialë, tha me vete. Një nuse të tillë donte Bame Toroja për ty, një nuse gazmore dhe të zoniën për t'u marrë me çdo punë, kështu, si këto vajzat e Kreshnikës. Disa herë e kishte skicuar në mendjen e tij dasmën e Turabiut, e cila ishte shndërruar tani në një ëndërr e përealizueshme. Ah, more dialë, tha prapë me vete. Një nuse të tillë donte Bame Toroja për ty, një nuse gazmore, por... në vend të dasmës njerëzit do të jenë mbledhur tani për të dhënë lamtumirën e fundit, more bir i babait... kurse unë nuk jam aty që të të uth në ballë... Ah, m'u vra dhe Turabiu, tha gati duke murmuritur me vete. Martin Reka që e kuptoi se ai s'e kishte fare mendjen aty filloi të bënte ca nvetje të kota vetëm sa për t'i tërhequr vëmendjen. Bame Toroja ia kuptoi qëllimin dhe i rrahu shpatullat ashtu sic bënte kurdoherë kur Turabiu thoshte ndonjë gjë të mençur. Ngado e kishte dashur shumë Turabiun, bile më shumë se të gjithë femijët e tjerë, vdekja e tij e papritur ia kishte dërrmuar



shumë gjendjen shpirtërore. Duke mbajtur afër Martin Rekën, atij i dukej sikur i lehtësoheshin dhimbjet. Herë-herë i dukej sikur Turabiu ishte ende gjallë, se lajmi për vrasjen e tij ishte një bllof, se Turabiu ishte ende gjallë, se Turabiu ishte përpara syve të tij duke përgatitur lëndën eksplozive. Mirëpo, kur e vështronte me vëmendje fytyrën e Martin Rekës, ai bindej se mendimet që i vërtitëshin në kokën e tij ishin vetëm iluzione. Çfarë po ndodhte vallë diku në thellësi të ndër-gjegjes së tij? Përse donte që Martin Reka t'i rrinte sa më pranë dhe ta bënin çdo gjë bashkë? Mos vallë një gjë e tillë i kishte rënë në sy Kristaq Dvoranit dhe ishte kjo arsyeja që ai nuk u ishte afruar asnjëherë pranë gjatë gjithë ditës? Përse në vend të fytyrës së Martin Rekës atij i dilte shpeshherë fytyra e Turabiut? Ky ishte një proces mjaft i ndërlikuar që po ndodhte në qenien e tij.

— Kur të shoh ty, more djalë, — tha Bame Toroja me zë të mallëngjyer — më duket, sikur kam para syve Turabiun!

Martin Reka uli sytë përdhe.

— Akoma nuk më besohet se Turabiu nuk jeton më. Martin Reka vazhdonte të vështronte përdhe.

— Ty do të të kem në vend të Turabiut, — i tha pas pak. — Dakord je?

Martin Reka ngriti kokën duke buzëqeshur lehtë. Pas pak ai ndjeu mbi shpinë pëllëmbën e dorës së tij të rëndë, që po e godiste lehtë-lehtë. Aty për aty iu kujtua i ati që ishte vlarë gjatë luftës.

— Dakord jam! — u përgjigj me vonesë, sepse nuk donte që të linte përshtypjen se edhe ai ishte po aq i mallëngjyer nga miqësia e sinqertë që po lindte midis tyre.

— Ha, ha, ha! — vazhdonte të qeshte Katerina me shoqet e saj.

Kjo vajzë kaq gazmore, tha me vete Bame Toroja, por në çast e hoqi mendjen nga ajo. Në drejtim të Kreshtës së Vdekjes u dëgjua një gjëmim i fuqishëm.



Ramë Sheldia dha sinjalin e alarmit dhe njerëzit, si zakonisht, u larguan nga zona e rrezikshme. Këtë radhë, ndryshe nga herët e tjera, orteku rrëshqiti në anën tjetër të Përroit të Thellë. Ja edhe Kristaq Dvorani, mendoj Bame Toroja. Ç'njeri i çuditshëm! Në çdo punë do që të jetë i pranishëm dhe mundësisht të japë një ndihmë sa më konkrete. Po kjo është gjë që s'bëhet. I kam thënë se, si drejtues dhe organizator, ai nuk duhet që të vërë dorë në çdo gjë, sepse kjo është një gjë e pamundur, po ai vazhdon në të tijën. E ha meraku shumë për punën.

— Orteku! — thirri papritur Ramë Sheldia, duke u kthyer nga Baudin Kazazi që ndodhej aty pranë. — Pa shikoni sa i madh që është!

Ai tregonte me dorë në drejtim të Kreshtës së Vdekjes nga dukej të zbriste një ortek i madh. Baudin Kazazi u ngjiti në një bregore për të parë sa më mirë. Ngriti syzet e tij optike me gishtin tregues dhe, duke lëvizur kokën sa nga e majta në të djathtë, vështroi një copë herë andej nga vinte gjëmimi. Orteku rrëshqiti për disa minuta në drejtim në Zonës A dhe pastaj, befas, u kthye dhe, pa u përplasur si zakonisht në shkëmbin e lartë që kishin përballë, u zhduk poshtë në greminë.

— S'merret vesh, — tha njëri nga minatorët që po përgatiste një ngarkesë të re me lëndë eksplozive. — Herë-herë ato zbresin mbi kokat tona, duke shkaktuar gju llurdi e panik, kurse herë të tjera, megjithëse nisen në drejtimin tonë, papritur ndërrojnë rrugë, rrëshqasin e bien në greminë, pa shkaktuar rrezik. Duket sikur tallen me ne.

Adushi qeshi.

— S'kemi ç'të bëjmë, o Shpëtim, — i tha shokut që kishte përbri. — Vetëm ligjet e natyrës nuk i ndryshojmë dot!

Motokompresori ishte fikur. Atë po e përgatisnin për ta futur në ndërtesën e re që sapo ishte përfunduar. Vajzat me pëllëmbët e duarve fshinin dëborën nga shpina e tij e stërgjatë. Era e ftohtë kishte pushuar dhe fijonte



vetëm një borë e lehtë që nuk e pengonte aspak punën. Druvarët vazhdonin të lëshonin nga lart përmes një lugu lëndën e drurit, e cila do të përdorej, si dukej, në ditët e ardhshme për ndërtimin e galerive. Poshtë ijeve të fryra të malit të Kreshnikës, nën tokën shkëmbore, që tani ishte mbuluar gjithandej me dëborë, ndodhej minerali i kromit, shtresa-shtresa në drejtime të ndryshme, të vendosura njëra mbi tjetrën, sikur t'i kishte rregulluar ndokush me dorë. Kur ne të arrijmë të futemi thellë në zemrën e malit të Kreshnikës, po thoshte me vete Kristaq Dvorani, minerali i kromit do të vërshonte kaq me shumicë nëpër grykat e galerive, sa automjetet nuk do t'i dalin mbanë punës për ta transportuar. Ndërsa venin e vinin nëpër territorin e Zonës A, njerëzit, të veshur me rroba dimërore, pa e ditur as vetë, qeshnin me njëri-tjetrin dhe bënin shenja me dorë. Ata dukeshin tepër të gëzuar. Kjo vinte ndoshta, ngaqë çasti i lumtur i inaugurimit të minierës po afrohej përherë e më shumë. Shumica e vrimave ishin mbushur me lëndë eksplozive, ndërsa pjesa tjetër që kishte mbetur duhej të përfundonte deri në mbrëmje, sepse të nesërmen do të bëhej shpërthimi. Shumica e forcave ishin përqëndruar në përgatitjen e terrenit për shpërthimin tjetër, i cili duhej të kryhej një ose dy ditë më vonë. Javën e ardhshme, thoshte vazhdimisht me vete Kristaq Dvorani, minerali i kromit duhet të zbresë poshtë në xhade.

— Orteku! — u dëgjua prapë zëri i Ramë Sheldisë, i cili dukej sikur gëzohej sa herë që zbrisnin ortekët nga Kreshta e Vdekjes.

Njerëzit që punonin në zonën e rrezikshme u larguan menjëherë që andej dhe pritën, derisa orteku të rrëzohej poshtë në greminë. Mirëpo ai, ashtu si edhe disa herë të tjera, kaloi në anën tjetër të greminës.

— Kot e lamë punën, — tha Martin Reka.

Bamë Toroja u mendua pak.

— Jo, more djalë, — i tha. — Është gjë që s'dihet. Ja, kaloi këtej! Po pastaj? A e di ti se një nënvleftësim i tillë mund t'u kushtojë jetën disa njerëzve? Po të mori përpara, masa e dëborës të vërvit poshtë në greminë.



Martin Reka bëri një gjest sikur të donte të thoshte: S'ka ç'na bën, sepse dëborë është fundja. Dëborë nuk po pushonte. Grupi i vajzave kaloi pranë tyre, duke biseduar e duke bërë shaka me njëra-tjetrën. Martin Reka hodhi sytë nga Katerina. Ajo ishte me të vërtetë vajzë e bukur. Flokët e saj të verdhë, që i kishin dalë nga shalli i trashë plot thekë, ishin ngarkuar me dëborë. Sa e bukur që është, mendoi Martini dhe hapi gojën përgjysmë, për t'i thënë diçka Bame Toros; mirëpo aty për aty ndërroi mendje. Pastaj për një copë herë të gjatë ai u mundua të përfytyronte se si do të ishte gruaja e tij e ardhshme. Ndoshta si Katerina, tha me vete. Bjonde me sy bojë qielli, shtathollë, përherë gazmore, apo si Tana, pak brune, me flokë të drejtë ngjyrë-gështenjë dhe pak më e shkurtër se Katerina. Nga të gjitha vajzat kreshnikase që kishte parë këto ia kishin zënë syrin më shumë. Ndoshta ndonjëra nga këto... , po në çast e hoqi mendjen prej andej. Katerina ishte tepër e bukur dhe, për më tepër, diçka flitej për të. Ajo donte Sokol Dinon, sekretarin e organizatës së rinisë të fshatit, kështu që... Ndërsa Tana... O ç'budalla që jam, tha më në fund me vete për të hequr dorë përfundimisht nga ato mendime, që po i dukeshin të parakohshme.

— Martin, — tha Bame Toroja, — a je i fejuar?

Martini fshiu borën me pëllëmbë nga balli i tij i kërcyer. Pyetja që i drejtoi Bame Toroja ishte kaq e papritur, sa ai nuk diti se ç'të thoshte. Si ishte e mundur që edhe Bame Toroja po mendonte për të njëjtën gjë? Në të vërtetë edhe ai kishte filluar ta donte shumë Bame Toron. Vdekja e Turabiut e kishte pikëlluar atë në mënyrë të jashtëzakonshme. Dhembshuria e tyre për njëri-tjetrin po shfaqej në trajtën e një hutimi që qëndronte vazhdimisht pezull mbi kokat e tyre. Që ata po lidheshin me fije të padukshme, kjo shihej edhe në përgjigjet e vonuara që i jepnin njëri-tjetrit:

— Po ja, — tha Martini, — akoma nuk jam ndeshur me fatin tim.

Ai ktheu kokën përsëri nga grupi i vajzave, të cilat, siç dukej, i kishin ngarkuar me detyrë që të stivosnin



lëndën e drurit që ishte grumbulluar mbi një rrafshinë njëqind metra përtej ndërtesës së motokompresorit.

Ra edhe një ortek tjetër nga Kreshta e Vdekjes, tha me vete Bame Toroja. Masa e madhe e bardhë u lëshua poshtë në greminë pa ndonjë rrezik për forcat që punonin. Dëbora kishte filluar të dendësohej. Lart nga Kreshta e Vdekjes, vende-vende e mbuluar me reshje dëbore e vende-vende e qartë si qelibari, dëgjoheshin ca zhurma e angullima të çuditshme, që të gjitha së bashku sajonin një zhaurimë të largët, të pakuptueshme e misterioze njëkohësisht. Sipër nëpër pyllnaja dëbora kishte kohë që vazhdonte të binte.

— Tërë kjo dëborë po bie! — tha dikush që kaloi aty pranë. — E si të mos zbresin ortekë nga Kreshta e Vdekjes?

— Kohë e poshtër! — tha tjetri.

Fytyra i ishte skuqur e tëra nga të ftohtët, kurse mbi rroba, nëpër flokë e në pjesë të tjera të trupit kishte copëza akulli të përziara me dëborë.

— Thonë se atje lart nën Kreshtën e Vdekjes nëpër disa shpella strehohet banda e Çuman Kokobogos, — tha një zë i largët.

— Si është e mundur? — u habit një tjetër.

Këto ishin fragmente bisedash që dëgjoheshin andej-këndej nëpër territorin e Zonës A.

— Do ta realizojmë në kohën e duhur se s'bën shpërthimin e parë, — po u thoshte Kristaq Dvorani disa kreshnikasve që e kishin vënë në mes.

Në krahun e tij të djathtë qëndronte në këmbë me një bllok shënimesh në dorë tekniku Baudin Kazazi. Ai po shënonte diçka me një pamje të menduar në fytyrë.

## ZEMËRIMI I PLAKUT UJKAN SHKABA

Vazhdonte bllokimi i shtigjeve që të çonin te shpellat, nën Kreshtën e Vdekjes. Forcat e ndjekjes ishin shpërndarë në katër drejtime kryesore, duke lënë poshtë në repart vetëm një numër të vogël ushtarësh. Vëmendja kryesore ishte përqendruar në rrugën e teqesë së baba Ali Çakmaxhianit. Kësaj radhe do të bëhet kërdia, kishte thënë plaku Ujkan Shkaba, kur kishte mësuar lajmin e dislokimit të forcave të ndjekjes rreth Kreshtës së Vdekjes. Dhe, kur dikush i kishte thënë se Çuman Kokobogojë me njerëzit e tij po bëjnë përpjekje për të shkatërruar minierën e re të kromit, duke djegur e hedhur në erë barakat e mjetet teknike e duke u prerë kokat me thikë anëtarëve të ekspeditës, ai ishte revoltuar shumë dhe kishte kërkuar që t'i jepnin menjëherë armën për të dalë në pritë. Burrave të fshatit u ishte dashur një kohë e gjatë që t'i mbushnin mendjen se koha ishte shumë e keqe, dhe, ngaqë ishte tepër i moshuar, nuk bënte mirë që të dilte jashtë në një kohë të tillë etj. etj. Ne jemi tërë këta burra, i kishin thënë ata; edhe sikur vetëm të ishim, pa llogaritur forcat e ndjekjes, ne do ta mbysnim me pështymë bandën e Çuman Kokobogos. Plakut Ujkan Shkaba i qe mbushur mendja më në fund, por me një kusht që, në rast se do të kapej i gjallë ai kriminel i ndyrë, t'ia çonin para syve sa për ta parë e për ta pështyrë një herë në fytyrë.

Ndërkohë frekuentimi i teqesë së baba Ali Çakmaxhianit nga dervishët dhe myhibët e fshatrave fqinje po



bëhej përherë e më i shpeshtë. Ata venin e vinin në këmbë, hipur mbi mushka, grupe-grupe, dy e nga dy, duke i pëshpëritur njëri-tjetrit në vesh dhe duke u mbllaçitur. Baba Ali Çakmaxhiani kishte më tepër se dy javë që nuk kishte zbritur në fshat, siç bënte vazhdimisht. Disa thoshin se ai nuk dilte, ngaqë donte të ruhej nga të ftohtët. Disa të tjerë përshpërisnin me zë të ulët se ishte shumë i sëmurë, bile në gjendje të rëndë; dhe me këtë ata shpjegonin në një farë mënyre edhe hyrjedaljet e shpehta të dervishëve e të myhibëve në teqe. Ndryshe nga këta një njeri krejt i panjohur kishte hapur një lajm të çuditshëm. Ai u kishte thënë dy besimtarëve kreshnikas se baba Ali Çakmaxhianit i kishte rënë damllaja pikërisht në kohën që po u mbante një fjalim të rëndësishëm dervishëve e myhibëve të krahinës dhe se ishte shumë keq e po dergjej në shtrat gati për vdekje. Sipas njoftimeve jo të sigurta atij i ishte shtrembëruar fytyra, shtrembërimi ishte aq i theksuar, saqë nuk dallohej më nëse ishte fytyrë e një njeriu të gjallë, apo e një kafshe të çuditshme që nuk ishte parë ndonjëherë përmbi dhé. Konsultat e njëpasnjëshme që kishin bërë disa nga dervishët dhe myhibët që e hiqnin veten për më të zgjuar nuk kishin mundur ta shpjegonin shkakun e kësaj sëmundjeje. Ishte kjo arsyeja që baba Ali Çakmaxhiani sipas thashethemeve i kishte nxjerë jashtë ata, duke u thënë se nuk donte t'ua shihte më sytë. Që nga kjo ditë në dhomën e tij lejohej të hynte vetëm njëri nga dervishët më të besuar.

Kur ia kishin treguar këto gjëra plakut Ujkan Shkaba, ai ishte shkukur së qeshuri.

Ndërkohë qarkullonin edhe zëra, sipas të cilëve mendohesh se tërë kjo ishte një bllof, e se baba Ali Çakmaxhiani gëzonte shëndet të mirë. Por, me sa dukej, këto lajme përhapeshin andej-këndej për të justifikuar hyrjet e daljet e shpeshta të dervishëve e myhibëve që, herë me vetëdije, herë pa vetëdije, i çonin ushqime bandës së Çuman Kokobogos.

Tërë ky informacion grumbullohej diku dhe përpuñohej me kujdes e me qëllime të caktuara.

## BABA ALI ÇAKMAXHIANI

Baba Ali Çakmaxhiani u afrua edhe një herë te dritarja. Jashtë binte dëborë.

— Kam dy javë që po jetoj i mbyllur në teqe, — tha ai me një zë të mallëngjyer. — Do të dal njëherë jashtë, së plasa!

— Kjo është tepër e rrezikshme për ju, — i tha dervishi që i shërbentë për çdo gjë që kishte nevojë.

— Do të dal! — nguli këmbë ai. — Plasa!

Nëpër dhomën e lartë u dëgjua një psherëtimë e thellë që ngjante më shumë me rënkimin e një kafshe të përbindshme.

Si të doni, — tha përsëri dervishi me zërin e tij të ngjirur. — Vetëm duhet të dini se, po ta marrë vesh këtë gjë kapedan Kokobogoja, do të zemërohet.

Baba Ali Çakmaxhiani, pasi psherëtiu përsëri, mbështolli më mirë shpatullat e tij të gjera me peshqirin e madh që kishte hedhur mbi supe. Ai sapo ishte ngritur nga shtrati, ndaj po ndiente të ftohtë.

Uturima e largët e motokompresorit e shqetësonte vazhdimisht. Poshtë në oborrin e teqesë dëgjoheshin zëra. Ishin dervishët dhe myhibët e fshatrave veri-lindore të Kreshnikës, të cilët kërkonin me këmbëngulje të takoheshin me baba Ali Çakmaxhianin. Nga fragmentet e bisedave që arrinin deri sipër në dhomën e tij dilte qartë se ata ishin shumë të shqetësuar për gjendjen e tij shëndetësore. Njëri nga dervishët, të cilet i ishte caktuar detyra që



të priste dhe të përcillte mysafirët e teqesë, po përpiquej t'u shpjegonte arsyet se pse ishin ndaluar takimet me baba Ali Çakmaxhianin. Ata nuk bindeshin dhe qëndronin në të tyren.

— Kemi ardhur nga ana e anës, — thoshte me një zë të dridhur një dervish shtatimët që mezi po e duronte të ftohtët. — Duam të takohemi patjetër me të.

Kjo gjendje ishte tepër dëshpëruese për baba Ali Çakmaxhianin.

— Do të dal! — tha prapë ai me një zë të mallëngjyer.

— Nuk duhet të ekspozoheni, — i tha dervishi këtë herë me një ton gati urdhërues. — Sipas planeve të Kapetan Kokobogos...

Baba Ali Çakmaxhiani ia la mendimin përgjysmë. Që t'i jepte të kuptonte dervishit se nuk donte të dëgjonte më këshilla, ia nguli sytë e tij të mëdhenj me qeska anash e të etur për t'u grindur me dikë.

Dervishi uli sytë në dysheme dhe nuk foli më.

— Dua të shoh dervishët dhe myhibët e mi, — tha ai me zë të rëndë. — Ata janë rraskapitur nga rruga e gjatë, kurse unë... Me kreshnikasit i shkëputëm pothuajse fare lidhjet... Çfarë më këshilloni të bëj? Mos vallë duhet t'i shkëputim lidhjet edhe me dervishët dhe myhibët e fshatrave të tjera? Po pastaj me se do të mbahet në këmbë teqeja dhe kush do t'i ushqejë tërë këta barkderra?

— Kjo është një gjendje e përkohshme, — tha dervishi me një zë të dridhur. — Ndoshta...

— Çfarë «ndoshta»? Këto janë veprime që e cënojnë rëndë autoritetin e teqesë... por ç'të bëj... kam dhënë fjalën dhe tani...

— Ndoshta nuk do të vazhdojë gjatë, — tha prapë dervishi me njëfarë besimi në vetvete.

— Pusho! — thirri baba Ali Çakmaxhiani, duke përplasur këmbën e majtë në dysheme. — Më vjen ndot nga këshillat e tua...

Në çast u ngrit dhe, megjithëse zgjati kokën nga dritarja për të parë se ç'bëhej poshtë në oborrin e teqesë, nuk pa asgjë. Jashtë vazhdonte të binte dëborë. Siç dukej, të porsaardhurit ishin futur nëpër dhomat e zjarrit.



Nëpër korridoret e hyrjes kryesore vazhdonte të dëgjohej zëri i hollë i dervishit shtatimët. Unë nuk iki që këtej, pa u takuar me baba Ali Çakmaxhianin, thoshte ai. Më ka marrë malli shumë, sepse kam gjashtë muaj pa e parë me sy. Kur mora vesh se i ka rënë damllaja, më ra të fikët te pragu i derës.

— Ç'gjë e tmerrshme! — tha baba Ali Çakmaxhiani me një zë të përlotur. — Po ndahem nga njerëzit për së gjalli...

Ai doli në korridorin e katit të sipërm, për të dëgjuar më mirë zërat që vinin nga dhomat e zjarrit. Dervishi e ndoqi pas me një shqetësim të madh në gjoks.

— Thonë se njerëzit e kapedan Kokobogos, sot kanë zbritur poshtë, — tha ai. — Kanë marrë urdhër që të shkatërrojnë minierën dhe të djegin të gjallë të gjithë anëtarët e ekspeditës që ka ardhur nga Tirana. S'është çudi, që disa nga trimat e tij të vijnë sonte në teqe..., — shtoi pas pak dervishi.

Baba Ali Çakmaxhiani e përpiu me sytë e tij të mëdhenj e të përgjakur. Tani do të zbres poshtë, po thoshte me vete, që ta marrin vesh të gjithë se unë jam shëndoshë e mirë, se damllaja, larg qoftë, nuk më ka rënë mua, por... Mirëpo sapo dëgjoji fjalët e dervishit që e ndiqte pas porsì një hije e keqe, u ndal te shkallët e drunjtja që zbrisnin në katin e parë.

Ai qëndroi një copë herë të gjatë në heshtje dhe pastaj, para se të futej përsëri në dhomën e tij të gjumit, tha:

— Do të duroj edhe disa ditë, vetëm se...

Dervishi e ndoqi një copë herë me sy, duke ua ngulur vështrimin vitheve të tij të trasha që uleshin e ngriheshin ritmikisht në përputhje me ritmin e hapave të tij të rëndë. Kohët e fundit baba Ali Çakmaxhiani ishte shëndoshur së tepërmi. Meqenëse disa nga dyert e brendshme të teqesë, sidomos ato të WC-ve, nuk e nxinin më, ai kishte dhënë urdhër të zgjeroheshin sa më parë. Po kështu po riparoheshin me ngut edhe disa dërrasa gjysmë të kalbura nëpër korridore, që ishin thyer për shkak të peshës së tij të rëndë.



Njerëzit e kapedan Kokobogos, mendoj baba Ali Çak-  
maxhiani, kanë marrë urdhër të shkatërrojnë minierën  
dhe të djegin të gjallë anëtarët e ekspeditës që ka ardhur  
nga Tirana... Ai u mendua një copë herë dhe pastaj tha  
me vete: Me minierën le të bëjnë c'të duan, ndërsa te-  
qenë bëjnë mirë ta lënë rehat.

— Ç'është t'është! — the baba Ali Çakmaxhiani  
me një zë të përlotur. — Po ndahem nga njerëzit për të  
gjallë!

Ai doi në korridorin e katit të sipërm, për të dëgjuar  
me dritë zërat që vinin nga dhomat e zjarrit. Dërvishi  
ndodhi pas me një sipërfaqe të madhe në shtok.  
— Thonë se njerëzit e kapedan Kokobogos, sot ka-  
në shtritur pozitë... the ai. — Kanë marrë urdhër që të  
shkatërrojnë minierën dhe të djegin të gjallë të gjithë  
anëtarët e ekspeditës që ka ardhur nga Tirana. S'është  
evident, që disa nga trimat e tij të vijtë sonte në teqe... —  
shtoi pas pak dërvishi.

Baba Ali Çakmaxhiani e përdriu me sytë e tij të më-  
dhanj e të pengjakur. Tani do të shpues pozitë, po thekiste  
me vete, që ta marrin veç të gjithë se unë jam shën-  
dashë e mirë, se demtillaja, larg çelës, nuk më ka këna-  
qur, por... Mirëpo ajoqë dëgjoi thirrje dërvishi dhe e ndo-  
ti pas portit që i hite e këpë, u ndal të shkallët e druajtë  
që çelësin në katin e parë.

Ai dëndroi një copë herë të shtë në heshtje dhe pas-  
aj, para se të futet përballë në dhomën e tij të gjumit, the:  
— Do të duroj edhe disa ditë, vetëm se...  
Dërvishi e ndodhi një copë herë me sy duke ua ngre-  
tur vështrimit vijëve të tij të basha që uleshin e prishje-  
shin ritmikisht në përpjetë me trimin e hapave të tij të  
rëndë. Kohët e fundit baba Ali Çakmaxhiani ishte shëndo-  
shur sa tepërt. Mendonëse disa nga dërvit e përdahmë të  
tepesë, sidomos ato të WC-ve, nuk e nxinin më, ai kishte  
dhënë urdhër të xjeteroshin sa më parë. Po kështu po  
riparoneshin me gurt edhe disa dërrasa gjyansë të kalbura  
nëqort korridorit, që ishin llyer për shkak të peshës së tij  
të rëndë.

## NË VALËN E PUNËS

Shefi i kantierit, Kristaq Dvorani, vente dhe vinte nga njëri skaj i Zonës A në tjetrën. Përgatitja e terrenit për kryerjen e shpërthimit të parë po hynte në fazën përfundimtare. Minatorët nën drejtimin e Bame Toros përgatiteshin për të vendosur lëndën eksplozive. Për t'ua lehtësuar punën, vajzat dhe disa të rinj kreshnikas largonin dëborën, ndërsa Sokol Dinoja me disa shokë vazhdonin të shponte vrima të tjera në sektorin ku mendohej të bëhej shpërthimi i dytë. Zaçe Çapoku, si zakonisht, rrinte pranë motokompresorit, kurse Ramë Sheldia dhe një tjetër qëndronin në pikën e vrojtimit, në gatishmëri për të dhënë sinjalin për zbritjen e ortekëve nga Kreshta e Vdekjes. Kristaq Dvorani urdhëroi të ndaheshin më dysh forcat e reja që kishin ardhur para dy orësh nga fshati: një pjesë të shkonte në ndihmë të muratorëve që vazhdonin punën për ngritjen e ndërtesës së motokompresorit, kurse pjesa tjetër të bashkohej me druvarët që prisnin lëndë druri për galeritë e ardhshme. Poshtë, në barakën e dytë. Ata kishin vendosur që, sapo të përfundonin atë, të fillonin nga puna për të ndërtuar një garazh të vogël për automjetet. Ritmi, me të cilin punohej kudo, të linte përshtypjen se gjithsecili përpiqej t'ia kalonte tjetrit dhe se çdo njeri veçmas apo në grupe me nga tre-katër shokë dëshironin të ishte kurdoherë në garë. Në të gjitha frontet e punës dëgjoheshin gjithfarë zhurmash



të goditura, zëra, psherëtima, të qeshura, hapa të shpejtë mbi dëborë, rënkime; por mbi të gjitha këtu sundonte uturima e motokompresorit dhe kënga e barominave. Megjithëse shakullima e erës, herë-herë e fuqishme, ua përplaste dëborën njerëzve në fytyrë, ata nuk donin t'ia dinin. Secili luftonte në pozicionin e vet, duke mos përfillur vërshtëllimën e erës, e cila dukej sikur ulërinte nga inati. Ajo që ndodhte rreth tyre i ngjante një beteje të vërtetë, në të cilën nga njëra anë ishin dislokuar forcat njerëzore me shtabin e vet, kurse nga ana tjetër forcat e natyrës si edhe njerëzit e Çuman Kokobogos. Plani i tyre për shkatërrimin e minierës dhe asgjësimin e punonjësve të ekspeditës ishte përpunuar, tashmë, me kujdes. Pritej me padurim që të gjendej vetëm çasti më i përshtatshëm për ta vënë në jetë. Forcat e ndjekjes ishin në dijeni të plotë të këtij plani. Ato ishin vënë në lëvizje për të kapur e asgjësuar bandën e Çuman Kokobogos që shfaqej herë pas here diku në skajin lindor të pyllnajës, në lagjet e sipërme të Kreshnikës, në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit. Në orët e vona të natës ajo ishte parë të qarkullonte edhe në qendrën e fshatit njëqind metra larg zyrave të këshillit popullor të lokalitetit, fare pranë oborrit të vatrës së kulturës. Vrasja e dy pjesëtarëve të saj në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit e kishte tërbuar pa masë Çuman Kokobogon. Në disa operacione ai kishte marrë pjesë edhe vetë, me qëllim që të ngrinte moralin e njerëzve të tij të rraskapitur.

Rezistenca e armiqve të klasës ndihej kudo: pengohej furnizimi i popullsisë me sende veshmbathjeje dhe gjëra ushqimore, sabotohej grumbullimi i drithërave dhe i produkteve të tjera bujqësore e blegtorale, krijoheshin vështirësi për luftën kundër analfabetizmit etj. etj. Ishin pikërisht këto arsye që kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, Burhan Kola, kishte pothuajse dy ditë që nuk ishte dukur në sektorin e minierës.

Vazhdonte të binte dëborë. Kristaq Dvorani vështronte ndërtesat me çati të larta të Kreshnikës dhe mendonte për takimin që duhej të bënte me Burhan Kolën,

Një takim i tillë është i domosdoshëm, po thoshte me vete ai. Nesër do të bëjmë shpërthimin e parë; me këtë rast na duhet të organizojmë patjetër një ceremoni të thjeshtë, e cila do të mbetet si çasti më i lumtur për minatorët, si dita e krijimit të minierës që do të festohet pastaj nga brezat e ardhshëm.

Grupi i minatorëve nën drejtimin e Bame Toros vazhdon të vendoste me kujdes lëndën eksplozive. Ndërkohe Sokol Dinoja me shokët e tij vazhdon të shponte vrima të reja në sektorin ku mendohej të bëhej shpërthimi i dytë.



## NËPËR PYLLNAJËN ME DËBORË

Kishte kaluar më tepër se një orë që njerëzit e Çuman Kokobogos (ai përsëri nuk vajti vetë) ishin vendosur nëpër pozicione dhe vështronin nga lart se ç'punë e madhe po bëhej në Zonën A të minierës së re të kromit. Pamja ishte e mahnitshme. Dukeshin qartë një ndërtesë e re, që nuk kishte përfunduar akoma, një motokompresor që uturinte pa pushim, në të djathtë një grup minatorësh që vendosnin me kujdes lëndën eksplozive; diku në qendër po hapeshin vrima të reja; në të majtë po ngriheshin stiva me lëndë druri, siç dukej, për t'i përdorur për armaturën e galerive që ndoshta do të fillonin të hapnin së shpejti dhe sipër mbi një majë shkëmbi dy njerëz që vrojtonin vazhdimisht në drejtim të Kreshtës së Vdekjes. Njërin prej tyre Alush Manjaku e njohu menjëherë: ishte Ramë Sheldia, me të cilin ai ishte takuar dy ditë më parë për t'i dhënë porosi të kapëdan Kokobogos. Dëborë që vazhdonte të binte papushim, e kishte zbardhur krejt dhe i kishte dhënë një pamje të çuditshme. Kur e pa për herë të parë, Alushit i erdhi për të qeshur, por u përmbajt, se aty për aty u kujtua që ndodheshin fare afër dhe zhurma më e vogël mund të ekspozonte tërë bandën. Diku në krahun e tyre të majtë punonin druvarët, të cilët prisnin lëndë druri për minierën e re dhe e lëshonin nga lart nëpër rrugën, që kishin krijuar mbi dëborën e ngrirë. Alushi shtrëngonte me të dy duart automatikun e tij anglez. Çdo dy-tre hapa në të dy krahët e tij ishin shtrirë në dëborë në poza të ndryshme tërë pjesëtarët e



bandës. Diku sipër pas shpinës së tyre lëvizte me kujdes patrulla, e cila kishte si detyrë që të sinjalizonte për çdo rast rreziku. Alushi ngriti sytë nga rrafshina ku lëviznin sa andej-këndej dhjetëra punonjës dhe pastaj u shmang pak nga e majta për të parë më mirë. Megjithatë iu duk se njohu disa fytyra kreshnikasish, prapë nuk ishte shumë i sigurt. Dëbora, që vazhdonte të binte pa pushim, nuk i lejonte që t'i dallonin mirë njerëzit, të cilët po i shpeshonin lëvizjet duke kaluar sa nga njëri skaj i territorit të punës në tjetrin. Siç dukej, ata ishin duke përfunduar ose kishin filluar një punë të re, që u shkaktonte kënaqësi. Shkonin e vinin te njëri-tjetri, mblidheshin kokë më kokë, diskutonin duke bërë gjeste me duar, shpërndareshin, prapë mblidheshin diku në një vend tjetër dhe kështu pa pushim lëviznin pors i milingonat mbi dëborën e bardhë.

Alushi ktheu kokën në të dy krahët për të parë se ç'po bënin shokët e tij, kur befas dëgjoi një zë, që erdhi nga poshtë. Një kreshnikas me fytyrë shtetëzakonisht të kënaqur po vraponte nga njëri grup te tjetri, duke bërë titur: «Minimi përfundoi! Shpërthimi i parë është gati!» Alushi e ndoqi atë një copë herë të gjatë, duke e parë nëpërmjet rrethit të shënjestrës së automatikut. Ai deshi t'ia zbraste tërë karikatorin në gjoks, por, kur iu kujtua porosia e kapedan Kokobogos, e uli tytën e tij të ftohtë mbi dëborë, duke kërcitur dhembët si i tërbuar. Që nga pozicioni që kishte zënë ai kishte një gjendje që të asgjësonte shumicën e njerëzve që lëviznin sa andej-këndej mbi rrafshinën e minierës. Mirëpo këtë ai nuk mund ta bënte, sepse, sipas urdhrat që kishte marrë, duhej që anëtarët e ekspeditës të digjeshin të gjallë, kurse shefi i tyre të varej në shtyllën e telefonit. Një breshëri automatiku mbi turmë do të prishte shumë punë, sepse ata mund të shpëtonin. Një veprim i tillë nuk do ta bënte efektin e duhur.

— Sikur të largoheshim që këtej, — tha njëri nga diversantët që kishte në krah. — Mbase e bëjnë shpërthimin tani dhe... po e bënë... na hodhën në erë të gjithë...

Alushi u mendua një copë herë.



— Mirë e ke, — i tha. — Të kalojmë në krahun e majtë me kujdes se mos ndeshemi me druvarët dhe pastaj na mori lumi...

Ata u ngritën, duke i bërë shenjë me kokë njëri-tjetrit. Një diversant me fytyrë të çakërdisur tha:

— Më lejoni t'i shkoj të tërë në plumb!

Ai ishte shtrirë mbi dëborë dhe, duke marrë shenjë, lëvizte tytën e automatikut sa majtas-djathtas.

— Çohu, more derr! — i shfry Alushi. — Se mos na bën ndonjë gafë?!

Kur ai e qëlloi me shkelm në vithe, diversanti me fytyrë të çakërdisur u ngrit tepër i revoltuar.

— Pusho, — i tha Alushi, — se t'i hodha trutë në erë! Pse nuk dimë të qëllojmë ne të tjerët, vetëm ti... derr i derrit!

Diversanti me fytyrë të çakërdisur pështyu përdhe dhe pastaj e ndoqi pas me kokën ulur përdhé. Edhe hapat e tij mbi dëborë tregonin se ishte nevrík i madh.

Ata dolën përsëri mbi një rrafshinë ku po i priste patrulla. Alushi u vu në krye të bandës dhe u bëri shenjë me kokë gjithë të tjerëve që ta ndiqnin pas me shumë kujdes, me qëllim që të mos diktoheshin nga druvarët. Diku, në të majtë, u dëgjua e rrahura e një sëpate. Ata qëndruan një copë herë në këmbë, duke ngrirë në vend në poza të ndryshme; pastaj u shmangën pak nga e djathta për t'iu larguar druvarit që nuk ishte më shumë se dhjetë hapa larg. Kudo dukeshin gjurmë ashklash dhe drurë të prerë dhe të hedhur sa andej-këndeje. Druvarët, siç dukej, kishin qenë aty pak më parë, kurse tani kishin zbritur pak më poshtë.

— Kujdes! — murmuriti nëpër dhëmbë njëri nga diversantët. — Paska njerëz!

Alush Manjaku dhe tre-katër veta që e ndiqnin pas shtangën në vend. Diversanti me fytyrë të çakërdisur me automatik në gjoks, eci edhe pak dhe u ndal pas një pishe të ngarkuar me dëborë.

— Ku vete, more qorr! — i shfryu me zë të ulët Alushi.



Ai rrotulloi tërë trupin nga ata dhe, duke mbajtur automatikun të shtrënguar në gjoks, tha:

— Dua të derdh gjak! S'më durohet!

Alush Manjaku ia kërcëlliu përsëri dhëmbët. Ai u detyrua ta ulte kokën përdhe, ndërsa tytën e automatikut e ngriti menjëherë nga qielli.

— Ja një druvar! — tha një zë prapa një pishë.

Druvarin e kishte aq afër, saqë mund ta vriste me qytën e hekurt të automatikut. Me zor të madh e përmbajti veten. Druvari u zhduk nëpër një rruginë duke mbajtur në krah një vandak me lëndë druri. Më tutje kishte disa stiva me lëndë druri që, siç dukej, i kishin bërë gati për t'i transportuar. Alushi u shmang menjëherë nga e majta, duke menduar se diku në afërsi të stivave mund të kishte njerëz. Ai vuri re se sytë e diversantit me fytyrë të çakërdisur rrëshqitën si me përtim nëpër stivat e druve. Dukej, sikur kërkonte midis tyre ndonjë druvar. Mbase shpreson të gjejë ndonjë torbë me ushqime, mendoi Alushi. Edhe një diversant tjetër që po ecte pranë tij bëri të njëjtën gjë. Janë të uritur derrat e derrat, tha prapë me vetë Alushi. Duan të hanë.

Një egërsirë që s'u mor vesh se ç'ishte, kaloi me shpejtësi midis disa pishave e bredhave, duke shkundur dëborën nga degët e tyre. Tre-katër hapa para tyre njëri nga diversantët u shtri menjëherë mbi dëborë dhe mori shenjë, duke zgjatur kokën përpara gjithë kureshtje. Po, kur u bind se egërsira u zhduk nëpër pyll, u ngrit, duke mbështetur qytën e automatikut.

— Asnjeri të mos qëllojë pa urdhrin tim! — u tha Alushi që prapa një bredhi të lartë që dukej pak si i vetmuar.

Pas disa minutash ata zbritën mbi një kodrinë të pyllëzuar nga ku dukej shumë mirë kantieri i minierës së re të kromit. Rreth e rrotull hanit të dikurshëm, pranë të cilit kishin kaluar dy javë më parë, ishte krijuar një ambient krejt tjetër. Dy barakat që ishin ngritur gjatë dy ditëve të fundit nga vëllezërit Ukcama dukeshin të bukurra. Çatitë e tyre të larta dhe të pjerrëta ishin mbuluar me një shtresë të lehtë dëbore.



— Ja barakat, — tha njëri nga diversantët që i pa i pari.

Rreth e rrotull vendi dukej i bardhë. Vëllezërit Uk-cama sapo kishin filluar nga puna për ndërtimin e garazhit të automjeteve.

Alushi po kërkonte me sy ndonjë shtyllë telefoni. Ja ku qenka, tha me vete duke hedhur sytë njëqind metra përtej barakave. Shtylla dukej e fortë dhe ndodhej në anë të xhadesë në një vend mjaft të përshtatshëm që binte në sy menjëherë. Do të ishte mirë të vendosnim mbi të një dërrasë në formën e kryqit, tha me vete Alush Manjaku, dhe aty ta mbërthenim porsì Krishtin shefin e ekspeditës. Do të ishte një gjë e bukur, mendoi ai, duke u përpjekur të përfytyronte skenën e llahtarshme. E mrekullueshme! Kapedan Kobobogoja do të shqyhej së qeshuri, kur t'ia tregonin dhe... sigurisht... duke qenë në eufori... nuk do t'ia kursente edhe një qese tietër me flori... Futi dorën në xhëp dhe preku me dorë florinjtë që kishte marrë me vete për t'ia dhënë baba Ali Çakmaxhi-anit.

Një kamion i ngarkuar me disa thasë të mëdhenj, siç dukej me drithë, po zbriste me ngadalë nga Qafa e Humerës. Shoferi kishte hapur derën dhe, duke qëndruar në këmbë me një dorë në timon, e ngiste makinën ngadalë e duke parë rrotat e mbrapme, të cilat, herë pas here, xhironin në dëborë.

— T'i dalim përpara! — tha diversanti me fytyrë të çakërdisur e duke shtreimbëruar turinjtë me neveri.

Alushi po mendohej për vendimin që duhej të merrte. Kishte shumë mundësi që kamioni të transportonte miell për në zonat e thella, gjë që për ata do të ishte shumë e dëshirueshme! Ata mund ta hiqnin qafe me lehtësi shoferin, të merrnin disa thasë me vete dhe pastaj t'i vinin shkrepësen kamionit! Mirëpo një veprim i tillë do t'i ekspozonte dhe do të bënte që të dështonte operacioni kundër minierës. Në këto rrethana ai vendosi që të mos bënin asnjë hap në drejtim të xhadesë.

— Asnjë lëvizje pa urdhrin tim! — i paralajmëroi ai trimat e tij që ishin shtrirë sa andej — këndeje nëpër dë-



borë me vështrimin mbërthyer te kamioni që po ngjitej me vështirësi nëpër xhadenë malore. Si të merrte edhe një kthesë të rrezikshme, ai do të dilte në rrugën e drejtë që kalonte para kantierit të minierës së kromit. Aty katër nga vëllezërit Ukcama po çanin dërrasa mbi një skelë që e kishin ngritur për këtë qëllim në anë të një ledhi plot kaçuba e gjemba.

— Njëri më duket si Baftjari, — tha diversanti me fytyrë të çakërdisur. — Është vëllai i madh i Ukcamajve.

— Siç duket, — tha një tjetër andej nga mbrapa, — të pestë vëllezërit Ukcama paskan ardhur në ndihmë të minierës.

— Mbase duhen varur edhe këta që të pestë, ja, mu atje te skela e sharrës, — tha Alushi me një pamje të zemëruar.

Diversantit me fytyrë të çakërdisur iu bë qejfi. Ai i buzëqeshi për herë të parë mikut më besnik të kapedan Kokobogos, të cilin nuk e shikonte dot me sy vetëm e vetëm se Çuman Kokobogojja e mbante vazhdimisht në krahun e djathtë dhe bisedonte me të për çdo gjë.

— Paskan vendosur edhe telefon, — tha dikush në krahun e djathtë të Alushit.

— Ku? — pyeti një tjetër.

— Ja, nuk e shikon linjën telefonike që duket nën strehën e hanit? — ia shpjegoi tjetri: Ai i tregoi fijen e telit, e cila vinte nga shtylla telefonike që ndodhej njëqind metra përtej barakave.

Teli, i ngarkuar vende-vende me dëborë, ishte lidhur në një shtyllë provizore diku në afërsi të garazhit të automjeteve. Tërë këto gjëra që i kanë bërë brenda këtyre dy-tri ditëve, po thoshte me vete Alushi, do të zhduken sonte natën për një sekondë. Si tha këtë gjë me vete, ai u anua dhe nxori një cigare, të cilën shoku që kishte pranë ia ndezi menjëherë.

— Ky është pozicioni më i përshtatshëm, nga ku duhet të nisemi për të sulmuar kantierin, — tha Alushi, pa e hequr cigaren nga goja. — Tani ne duhet të ngjitemi më lart në teqe dhe të presim derisa të ngriset.



Diversanti me fytyrë të çakërdisur e miratoi menjëherë mendimin e tij. Në çast Alushi u ngrit, duke dhënë urdhër që ta ndiqnin pas.

Në muzg, tamam në çastin kur njerëzit e Çuman Kokobogos po bëheshin gati të hidheshin në oborrin e teqesë së baba Ali Çakmaxhianit, për të pritur aty derisa të binte mirë nata dhe pastaj të zbrisnin poshtë për të shkuar në kantierin e ri të minierës, ranë në përpjekje me forcat e ndjekjes që ishin duke udhëtuar në drejtimin e kundërt. Ata kishin hipur si zakonisht mbi kuaj dhe po ecnin ngadalë për të mos u diktuar. Mirëpo dikush nga njerëzit e Kokobogos e dëgjoi trokun e kuajve mbi dëborën e ngrirë dhe dha menjëherë alarmin, duke thirrur: «Prapa!»

Forcat e ndjekjes zunë menjëherë pozicionet për të luftuar. Një copë herë të dyja palët qëndruan në heshtje. Një minutë më vonë diversantët filluan të zvarriteshin mbi dëborë, me qëllim që t'i largoheshin sa më shumë rrezikut. Ata ishin futur nëpër disa kaçuba dhe ndodheshin shumë afër forcave të ndjekjes. Në krahun e djathtë kishin një përrua të thellë, në të majtë gardhin e oborrit të teqesë, kurse përpara forcat e ndjekjes. Kthimi mbrapsht ishte krejt i lirë, por atyre nuk u leverdiste, sepse forcat e ndjekjes ishin mbi kuaj dhe do t'i zinin menjëherë.

Dikush u përpoq të kapërcente gardhin për t'u hedhur në oborrin e teqesë, mirëpo një breshëri automatiku e la atë të varur mbi një hu ndërkohë që ai ishte kapur për të kaluar në anën tjetër.

Pak më vonë shpërtheu mbi kaçubë një zjarr i pandërprerë automatiku, i cili u shoqërua nga tre-katër automatikë të tjerë.

— Ou! — u dëgjua një zë nëpër errësi.

Automatikët vazhdonin të villnin zjarr mbi kaçubë. Hijet e zeza filluan të lëviznin njëra pas tjetrës. Dikush dha urdhër.

— Në përrua! Pas meje, hidhuni! — ulëriu edhe një herë i njëjti zë.

Hijet e zeza kërcyen njëra pas tjetrës në Përruan e Thellë dhe u zhdukën përmes kaçubave e gjembave që ishin mbuluar krejtësisht nga dëbora. Zjarri i automati-këve u përqëndrua në drejtim të përroit, por pa sukses. Njerëzit e Kokobogos mundën të dilnin në anën tjetër; në panik e sipër ata qëlluan disa herë në drejtim të forcave të ndjekjes, duke lënë të vrrarë një nga kuajt e tyre më të mirë.

Në thellësi të përroit vazhdonte të dëgjohej një rënkim i mbytur, që vinte duke u dobësuar. Me sa dukej, ndonjë i plagosur ishte hedhur në përrua, për të shkuar bashkë me shokët e vet, por nuk kishte mundur të dilte në anën tjetër.

Forcat e ndjekjes qëndruan një copë herë të gjatë në përgjim për të mësuar rrugën që përshkuan njerëzit e Çuman Kokobogos, derisa u ngjitën lart në pyll. Ndjekja e mëtejshme e tyre ishte me rreziqe dhe në të njëjtën kohë krejt e panevojshme.

Taktika e forcave të ndjekjes ishte asgjësimi i bandës pjesë-pjesë dhe pa vënë në rrezik jetën e ushtarëve.

Poshtë në përrua vazhdonte të rënkonte diversanti i plagosur që po kalonte çastet e fundit të jetës së tij.



DATA E SHITATÉ

È pientie 30 apbrur 1948

## ZEMËRIMI I KAPEDAN KOKOBOGOS

Në mëngjes herët, ende pa u gdhirë mirë, Zenel Kokobogoja u ngrit dhe me hapa të ngadaltë e si të mpirë u drejtua nga dalja e shpellës së tij të madhe.

Roja po flinte ulur mbi një gur dhe me fytyrën mbështetur mbi tytën e automatikut. I këputi një të sharë vendçe dhe pastaj e pyeti nëse kishte ndonjë lajm në lidhje me trimat e tij që kishin zbritur poshtë me detyrë të posaçme. Ai kishte pritur me orë të tëra të shikonte barakat e kantierit të mbuluara në flakë, por më kot. Në fund, pasi ishte bindur se një gjë e tillë s'kishte për të ndodhur gjatë asaj nate, ishte grindur një copë herë të gjatë me veten dhe pastaj ishte futur brenda për të pushuar.

— Ata u kthyen, — tha roja, duke murmuritur nëpër dhëmbë.

— Si?! — u habit Çuman Kokobogoja. — Po barakat, po njerëzit e ekspeditës...

Roja uli sytë përdhe, gjë që donte të thoshte se ata kishin dështuar plotësisht.

Sytë e Çuman Kokobogos, të përsququr nga pagjumësia, u zmadhuan në mënyrë të habitshme. Ai i rrotulloi ata një herë nga e majta dhe pastaj nga e djathta, dhe më në fund ia nguli rojës me një etje të madhe për t'u përlëshur me dikë.

— Ku janë futur horrat e qelbur! — klithi me sa kishte në kokë.



— Njëpër shpella, — tha roja duke u dridhur.

— Përse nuk më njoftove menjëherë, o kopuk i djallit!

Roja filloi të dridhej i tëri.

— Të paraqiten menjëherë tek unë! Do t'i dërgoj të gjithë në djall!

Për një sekondë ai u ndodh i gozhduar në ndenjësen e tij të zakonshme në krye të shpellës. Trimat që kishte mbajtur me vete ishin ngritur të trembur dhe po sorollateshin njëpër gjysmerrësirën e shpellës. Ata u ulën pranë tij në heshtje.

Alush Manjaku, njeriu me fytyrë të çakërdisur dhe gjithë njerëzit e tjerë filluan të hynin në shpellë një nga një kokulur dhe duke u dridhur nga frika dhe nga të ftohëtet njëkohësisht. Shumica mezi qëndronin në këmbë, kurse disa andej nga fundi kërcëllinin dhëmbët duke murmuritur me vete ca fjalë të pakuptueshme, që ngjanin më tepër me lutjet që i drejtoheshin zakonisht allahut. E hëngri tani, e hëngri, pëshpëriste dikush te hyrja e shpellës.

Çuman Kokobogoja rrinte ulur në copën e shkëmbit të veshur me gjithfarë lëkurë egërsirash dhe nuk fliste. Nga hyrja e shpellës vinin ca rreze drite; herë-herë ato ndriçonin sytë e tij të zmadhuar në mënyrë të tmerrshme, duke i dhënë fytyrës së tij një pamje të përbindshme. Megjithëse e pa që ishin grumbulluar të gjithë dhe po rrinin si të ngrirë e në poza të ndryshme para tij, ai nuk po ua thoshte ende mendimet e llahtarshme që i vërtiteshin në kokë.

Truri i tij dukej sikur kishte marrë zjarr dhe fytyra i ishte shtrembëzuar e tëra. Një copë herë të gjatë qëndroi me vështrimin e egër të mbërthyer në një pikë të vetme dhe me automatikun shtrënguar në gjoks.

— O zot! — tha një zë i dobët. — Do të na pushkatojë të gjithë!

— Horrat e dërrit! — thirri ai me një zë të prerë.

Pas pak kapedan Çuman Kokobogoja filloi të dridhej nga histerizmi i papërmbajtur. Njerëzit vazhdonin të rrinin si të ngrirë, sepse nuk dihej ende se ç'vendim ishte



marrë në trurin e tij. Të gjithë kishin shtangur në vend. Kur ai hapi gojën për të folur, Alush Manjaku po murmuriste diçka nëpër dhembë.

— Çfarë the? — klithi përsëri ai.

— Tha se forcat e ndjekjes ishin me shumicë e në lëvizje. Punëtorët dhe kreshnikasit ishin me ta, — u përgjigj njeriu me fytyrë të çakërdisur në vend të tij.

Sytë e zmadhuar të Çuman Kokobogos iu qepën fytyrës së Alush Manjakut. Ai filloi të ngrihej në këmbë me ngadalë. Në sekondë lëvizi automatikun duke ia vënë tytën në gjoks Alush Manjakut.

— Çarmatoseni horrin e derrit! — thirri me gjithë forcën e tij.

Dy nga trimat që kishte në krah e çarmatosën menjëherë dhe i bllokuan duart, që të mos kishte mundësi të bënte asnjë lëvizje.

— Jashtë! Shporruni! — u tha të tjerëve.

Ata dolën porsì bagëtia, duke shtyrë njëri-tjetrin. Për një copë herë të gjatë shpella ra në qetësi. Trimat më besnikë të Çuman Kokobogos e kishin kapur në të dy krahet Alush Manjakun dhe po prisnin urdhrin e padronit të tyre.

— Ju, — foli prapë ai, po kësaj radhe me një zë të ulët dhe poshtërues, — i keni shërbyer deri më sot lartmadhërisë së tij, mbretit Zog, dhe, për këtë, — tha prapë me të njëjtin ton, — unë, miku i tij personal, nuk jua kam kursyer qeset me flori... Por kësaj radhe, — këtu zëri i tij filloi të ngrihej, — ti na mbulove me turp... se ne njoftuam që mbrëmë qendrën... se... aksioni u krye... dhe sot gazetat e kanë botuar atë me germa të mëdha... prandaj meriton një gjë tjetër... meriton plumbin ballit... Më kupton? Plumbin! Jashtë! Derr i derrit!

Shpella buçiti përsëri nga zëri i tij i tërbuar.

— Jo, jo, jo! — thërriste Alush Manjaku, duke u përpëlitur në duart e trimave të Çuman Kokobogos. — Mos më pushkatoni, unë s'kam faj. Pritëm tërë natën në dëborë, por ishim në rrezik, ishim në rrezik... Jo, jo, jo!

Ishte e pamundur t'ia mbyllje gojën. Dikush u përpoq që t'i vinte një shami, po ai e kafshoi dhe vazh-



doi të ulërinte i tmerruar. Vetëm një grusht i fortë pas veshit e shembi atë përdhe. Ashtu siç ishte, i shtrirë mbi dëborë, pak anash, Çuman Kokobogojë, pa e hequr automatikun nga gjoksi, zbrazti mbi trupin e tij të gjatë një karikator të tërë. Kufoma u mblodh kruspull e pastaj ngriu me sytë hapur.

— Tani hidheni poshtë! — urdhëroi Çuman Kokobogojë.

Trimat e tij e rrëmbyen menjëherë dhe u hodhën poshtë në humnerë.

Rreth e rrotull njerëzit rrinin si të ngrirë. Njeriu me fytyrë të çakërdisur buzëqeshi lehtë.

— Ti, — i tha Çuman Kokobogojë, — do të zësh vendin e tij në katërshen time më besnike.

Njeriu me fytyrë të çakërdisur buzëqeshi përsëri. Ai po kërkonte me sy tre trimat e tjerë.

— Kush nuk zbaton urdhrat e mi, kështu do ta pësojë! — tha pas pak Çuman Kokobogojë, duke rrudhur vetullat e tij të pjerrëta.

Ai u mundua t'i përfshinte të gjithë me një vështrim. Sytë e tij të përskuqur tregonin se ai vazhdonte të ishte i tërbuar nga inati.

— Dhe tani, — tha pasi qëndroi një copë herë të gjatë në heshtje, — ejani të gjithë pas meje. Atë, që nuk e bëtë ju gjatë natës do ta bëj unë në mes të ditës!

Me gjithë zërin e tij, në dukje të butë, sytë e përskuqur tregonin qartë se ai vazhdonte të ziente përbrenda.

— Këtu do të qëndrojnë vetëm roja dhe radisti, — tha dhe u nis i pari nëpër pyllnajën me dëborë.

Diversantët e shoqëruan atë kokulur dhe duke u radhitur njëri pas tjetrit. Në krye, fill pas tij, vinte katërshja më e besuar, ndërmjet të cilëve tani ndodhej edhe njeriu me fytyrë të çakërdisur. Aty-këtu, sidomos nga fundi, dëgjohej ndonjë pëshpërimë apo kërcëllitje nufullash nga të ftohtët. «E kam thënë unë, — pëshpëriste më vete Çuman Kokobogojë, — më mirë të kem një trim atje, në kantier, se dhjetë derra si Alush Manjaku».

## NJË DITË E BUKUR ME DIELL

Fijet elektrike që ishin lidhur tashmë me tërë kallëpët e lëndës eksplozive, ishin përqendruar në një pikë të vetme diku në të majtë të ndërtesës së motokompresorit, në një vend të mbrojtur nga copat e shkëmbinjve që do të fluturonin në erë. Ishte ndaluar rreptësisht kalimi në zonën e minuar. Aty mund të shkonin tani vetëm minatorët dhe tekniku Baudin Kazazi, i cili po bënte kontrollin përfundimtar të linjave elektrike.

— Ja ku është, — tha njëri nga minatorët, duke treguar me dorë aparatin e vogël të ushqimit me energji elektrike.

Baudin Kazazi e mori atë dhe e vendosi me kujdes mbi një trvezë dërrase të sajuar aty për aty posacërisht për të vendosur ushqyesin e energjisë elektrike, i cili kishte mbi vete një dorezë metalike në formë T-je. Lidhia përfundimtare me ushqyesin e energjisë elektrike ende nuk ishte bërë.

Me bishtin e syrit Baudin Kazazi po shikonte fytyrat kureshtare të disa kreshnikasve që qëndronin rreth e rrotull tij tre-katër metra larg. Ata vështronin herë aparatin e vogël mbi trvezë e herë zonën e minuar ku ndodhej një shkëmb gjigant me majë të thepisur. Kreshnikasit pëshpërisnin me njëri-tjetrin vesh më vesh. Si dukej ata pyesnin njëri-tjetrin për punën e shkëmbit. Pa e hedhur në erë këtë shkëmb, kishte thënë një ditë tek-



niku Baudin Kazazi, neve do të na dalin mjaft vështirësi për shfrytëzimin e shtresës së mineralit të kromit.

— E, si të duket? — i tha Baudin Kazazi kreshnikasit shtatlartë.

— Besa, tepër i madh është, — tha ai duke ngritur supet me mosbesim.

Baudin Kazazi vuri buzën në gaz dhe ngriti syzet e tij optike me gishtin tregues. Dy-tre kreshnikas që ndodheshin pak më tej qeshën me zë. Në krahun tjetër qëndronin në heshtje rreth e rrotull shefit të ekspeditës Bame Toroja, Martin Reka, Zaçe Çapoku, Sokol Dinoja, Hajrija me shoqet e saj, Katerinën, Tanën, Marien dhe Ajkunën. Ata vështronin gjithë kureshtje lëvizjet e duarve të teknikut Baudin Kazazi si dhe të tre minatorëve të tjerë që i vinin në ndihmë për çdo gjë që kërkonte ai.

Ai e kishte bërë më në fund lidhjen me ushqyesin e energjisë elektrike. Mjaftonte vetëm një rrotullim i vogël i dorezës në formë T-je dhe çdo gjë do të hidhej në erë.

— Hë, — ia bëri Baudin Kazazi, duke ngritur kokën nga kreshnikasi shtatlartë, me të cilin kishte biseduar pak më parë. — Po tani nuk ta mbush syrin!

Ramë Sheldia i shqeu sytë kur teknikun tha këto fjalë. Ndërsa kreshnikasi shtatlartë bashkë me shokët e tij qeshën me gjithë shpirt, duke vështruar pak si i turpëruar diku anash, ai e pa se s'kishte çfarë të thoshte.

— Ma mbush, si s'ma mbush syrin, — tha pas pak.

— Do të pimë prapë! — tha me shaka njëri nga minatorët që ndodhej aty pranë.

— Do të pimë, si jo? — tha kreshnikasi shtatlartë.

— Dhe do të thërrasim: Rroftë klasa jonë punëtorë! — tha një kreshnikas tjetër.

Ata qeshën përsëri me gjithë shpirt. Baudin Kazazi ngriti pëllëmbët e duarve në ajër, sikur të donte të thoshte se tani çdo gjë është gati e s'kemi lënë asgjë mangut. Tre minatorët e tjerë: Shpëtimi, Adushi dhe Faiku thanë «po» me kokë. Pastaj ata biseduan diçka me zë të ulët, duke bërë shenjë me duar në drejtim të shkëmbit të madh. Siç dukej, ishin të mendimit që të bëhej edhe



një kontroll i fijeve elektrike, me qëllim që të siguroheshin plotësisht. Baudin Kazazi u afrua te shefi i ekspeditës, Kristaq Dvorani, dhe bisedoi diçka me të, bisedë, të cilën e miratonte me kokë edhe Bame Toroja, që dukej disi i vrarë në fytyrë. Vdekja e papritur e të birit, e kishte dëshpëruar pa masë. Megjithëse mundej ta fshihte brengën që kishte përbrenda, prapëseprapë atë e tradhtonin sytë, vetullat, balli, buzët e mbërthyera në të dy anët dhe lëvizjet e ngathëta të gjymtyrëve. Nuk ishte më ai Bame Toroja i parë, dinak dhe plot shaka, që të shkulte së qeshuri dhe që të jepte mësimë të mira me ato fjalët e tij, që vërshëllenin porsì kamxhik, kur e donte puna.

— Të them të drejtën, s'më mbushet syri, — po u thoshte shokëve të vet kreshnikasi shtatlartë, duke përdredhur mustaqet e tij të zeza. — Si është e mundur, — tha, — që një aparat aq i vogël të hedhë në erë një shkëmb kaq të madh?!

Dikush që u ndodh aty pranë qeshi me zë. Pas tij qeshi edhe Katerina, e cila tërhoqi vëmendjen e të gjithëve. Sokol Dinoja e vështrroi me bishtin e syrit, sikur të donte t'i thoshte: Ç'ka këtu për të qeshur?

— Shkëmbin nuk do ta hedhë në erë aparati, bre burrë, — tha një kreshnikas i moshuar, — por lënda eksplozive.

Si i tha këto fjalë që i dhanë fytyrës së tij një pamje edhe më serioze, kreshnikasi shtatlartë ktheu kokën anej dhe tha:

— E di, e di!

Dikush anej nga fundi mezi e gëlltiti të qeshurën e tij.

Katerina qeshi përsëri. Ajo ishte mbështetur në supin e Hajrijes dhe po i pëshpëriste diçka në vesh.

— Çfarë, çfarë? — tha Maria që ndodhej aty pranë.

Si dukej e qeshura e tyre kishte lidhje me dikë tjetër, ndoshta me Sokolin, sepse, sa herë që ajo i pëshpëriste diçka në vesh Hajrijes, kthente kokën nga ai dhe e vështronte me sytë e saj të mëdhenj bojë qielli. Ramë Sheldia, që ishte tre-katër hapa më tej, po i ndiqte me vë-



mendje të gjitha lëvizjet. Ai i kishte hedhur duart prapa dhe, duke tundur ritmikiisht njëren këmbë, kafshonte anën e mustaqes, siç bënte kurdoherë kur në kokën e tij vërtiteshin mendime të mykura. Sytë e tij të vegjël dhe të futur thellë në zgavra mundoheshin vazhdimisht t'u ngjiteshin syve të bukur e me qerpikë të gjatë të Katerinës.

Ajo i kthente vazhdimisht shpinën. Qelbësira, thoshte me vete. S'ka turp nga vetja e tij. Pa shikoje veten në pasqyrë, more hajvan. Ç'ke me ne që na bie në qafë, ç'ke?

Ishte një ditë e ftohtë, po e bukur e me diell të fortë. Rrezet e tij të verbonin sytë, gjë që vinte, si duket, ngaqë ato reflektoheshin në sfondin e bardhë të dëborës.

Baudin Kazazi dhe tre minatorët, pasi bënë një inspektim në tërë zonën e minuar, u kthyen, duke biseduar me njëri-tjetrin. Fytyrat e tyre shkëlqenin nga gëzimi. Dukej qartë se çdo gjë ishte në rregull.

— Tani duhet të marrim masa sigurimi këtu, — i tha Bame Toroja shefit të ekspeditës.

— E drejtë, e drejtë! — tha Kristaq Dvorani.

Ai dha urdhër që të gjithë njerëzit të largoheshin njëzet-tridhjetë metra tutje zonës ku ishte vendosur ushyesi elektrik.

— Pranë aparatit, — tha ai, — të qëndrojnë vetëm tekniku, Baudin Kazazi, dhe tre minatorët. Shpërthimi do të bëhet fiks në orën dhjetë e tridhjetë minuta!

Ramë Sheldia kafshoi përsëri anën e mustaqes dhe me një pamje serioze në fytyrë filloi të largohej bashkë me turmën. Nuk kam si të veproj, kjo punë mori fund, po thoshte me vete ai. Një sekondë më vonë ai u kujtua se duhej të përpiqej që me çdo mënyrë të sabotonte shpërthimin, ose ta bënte atë para kohe; përndryshe kapedan Kokobogojja do ta varte për gjuhe, ja, atje, para ndërtesës së motokompresorit. Ky është urdhër i qendrës, i kishte thënë Çuman Kokobogojja në takimin që kishin pasur në afërsi të teqesë së baba Ali Çakmaxhianit. Si të vepronte? Turma vazhdonte të largohej nga zona ku ndo-



dhej ushqyesi elektrik. Mjaftonte vetëm një lëvizje e dorës dhe... Tani atje kishin mbetur vetëm tekniku, Baudin Kazazi, dhe tre minatorët. Shefi i ekspeditës, Bame Toroja, Martin Reka dhe Zaçe Çapoku po lëviznin bashkë me turmën. Zaçe Çapoku, tha me vete Ramë Sheldia. Ky do të kishte qenë ndoshta njeriu më i përshtatshëm, i cili mund ta ndihmonte për kryerjen e detyrës që i kishte ngarkuar Çuman Kokobogojë. Mirëpo tani është vonë, tepër vonë, mendoi ai, duke kërcitur dhëmbët. Ky është urdhër i qendrës, i thoshte një zë diku në thellësi të trurit të tij. Fjala «qendër» i rrëqethte atij tërë trupin. Ajo e nxiste atë që të kthehej mbrapsht, të vraponte në drejtim të pikës ku ndodhej aparati me dorezë në formë T-je, të shkulte thikën nga brezi, t'ua ngulte në shpinë tre minatorëve dhe teknikut, Baudin Kazazit, dhe... të realizonte shpërthimin... pikërisht tani, sa nuk ishin larguar njerëzit nga rrezja e veprimit të lëndës eksplozive... Ndoshta do të ketë shumë viktima, murmuriti me vete ai, duke kafshuar qoshen e mustaqes. Po pastaj ku të vete? Të gjithë do të grumbullohen rreth meje dhe do të më vënë thonjtë në grykë! Një kreshnikas që ecte për bri të tij i pëshpëriti në vesh se ç'kishte e përse rrinte si i shastisur. Ashtu, kot, i tha dhe u mundua të buzëqeshte. Po tjetri që, s'i dukej, ia njihte mirë telat, i tha prapë në vesh se diçka kishte e se ishte qerrata i madh. Ramë Sheldia i dha menjëherë një pamje serioze fytyrës së tij ezmore. Të lutem, më lër rehat, i tha. Më dhemb ca koka, ç'të kem tjetër. Shoku që vazhdonte të ecte për bri të tij qeshi nën hundë. Thonë se do të vijë edhe sekretari politik shoku Sami, tha pas pak ai, duke i pëshpëritur përsëri në vesh Ramë Sheldisë. E di, dhe pastaj? ia ktheu. Kot, kot, thashë se mos nuk e dije. E di, e di, tha prapë Ramë Sheldia. Siç duket, po i japin një rëndësi të veçantë këtij shpërthimi, sepse ka karakter politik. E di, e di, pëshpëriti prapë Ramë Sheldia. Po që pritet të vijë edhe një korrespondent i gazetës «Bashkimi», a e di? Edhe këtë e di, po lërmë rehat tani, se po më dhemb koka.

Njeriu që i pëshpëriti në vesh qëndroi në këmbë pranë tij. Ramë Sheldia e njihte shumë mirë. Ishte nga lagj-



ja «Kolaj». Gjatë luftës kishte qëndruar indiferent, ashtu si edhe ai, ndërsa mbas Çlirimit e kishte hedhur ndonjë fjalë aty-këtu, sepse ishte i pakënaqur nga pushteti popullor; sidoqoftë me të ai nuk kishte zhvilluar asnjëherë biseda të tilla. Po vijnë korrespondenti i gazetës «Bashkimi» dhe dy mysafirë nga miniera «Ylli i kuq», po thoshte dikush andej nga krahu i majtë i turmës. Ramë Sheldia dhe kreshnikasi që kishte përmbri, në mënyrë krejt mekanike e si të komanduar nga një sustë, kthyen kokat andej nga erdhi zëri. Drejtorin e minierës «Ylli i kuq», Xhavit Çelikun dhe tjetrin, një specialist i vjetër, ai i njihte mirë, kështu që i treti duhej të ishte patjetër korrespondenti i gazetës «Bashkimi». Ai ishte shtatmesatar, simpatik, i qeshur dhe mbante në sup një aparat fotografik. Si duket do të fotografojë shpërthimin e parë në minierën e re të kromit, tha me vete Ramë Sheldia. Gazetari ua dha dorën të gjithë njerëzve që u ndodhën aty rreth e rrotull; kur u takua me shefin e ekspeditës, Kristaq Dvoranin, u përçafua një copë herë të gjatë. Xhavit Çeliku ishte njeri tepër i njohur në ato anë. Ashtu siç ishte në këmbë, krah për krah me shefin e ekspeditës, me Bame Toron, me gazetarin dhe me njerëzit e tjerë, ai ngrinte herë pas here dorën në ajër për të përshëndetur të njohurit e tij të shumtë që ndodheshin andej-këndej nëpër bregoren e mbuluar me dëborë. Kreshnikasit, i përgjigjeshin duke i buzëqeshur. Ky është një njeri me të vërtetë baballëk, po thoshte dikush. Xhavit Çeliku vazhdonte të përshëndeste me kokë të njohurit e tij andej-këndej nëpër turmë. Fytyra e tij dukej përherë serioze, por, kur e donte puna, ndriste nga një buzëqeshje e lehtë që largohej pastaj fare ngadalë nga mollëzat e faqeve. Përmbri tij qëndronte një minator, i cili po i thoshte diçka duke bërë gjeste energjike me duar. Shefi i ekspeditës, Kristaq Dvorani, vazhdonte bisedën e tij të përzemërt me gazetarin. Ata po shkriheshin së qeshuri. Si dukej korrespondenti i gazetës «Bashkimi» i kishte sjellë atij lajme të mira nga familja. Bame Toroja me tre-katër shokë, midis të cilëve ishte edhe Martin Reka me Zaçe Çapokun, se ku kishin shkuar. Hajrija me



shoqet e saj ishin hequr mënjanë dhe bënin shaka me njëra-tjetrën. Ato ngacmonin vazhdimisht Katerinën, ngaqë e donin shumë atë. Ja tek është Sokoli, ja tek është, po i thoshte Maria në kohën që bashkë me dy të tjerë kaloi dhjetë hapa para tyre. Diku, në krahun e djathtë të shkëmbit të madh, kishte lëvizje. Atje u shfaq për një çast Bame Toroja me disa të tjerë që u zhdukën pas-taj menjëherë prapa një kthese. Në pikën e vrojtimit kishin dhënë urdhër që të dilte, edhe Ramë Sheldia me shokun e tij. Siç duket, ka shenja për zbritjen e ortekeve, tha dikush. Në krahun tjetër të humnerës paskan rënë dy ortekë të vegjël që ne nuk i paskemi vënë re.

Ku drejtin më gjetën përsëri mua që të ngjitem në pikën e vrojtimit, dhe pikërisht tani që..., po thoshte me vete Ramë Sheldia. Ky është urdhër i qendrës, i thërriste vazhdimisht një zë diku në thellësi të trurit të tij.

Nga Kreshta e Vdekjes u dëgjua përsëri një gjëim i mbytur, por njerëzit, megjithëse të përgatitur për rënien e ortekut, nuk panë gjë me sy. Siç dukej, ato ose shkatërroheshin diku nëpër honet e thella dhe nuk arrinin të zbrishnin deri poshtë, ose kalonin në anën tjetër të humnerës ku nuk shiheshin për shkak të kodrinës që kishin përpara.

Koha kishte filluar të prishej në mënyrë të papritur. Në veri dhe verilindje kishin dalë disa re të mëdha dëbore. Dielli nuk dukej më. Temperatura kishte rënë menjëherë.

— Orteku! — u dëgjua një zë nga pika e vrojtimit.

Bubullima, tashmë e njohur, erdhi duke u rritur, derisa orteku u përplas poshtë në humnerë.

Njerëzit që punonin diku në afërsi të shkëmbit, siç duket, për të përfunduar ndonjë punë të lënë përgjysmë ose për të ndrequr ndonjë difekt të mundshëm në fijet elektrike, iu shmangën copëzave të ortekut që fluturonin mbi kokat e tyre. Pak çaste më vonë ata u futën përsëri prapa shpinës së shkëmbit.

Shefi i ekspeditës dukej tepër i shqetësuar. Ai e kishte ndërprerë bisedën me gazetarin dhe po ndiqte me sy lëvizjet e Bame Toros dhe të shokëve të tjerë që nën ur-



dhrat e tij, shpejtonin të ndreqnin diçka sa më shpejt që të ishte e mundur. Lëvizjet e tyre sa andej-këndeje, shpeshherë pa ndonjë qëllim të caktuar, tregonin se ata ishin të hutuar.

— Orteku! — u dha përsëri sinjali nga pika e vrojtimit.

Mirëpo kësaj radhe shenja e rrezikut ishte dhënë me vonesë. Njerëzit që punonin nën drejtimin e Bame Toros, meqenëse nuk mundën të largoheshin në kohë, u mbuluan papritur nga një masë e madhe dëbore. Turma e njerëzve që ndodhej në krahun tjetër të zonës së minuar, si e përmendur nga një trullasje, u sul përpara për t'u shkuar në ndihmë. Qetësia e këndshme që sundonte pak më parë u shndërrua në një potere të madhe, aq sa s'merrej vesh se ç'bëhej. Dëgjoheshin njëherësh hapa njerëzish mbi dëborë, zëra, klithma vajzash, të qara, tri ngëllima lopatash, që përpiqeshin të largonin sa më shpejt dëborën nga vendi ku ndodhej grupi i punës, ulërima dhe gjithfarë zhurmash të tjera. Dukej sikur tërë ai gëzim i shumëpritur, kishte përfunduar me një fatkeqësi të tmerrshme. Andej lart nga Kreshta e Vdekjes u dëgjua edhe një gjëmim tjetër. Orteku! u dëgjua përsëri një zë i fortë nga pika e vrojtimit. Diçka u rrokullis dhe ra poshtë me një zhurmë shurdhuese. Dikush klithi, kurse një tjetër kërkonte t'i shkonin disa forca në ndihmë, nga e djathta. Siç dukej, andej duhej të ndodheshin ata që ishin goditur nga orteku i fuqishëm. Bame Toroja, i cili, ose kishte mundur të shmangej, ose ndokush e kishte çliruar nga pesha e rëndë e dëborës, thërriste vazhdimisht.

— Këndeje, djema!

Ndërsa Kristaq Dvorani e pyeste me zë të lartë se sa veta mungonin, ai ngrinte supet i hutuar. Martini Reka, thoshte, Martini duhet të jetë këndeje! Sokol Dinoja, që kishte mundur gjithashtu të shpëtonte, në vendin ku kishte qenë shtrirë vetë vazhdonte të gërmonte dëborën me thonj. Përbri tij, me sy të përlotur, të njëjtën gjë bënte edhe Katerina. Pak më tej ishin edhe disa nga shoqet e saj. Mos qaj, budallaqe, i thoshte Maria, që sapo kishte

zbuluar një këmbë njeriu nëpër dëborë. Këtu, këtu, po thoshte ajo. Këtu është një njeri. Sokol Dinoja u vërsul menjëherë dhe, duke u larguar dëborën me forcë, e nxori atë dhe e mori në duar. Ishte një kreshnikas i asfiksuar. Katër-pesë veta që u ndodhën aty e rrëmbyen atë menjëherë dhe e bashkuan me dy të tjerët që i kishin shtrirë dhe po u bënë frymëmarrje artificiale.

— Këndeј, djema, — vazhdonte të thërriste Bame Toroja.

Ai ishte i bindur se në atë drejtim duheј të gjenin Martin Reken që kishte qenë vetëm dhjetë hapa larg nga buza e greminës. I shtrirë në tokë dhe tepër i shqetësuar vazhdonte të kërkonte nëpër dëborë bashkë me tre-katër të tjerë. Këndeј, këndeј, murmuriste nëpër dhëmbë. Këndeј, se ishte i shkëputur nga ne, kështu që... Orteku! u dëgjua një zë i largët, po njerëzit nuk lëvizën më nga vendi. Ata vazhdonin të kërkonin nëpër dëborë njerëzit që qenë zhdukur. Zhaurima e zërave kishte një dendësi të papërfytyrueshme. Shumica pyesnin se kush kishte qenë tjetër në vendin që ishte mbuluar papritur nga masa e madhe e dëborës. Fliteј se ata që ishin gjetur kishin shpëtuar dhe gëzonin shëndet të mirë.

— Ah, Martin, Martin! — thirri, i pikëlluar në kulm, Bame Toroja. — Të thashë, more djalë, si s'erdhe pas meje?

Ata pastruan krejt dëborën nga rrafshina, por nuk gjetën gjë. Mungonte vetëm Martin Reka, trupi i të cilit, si dukeј i përfshirë nga orteku, duheј të kishte rënë me siguri në humnerë.

— Ah, more djalë, të thashë, — thoshte Bame Toroja. — Si s'erdhe pas meje?!

Turma e njerëzve shtangu në vend. Sapo u mor vesh laјmi i hidhur, gjithandeј ra një heshtje prej varri.

— Si është e mundur? — po thoshte Kristaq Dvorani.

Ai po vinte tepër i shqetësuar së bashku me Xhavit Çelikun. Pak çaste më parë kishin qenë te vendi ku ishin grumbulluar të asfiksuarit nga dëbora.



— Si është e mundur?! — vazhdonte të thoshte Kristaq Dvorani, dyllë i verdhë në fytyrë.

Ndërkohë Bame Toroja, që s'e donte veten dhe dukej shumë i pikëlluar, i kishte ngulur humnerës vështrimin e tij të palëvizshëm.

— A kërkuat mirë, more djema? — pyeti me një zë të shqetësuar Xhavit Çeliku.

Bame Toroja tha «po», duke lëvizur vetëm kokën.

— Ishte këtu, — tha duke treguar vendin. — Unë i thirra të vinte pas meje, po ai nuk erdhi. Si duket, është hutuar dhe do të ketë ikur në drejtimin e kundërt. Atë ose e ka marrë orteku përpara, ose ka shkuar me këmbët e tij në humnerë... Ah, more djalë! Si nuk më dëgjove?!

— Ejani këndeji! — po thoshte një kreshnikas i ri, i cili nga lodhja merrte frymë me vështirësi.

Ai tha se diku njëqind metra më poshtë ndodhej një rrugë, nga ku me ndihmën e litarëve mund të zbritej në fund të Përroit të Thellë. Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja zbritën me shpejtësi në atë drejtim. Turma i ndoqi menjëherë nga pas. Fytyrat e njerëzve dukeshin tepër të shqetësuara. Njëra nga vajzat ishte e përlotur.

— Thonë se ka litar poshtë në kantier, — tha dikush.

— Merreni sa më shpejt! — thirri Kristaq Dvorani.

— Po e sjellin! — u përgjigj një tjetër.

Bame Toroja kishte zbritur mbi një rrafshinë, nga ku dukej mirë fundi i Përroit të Thellë. Meqenëse buza e tij dukej si e prerë me thikë, ishte e qartë se pa litar nuk mund të zbritej në asnjë mënyrë deri atje poshtë. Ndërsa Sokol Dinoja dhe tre-katër të tjerë, po kërkonin vendin më të përshtatshëm për të zbritur, disa të tjerë po kërkonin me sy trupin e Martin Rekës. Hëpërhë s'dukej asgjë, përveç masës së bardhë të dëborës që e kishte mbushur tejmbanë fundin e përroit. Litari erdhi. Sokol Dinoja e rrëmbeu atë, kurse dy-tre veta e ndihmuan për t'u lidhur në mes. Litari dukej i fortë. Sipër nga Kreshta e Vdekjes u dëgjua një gjëzim tjetër. Shpejt, thoshte dikush, se mund të mbulohet me shtresa të reja dëbore. Në anën tjetër të Përroit të Thellë filluan të rrëshqisnin

copa të mëdha dëbore. Sapo kishte filluar të frynte një erë e ftohtë që të verbonte, sepse ngrinte në ajër pluhur dëbore. Qielli ishte mbuluar papritur me re të dendura. Është ciklon, po thoshte një kreshnikas i moshuar. Kështu në mënyrë fare të papritur ndryshon koha këtu gjithmonë. Shpejt, se mos e mbulojnë shtresa të reja dëbore. Sokol Dinoja kishte zbritur rreth njëzet e pesë — tridhjetë metra poshtë. Kishte për të bërë gati edhe gjysmën e rrugës që të arrinte deri në fund. Shtatë-tetë burra të fuqishëm, mbanin litarin dhe e lëshonin atë, sa herë që Bame Toroja u jepte urdhër që nga rrafshina në anë të përroit.

— Kini mendjen! — thërriste vazhdimisht Kristaq Dvorani, duke ndjekur me kujdes çdo lëvizje të litarit.

Një bubullimë e fuqishme u dëgjua sipër nga Kresha e Vdekjes.

— Orteku! — thirri dikush.

Qielli nxinte nga retë e dendura. Rrëshqitja e një orteku tjetër, si ai që kishte rënë pak më parë, rrezikonte jetën e Sokol Dinos. Në të vërtetë kësaj radhe zhurma shurdhuese ishte rezultat i një shkaktimi të fuqishëm elektrik. Sipër u duk përsëri një dritë verbuese, e cila u shoqërua me bubullima në të katër anët e luginës. Janë re dëbore, shpejtoi të thoshte një kreshnikas. Vajzat ishin mbledhur kokë më kokë dhe po i murmurisnin diçka në vesh Katerinës, e cila dukej e mallëngjyer dhe mezi po e mbante veten. S'ka gjë, budallaqe, i thoshin ato. Mos u bëj merak, se ai do të dalë sipër shëndoshë e mirë. Pa shiko tërë këta burra që e mbajnë fort litarin.

— Hiquni këtej! — thirri kreshnikasi shtatllartë. — S'është punë për femra kjo!

Ai mbante në krah një rrotë të madhe litari, që s'dihej se nga e kishte marrë. Bashkë me disa të tjerë ai e hapi dhe filloi të lidhej në mes.

— Shoku shef i ekspeditës! — tha ai, duke iu marrë fryma. — Më lejoni edhe mua të zbres poshtë.

— Mirë, — tha Kristaq Dvorani.

— Largohuni që këtej! — thërriste një zë, duke iu



drejtuar njerëzve që ishin grumbulluar te buza e Përroit të Thellë.

Filloi të binte dëborë e shoqëruar me një erë të fortë që vërshëllente si e tërbuar. Fundi i përroit po mbulohej me mjegull, e cila pengonte të merrnin vesh se ç'bëhej poshtë.

— Lëshojeni! — jehoi një zë.

Ishte Sokol Dinoja, i cili, siç dukej, duhej të kishte mbërritur në fund të Përroit të Thellë. Krahas po zbriste me nxitim edhe litari tjetër, ku ishte lidhur kreshnikasi shtatlartë. Dhjetë-pesëmbëdhjetë burra e mbanin fort atë.

— Ç'do të bëjmë, në qoftë se zbret ndonjë ortek tjetër? — pyeti Kristaq Dvorani.

— Duhet t'i ngremë lart me shpejtësi, — tha Xhavit Çeliku, duke lëvizur sa andej-këndej.

Korrespondenti i gazetës «Bashkimi» ndiqte në heshtje gjendjen që ishte krijuar.

— Era mund t'i përplasë në ndonjë shkëmb, — tha Kristaq Dvorani.

— S'ka mundësi, — tha Xhavit Çeliku për ta qetësuar.

— Vetëm ortek të mos ketë, — tha dikush.

Të lodhur dhe të rraskapitur nga shqetësimi i madh që u thërrte në zemër, Kristaq Dvorani dhe dy-tre kreshnikas tërhiqnin litarin.

— Shoku Xhavit! — tha. — Ata të krahut tjetër më duket se kanë nevojë për ndihmë. Litari i tyre qenka i këputur diku.

Xhavit Çeliku vrapoi në atë drejtim. Pas tij shkoi edhe gazetari me tre-katër të tjerë. Era ua përplaste dëborën me forcë në fytyrë.

— Nuk e shikoni, — tha Katerina e shqetësuar. — Litari i tij po këputet!

Vërtet. Litari, me të cilin kishte zbritur Sokol Dinoja, ngaqë ishte ngrënë duke u fërkuar pas shkëmbit, kishte rrezik të këputej.

— Kujdes, djema! — thërriste Bame Toroja.

Njerëzit kishin ngrirë në vënd. Fytyrat e tyre, të

skuqura nga të fitohet dhe stërmundimi, u dukën sikur aty-për aty u zverdhën menjëherë.

— Kujdes, djema! — vazhdonte të thërriste Bame Toroja.

— Sokol! — thirri Katerina dhe ia plasi të qarit.

— Mos, budallaqe! — i thoshin shoqet.

Katerina u shkëput prej tyre dhe vrapoi në atë drejtim, siç duket, për të dhënë ndihmën e saj. Ndërkohë rreziku i këputjes së litarit qe evituar, sepse në vendin e dëmtuar kishin formuar një komb.

— Lëshoje! — dëgjohej një zë nga fundi i përroit, të cilin megjulla e kishte mbuluar plotësisht. Tani për çdo gjë veprohej sipas urdhërave që jepnin Sokol Dinoja dhe kreshnikasi shtatlartë që, siç dukej, ishin takuar poshtë në fund të përroit dhe komunikonin me njëri-tjetrin.

Vajzat ishin tërhequr pak më lart për të mos penguar lëvizjet e njerëzve. Duke vështruar njëra-tjetrën, ato prisnin me ankth se ç'do të bëhej. Katerina ishte ngjitur pas Hajrijes dhe dridhej e tëra, sepse ishte tepër e shqetësuar. Me gjithë përpjekjet, që bënte në vetvete, ajo nuk mund të fshihnte gjendjen e saj të rënduar shpirtërore.

— Duhet të jesh më trime, — po i thoshte ngadalë Maria, ndërsa i shtrëngonte shallin që gati sa nuk po ia fluturonte era nga koka.

— Lërmë rehat, të lutem! — i tha Katerina me një zë të lodhur. — Në më do, lërmë të qetë. Në djall të vejë shalli im!

Hajrija mendohej t'i buzëqeshte, duke e shtrënguar përherë e më fort pas trupit të saj. Ia kapi duart, dhe, kur vuri re se ato ishin bërë akull, ia ngrohu me duart e saj.

Kristaq Dvorani donte të fliste, po një bubullimë e fuqishme ia mbylli gojën. Era vazhdonte të ulërinte si e tërbuar. S'merrej vesh nëse ishte ortek dëbore apo ndonjë shikarkim tjetër elektrik tutje lart nga Kreshta e Vdekjes.

— Orteku, o shokë! — tha një zë.

Një masë e madhe dëbore u përplas me forcë në fund



të përroit, duke tronditur tërë vendin rreth e rrotull. Katerina nuk e përmbajti dot veten. Ajo donte të thërriste përsëri «Sokol», po Hajrija ia zuri gojën me pëllëmbën e dorës dhe ia mbështeti ballin në gjoksin e saj. Edhe Tana u ngjit pas Maries. Ajkuna po rrinte midis tyre krejt e lebetitur.

— Po tani? — pyeti ajo me një zë të pikëlluar.

Katerina dukej e tmerruar.

— Jam gati që të jap jetën time, vetëm të shpëtojë ai.

Nga këto fjalë u tronditën edhe shoqet e saj.

Orteku i fuqishëm kishte rënë përsëri në anën tjetër të Përroit të Thellë.

— E gjetëm, o shokë! — gjëmoi fundi i përroit. — Të ngrihen litarët!

Kristaq Dvorani i hodhi një vështrim Bame Toros. Fytyrat e tyre ndritën nga një rreze e largët drite. Siç dukej, ata mbanin shpresë se Martin Reka duhej të ishte ende gjallë, megjithëse kishte kaluar gati një gjysmë ore që ai ndodhej në fund të përroit e i mbuluar me dëborë. Një grumbull burrash nga kreshnikasit më të fuqishëm tërhiqnin litarët me mudim të madh, ndërsa disa të tjerë i mbanin ata të ngritur që të mos fërkoreshin me shkëmbin. Bame Toroja mezi arriti deri te Kristaq Dvorani. Fytyra e tij dyllë e verdhë, kishte humbur çdo shpresë.

— Nuk është e mundur të ketë shpëtuar i gjallë! — tha ai me një zë të venitur.

Kristaq Dvorani uli kokën i pikëlluar ndërkohë që Xhavit Çeliku priste në ankth të shihte trupin e Martin Rekës. Korrespondenti i gazetës «Bashkimi» vështronte andej-këndeje si i shastisur. Si dukej, ai e kishte humbur fare toruan dhe tani s'dinte se ç'bënte.

— Po i afrohen bregut! — tha një zë.

— Edhe pak, edhe pak! — thoshte një tjetër që, siç dukej, i shikonte më mirë që nga maja e një bregoreje.

— Të jetë akoma i gjallë?! — pyeti dikush.

— S'është e mundur! — murmuriti nëpër dhëmbë një tjetër.

— Litarët vazhdonin të ngjiteshin sipër, duke lëvi-

zur paralelisht. Dhjetëra sy i ndiqnin ata në anë, duke pritur që të dilte në sipërfaqe trupi i Martin Rekës.

— Përgatitni batanijet! — tha një kreshnikas.

— Duhet ta mbledhim mirë dhe ta fusim sa më parë në ndërtesën e motokompresorit, — po thoshte një tjetër.

— I keni marrë masat?

— Po, i kemi marrë!

Hajrija takoi vështrimin e Katerinës dhe u mundua t'i buzëqeshte.

— Merrini këto, se do të na duhen, — tha një fytyrë e panjohur, duke iu drejtuar Hajrijes.

— Ngjituni shpejt lart! — u tha edhe Bame Toroja vajzave.

Vajzat morën çarçafët dhe tre-katër batanije dhe vrapuan në drejtim të ndërtesës së motokompresorit. Era vazhdonte të frynte si e tërbuar, ndërkohë që qielli ishte mbushur me re dëbore. Tani fijonin vetëm flokë të rrallë që, kur të preknin në fytyrë, dukej sikur të prisnin, ngaqë shndërroheshin menjëherë në akull. Turma vazhdonte të shikonte nga bregu i përroit me një shqetësim të madh në fytyrë.

— Po ju? — thirri Xhavit Çeliku, kur pa një kreshnikas të ri në majë të një bregoreje, që gati sa nuk po binte poshtë në humnerë. — Largohu që këtej! — u nxe ai edhe më keq.

— Ik, ore djalë, që andej! — tha me dhimbje Bame Toroja.

— Turp të keni! — i shfryu një tjetër dhe u mat t'i hiqte një pëllëmbë.

Djaloshi u zhduk në turmë, duke mbledhur pas veshëve jakën e tij të ngritur.

Sokol Dinoja doli i pari në sipërfaqe. Trupin e Martin Rekës e mbante në krah kreshnikasi shtatlartë. Dy-tre veta u afruan menjëherë për t'i ndihmuar.

— S'është nevoja, s'është nevoja! — tha Sokol Dinoja. — Largohuni se mund të shikisni poshtë!

— Kini kujdes!

Trupin e Martin Rekës po e sillte kreshnikasi shtat-



lartë. Ai e mbante atë para gjoksit me një kujdes të jashtëzakonshëm. Bame Toroja iu afrua me të shpejtë dhe e mbështolli me batanije, sikur të ishte ndonjë fëmijë.

— Është pa ndjenja! — tha Sokoli.

Fjalët e tij e shqetësuan së tepërmi Bame Toron. Kristaq Dvorani e pa me kujdes në fytyrë, mirëpo, për shkak të zhurmës së madhe, nuk mori vesh në ishte gjallë apo kishte vdekur.

Një tronditje e fortë shqetësoi papritur turmën që ndiqte pas trupin e tij. Pastaj u dëgjua një krismë e fuqishme që u duk sikur e çau përgjysmë shkëmbin e minuar që ndodhej përbri tyre. Të gjithë u vërsulën në drejtimin e kundërt.

— Ngjijtuni! Shpejt! — thërriste Bame Toroja, duke prirë në krye të turmës.

Trupin e Martin Rekës vazhdonte ta mbante kreshnikasi shtatlartë. Përbri tij ecte Sokol Dinoja, i cili dukej tepër i lodhur dhe njëkohësisht i pikëlluar. Bame Toroja hyri rrëmbimthi në ndërtesën e motokompresorit, duke shtyrë me këmbë derën e drunjte. Vajzat e kishin bërë gati vendin ku do të shtrihej trupi i tij.

— Sokol! — u dëgjua zëri i Kristaq Dvoranit. — Sillemi këndeje.

E gjithë turma u ndal te dera e ndërtesës së motokompresorit. Njerëzit, të shkrirë në një masë të vetme, prisnin me ankth. A do të jetë gjallë? thoshin, duke i pëshpëritur njëri-tjetrit në vesh. Bame Toroja, pasi u hodhi një sy tre kreshnikasve, që i kishin shtrirë më tej, doli vetëtimthi jashtë.

— Ku është Baudin Kazazi? — pyeti ai për teknikun.

Dikush ia tregoi me dorë. Bame Toroja u habit kur e pa me një dorë të lidhur.

— Ç'është kjo! Çfarë ka ndodhur? — pyeti ai rrëmbimthi. — Po shokët e tjerë ku janë?

Diku në krahun e majtë të ndërtesës së motokompresorit ndodhej Ramë Sheldia, i gjakosur në fytyrë dhe me duart të lidhura pas.

— Çfarë ka ndodhur këtu? — pyeti Bame Toroja tepër i shqetësuar.

Megjithëse ushqyesi elektrik ndodhej në vendin e vet, mbi tryezën e drurit, aty diçka kishte ndodhur. Edhe njëri nga minatorët ishte plagosur në njëren vetull dhe kishte një njollë të zezë poshtë nofullës.

— Çfarë ka ndodhur këtu? — pyeti edhe Kristaq Dvorani, duke hedhur sytë herë te njëri e herë te tjetri.

Ramë Sheldia e kishte varur kokën në gjoks.

— Ja, pa shikojeni këtë fytyrë! — tha Baudin Kazazi.

Bame Toros gati sa nuk i ra qielli mbi kokë. E mori me mend se çfarë duhej të kishte ndodhur.

— U përpoq të hidhte në erë zonën e minuar, — tha njëri nga minatorët, — e pikërisht në kohën kur atje ndodheshin dhjetëra njerëz.

Bame Toroja u tmerrua. Aty rreth e rrotull u grumbulluan mjaft njerëz.

— Si?! — tha ai, duke iu afruar Ramë Sheldisë me hapa tepër të ngadalshëm dhe me një vështrim të tillë që dukej sikur po bëhej gati ta përpinte.

— Largohuni që këtej, ju lutem! — po u thoshte Kristaq Dvorani njerëzve që po shtynin njëri-tjetrin për të parë më mirë.

Në mes të rrëmujës ai u kthye menjëherë nga Bame Toroja, i cili me duart e tij porsì darë e kishte kapur Ramë Sheldinë në grykë dhe po e ngrinte në ajër. Fytyra e tij e tmerruar dukej sikur kërkonte ndihmë. Ai nuk fliste dot, se Bame Toroja e kishte shtrënguar aq shumë, sa pas një sekonde koka e tij u anua anash.

— Mos, — thirri Kristaq Dvorani. — Lëshoje!

Ai e lëshoi dhe Ramë Sheldia u shtri në ije. Dora e fortë e Bame Toros e rrëmbeu për supi dhe e ngriti porsì leckë në këmbë.

— Armik! I poshtër! — i tha.

— Lëre, lëre, se do ta vdesësh fare! — tha prapë Kristaq Dvorani.

Ramë Sheldia hapi sytë i habitur, siç dukej ngaqë e pa veten gjallë. I dridhej mjekra e poshtme dhe njëri



sy i kishte shkuar shtrembër. Kristaq Dvorani e rrëmbu për krahu bashkë me dy të tjerë dhe e tërhoqi në drejtim të ndërtesës së motokompresorit për ta vënë në një vend më të sigurt. Ngaqë s'e mbanin këmbët, Ramë Sheldia përpiquej të shtrihej përtokë, ndërkohë që njerëzit e tënhiqnin nga supet dhe s'e linin të binte poshtë. Bame Toroja e kapi edhe një herë nga flokët dhe e shembi diku mbrapa ndërtesës së motokompresorit.

— Këtu të rrish, qelbanik! — i tha.

— Të largohen të gjithë njerëzit nga zona e minuar — urdhëroi Kristaq Dvorani.

Ramë Sheldia, i trembur për vdekje, kthente kokën nga njerëzit që e rrethonin. Ai donte të thoshte diçka, po nuk kishte më forca të hapte gojën. Duke e ndier edhe vetë se muskujt po i mblidheshin, filloi të shtrëngonte dhëmbët nga dëshpërimi.

— Maskara! — i tha Bame Toroja dhe e pështyu në fytyrë.

— Ruaj gjakftohtësinë! — i tha ngadalë në vesh Kristaq Dvorani.

— Çfarë gjakftohtësie, more?! — tha Bame Toroja. — Ai dhe për pak desh na hodhi trutë në erë të gjithëve, kurse ne...

Ata u larguan të dy për të parë se në ç'gjendje ishte Martini Reka.

Te dera e drunjte e ndërtesës së motokompresorit ishin grumbulluar shumë njerëz.

## TAKIMI ME SEKRETARIN POLITIK

Barakat e reja të kantierit të minierës së kromit sekretari politik i pa për herë të parë kur po kalonin para çadrave të repartit të ndjekjes që ishte dislokuar para dy javësh në anë të khadesë, në të djathtë të Kreshnikës. Në sfondin e përhimë të qiellit para syve të tyre ato u ravijëzuan në fillim turbull; pastaj u shfaqën më qartë çatitë karakteristike të stilit gotik, pak më vonë dritaret e tyre katrore dhe më në fund të gjitha ndërtesat.

— Ja ku është kantieri i minierës, — i tha plot kënaqësi sekretarit politik kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, Burhan Kola, i cili qëndronte vetëm në sediljen e prapme të makinës.

— E shoh, — tha sekretari politik me një shprehje të gëzuar në fytyrë.

Ai po çuditej me vete, sepse katër ose pesë ditë më parë, kur kishte qenë në Tiranë, pasi e kishin thirrur për një gësitje urgjente në Komitetin Qendror dhe, kur kishte kaluar nga kjo rrugë, veç një hani të vjetër, nuk i kishte zënë syri asgjë tjetër në atë vend, ku tani po hidhte shtat me shpejtësi kantieri i minierës së re të kromit. Ja se ç'bën revolucionin, po thoshte me vete ai, ndërsa makina i afrohej përherë e më shumë minierës.

Kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, Burhan Kola, vështroi një copë herë fytyrën e zbehtë të sekretarit politik, e cila dukej tepër e lodhur, mbase nga pa-



gjumësia. Flokët e tij të drejtë, vende-vende të ndarë në tufa dhe të rrëzuar përmbi ballë, dukeshin sikur nuk ishin krehur ndonjëherë. Ai donte të dinte se çfarë po mendonte sekretari në këtë çast për minierën e re të kromit. Befas iu kujtua se si një ditë para zgjedhjeve sekretari politik e kishte thirrur atë në zyrën e tij dhe i kishte komunikuar vendimin e qeverisë për vënien në shfrytëzim të minierës së kromit në Kreshnikë. Burhani gati sa s'kishte fluturuar nga gëzimi. Mirëpo, kur ai i kishte thënë se brenda javës duhej të njoftohej qeveria se miniera kishte filluar nga puna, se për këtë nga Tirana pritej të vinte vetëm një ekspeditë e vogël dhe se barra kryesore e punës do të përballohej me kreshnikasit etj. etj., atëherë ishte shtangur në vend. Si është e mundur? kish-te thënë. Ku t'i gjejmë ne tërë këto forca pune? Veç kësaj njerëzit tani nuk kanë as idenë se ç'janë minierat, pa le të shkojnë të punojnë vetë dhe të nxjerrin krom nga mali i Kreshnikës. Kjo është krejt e pamundur, i kishte thënë. Pasi e kishte dëgjuar, sekretari politik i ishte përveshur pastaj vendçe, e kishte bërë, si i thonë fjalës, për ujë të ftohtë. Cili je ti, more, i kishte thënë, që më flet me këtë gjuhë? Kur nuk mban qëndrim të drejtë ti, kuadër i revolucionit dhe njeriu më me përgjegjësi shtetërore në krahinë, (mos harro se je kryetar i këshillit popullor të lokalitetit), atëherë ç'do të thonë njerëzit e thjeshtë? Më vjen shumë keq, i kishte thënë, që mendon në këtë mënyrë. Nuk e prisja një gjë të tillë nga ti! Nuk e shikon se në ç'gjendje të vështirë ekonomike është vendi! Çdo gjë është rrënuar përtokë nga lufta, furnizimi i popullsisë bëhet me vështirësi të mëdha dhe njerëzit vuajnë nga padija. Ai kishte shtuar se, si për inat, pikërisht në këto rrethana jashtëzakonisht të vështira pushteti popullor në Shqipëri rrezikohej seriozisht si nga armiqtë e jashtëm, ashtu edhe nga ata të brendshmit. Burhan Kola nuk e kishte parë sekretarin politik ndonjëherë aq të revoltuar si atë ditë. Aty për aty ishte penduar njëqind herë. Një situatë të tillë atij s'i kishte mbetur rrugëdalje tjetër, veçse të ulte kokën dhe të merrte shënim një për një tërë detyrat që i dil-

nin për vënien në shfrytëzim të minierës së kromit. Tani që çdo gjë ishte bërë realitet, ai e kuptonte fort mirë se kishte bërë një gabim që s'i falej. Në dy-tri raste kishte menduar të bisedonte me sekretarin politik e të bënte njëfarë autokritike për atë gabim që kishte bërë e që i kishte mbetur si plagë në ndërgjegjen e tij të pastër, mirëpo prapë kishte ndërruar mendje. Autokritika më e mirë, kishte thënë me vete ndoshta për të dhjetën herë, është puna për plotësimin deri më një të detyrave. Këtë gjë ne e kemi bërë. E përse ta lëndoj një plagë që tashmë është mbyllur?

Gjatë pak ditëve kreshnikasit bashkë me punonjësit e ekspeditës, të ardhur nga Tirana, kishin bërë me tërë mend një punë që të habiste. Sipas detyrës që i qe dhënë nga sekretari politik, brenda javës duhej të kryhej shpërthimi i parë dhe të fillonte shfrytëzimi i mineralit të kromit në sipërfaqe. Në të vërtetë kjo detyrë tashmë jo vetëm që ishte realizuar dy ditë para afatit (ata po shkonin në minierë pikërisht për të marrë pjesë në kryerjen e shpërthimit të parë), por ishin ndërtuar në një kohë rekord dhe dy baraka shumë të domosdoshme për punonjësit e ekspeditës, ishte në përfundim e sipër garazhi i automjeteve, ishte hapur qysh ditën e parë e me një shpejtësi të rrufeshme rruga që të çonte deri në sektorin e parë të punës që shokët e ekspeditës e kishin quajtur Zona A, ishte krijuar një rezervë e madhe lënde druri për galeritë e ardhshme dhe ishte ndërtuar një godinë për motokompresorin dhe grumbullimin e mjeteve të tjera teknike. Bile ishin hedhur mendime edhe për ndërtimin e teleferikut që do të shërbente për zbritjen e mineralit të kromit poshtë në xhade. Aty ishte vënë në plan të ndërtoheshin sa më parë dy platforma për ngarkimin e mineralit të kromit nëpër automjetet që do ta transportonin atë për në portin e Durrësit. Ja, të gjitha këto, po pyeste me vete Burhan Kola, a nuk janë autokritika më e mirë që mund të bëja unë përpara sekretarit? Megjithatë, ai nuk ishte i kënaqur nga vetvetja. Nuk duhej t'ia kisha thënë atë fjalë sekretarit politik atë ditë, mendonte vazhdimisht.



— E, si ju duken, shoku Sami? — e pyeti Burhan Kola sekretarin politik, kur mbërritën në kantierin e minierës.

— Ndërtesa të bukura, — pohoi ai i kënaqur. — Kot i quani baraka, këto janë në fakt shtëpiza të drunjtja që të bëjnë menjëherë për vete me paraqitjen e tyre të jashtme.

Burhan Kolës iu bë qejfi.

— Kush i ka ndërtuar? — pyeti përsëri në mënyrë të papritur sekretari politik.

Burhan Kola nuk u përgjigj menjëherë. Kur pa se ai ngulte këmbë për përgjigjen e pyetjes së tij, i tha se barakat i kishin ndërtuar vëllezërit Ulkama.

— Interesant. Kam dëgjuar diçka për ta, — tha sekretari politik, duke vrarë për një copë herë mendjen. — Hë, — ia bëri, — dikush më ka thënë se janë pesë vëllezër dhe se janë të pestë mjeshtër duarartë të drurit. Doja të thosha, janë punëtorë të talentuar.

— Ashtu është, — tha Burhan Kola kokulur.

— Interesant, — vijoi prapë sekretari politik, duke u kthyer në fillim nga ai e pastaj nga barakat. — Kanë bërë me të vërtetë një punë kolosale brenda një kohe shumë të shkurtër!

Kryetari i këshillat popullor të lokalitetit u përtyp një copë herë dhe pastaj tha «po» si nëpër dhëmbë.

— Sidoqoftë ky është vetëm fillimi, — shpjegoi pas pak ai.

— Ndërtesa të bukura, — vijoi të thoshte shumë i kënaqur sekretari politik. — Duhet të ngremë edhe disa ndërtesa të tjera të tilla këtu, se punonjësit e minierës do të shtohen shpejt. Meqenëse do të marrim forca punëtoresh edhe nga fshatrat fqinje, do të na duhen ambiente për fjetje, mensa dhe gjëra të tjera të domosdoshme për një qytezë minatorësh. Hëpërhë le të ngremë një qytezë të drunjtë, — bëri shaka ai, — sepse ende nuk dimë me siguri se ç'rezerva kromi ka mali i Kreshnikës. Më vonë, ndoshta, këtu do të ndërtohet një qytet i vërtetë minatorësh, me pallate shumëkateshe, me objekte të ndry-

shme social-kulturore, me dyqane të shumta. Qyteti do të ketë me siguri edhe administratën e vet. Apo jo?

— Sigurisht, — tha Burhan Kola me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë.

Para tyre u gjendën papritur vëllezërit Ukcama. Ata e lanë menjëherë punën dhe u kthyen andej nga po vinte sekretari politik. Të gjithë ishin burra të shëndetshëm dhe njëri më i gjatë se tjetri.

— Punë të mbarë! — u tha, pa mbërritur akoma te vendi.

Ata ishin gati dhjetë hapa përtej, kur ai u zgjati dorën për t'i takuar. Dy-tre nga ata u afruan duke qeshur me gjithë zemër dhe i dhanë dorën njëri pas tjetrit. Sekretari i përqafoi ata dhe i puthi në të dyja faqet, sipas zakoneve të krahinës, gjë që krijonte aty për aty një atmosferë të ngrohtë, gati familjare.

Ç'njeri i çuditshëm që është, po thoshte me vete Burhan Kola. Të bën për vete që në takimin e parë. Sekretari filloi të bisedonte me vëllezërit Ukcama, sikur të njihej me ta prej kohësh. U foli në fillim për detyrat e ngutshme të minierës, pastaj për të ardhmen e saj të ndritur. Vëllezërit Ukcama e dëgjonin me vëmendje dhe me një shprehje të gëzueshme në fytyrë. Ai bisedoi me ata një copë herë të gjatë dhe pastaj u nda prej tyre duke nderuar me grusht.

— Ku janë të tjerët? — pyeti ai.

Rreth e rrotull nëpër oborrin e kantierit të minierës nuk dukej frymë njeriu, përveç tyre.

— Janë të gjithë lart, — tha Burhan Kola. — Atje po na presin.

— Ashtu?!

— Po.

— Atëherë shkojmë.

Ai u bë gati të ngjitej në një rrafshinë të mbuluar me dëborë.

— Kënde, kënde, — i tha Burhan Kola.

— Ah, po, — ia bëri sekretari. — Gati harrova se ju keni hapur rrugën deri në vend.

— Makina shkon deri lart, kështu që...



— Ah, jo, jo! — tha sekretari politik. — S'është nevoja, shkojmë në këmbë! — nxitoi të thoshte ai dhe u nis të ngjitej i pari nëpër rrugën e re malore që ishte hapur tri ditë më parë. — Ti prit këtu, — i tha shoferit, — ose, po të duash, siguroje makinën dhe eja lart me ne!

Një copë herë ata ecën në heshtje. Pas pak sekretari politik nisi t'i tregonte për një marshim të rrezikshëm që kishte bërë gjatë kohës së luftës nëpër dëborë.

— Ishim të rraskapitur, — tha ai, — pa gjumë dhe të pangrënë... Rruga ishte e ngarkuar me dëborë, si kjo, dhe frynte një erë e fortë dhe e ftohtë. Ne mezi qëndronim në këmbë. Me vete kishim një shok të plagosur rëndë...

Burhan Kola dëgjonte në heshtje.

## DUHET T'I DÛROSH DHIMBJET

Martin Reka kishte filluar të vinte në vete. Në fillim lëvizi qerpikët, pastaj vetullat e tij të zeza. Pak e nga pak fytyra e tij e venitur filloi të gjallërohej.

— Është gjallë! — tha Ajkuna, e cila kishte kohë që po i rrinte te koka bashkë me Tanën.

Vajzat u afruan menjëherë me majat e këmbëve për ta parë. Vërtet. Ai ishte i gjallë! Ai kishte shpëtuar tashmë nga vdekja! O, sa u gëzua Tana! Sa u gëzuan të gjitha shoqet e saj! Katerina doli jashtë me majat e gishtërinjve që të njoftonte të pranishmit se ai ishte gjallë! O, sa mirë! thanë të gjithë. Bame Toroja u gjend menjëherë te koka e tij. Një sekondë më vonë hyri edhe Kristaq Dvorani. Me njëfarë mëdyshjeje ata lejuan të futeshin Sokol Dinoja me kreshnikasin shtatlartë që ishin shpëtimtarët e tij të vërtetë.

Një rreze drite filloi të hynte si me druajtje nga një e çarë e dritares së ndërtesës së motokompresorit. Njerëzit që prisnin te dera vështronin të lumtur njëri-tjetrin dhe pëshpërisnin vesh më vesh. Po vjen në vete, po vjen në vete. O, sa mirë! Shpëtoi më në fund. Ç'djalë i mirë që është! Jashtë vazhdonte të binte dëborë, megjithëse koha po jepte shenja për t'u hapur. Qielli i lartë vende-vende ishte grisur nga dielli që çante midis reve, duke lëshuar tufa të mëdha rrezesh mbi tokën e mbuluar me dëborë të ngrirë. Ç'kohë e poshtë, tha dikush.



Martin Reka hapi sytë përgjysmë dhe njohu ndër-  
mjet njerëzve që e rrethonin fytyrën e Bame Toros dhe  
pastaj atë të Tanës... O, sa e afërt iu duk fytyra e saj.  
Por përse, vallë, ndodhej aty? Ku kishte qenë gjer tani?  
Ku? Përse e kishin rrethuar tërë ata njerëz, çfarë kishte  
ndodhur me të? O, sa të lodhur që e ndiente veten. Ai i  
mbylli përsëri sytë dhe ra në një gjumë të thellë.

Sytë e Tanës u përplotën. Edhe Katerina u bë gati  
të lotonte. Po ai lëvizi përsëri qerpikët. Është gjallë, me-  
ndoi Kristaq Dvorani. Deri tani nuk i kishte folur as-  
njeriu. Përse nuk flet, Martin? thoshte me vete Tana.  
S'kishte as dy ditë që ishte njohur me të dhe i qe dukur  
aq i sjellshëm, aq i mirë. Sokoli dhe Katerina u panë sy  
më sy. Të lumtë, u duk sikur i tha ajo. I shpëtove jetën  
një njeriu të mrekullueshëm! Ai filloi t'i hapte sytë nga-  
dalë dhe për herë të parë lëvizi njërën dorë. Njohu më  
në fund fytyrën e shefit të ekspeditës, Kristaq Dvoranit,  
atë të Sokolit e të Katerinës. Kur hodhi sytë nga dera,  
pa atje dhjetëra fytyra të ngjeshura pranë njëra-tjetrës.  
Çfarë të kishte ndodhur? Përse ishte i shtrirë në mes të  
ndërtesës së motokompresorit? Pak më tej vuri re se në  
të njëjtën gjendje ishin edhe tre kreshnikas, të cilët ta-  
shmë kishin ardhur plotësisht në vete. Çfarë të kishte  
ndodhur vallë? Në një sekondë iu drodh i tërë trupi. Di-  
ku në thellësi të trurit të tij gjëmoi një zhurmë e madhe.  
Eja pas meje, Martin! Dhe, kaq. Ai s'mbante mend më se  
çfarë kishte ndodhur më vonë. I kishte mbetur në mendje  
zëri aq shumë i dashur i Bame Toros. Të dua si djalin  
tim, të kam në vend të Turabiut, i kishte thënë me dhje-  
tëra herë gjatë asaj dite. Ai hodhi sytë përsëri nga fytyra  
e merakosur e Bame Toros.

— Edhe ti qenke gjallë? — i tha, duke marrë frymë  
me vështirësi.

— Gjallë jam, o djalë i Bame Toros! Gjallë!

U mundua t'i buzëqeshte dhe pastaj i mori dorën  
dhe ia afroi pranë faqes së tij.

— Sa mirë që qenke larguar në kohë, — tha ngadalë e  
me mundim. — Kurse unë...

Mendimi i mbeti përgjysmë nga një dhimbje e fortë që ndjeu në gjoks. Ai po luftonte me kurajë kundër dhimbjes fizike që po i pushtonte pak e nga pak tërë kraharonin. Ishte e vetmja plagë, që kishte marrë, siç duket, duke u përplasur në ndonjë shkëmb. Një copë heurë i mbylli sytë dhe pastaj i hapi përsëri me ngadalë. Hodhi një vështrim rreth e rrotull dhe u buzëqeshi të gjithëve.

— Gjallë janë të gjithë shokët? — pyeti.

— Gjallë, — i tha Kristaq Dvorani. — Janë shëndoshë e mirë, — shtoi pas pak ai.

Atij iu bë qejfi. Rrotulloi sytë dhe u buzëqeshi prapë të gjithëve.

— Më ngrini pak, — tha, — se dua të shoh shokët!

— Këtu i ke të gjithë shokët, — i tha Bame Toroja.

— Mos u bëj merak. Ti duhet të rrish shtrirë, sepse ke një plagë të rëndë në gjoks.

Ai buzëqeshi përsëri me ngadalë.

— Mirë, — tha.

Dëborë kishte pushuar. Megjithëse koha kishte filluar të hapej, mbi Kreshtën e Vdekjes kishte akoma re të zeza, që vinin me shpejtësi nga verilindja.

— Jam shumë i lodhur, — tha pas pak Martin Reka.

— Më pihet ujë!

Kristaq Dvorani i mati pulsën.

— Ti je trim, — i tha. — Duhet t'i durosh dhimbjet. Çdo gjë do të kalojë.

Njëra nga vajzat i ngriti kokën me kujdes, ndërsa Tana i afroi gotën me ujë.

Kristaq Dvorani dhe Bame Toroja dolën jashtë, duke i porositur vajzat që të kujdeseshin për të.



## JEHONA E SHPËRTHIMIT TË PARË

Në platformën e Zonës A mbërriti sekretari politik, i cili shoqërohej nga kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, Burhan Kola. Ardhja e tij krijoi një atmosferë të gëzueshme. Ai i dha dorën shefit të ekspeditës dhe pastaj u takua me të gjithë anëtarët e saj të pranishëm. Në fund u përshëndet me Xhavit Çelikutun, si dhe korrespondentin e gazetës «Bashkimi». Duke e vështruar herë pas here në sy, Kristaq Dvorani e vuri atë në dijeni, pa u futur në hollësira të panevojshme për gjendjen e krijuar para një gjysmë ore si rezultat i një cikloni që kish-te kaluar aty fare papritur. Sekretari politik, i shqetësuar, e qortoi atë që nuk po ia thoshte gjërat më shkoqur.

— Shpjegoja të gjitha, ashtu siç ndodhën, Kristaq, — i tha Bame Toroja.

Kur mbaroi raportimin shefi i ekspeditës, sekretari politik ndenji një copë herë të gjatë pa folur.

— Mos u dëshpëroni nga të gjitha këto që kanë ndodhur, shokë, — tha ai duke iu drejtuar të gjithëve. — Shqipëria jonë e vogël është e rrethuar në të katër anët, kështu që ne do të jemi të detyruar, shokë, të ndeshemi si me vështirësitë e natyrës, ashtu edhe me armiqtë e klasës.

Ai heshti një copë herë. Fytyra e tij dukej tepër serioze.

— Ku janë të sëmurët? — pyeti pas pak. — Dua të shikoj të sëmurët.

Kristaq Dvorani i tregoi rrugën për te ndërtesa e motokompresorit. Pas tri-katër minutash ata u ndodhën në ndërtesën e thjeshtë, të ngritur shpejt e shpejt me gurë të thatë dhe me një çati të përkohshme prej dërrasash pishe. Sekretari politik u takua me të katër të sëmurët dhe, pasi i pyeti ata me hollësi për gjendjen shëndetësore, i hodhi një sy motokompresorit që ndodhej pak më tej dhe doli jashtë.

— Po këta ç'janë? — pyeti ai, kur pa teknikun, Baudin Kazazin, me kokë të lidhur dhe dy nga minatorët e plagosur lehtë nëpër duar dhe në fytyrë.

Bame Toroja i shpjegoi se ata ishin plagosur gjatë përleshjes me Ramë Sheldinë.

— Aha, — ia bëri ai. — Të mbahet nën vërejtje ai maskara! — tha.

— E kemi siguruar mirë, — tha Bame Toroja, duke vështruar me bishtin e syrit nga Burhan Kola.

Sekretari politik ecte i zhytur në mendime.

— Mos harroni, — tha ai, — se këtu rreth e rrotull vërtiten banda diversantësh. Me sa jemi informuar, minierën tuaj e kanë vënë në shënjestër!

— Bame Toroja qeshi nën hundë.

Pas pak ata u ndalën në afërsi të pikës, nga ku do të kryhej shpërthimi. Ora ishte dhjetë e tridhjetë minuta. Tekniku, Baudin Kazazi, me kokën të lidhur, u afërua ngadalë pranë ushqyesit elektrik. Turma që kishte mbuluar tërë rrafshinën që zbardhte nga dëborë priste në anktë të dëgjonte jehonën e shpërthimit të parë të minierës së re të kromit.

Qëndruam një copë herë të gjatë në heshtje.

— Ta gëzoni minierën tuaj! — tha sekretari politik me zë solemn.

Bame Toroja ia bëri me kokë teknikut, Baudin Kazazit, i cili në sekondë rrotulloi dorezën metalike të ushqyesit elektrik. Përballë tyre u ngrit një re e madhe



tymi, që pas pak u shoqërua me një krismë shurdhuese. Kur kërpudha e tymit të zi filloi të shpërndahej, njerëzit vunë re se shkëmbi i lartë ishte rrafshuar. Në shpinën e malit të Kreshnikës ishte hapur një plagë e madhe. Jehona e shpërthimit u përplas në malet e larta që rrethonin si kurorë luginën e Kreshnikës, u kthye përsëri mbrapsht dhe pastaj u zhduk tutje nga Qafa e Humnerës. Të gjitha këto ndodhën në një minutë.

— Urra! — thirrën kreshnikasit të gëzuar pa masë.

— Fitore! — gjëmoi zëri i kreshnikasit shtatlartë.

— Fitore! — thirrën të gjithë njëzëri.

Pas pak platforma e Zonës A u mbulua nga zëra të gëzuar, të qeshura, biseda të pafund për kromin dhe të ardhmen e minierës. Shumica vrapuan drejt vendit ku sapo ishte kryer shpërthimi. Njërit prej atyre që po ktheheshin me copa minerali nëpër duar Bame Toroja i rrëmbeu një copë të madhe minerali, e puthi dhe ia dha sekretarit politik. Ai e pa duke e vërtitur i kënaqur nëpër duar dhe pastaj ia ktheu Bame Toros.

— Ta gëzoni minierën! — tha prapë ai dhe u përqaftua me shefin e ekspeditës, Kristaq Dvoranin.

Të tjerët i përshëndeti me dorë.

— Miniera jonë, — thirri papritur Bame Toroja, — do të quhet miniera «Fitorja».

— Urra! — thirrën të gjithë të pranishmit.

Njerëzit venin e vinin nëpër platformën e Zonës A. Ata ishin bërë dy e nga tre sipas dëshirës dhe kuvendnin me njëri-tjetrin të gëzuar. Dikush po vraponte për te ndërtesa e motokompresorit me një copë mineral në dorë. Ai hyri brenda dhe ia dha në dorë Martin Rekës.

— E pashë shpërthimin nga dritarja, — tha i gëzuar ai. — Ishte me të vërtetë një shpërthim i fuqishëm!

Vajzat vazhdonin të përqafoheshin te dera e motokompresorit, duke u shtrënguar pas njëra-tjetrës.

— Rroftë klasa jonë punëtore! — po thërriste kreshnikasi shtatlartë. Atë e kishin rrethuar dhjetë-pesëmbëdhjetë burra që gati sa s'po i merrnin frymën. — Rrofshin

edhe vajzat tona punëtoare! — thirri pas pak ai kur hodhi sytë nga dera e motokompresorit.

Tekniku, Baudin Kazazi ia afroi buzët te veshi dhe i pëshpëriti me ngadalë.

— E, si të duket? — i tha, duke i treguar vendin, ku pak më parë qëndronte në këmbë shkëmbi i lartë.

— Aha, tani u binda! — tha ai me zë të lartë. — Rroftë klasa jonë punëtoare! — vazhdonte të thërriste, duke tundur grushtin e tij të fuqishëm mbi kokat e njerëzve.

Pikërisht në këtë kohë po zbrisnin nga pyllnaja e mbuluar me dëborë disa ushtarë të forcave të ndjekjes. Midis tyre ecnin kokulur një grup diversantësh të arrestuar dhe me pranga në duar. I pari ishte Çuman Kokobogja, i cili, sapo zbriti mbi platformën e Zonës A, e ngadalësoi hapin e tij, duke vështruar i habitur turmën e njerëzve që kishte përpara. Reja e tymit ndodhej akoma pezull mbi zonën ku pak më parë ishte bërë shpërthimi.

— Ec, — i tha njëri nga ushtarët e ndjekjes, duke e shtyrë me tytën e automatikut.

Ai shqeu sytë e tij të përskuqur dhe me vështrimin të mbërthyer diku sipër nga Kreshta e Vdekjes, kaloi përmes turmës së njerëzve.

— Ç'njeri i poshtër! — tha dikush nga mezi i turmës.

— Edhe me pranga në duar nuk e ka ulur kokën maskarai! — tha një tjetër.

Ndryshe nga ai trimat e tij ecnin me kokën varur në gjoks dhe duke u dridhur pors i minj.

— Ç'maskara! — tha përsëri një zë andej nga fundi.

— Ky ishte një nga kriminelët më të rrezikshëm, që vërtitej nëpër rrethin tonë, — po u thoshte sekretari politik njerëzve që e rrethonin. — Banda e tij ishte e madhe; ajo përbëhej nga tridhjetë-dyzet veta, po u asgjësua pjesë-pjesë nga forcat e ndjekjes dhe nga populli. Këto ishin mbeturinat e saj të fundit! — theksoi më në fund, duke lënë të nënkuptohej se ai ishte në dijeni që më parë për kapjen dhe asgjësimin e plotë të saj.



Pas pak zbritën nga pyllnaja tre-katër kuaj të ngarkuar me kufoma. Në njërin prej tyre ishte hedhur trupi i njeriut me fytyrë të çakërdisur. Një plumb e kishte marrë atë mbi vetullën e djathtë prej nga vazhdonte të rridhte gjak. Koka e tij me leshra të pakrehura dhe mjekër të gjatë përplasej ritmikisht në vithet e kalit.

Bame Toroja u doli përpara dy ushtarakëve me uniformë oficeri.

— Ejani pak kënde! — u tha ai.

Ata vunë buzën në gaz, sepse nuk po e kuptonin se ç'donte të thoshte njeriu që kishin përpara.

— Ejani ju lutem! — tha prapë Bame Toroja me një pamje serioze në fytyrë.

Ata e ndoqën pas me një shprehje habie në fytyrë.

— Merreni edhe këtë maskara! — tha ai, kur mbërriti prapa ndërtesës së motokompresorit. — Është këlyshi i tyre, prandaj bashkojeni me ta dhe çojini gjëkund që të na plehërojnë tokën!

Ushtarakët me uniformë oficeri po vështronin të habitur njëri-tjetrin në sy, siç duket ngaqë nuk po e kuptonin se si qëndronte puna.

Ramë Sheldia ishte ngritur në këmbë dhe po dridhej nga frika.

— Merreni, merreni! — tha prapë Bame Toroja. — Ky surrat, — tha pas pak ai, duke zgjatur gishtin tregues në drejtim të tij, — u përpoq të hidhte në erë dhjetëra punonjës të minierës sonë të re, por shokët tanë vijilentë e kapën për zverku dhe ia shtypën turinjtë...

Ai vështroi nga tekniku, Baudin Kazazi, i cili ishte me kokë të lidhur, dhe pastaj nga dy minatorët e plagosur në fytyrë.

— Ja, edhe këto plagë, — tha Bame Toroja, — janë rezultat i veprës së tij të ndyrë. — Po të ishte koha e luftës, — shtoi pas pak ai, duke i zvarritur fjalët, — unë do ta kisha pushkatuar, m'u këtu, në sy të të gjithëve, po tani... jemi në pushtetin popullor... kështu që... le ta gjykojë gjyqi i popullit.

Sekretari politik vuri buzën në gaz. Dikush andej nga fundi qeshi nën hundë.

— Maskara!

Pas pak Ramë Sheldinë e bashkuan me grupin e diversantëve që ishin kapur të gjallë nga forcat e ndjekjes.

Ata morën rrugën që të çonte poshtë në kantierin e minierës së re të kromit, e cila tashmë mbante emrin «Fitorja».



## PRAPË ME HALLE TË MËDHA

Kishin njëzet minuta që po bisedonin me sekretarin politik para barakave të reja që ishin ngritur përbri ndërtesës së hanit të vjetër. Ai dukej shumë i kënaqur nga puna që ishte bërë gjatë atyre katër ditëve.

— Kjo është një gjë kolosale! — tha ai, duke hedhur sytë nga shefi i ekspeditës, Kristaq Dvorani, dhe pastaj nga Burhan Kola. — Kjo tregon... vitalitetin... — tha ai duke ngritur gishtin tregues në ajër, — flet... si të thuash... për forcën e pushtetit tonë popullor...

Bamë Toroja po e dëgjonte në heshtje e me një pamje të menduar në fytyrë.

— Sigurisht, — vijoi të thoshte ai, — ne jemi një vend i vogël... këtë nuk mund ta mohojmë... por... punën e bëjmë të madhe... sepse kemi në krye një Parti me të vërtetë sokoleshë... Arma jonë më e fortë është ideologjia marksiste-leniniste... ndaj..., armiqtë... cilëndo qofshin ata... s'kanë se çfarë të na bëjnë.

Ai fliste vazhdimisht duke i zvarritur fjalët, sikur të donte që t'ua ngulte ato sa më mirë në tru njerëzve që e rrethonin. Herë pas here ai u buzëqeshte atyre me dashamirësi.

— Po ju uroj edhe një herë, — u tha më në fund të pranishmëve. — Ta gëzoni minierën! Rriteni dhe stoliseni me duart tuaja!

Makina e tij u kthye në drejtim të qytetit, pasi si dukej do të merrte me vete të sëmurë që ishin më rëndë.

Njëri prej tyre ishte Martin Reka, i cili vazhdonte të ndiente ende dhimbje të forta në gjoks.

— Të shkuara! — u tha Bame Toroja.

— Të shkuara ju qofshin! — thanë edhe disa të tjerë.

— Pas një ore, — tha sekretari politik në çastin që po hipte në makinë, — unë do të kaloj përsëri kënde, pasi do të shkoj në Tiranë. Na thërresin për një mbledhje të jashtëzakonshme të plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

Si tha këto fjalë, heshti për një sekondë dhe mori një pamje të menduar në fytyrë. Ai donte të thoshte edhe diçka më tepër, po nuk e tha. E di unë, e di, mendoi Bame Toroja. Edhe tani, pas luftës, prapë me halle të mëdhaja është kjo Partia jonë! Po të mos ishte Enver Hoxha... murmuriti pothuajse me vete ai, kush e di se në ç'batak do të kishim rënë.

— Ah, po, — tha pas pak sekretari politik, duke u kthyer rrëmbimthi nga shefi i ekspeditës. — Doja të thosha se mbase nuk do të ishte keq që të vije edhe ti me mua. Pas dy-tri ditësh unë do të kthehem përsëri dhe, ndoshta me këtë rast të raportoje në ministri për gjendjen e minierës, t'u thoshe shokëve të dikasterit për ndonjë nevojë urgjente, siç është ajo çështja e teleferikut, dhe në të njëjtën kohë të shikoje edhe familjen, pasi, siç më kanë thënë, ke ikur në mënyrë krejt të papritur nga Tirana.

Sekretari politik po i buzëqeshte atij, duke pritur që ai të reagoje menjëherë. Por ndodhi e kundërta. Kristaq Dvorani u vrenjt në fytyrë, dhe, pasi ktheu kokën nga Bame Toroja, tha:

— Para dy ditësh Bame Toros, iu vra djali dhe... dje ...duhet të jetë varrosur... mirëpo...

Sekretarit politik i ngriu buzëqeshja menjëherë në fytyrë.

— Si?! — u habit ai. — Dhe ju po ma thoni tani këtë?!...

Ai mori menjëherë një pamje tepër serioze.



— Pse s'ke ikur? — i tha Bame Toros. — Ti duhej të ishe nisur menjëherë!

Bame Toroja uli kokën.

— Ishte kohë e keqe, — tha ai. — Rrugët ishin të bllokuara dhe... përveç kësaj...

— Mund të gjendej ndonjë rrugëzgjidhje, — tha vetëtimthi sekretari politik dhe pastaj pyeti se si kishte ndodhur.

Bame Toroja ia shpjegoi shkurt.

Ai e ngushëlloi me një dhimbje të madhe dhe pastaj i tha që të bëhej gati, se do të udhëtonin bashkë.

— Do të përpiqem që të nisemi edhe më shpejt, — i tha, kur po ulej në sedilje. — Ku e ke familjen?!

— Në Gjirokastër.

— Ashtu?! — i tha dhe, si u mendua pak, tha: — Do të të jap makinën time! Sonte do të jesh patjetër pranë familjes.

Ç'njeri i mrekullueshëm, tha me vete Bame Toroja. Qëndrimi i sekretarit politik e preku aq shumë sa që ai u mallëngjye pa masë. Për kuadro të tillë ka nevojë Partia, mendoi në çastin që makina u zhduk përtej në xhade pas një kodrine të mbuluar me dëborë.

Të sëmuret vazhdonin të përshëndesnin me dorë, ndërsa sekretari politik nuk po ia hiqte sytë kantierit të minierës së re të kromit.

## DRITAT E BUKURA TË KRYEQYTETIT

Margarita mbështeste zakonisht bërrylat mbi banak dhe sa herë që gjëmonte motori i ndonjë automobili nëpër rrugët e pazarit të vjetër, hidhte menjëherë vështrimin përjashta. Ajo kishte pesë ditë që s'e kishte parë të shoqin. Jashtë bënte shumë ftohtë. Temperatura, siç thoshte çdo mbrëmje spikeri i Radio Tiranës, po vinte çdo ditë duke u ulur. Jemi nën ndikimin e cikloneve të Evropës Qendrore, thoshin vazhdimisht njerëzit gjatë bisedave që bënin nëpër klube, në trotuare, në rrugëkryqe si dhe gjatë vizitave familjare. Çështja e klimës ishte në qendër të vëmendjes së njerëzve. Gjatë tri-katër ditëve të fundit në Tiranë kishte rënë një dëborë e imët, e cila nuk kishte arritur të zbardhte dot çatitë e shtëpive. Të ftohtët ishte mjaft i hidhur. Mali i Dajtit ishte ngarkuar me dëborë si asnjëherë tjetër.

Kushedi se ç'dëborë do të ketë rënë në malet e Kreshnikës, tha për të tretën herë me vete Margarita. Ajo sapo kishte dëgjuar lajmet e orës 18.00, ku, ndërmjet të tjerave, veshi i kishte zënë edhe një njoftim të shkurtër mbi shpërthimin e fuqishëm në minierën e re të Kreshnikës. Megjithëse altoparlanti që ndodhej diku në krahun e djathtë të librarisë, i varur mbi një shtyllë telefonike, kishte zë të çjerrë e nuk dëgjohej mirë, ajo kishte marrë vesh se shpërthimi kishte qenë i fuqishëm dhe, mbi të gjitha, ky sukses i madh, siç kishte thënë spikeri, ishte arritur në kushte shumë të vështira kli-



materike. Kushedi se ç'dëborë do të ketë rënë atje, tha prapë me vete ajo. Ajo kishte vënë një libër përpara mbi banak dhe përpiquej që të lexonte të paktën disa radhë. Por ishte e pamundur. Mendja i fluturonte tek i shoqi. Herë-herë kërkonte me sy midis kalimtarëve të shumtë shtatin e lartë të Kristaq Dvoranit, të veshur krejt me ngjyrë të murme. Ajo kishte njëfarë parandjenje se do të takohej së shpejti me të. Fatos Trebeshina e kishte siguruar se gjëja e parë që do t'i thoshte të shoqit sapo të mbërrinte në Kreshnikë ishte që ai të gjente mundësinë për të ardhur në Tiranë qoftë edhe për një natë. O, sa mirë do të jetë sikur ai... Ajo e kishte ndier shumë mungesën e tij. Nganjëherë i dukej se mund ta kalonte kohën edhe pa të, duke u marrë me punët e shtëpisë dhe me Rudinën e vogël, mirëpo... aty për aty e pushtonte një valë e pakuptueshme trishtimi. Ajo mundohej ta shpërndante vëmendjen gjetskë, merrte vajzën në krahë, e përkëdhelte, e puthte me gjithë shpirt dhe pastaj e vështronte drejt e në sy. Vocka e nënës, murmuriti me vete duke menduar se pikërisht tani vogëlushja priste në çerdhe që të shkonte ta merrte e ëma.

— Do të të mar ca gështenja të pjekura? — e pyeti Dimkë Teneqexhiu, i cili kishte kohë që po rrinte me ca shokë në trotuar.

— Jo, jo, — tha Margarita. — S'më hahet pothuajse asgjë.

— Mirë, si të duash, — tha Dimkë Teneqexhiu.

Ai kishte respekt të madh për Margaritën. Në mënyrë të veçantë pas takimit që kishte pasur me Kristaq Dvoranin ai s'dinte se ç'të bënte për ta kënaqur atë. I vinte shumë keq kur e shikonte ashtu të mërzhitur dhe të mbyllur në vetvete.

— Eja më mirë të ikim, — i tha ai prapë Margaritës. — Ora vajti shtatë pa pesë minuta.

Margarita vështroi sahatin e madh të qytetit që kishte përballë. Rrugicat e pazarit të vjetër gumëzhinin nga zërat. Ishin ndezur të gjitha dritat e vitrinave. Diku në krahun e majtë u dëgjua përsëri një gjëmim automobili që kaloi, si duket, nëpër një rrugicë tjetër në punën e vet.



Margaritën kishte filluar ta shqetësonte përherë e më shumë prania e tregtarit të peliçeve në dyqanin përballë. Sa herë që ajo mbyllte librarinë, ai dilte në trotuar dhe rrinte vështronte me ata sytë e tij të fryrë, derisa ajo largohej tutje nëpër rrugicat gjysmë të errëta të pazarit të vjetër. Ajo e kishte parë atë të kalonte ngandongëherë edhe nëpër rrugën «Mine Peza». Ngaqë e urrente me gjithë shpirt, bëhej tepër nervoze sa herë që i dilte përpara fytyra bullafiqe e Shemshedin Bërdëllimës.

Margarita i tha Dimkë Teneqexhiut që ta shoqëronte deri te çerdhja e fëmijëve. Ai nuk pati asnjë kundërshtim. Përkundrazi, iu bë qejfi që ajo po i kërkonte për herë të parë një ndihmë të tillë. Ata ndoqën rrugicën më të shkurtër që të nxirrte në sheshin «Skënderbej». Rrugët dhe trotuaret e gjera të kryeqytetit llamburrisnin nga dritat e forta, kurse vitrinat e dyqaneve që aty-këtu ruanin ende gjurmët e zbukurimeve të bëra me rastin e fushatës së zgjedhjeve, shkëlqenin si asnjëherë tjetër. Ata kaluan përmes sheshit «Skënderbej», u kthyen më të djathtë dhe kaluan para reklamave të kinemave. Në të gjitha kinematë e kryeqytetit vazhdonte të shfaqej filmi «Lenini në Tetor». Dimkë Teneqexhiu vështroi një copë herë reklamat. Trotuari para stendave gumëzhinte nga zërat. Margarita filloi të bëhej nervoze. Ajo i tha atij që të largoheshin prej andej. Pas pak u nisën drejt bulevardit «Stalin». Në atë drejtim, diku mbrapa maternitetit, ndodhej çerdhja e vetme e kryeqytetit. Kohët e fundit qenë hapur fjalë se në Tiranë do të hapeshin edhe tri-katër çerdhe të tjera në ato lagje, ku numri i fëmijëve ishte i madh. Dalngadalë, pa u kuptuar, ata e kishin lënë bulevardin dhe tani po ecnin nëpër një rrugicë të ngushtë tiranase, gjysmë të errët, me shtëpi të ulëta njëkatëshe anash. Më në fund ata dolën përballë një ndërtese dykatëshe. Kjo është çerdhja, tha Margarita. Aty është vocka e nënës që po pret ta marr. Ata hynë në oborrin e çerdhes. Dy plaka kuvendonin me njëra-tjetrën gati duke pëshpëritur vesh më vesh. Ajo filloi të ngjiste shkallët e gurta të verandës së bukur të



çerdhes, ndërsa Dimkë Teneqexhiu e ndiqte hap pas hapi në heshtje. Nëpër korridorët e pastra plot dritë të çerdhes lëviznin andej-këndeje edukatorët me bluzë të bardhë dhe prindërit apo të afërmit e fëmijëve, që prisnin me padurim të merrnin fëmijët. Margarita qëndroi në mes të korridorit me një buzëqeshje të ngrirë në fytyrë. Përbri saj u ndal në heshtje edhe Dimkë Teneqexhiu. Njerëzit lëviznin andej-këndeje pa folur me njëri-tjetrin. E, si ka qenë sot Rudina ime? pyeti me shenja nga larg një edukatore që u shfaq te dera gjysmë e hapur. Shumë mirë, ia ktheu ajo po me gjeste. Margarita tani dukej e qetë. Fytyra e saj ndriste nga një kënaqësi e brendshme. Për ta mbrojtur Rudinën nga të ftohtët, Margarita kishte marrë me vete në çantë edhe një peliçe. Do ta mbështjell mirë, do ta pushtoj në gjoks vockën e nënës, murmuriste me vete, që të mos e rrahë era, derisa ta çoj në shtëpi. Gjatë ditëve që i shoqi mungonte në shtëpi, ajo ishte munduar që ta plotësonte boshllëkun, duke u marrë me të bijën. E lante çdo mbrëmje dhe e ndërronte, duke e përkëdhelur porsì një kukull. Pastaj nënë e bijë shtrihe-shin të dyja në minder.

Njerëzit vazhdonin të prisnin në heshtje. Një fëmijë i rritur që, si dukej, kishte ardhur aty me prindërit a me të afërmit, kishte vënë hundën te xhami i lartë i dritareve të verandës dhe vështronte përjashta natën e errët. Margarita e vështrroi me dashamirësi. Ajo i afroi kokën te qafa dhe e pyeti me zë të ulët:

— Motrën apo vëllanë do të marrësh këtu?

Fëmija u turpërua, kafshoi buzët dhe, duke vështruar në të gjitha drejtimet, u mundua që t'i shmangej vështrimit të Margaritës.

— Motrën, — murmuriti me një gjysmë zëri vogëlushi i turpëruar.

Margarita e përqafoi nga prapa dhe e puthi në faqe. Ajo i donte shumë fëmijët.

— Të ka xhan teta, — i tha.

Fëmija i buzëqeshi, duke e parë drejt në sy me njëfarë druajtjeje.



Në këtë kohë në korridor u dëgjua papritur zëri i edukatores.

— Rudina! Ku janë prindërit e Rudinës? — pyeti ajo.

Margarita u vërsul në drejtim të dhomës së fëmijëve dhe e mori Rudinën në krahë.

Bashkë me Dimkë Teneqexhiun ata dolën jashtë në ajrin e ftohtë e plot lagështi. Vocka e nënës, murmurishte me vete Margarita, duke e mbështjellë atë sa më mirë. Një turmë njerëzish po kalonte në trotuarin para ndërtesës dykatëshe të çerdhes.

— Do të të çoj deri në shtëpi, — i tha Dimkë Teneqexhiu dhe shpejtoi hapin për të ecur përbri saj.

Ky gjest ia ngrohu zemrën Margaritës. Po sikur të mos ishte Dimkë Teneqexhiu, tha me vete ajo, kush do të më shoqëronte nëpër këtë natë të errët?

Pas pak ata dolën në bulevardin «Stalin». Nëpër vitrinat e larta të dyqaneve llamburisinin drita të forta shumëngjyrëshe. Njerëzit që lëviznin andej-këndej nëpër trotuare, i jepnin një gjallëri të jashtëzakonshme bulevardit të gjerë me një trotuar të drejtë midis. Dimkë Teneqexhiu vazhdonte të ecte në heshtje në krahun e majtë të Margaritës.

Për një copë herë të gjatë Margarita dhe Dimkë Teneqexhiu ecën nëpër disa rrugica të errëta, për të prerë sa më shkurt. Pas dhjetë minutash ata u ndodhën në rrugën «Mine Peza».

— Tani kthehu, — tha Margarita. — Shkoj vetë deri në shtëpi. Falemnderit.

— Jo, jo, — ia ktheu Dimkë Teneqexhiu. — Do të të çoj deri te porta.

Befas sytë e Margaritës u ndeshën me sytë e fryrë të tregtarit të peliçeve. Shemshedin Bërdëllima, i cili me një hap të rëndë të ngrirë kaloi atë çast pranë tyre. Ç'fytyrë e ndyrë, tha me vete Margarita, ndërsa po bëhej gati t'i thoshte «natën e mirë» Dimkë Teneqexhiut. Ajo ndjeu pikat e shiut në fytyrë.

Rruga «Mine Peza», si zakonisht, kishte gjallëri. Dikush po shtynte me shpejtësi një karrocë dore. Një gru-



mbull të rinjsh bënin shaka me njëri-tjetrin në trotuarin përballë, kurse në rrugën e Durrësit po kalonte një pajton. Troku i kuajve të pajtonëve që endeshin andej-këndej dëgjohej fare qartë dhe përhapej gjithandej në ambientet rreth e rrotull rrugës «Mine Peza».

Dimkë Teneqexhiu qëndroi në trotuar derisa Margarita filloi të ngjiste shkallët e gurta të ish-vilës së Veli beut. Ai hoqi kapelën dhe, si e tundi atë në ajër, u kthye mbrapsht dhe u largua në drejtimin nga kishte ardhur.

Oborri ishte i errët. Ndërkohë që ajo nxitoi të hapte derën e jashtme me duart që i dridheshin nga të ftohtët, ndjeu se dikush po ecte nëpër oborr. Ktheu kokën dhe atë çast iu duk se njeriu që po afrohej nëpër errësirë ishte i shoqi.

— Kristaq! — tha ajo me një gjysmë zëri.

Silueta që lëvizte nëpër gjysmëerrësirën e oborrit vazhdonte të afrohej në heshtje. Margarita ia bëri me dorë, po ai nuk reagoi.

— Kristaq! — thirri përsëri Margarita. — Ti je?

— Po, unë jam, — tha ai dhe i buzëqeshi nëpër errësirë.

— O, Kristaq! — tha prapë ajo. — Sa u tremba!

Asaj iu duk i dobësuar i shoqi. Ai buzëqeshi përsëri dhe pastaj tha:

— Ç'ke kështu?

— Oh, ti je? Sa u tremba!

— Ç'budallaqe që je.

Ajo u lëshua e tëra në gjoksin e tij; ai e pushtoi me të dyja duart dhe i puthi flokët ashtu siç e kishte zakon.

— Si është vajza? — e pyeti.

— Ja, siç e shikon, shumë mirë.

Rudina e vogël klithi papritur.

— Si duket të ka harruar, — i tha. — Është babi, moj, — i thoshte së bijës.

Vogëlushja klithi përsëri e trembur.

Kristaq Dvorani e mbuloi me të puthura. Pastaj e puthi edhe Margarita, e cila s'dinte se si ta shprehte ndryshe gëzimin e saj të papërmbajtur.

— Kristaq! — tha prapë. — Nuk e merr dot me mend se sa më ka marrë malli. Megjithëse nuk ka kaluar as një javë që nga dita që ti u nise për në Kreshnikë, më duket sikur kemi një kohë të gjatë që nuk jemi parë me njëri-tjetrin.

— Edhe mua kështu më është dukur, — i tha i shoqi.

Në çast ai ia afroi kokën në gjoksin e tij dhe i puthi flokët. Margaritës iu mbushën sytë me lot.

— Do të ikësh prapë? — i tha.

— Po.

— Kur?

— Pas dy ditësh.

— Do të vij edhe unë me ty. Nuk mund të rri më vetëm as edhe një minutë. A më kupton? As edhe një minutë të them!

Zëri i saj dukej tepër i mallëngjyer.

— Ashtu?! — tha Kristaqi.

— Po. Atje ku të jetosh ti, do të jetoj edhe unë bashkë me Rudinën e vogël.

Ai i puthi përsëri flokët.

— Mos u bëj merak, — i tha. — Së shpejti do të të marr me vete. Bisedova me ata të këshillit të fshatit dhe u thashë se kam një grua qaramane, që nuk ndahet dot prej meje. Ata nuk ma bënë fjalën dysh, më dhanë një dhomë provizorisht, kështu që...

— Vërtet?!

— Po.

— O, Kristaq! Sa e lumtur që jam! Kjo është një kënaqësi e vërtetë. S'e prisja një gjë të tillë.

Asaj iu mbushën përsëri sytë me lot nga gëzimi. Kishte njëfarë hutimi të çuditshëm në fytyrën e saj. Fshiu lotët dhe pastaj i buzëqeshi të shoqit.

Margarita e ndiente veten jashtëzakonisht të lumtur. Ajo hapi portën e jashtme dhe ata hynë brenda.

— Të është ngjirur pak zëri, — i tha të shoqit kur po kalonin nëpër korridor. — Siç duket, nga të ftohtët. Bënte shumë ftohtë, bënte?



— Si jo? Kreshnika ka klimë të fortë, por të shëndetshme.

— Sa mirë! — tha Margarita porsì fëmijë. — Ti e di që mua më pëlqen shumë dëbora!

Ngrohtësia e këtij takimi ia mbushi zemrën gjithë gëzim Kristaq Dvoranit. Kur shkoi dorën nëpër flokët e tij të shpupuritur, në ballë iu zbulua plagëza e vogël që i qe shkaktuar disa ditë më parë. Për një çast e pa veten të shtrirë në mes të pragut të derës së kuzhinës. Ai qeshi me vete dhe bashkë me të qeshi njëkohësisht edhe Margarita, së cilës iu kujtua menjëherë e njëjta skenë.

— Të shkuara, të harruara, — i tha.

Kristaq Dvorani tundi kokën dhe vuri prapë buzën në gaz. Ndërkohë Margarita e shtriu fëmijën mbi krevatin e vogël, ashtu siç e kishte, dhe e mbuloi me batanije, pastaj vuri menjëherë përparësen për të sajuar diçka për darkë. I shoqi hoqi kapotën e tij ushtarake dhe e vuri në varësen që ndodhej në korridor.

— Dukesh i lodhur, — i tha Margarita. — Do të të bëj një kafe?

— Po, — tha ai.

Ata nuk po ia ndanin sytë njëri-tjetrit.

— A është e bukur Kreshnika?

— Shumë, — tha ai dhe ia nguli përsëri sytë fytyrës së saj simpatike që ndriste e tëra nga një kënaqësi e brendshme.

Ata dukeshin tepër të lumtur.

1978 - 1979

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Një shënim i shkurtër .....	3

### DITA E PARË

Nëpër rrugët e kryeqytetit .....	7
Jeta në pazarin e vjetër .....	12
Hezitimet e Margaritës .....	23

### DITA E DYTË

Miniera e re e Kreshnikës .....	35
Kudo jetojnë njerëz .....	45
Në arkivin e ministrisë .....	52
Përgatitje për udhëtim .....	55

### DITA E TRETË

Drejt Kreshnikës së largët .....	61
Mysafirë në minierën «Ylli i kuq» .....	69
Ajri i pastër i bjeshkëve .....	79



	Faqe
Rruga me plot të papritura .....	83
Para se të fejoreshin .....	90
Qafa e Humnerës .....	94

### DITA E KATËRT

Hani i vjetër ndanë rrugës .....	101
Të mbështetemi në forcat tona .....	107
Lëvrijnë armiqtë e klasës .....	114
Gëzimi i kreshnikasve .....	120
Në të gjitha frontet .....	128
Linja e re telefonike .....	140
Në zjarrin e punës .....	143
Mbrëmja e parë në kantier .....	151

### DITA E PESTE

Agimi i ditës së re .....	161
Pranë motokompresorit .....	170
Në kullën e Ujkan Shkabës .....	175
Në gatishmëri numër një .....	179
Vëllezërit Ukcama .....	182
Kënga e barominave .....	185
Një bandë diversantësh .....	187
Dashuria ta merr mendjen .....	195
Një lajm i hidhur .....	198

### DITA E GJASHTË

Shqetësimet e Bame Toros .....	209
Te hyrja e shpellave .....	213
Në vend të Turabiut .....	230
Zemërimi i plakut Ujkan Shkaba .....	227

Baba Ali Çakmaxhiani .....	229
Në valën e punës .....	233
Nëpër pyllnajën me dëborë .....	236

### DITA E SHTATË

Zemërimi i kapedan Kokobogos .....	247
Një ditë e bukur më diell .....	251
Takimi me sekretarin politik .....	269
Duhet t'i durosh dhimbjet .....	275
Jehona e shpërthimit të parë .....	278
Prapë me halle të mëdha .....	283
Dritat e bukura të kryeqytetit .....	286